

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • NËNTOR 2018

Liahona

Fjalime në Konferencën e Përgjithshme

Jezu Krishti: Qendror
për Jetën Tonë dhe
Emrin e Kishës

Programi i Ri Mësimor
dhe Programi për të
Dielën Baraspeshojnë
Studimin e Ungjillit në
Shtëpi dhe në Kishë

Njoftohen 12 Tempuj
të Rinj





“Sonte unë ju nxit, me tërë shpresën e zemrës sime, që të luteni për t’i kuptuar dhuntitë tuaja shpirtërore – t’i lëvroni, përdorni dhe zgjeroni ato, madje më shumë nga sa keni bërë ndonjëherë. Ju do ta ndryshoni botën teksa e bëni këtë. . . .

Motrat e mia të dashura, ne kemi nevojë për ju! Ne kemi nevojë për forcën tuaj, kthimin tuaj në besim, bindjen tuaj, aftësinë tuaj për të udhëhequr, urtësinë tuaj dhe zërat tuaj’. Ne thjesht nuk mund ta mbledhim Izraelin pa ju.

Unë ju dua e ju falënderoj dhe tani ju bekoj me aftësinë që ta lini botën pas teksa jepni ndihmesë në këtë punë jetike dhe të ngutshme. Së bashku ne mund të bëjmë gjithçka që Ati ynë Qiellor ka nevojë që të bëjmë për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Birit të Tij të Dashur.”

Presidenti Rasëll M. Nelson, “Pjesëmarrja e Motrave në Mbledhjen e Izraelit”, f. 69, 70.

Plotësimi i Ciklit,
nga Jenedy Paige

Sesioni i Paradites të së Shtunës

- 6 **Fjalët e Hapjes**
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 8 **Kthim i Thellë dhe Afatgjatë në Besimin tek Ati Qiellor dhe Zoti Jezu Krisht**
Plaku Kuentin L. Kuk
- 12 **Ngrijeni Kokën dhe Gëzohuni**
Plaku M. Xhozef Brof
- 15 **Ngritja e Themelit të një Vepre të Madhe**
Plaku Stiven R. Bangerter
- 18 **Mos u Shqetësoni**
Plaku Ronald A. Rasband
- 21 **T'i Sjellim në një Krye të Vetëm, në Krishtin, të Gjitha Gjërat**
Plaku Dejvid A. Bednar
- 25 **E Vërteta dhe Plani**
Presidenti Dallin H. Ouks

Sesioni i Pasdites të së Shtunës

- 28 **Mbështetja e Drejtuesve të Kishës**
Presidenti Henri B. Ajring
- 30 **I Vendosur dhe i Paepur në Besimin të Krishti**
Plaku D. Tod Kristoferson
- 34 **Ejani, Dëgjojeni Zërin e Profetit**
Peshkopi Din M. Dejvis
- 37 **Një në . . . Krishtin**
Plaku Ulises Soares
- 40 **Zjarri Ynë i Kampit të Besimit**
Plaku Gerit W. Gong
- 43 **Të Gjithë Duhet të Marrin mbi Vete Emrin e Dhënë prej Atit**
Plaku Pol B. Pajper
- 46 **Beso, Duaj, Bëj**
Plaku Diter F. Uhtdorf

Sesioni i Përgjithshëm i Grave

- 50 **Për Të**
Xhoi D. Khons
- 52 **Pakënaqësia e Shenjtë**
Mishel D. Krejg
- 55 **Gëzimi i Shërbimit Vetëmohues**
Kristina B. Franko
- 58 **Gratë dhe të Mësuarit e Ungjillit në Shtëpi**
Presidenti Henri B. Ajring
- 61 **Prindërit dhe Fëmijët**
Presidenti Dallin H. Ouks
- 68 **Pjesëmarrja e Motrave në Mbledhjen e Izraelit**
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Paradites të së Dielës

- 71 **Vegimi i Shëlbimit të të Vdekurve**
Presidenti M. Rasëll Ballard
- 74 **Të Bëhesh Bari**
Boni H. Kordën
- 77 **Shërbesa e Pajtitimit**
Plaku Xhefri R. Holland
- 80 **Roli i Librit të Mormonit në Kthimin në Besim**
Plaku Shein M. Bouen
- 83 **Të Plagosur**
Plaku Nil L. Andersen
- 87 **Emri i Saktë i Kishës**
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Pasdites të së Dielës

- 90 **Përpiquni, Përpiquni, Përpiquni**
Presidenti Henri B. Ajring
- 93 **Ati**
Brajën K. Ashton
- 97 **Marrja mbi Vete e Emrit të Jezu Krishtit**
Plaku Robert C. Gei
- 101 **A Dëshiron të Shërohesh?**
Plaku Methju L. Carpenter
- 104 **Zgjidhni Sot**
Plaku Dejll G. Renland
- 107 **Tani Është Koha**
Plaku Xhek N. Xherard
- 110 **Kujdestaria si një Bari për Shpirtrat**
Plaku Geri E. Stivenson
- 113 **Të Bëhemi Shenjtorë Shembullorë të Ditëve të Mëvonshme**
Presidenti Rasëll M. Nelson

- 64 **Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 115 **Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë**
- 116 **Lajme të Kishës**
- 121 **Eja, Më Ndiq - Për Kuorumin e Pleqve dhe Shoqatën e Ndihmës**



Konferenca e Përgjithshme Gjysmëvjetoje e 188-të

Sesioni i Përgjithshëm i Paradites të së Shtunës, 6 Tetor 2018

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring
Lutja e hapjes: Plaku Krejg A. Kardon
Lutja e mbylljes:
Plaku Adilson de Paula Parreja
Muzika nga Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit]; Mak Uilbergu dhe Rajën Mërfi, drejtues; Brajën Matiasi dhe Riçard Elioti, organistë: "Udh'hiqna, O i Madh Jehova", *Himne*, nr. 40; "Mëngjesi Nis", *Himne*, nr. 1, përsh. Wilberg; "If I Listen with My Heart" ["Nëse me Zemër Dëgjo"], DeFord, përsh. Murphy; "Maj' Malit Atje Lart", *Himne*, nr. 5; "I Will Follow God's Plan" ["Do Ndjek Planin e Perëndis"], *Children's Songbook*, f. 164–165, përsh. Hofheins; "Eni Shenjtor", *Himne*, nr. 21, përsh. Wilberg.

Sesioni i Përgjithshëm i Pasdites të së Shtunës, 6 Tetor 2018

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks
Lutja e hapjes: Sheron Iubank
Lutja e mbylljes: Plaku Soni L. Koh
Muzika nga një kor i bashkuar nga Qendra e Trajnimit të Misionarëve në Provo; Rajën Egeti dhe Elmo Keku, drejtues; Linda Margetsi dhe Boni Gudlifi, organiste: "Dëgjoni Kombe!" *Himne*, nr. 171, përsh. Schank; potpuri këngësh: "I Will Be Valiant" ["Do të Jem Guximtar"], *Children's Songbook*, f. 162 dhe "The Church of Jesus Christ" ["Kisha e Jezu Krishtit"], *Children's Songbook*, f. 77, përsh. Warby; "Thirrur t'i Shërbejm", *Himne*, nr. 158; "Shpres' e Izraelit", *Himne*, nr. 166, përsh. Schank.

Sesioni i Përgjithshëm i Grave i Mbrëmjes të së Shtunës, 6 Tetor 2018

Drejtimi: Xhin B. Bingham
Lutja e hapjes: Memnet Lopez
Lutja e mbylljes: Xhenifer Fri
Muzika nga një kor i Të Rejave nga kunjet në Plezënd-Grouv të Jutës; Tresi Uerbi, drejtuese; Boni Gudlifi, organiste: "Eni, Ju F'mij të Zotit", *Himne*, nr. 30, përsh. Warby; "This Is the Christ" ["Ky Është Krishti"], Faust, Pinborough dhe Moody; "Tani Le t'Gëzojmë", *Himne*, nr. 3; "We'll Bring the World His Truth" ["T'Vërtetën t'Sjellim n'Bot'"], *Children's Songbook*, f. 172–173, përsh. Warby.

Sesioni i Përgjithshëm i Paradites të së Dielës, 7 Tetor 2018

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring
Lutja e hapjes: Plaku Alan F. Paker
Lutja e mbylljes: Plaku Donald L. Hallstrom
Muzika nga Tabernacle Choir [Kori i Tabernakullit]; Mak Uilbergu, drejtues; Riçard Elioti dhe Endrju Ansuorthi, organistë: "Gëzim, Zoti Është Mbret!" *Himne*, nr. 35; "Shëlbes i Izraelit", *Himne*, nr. 6, përsh. Wilberg; "T'Drejten Zgjidh", *Himne*, nr. 150, përsh. Wilberg; "T'Falemi, Per'ndi, për Profetin", *Himne*, nr. 13; "His Voice as the Sound" ["Zëri i Tij si Tingull"], këngë popullore amerikane, Walker, përsh. Wilberg; "It Is Well with My Soul" ["Është Mirë në Shpirtin Tim"], Spafford dhe Bliss, përsh. Wilberg.

Sesioni i Përgjithshëm i Pasdites të së Dielës, 7 Tetor 2018

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks
Lutja e hapjes: Plaku Geri B. Sebin
Lutja e mbylljes: Plaku Majkëll Xhon U. Teh
Muzika nga Tabernacle Choir [Kori i Tabernakullit]; Mak Uilbergu dhe Rajën Mërfi, drejtues; Endrju Ansuorthi dhe Brajën Matiasi, organistë: "In Hymns of Praise" ["Në Himne

Lavdërimi"], *Hymns*, nr. 75, përsh. Murphy; "Un' Besoj në Krisht", *Himne*, nr. 72, përsh. Wilberg; "Perëndis' Lart Lavdi", *Himne*, nr. 34; "Our Prayer to Thee" ["Lutja Jonë ndaj Teje"], Nelson dhe Parry, përsh. Wilberg.

Mundësohen Bisedat e Konferencës

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në internet në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org dhe përzgjidhni një nga gjuhët. Bisedat mundësohen gjithashtu në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit]. Informacion për konferencën e përgjithshme në formate të përdorshme nga anëtarë me paaftësi, mundësohet në faqen disability.lds.org.

Në Kapak

Përpara: *Ndriçoje Botën* (2015), nga Walter Rane, nuk lejohet kopjimi.
Prapa: Fotografi nga Cody Bell.

Fotografimi i Konferencës

Fotografitë në Solt-Lejk-Siti u bënë nga Cody Bell, Janae Bingham, Mason Coberly, Weston Colton, Brian Nicholson, Leslie Nilsson, Matt Reier dhe Christina Smith.



NËNTOR 2018 VËLLIMI 20 NR. 6

LIAHONA 14853 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, Henri B. Ajring

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong, Ulises Soares

Kryeredaktor: Randy D. Funk

Këshilltarë: Brian K. Ashton, Randall K. Bennett, Becky Craven, Sharon Eubank, Cristina B. Franco, Donald L. Hallstrom, Larry S. Kacher, Erich W. Kopischke, Lynn G. Robbins

Drejtor Përgjegjës: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loybrog

Përgjegjës i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Përgjegjës: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Përgjegjës: Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Francisca Olson

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Maryssa Dennis, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Lori Fuller, Garrett H. Garff, LaRene Porter Gaunt, Jon Ryan Jensen, Charlotte Larcabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Sally Johnson Odekirk, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Selu, Chakell Wardleigh, Marissa Widdison

Drejtor Përgjegjës i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Faqesjes: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, David Green, Colleen Hinkley, Eric P. Johnson, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Emily Chieko Remington, Mark W. Robison, Brad Teare, K. Nicole Walkenhorst

Bashkërenduese për Pronësinë Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Përgjegjëse e Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Julie Burdett, Thomas G. Cronin, Bryan W. Gygi, Ginny J. Nilson, Marissa M. Smith

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor Shtypi: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Troy R. Barker

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendër tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës

Paraqitimi dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fixhisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboksisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sllovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2018 nga Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion për të drejtën e autorit: Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga *Liahona* për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të drejtohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., FL 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

November 2018 Vol. 20 No. 6. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published six times a year (January, April, May, July, October, and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #4001743)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.



Treguesi i Folësve

Ajring, Henri B., 28, 58, 90
Andersen, Nil L., 83
Ashton, Brajën K., 93
Ballard, M. Rasëll, 71
Bangerter, Stiven R., 15
Bednar, Dejvid A., 21
Bouen, Shein M., 80
Brof, M. Xhozef, 12
Dejvis, Din M., 34
Franko, Kristina B., 55
Gei, Robert C., 97
Gong, Gerit W., 40
Holland, Xhefri R., 77
Karpenter, Methju L., 101
Kordën, Boni H., 74
Krejt, Mishel D., 52
Kristoferson, D. Tod, 30
Kuk, Kuentin L., 8
Nelson, Rasëll M., 6, 68, 87, 113
Ouks, Dallin H., 25, 61
Pajper, Pol B., 43
Rasband, Ronald A., 18
Renland, Dejll G., 104
Soares, Ulises, 37
Stivenson, Geri E., 110
Uhtdorf, Diter F., 46
Xherard, Xhek N., 107
Xhons, Xhoi D., 50

Treguesi Tematik

Aktivizimi, 110
Ati Qiellor, 25, 40, 93, 104
Besëlidhjet, 30, 43, 80, 107
Besimi, 6, 15, 18, 21, 25, 30, 40, 52, 83, 90, 104, 113
Bota e shpirtave, 71
Dashuria, 18, 37, 40, 46, 50, 55, 58, 61, 74, 77, 90, 93, 97, 110
Dashuria hyjnore, 55, 58, 90
Dëshmia, 80
Dishepullimi, 12, 43, 46, 52
Dhënia e shërbesës, 37, 40, 46, 50, 68, 74, 77, 97, 110
E vërteta, 25, 107
Ekzistenca para lindjes, 93
Emri i Kishës, 87, 113
Falja, 12, 77
Familja, 6, 8, 15, 25, 58, 61, 113
Fatqeqësia, 12, 18, 30, 46, 55, 71, 83, 101
Fëmijët, 15, 25, 61
Frika, 18, 101
Fryma e Shenjtë, 18, 43, 80, 93
Gëzimi, 12, 40, 46
Gjykimi, 97
Hiri, 40, 52, 97
Jezu Krishti, 6, 8, 12, 15, 18, 21, 25, 30, 34, 37, 40, 43, 46, 50, 52, 55, 58, 71, 74, 77, 80, 83, 87, 90, 93, 97, 101, 104, 107, 110, 113
Jozef Smithi, 34, 52, 80, 107
Këmbëngulja, 30, 83
Këndvështrimi, 68, 107
Krijimtaria, 40
Kthimi në besim, 8, 21, 30, 37, 80
Libri i Mormonit, 34, 68, 80
Liria e zgjedhjes, 25, 104
Lutja, 58
Mbajtja në aktivizim e të kthyerve në besim, 37
Mbledhja e Izraelit, 21, 68, 74, 80

Mbrëmja familjare, 8
Media, 68
Mëmësia, 58, 61, 68
Mësimdhënia, 15, 58, 68
Miqësia, 37, 74
Mirësia, 61
Natyra hyjnore, 68
Ndjekja e profetit, 34
Nxitjet, 52
Pagëzimi, 43
Pajtimi, 77
Paqja, 18, 77, 83
Pendimi, 25, 101, 104
Përndjekja, 83
Përpërsëtitë, 107
Përsosuria, 40
Plani i shpëtimit, 25, 61, 71, 93, 104
Prindërimi, 15, 61
Profetët, 18, 34
Programi mësimor, 6, 8, 113
Puna në tempull, 68, 113
Ringjallja, 71, 93
Rinia, 74
Rivendosja, 87
Sakramenti, 8, 43, 90
Sakrifica, 55
Sprovat, 83, 90
Studimi i shkrimeve të shenjtë, 8, 37, 58
Shabati, 8
Shembulli, 113
Shërbimi, 37, 40, 50, 52, 55, 74, 97
Shërimi, 46, 83, 97, 101
Shoqata e Ndhmës, 68
Shoqërimi, 37
Shpresa, 46, 90
Shtëpia, 6, 8, 15, 18, 21, 58, 113
Shtëpia e Izraelit, 68
Teknologjia, 61
Tempujt, 18, 34, 113
Traditat, 15
Të mësuarit, 58, 113
Vdekja, 71
Vlera individuale, 74, 97
Zbulesa, 18, 34, 80



Pjesë të spikatura nga Konferenca e Përgjithshme Gjysmëvjetrore e 188-të

Edhe një herë, ndryshime të mëdha u njoftuan në konferencën e përgjithshme. Ndonëse njoftimet këtë herë ishin të ndryshme, qëllimet pas tyre janë të njëjtat: Profeti i Perëndisë ndien një ngutje për të na përgatitur për Ardhjen e Dytë të Zotit dhe po na fton ta forcojmë besimin tonë tek Ati Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti.

Këtu janë vetëm disa ftesa dhe premtime kryesore që u theksuan nga Presidenti Rasëll M. Nelson gjatë konferencës.

Bëjeni Shtëpinë më të Shenjtë

Në fjalët e tij të hapjes, Presidenti Nelson paraqiti nevojën për të bërë ndryshime në jetën tonë që do t'i bëjnë shtëpitë tona qendrën e të mësuarit të ungjillit. “Është koha për një *Kishë të përqendruar te shtëpia*, të përkrahur nga ajo që ndodh brenda ndërtesave tona të degës, lagjes dhe kungjit.”

- Lexojini ndryshimet e sugjeruara në shtëpi dhe përshtatjet në kishë që i përkrahin ato (shih faqen 8).
- Gjeni informacion shtesë të “Ndryshimet Ndhimojnë për ta Baraspeshuar Udhëzimin për Ungjillin në Shtëpi dhe atij në Kishë” (faqe 117).

“Lëreni Botën Pas”

Presidenti Nelson i ftoi motrat në sesionin e përgjithshëm të grave që të marrin pjesë në “kauz[ën] më [të] madhe . . . në tokë sot”. Ai premtoi: “Së bashku ne mund të bëjmë gjithçka që Ati ynë Qiellor ka nevojë që të bëjmë për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të [Jezu Krishtit]”.

- Lexojini katër ftesat e Presidentit Nelson drejtuar motrave (shih faqen 68).

“Rivendoseni Emrin e Saktë të Kishës së Zotit”

Presidenti Nelson u bëri thirrje anëtarëve që ta quajnë Kishën e

Shpëtimtarit me emrin që i dha Shpëtimtari. “Ju premtoj që, nëse ne do të bëjmë më të mirën tonë për ta rivendosur emrin e saktë të Kishës së Zotit, Ai, Kisha e të cilit është kjo, do të derdhë fuqinë dhe bekimet e Tij mbi kokat e shenjtoreve të ditëve të mëvonshme, në mënyra të cilat ne nuk i kemi parë kurrë.”


- Lexojini udhëzimet e Presidentit Nelson për emrin e Kishës (shih faqen 87).

“Jini në Shtëpinë e Tij të Shenjtë”

Presidenti Nelson e mbylli konferencën me njoftimin e 12 tempujve të rinj dhe ftesën për “të qenë [rregullisht] në shtëpinë e Tij të shenjtë”. Ai tha: “Ju premtoj se Zoti do t'i sjellë mrekullitë që Ai e di se ju nevojiten teksa bëni sakrificat për të shërbyer dhe adhuruar në tempujt e Tij”.

- Shihni se ku do të jetë vendndodhja e tempujve të njoftuar (shih faqet 113, 116).





Nga Presidenti Rasëll M. Nelson


Fjalët e Hapjes

Është koha për një Kishë të përqendruar te shtëpia, të përkrahur nga ajo që ndodh brenda ndërtesave tona të degës, lagjes dhe kunjtit.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, e kemi pritur me padurim mbledhjen me ju sërish në këtë konferencë të përgjithshme të tetorit të Kishës. Ne i shprehim mirëseardhjen tonë të përzemërt secilit prej jush. Jemi thellësisht mirënjohës për lutjet tuaja mbështetëse! Mund ta ndiejmë ndikimin e tyre. Ju faleminderit!

Jemi mirënjohës për përpjekjet tuaja të jashtëzakonshme për të vepruar

sipas këshillës së dhënë në konferencën e përgjithshme gjashtë muaj më parë. Presidentat e kunjeve në mbarë botën kanë kërkuar zbuluesën e domosdoshme për të riorganizuar kuorumet e pleqve. Burrat e këtyre kuorumeve, bashkë me motrat tona të përkushtuara të Shoqatës së Ndhmës, po punojnë me zell për t'u dhënë shërbesë vëllezërve dhe motrave tona në një mënyrë më të lartë e më të shenjtë. Ne jemi



frymëzuar nga mirësia dhe përpjekjet tuaja të jashtëzakonshme për t'ua sjellë dashurinë e Shpëtimtarit familjeve, fqinjëve dhe miqve e mikeshave tuaja, si dhe për t'u dhënë shërbesë atyre ashtu siç do të bënte Ai.

Që nga koha e konferencës së prillit, Motra Nelson dhe unë jemi takuar me anëtarë në të katër kontinentet dhe në ishujt e detit. Nga Jerusalem në Harare, nga Uinipegu në Bangkok, ne e kemi përjetuar besimin tuaj të madh dhe forcën e dëshmive tuaja.

Jemi gëzuar tej mase nga numri i të rinjve dhe të rejave tona që janë bashkuar me batalionin e rinisë së Zotit për të ndihmuar në mbledhjen e Izraelit të



shpërndarë.¹ Ne ju falënderojmë! Teksa vazhdoni t'i ndiqni ftesat që unë bëra në takimin tonë shpirtëror mbarëbotëror për rininë, ju po vendosni një standard për ta ndjekur ne të tjerët. Dhe çfarë ndryshimi po sillni ju rinia!

Në vitet e fundit, ne, në këshillat kryesuese të Kishës, kemi punuar për t'i dhënë përgjigje një pyetjeje themelore: Në ç'mënyrë mund t'i çojmë ungujllin, në pastërtinë e tij të thjeshtë, dhe ordinancat, me efektshmërinë e tyre të përjetshme, tek *të gjithë* fëmijët e Perëndisë?

Si shenjtore të ditëve të mëvonshme, jemi mësuar ta mendojmë "kishën" si diçka që ndodh në shtëpitë

tona të mbledhjeve, e përkrahur nga ajo që ndodh në shtëpi. Kemi nevojë për një përshtatje të këtij modeli. Është koha për një *Kishë të përqendruar te shtëpia*, të përkrahur nga ajo që ndodh brenda ndërtesave tona të degës, lagjes dhe kunjit.

Teksa Kisha vazhdon të zgjerohet në mbarë botën, shumë anëtarë jetojnë atje ku nuk kemi godina kishtarë – dhe mund të mos kemi për një të ardhme të afërt. Më kujtohet një familje, pjesëtarëve të së cilës, për shkak të rrethanave të tilla, u kërkohet të mbledheshin në shtëpinë e tyre. E pyeta nënën se sa i pëlqente të shkonte në kishë në vetë shtëpinë e saj. Ajo u përgjigj: "Më

pëlqen! Bashkëshorti im tani përdor fjalor më të mirë në shtëpi, duke e ditur se ai do ta bekojë sakramentin këtu çdo të diel."

Qëllimi afatgjatë i Kishës është t'u japë ndihmesë të gjithë anëtarëve që ta rritin besimin e tyre te Zoti ynë Jezu Krishti dhe te Shlyerja e Tij, t'u japë ndihmesë atyre për t'i bërë dhe mbajtur besëlidhjet e tyre me Perëndinë, si dhe për t'i forcuar dhe vulosur familjet e tyre. Në këtë botë të ndërlikuar sot, kjo nuk është e lehtë. Kundërshtari po i rrit sulmet e tij mbi besimin dhe mbi ne dhe familjet tona me një shkallë eksponenci-ale. Që të mbijetojmë shpirtërisht, kemi nevojë për strategji kundërvepruese dhe

plane paravepruese. Në përputhje me këtë, tani ne dëshirojmë të vëmë në zbatim disa përshtatje organizative që do t'i forcojnë më shumë anëtarët tanë dhe familjet e tyre.

Për shumë vite, udhëheqësit e Kishës kanë punuar për një program mësimor të harmonizuar për t'i forcuar familjet dhe individët nëpërmjet një plani të *përqendruar te shtëpia* dhe të *përkrahur nga Kisha* për ta mësuar doktrinën, forcuar besimin dhe nxitur një adhurim vetjak më të madh. Për-pjekjet tona gjatë këtyre viteve të fundit për ta shenjtëruar Shabatin – për ta bërë atë një kënaqësi dhe një shenjë vetjake ndaj Perëndisë të dashurisë sonë për Të – do të shtohen nga përshtatjet që do të paraqitim tani.

Këtë mëngjes, do të njoftojmë një baraspeshë dhe një lidhje të re mes udhëzimit për ungjillin në shtëpi dhe atij në Kishë. Secili prej nesh është përgjegjës për rritjen tonë shpirtërore vetjake. Dhe shkrimet e shenjta e bëjnë të qartë se prindërit e kanë përgjegjësinë parësore për t'ua dhënë mësim doktrinën fëmijëve të tyre.² Është përgjegjësia e Kishës që t'i japë ndihmesë çdo anëtar/eje për synimin e përkufizuar hyjnisht për rritje të njohurisë së tij apo të saj në ungjill.

Plaku Kuentin L. Kuk do t'i shpjegojë tani këto përshtatje të rëndësishme. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve janë të bashkuar në miratimin e këtij mesazhi. Me mirënjohje falënderojmë për frymëzimin nga Zoti që ka pasur ndikim në zhvillimin e planeve dhe procedurave që do të paraqitë Plaku Kuk.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë e di se Perëndia jeton! Jezusi është Krishti! Kjo është Kisha e Tij dhe Ai e drejton nëpërmjet profecisë dhe zbulesës ndaj shërbëtorëve të Tij të përlulur. Unë dëshmoj kështu, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Rasëll M. Nelson dhe Uendi W. Nelson, "Shpresa e Izraelit" (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), Hopeofisrael.lds.org.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 93:40; Moisiu 6:58–62.



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kthim i Thellë dhe Afatgjatë në Besimin tek Ati Qiellor dhe Zoti Jezu Krisht

Qëllimi ynë është t'i baraspeshojmë përvorjet në Kishë dhe në shtëpi në një mënyrë që do ta rritë shumë besimin e shpirtshmërinë dhe do ta thellojë kthimin në besim.

Sic e ka paraqitur bukur dhe qartë Presidenti Rasëll M. Nelson, udhëheqësit e Kishës për një kohë të gjatë kanë qenë duke punuar për "një plan të *përqendruar te shtëpia* dhe të *përkrahur nga Kisha* për ta mësuar doktrinën, forcuar besimin dhe nxitur një adhurim vetjak më të madh". Presidenti Nelson më pas shpalli një përshtatje për të arritur "një baraspeshë dhe një lidhje të re mes udhëzimit për ungjillin në shtëpi dhe atij në Kishë"¹.

Për t'i arritur këto qëllime – të përshkuara nga Presidenti Rasëll M. Nelson dhe nën drejtimin e tij, dhe në pajtim me vendimin e Këshillit të Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve – orari i mbledhjeve të së dielës do të përshtatet në mënyrat vijuese, duke filluar në janar 2019.

Orari i Mbledhjeve të së Dielës

Mbledhjet e Kishës të dielën do të përbëhen çdo të diel nga një mbledhje sakramenti 60-minutëshe, e përqendruar te Shpëtimtari, tek ordianca e sakramentit dhe mesazhe shpirtërore. Pas kohës për kalimin nëpër klasa, anëtarët e Kishës do të frekuentojnë një orë mësimore 50-minutëshe që do të alternohet me radhë çdo të diel:

- Shkolla e së Dielës do të mbahet në të dielat e para dhe të treta të muajit.
- Mbledhjet e kuorumeve të Priftërisë, të Shoqatës së Ndihmës dhe të Të Rejave do të mbahen në të dielat e dyta dhe të katërta.
- Mbledhjet në të dielën e pestë do të jenë nën drejtimin e peshkopit.

Fillorja do të mbahet çdo javë gjatë së njëjtës periudhe 50-minutëshe dhe



do të përfshijë kohën e të kënduarit dhe orët mësimore.

Në lidhje me orarin e mbledhjeve të së dielës, udhëheqësit kryesues të Kishës kanë qenë të vetëdijshëm për shumë vite që, për disa prej anëtarëve tanë të shtrenjtë, mund të jetë i vështirë një orar prej tri orësh i të dielës në kishë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për prindërit me fëmijë të vegjël, fëmijët e Fillores, anëtarët e moshuar, të kthyerit e rinj në besim dhe njerëz të tjerë.²

Por ka shumë më tepër në këtë përshtatje sesa thjesht shkurtimi i orarit të së dielës në shtëpinë e mbledhjeve. Presidenti Nelson ka vënë në dukje me mirënjohje se sa shumë po arrihet si rrjedhojë e besnikërisë suaj ndaj ftesave të mëparshme. Ai dhe e gjithë udhëheqja e Kishës dëshirojnë t'u sjellin gëzim më të madh për ungjillin prindërve, fëmijëve, rinisë, beqarëve, të moshuarve, të kthyerve të rinj në besim dhe atyre njerëzve që misionarët po u japin mësim – nëpërmjet një përpjekjeje të baraspeshuar, të përqendruar te shtëpia dhe të përkrahur nga Kisha. Qëllimet dhe bekimet e lidhura me këtë përshtatje dhe ndryshimet e tjera të kohëve të fundit përfshijnë sa vijojnë:

- Thellimin e kthimit në besim tek Ati Qiellor dhe Zoti Jezu Krisht, si dhe forcimin e besimit tek Ata.

- Forcimin e individëve dhe të familjeve nëpërmjet një programi mësimor të përqendruar te shtëpia dhe të përkrahur nga Kisha, i cili kontribuon në të jetuarit plot gëzim të ungjillit.
- Nderimin e ditës së Shabatit, me një përqendrim tek ordianca e sakramentit.
- Të ndihmuarit e të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor në të dyja anët e velit nëpërmjet punës misionare dhe marrjes së ordiancave, besëlidhjeve dhe bekimeve të tempullit.

Të Mësuarit e Ungjillit të Përqendruar te Shtëpia dhe të Përkrahur nga Kisha

Ky orar i së dielës lejon më shumë kohë për një mbrëmje në shtëpi dhe për ta studiuar ungjillin në shtëpi të dielën, ose në kohë të tjera siç mund ta zgjedhin individët dhe familjet. Një natë veprimtarie familjare mund të mbahet të hënën ose në kohë të tjera. Për këtë arsye, udhëheqësit duhet të vazhdojnë t'i mbajnë mbrëmjet e të hënave pa mbledhje dhe pa veprimtari të Kishës. Gjithsesi, koha e harxhuar në mbrëmjet e shtëpisë, në studimin e ungjillit dhe veprimtaritë për individët e familjet mund të organizohet në përputhje me rrethanat e tyre individuale.

Studimi i ungjillit në shtëpi si familje dhe individë do të rritet dukshëm nëpërmjet një programi të harmonizuar

mësimor dhe një materiali të ri burimor, *Eja, Më Ndiq* për individët dhe familjet, që bashkërendohet me atë që jepet mësim në Shkollën e së Dielës dhe në Fillore.³ Në janar klasat e Shkollës të së Dielës për të rinjtë e të rriturit dhe klasat e Fillores në Kishë do të studiojnë Dhiatën e Re. Materiali i ri burimor për studimin në shtëpi, *Eja, Më Ndiq* për individët dhe familjet – i cili trajton gjithashtu Dhiatën e Re – është hartuar që t'i ndihmojë anëtarët ta mësojnë ungjillin në shtëpi. Ai shpjegon: “Ky material burimor është për çdo individ dhe familje në Kishë. Ai është hartuar që [të na] ndihmojë ta mësojmë ungjillin – qoftë më vete ose me familjen [tonë]. . . . Përvijimet mësimore në këtë material [të ri] burimor organizohen në përputhje me një program . . . të përjavshëm.”⁴

Mësimet e reja nga *Eja, Më Ndiq* për Filloren, të dhëna mësim në kishë, do të ndjekin të njëjtin program të përjavshëm. Klasat e Shkollës të së Dielës për të rriturit dhe rininë në të dielat e para dhe të treta do të bashkërendohen që ta përkrahin materialin e ri burimor të shtëpisë *Eja, Më Ndiq*. Në të dielat e dyta dhe të katërta, të rriturit e priftërisë dhe të Shoqatës së Ndhmës do të vazhdojnë të studiojnë mësimet e udhëheqësve të Kishës, me theks te mesazhet e kohëve të fundit nga



profetët bashkëkohorë.⁵ Të rejtat dhe të rinjtë e Priftërisë Aarone do të studiojnë tema të ungjillit në ato të diela.

Materiali i ri burimor për studimin në shtëpi siguron “Ide për Studimin Familjar të Shkrimeve të Shenjta dhe për Mbrëmjen Familjare”⁶. Përvijimet e mësimave për secilën javë përmbajnë ide studimi dhe veprimtari të dobishme për individët e familjet. Materiali burimor *Eja, Më Ndiq* për individët dhe familjet gjithashtu ka shumë ilustrime, që do të ndihmojnë për ta rritur të mësuarit si individë dhe familje, veçanërisht për fëmijët.⁷ Ky burim i ri do t’i sigurohet çdo vatre familjare brenda dhjetorit të këtij viti.

Presidenti Nelson, duke filluar nga fjalimi i tij fillestar drejtuar anëtarëve të Kishës në janar, na ka nxitur që të përgatitemi për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit duke ecur në shtegun e besëlidhjeve.⁸

Kushtet në botë kërkojnë gjithnjë e më shumë thellimin e kthimit të individit në besim dhe forcimin e besimit tek Ati Qiellor, te Jezu Krishti dhe te Shlyerja e Tij. Zoti na ka përgatitur, rresht pas rreshti, për kohët e rrezikshme me të cilat përballemi tani. Në vitet e fundit, Zoti na ka udhërrëfyer që t’u drejtohe mi shqetësimeve thelbësore që lidhen me to, duke përfshirë:

- Nderimin e ditës së Shabatit dhe të ordinancës së shenjtë të sakramentit, që është theksuar përsëri për tre vitet e fundit.

- Nën drejtimin e peshkopit, kuoromet e forcuarat të pleqve dhe Shoqatat e Ndihmës përqendrohen te qëllimi dhe përgjegjësitë e caktuara në mënyrë hyjnore të Kishës⁹ dhe te të ndihmuarit e anëtarëve që të bëjnë e të mbajnë besëlidhje të shenjta.
- Dhënia e shërbesës në një mënyrë më të lartë e më të shenjtë po përveçtesohet plot gëzim.
- Duke e pasur në mendje që nga fillimi qëllimin përfundimtar, besëlidhjet e tempullit dhe shërbimi për historinë familjare po bëhen një pjesë plot qëllim e shtegut të besëlidhjeve.

Përshtatja e shpallur këtë mëngjes është edhe një shembull tjetër i udhërrëfimit për sfidat e kohës sonë.

Programi mësimor tradicional i Kishës ka theksuar përvojën e Kishës të dielën. Ne e dimë se kur kemi mësimdhënie më të mirë dhe anëtarë të klasës më të përgatitur shpirtërisht, ne kemi një përvojë më të mirë të Kishës të dielën. Ne bekohemi që shpesh Shpirti e rritur dhe e forcon kthimin në besim në mjedisin e Kishës.

Programi i ri mësimor, i përqendruar te shtëpia dhe i përkrahur nga Kisha nevojitet që ta ndikojë më fuqishëm bindjen e sjelljen fetare si familje dhe bindjen e sjelljen fetare si person. Ne e dimë ndikimin shpirtëror dhe kthimin e thellë dhe afatgjatë në besim që mund të arrihet në mjedisin e shtëpisë. Vite më parë, një studim nxori si përfundim se për të rinjtë dhe të rejtat ndikimi i Frymës së Shenjtë më së shpeshti shoqëron studimin e shkrimeve të shenjta dhe lutjen individuale në shtëpi. Qëllimi ynë është t’i baraspeshojmë përvojat në Kishë dhe në shtëpi në një mënyrë që do ta rritë shumë besimin e shpirtshmërinë dhe do ta thellojë kthimin në besim tek Ati Qiellor dhe Zoti Jezu Krisht.

Në pjesën e përqendruar te shtëpia dhe të përkrahur nga Kisha të kësaj përshtatjeje, ka mundësi ndryshimi për secilin individ dhe secilën familje që të vendosë me lutje se si dhe kur do të vihet në jetë ajo. Për shembull, ndërkohe që kjo do t’i bekojë shumë të gjitha

familjet, nisur nga nevojat vendore, do të jetë tërësisht e përshtatshme për të rinjtë beqarë, të rriturit e pamartuar, prindërit e vetëm, familjet pjesërisht anëtare, anëtarët e rinj¹⁰ dhe njerëz të tjerë që të mbledhen në grupe, veç shërbimeve të zakonshme të adhurimit të dielën, për t’u kënaqur me shoqërimin së bashku në ungjill dhe për t’u forcuar duke studiuar së bashku materialin burimor të përqendruar te shtëpia dhe të përkrahur nga Kisha. Kjo do të arrihet në mënyrë joformale nga ata që e dëshirojnë këtë gjë.

Në shumë vende të botës, njerëzit zgjedhin që të qëndrojnë në shtëpinë e mbledhjeve pas orarit të zakonshëm të së dielës që të gëzohen në shoqërinë e njëri-tjetrit. Nuk ka asgjë në këtë përshtatje të shpallur që do të ndërhynte në ndonjë mënyrë me këtë praktikë të mrekullueshme dhe shpërblyese.

Që t’i ndihmojnë anëtarët të përgatiten për Shabatit, disa lagje tashmë dërgojnë në mesjavë një mesazh informues me postë elektronike, telefon celular ose mediat shoqërore. Duke marrë parasysh këtë përshtatje, ne e rekomandojmë fuqishëm këtë lloj komunikimi. Këto ftesa do t’i kujtojnë anëtarët për orarin e mbledhjeve të së dielës për atë javë, përfshirë temën e ardhshme të orës mësimore, dhe do ta përkrahin bashkëbisedimin e vazhdueshëm për ungjillin në shtëpi. Përveç kësaj, mbledhjet e të rriturve të dielën do të sigurojnë edhe informacion për të krijuar lidhje midis studimit në kishë dhe në shtëpi çdo javë.

Mbledhja e sakramentit dhe periudha e orës mësimore do të kërkojnë shqyrtim plot lutje për t’u siguruar që përparësitë shpirtërore theksohen mbi funksionet administrative. Për shembull, për pjesën më të madhe, lajmërimet mund të kryhen në ftesën e mesjavës ose me një program të shtypur. Ndërkohe që mbledhja e sakramentit duhet të ketë një lutje të hapjes dhe të mbylljes, mbledhja e dytë nevojitet të ketë vetëm një lutje të mbylljes.¹¹

Siç u përmend më lart, orari i ri i së dielës nuk do të fillojë para janarit 2019. Ka disa arsye për këtë. Dy arsye të më të rëndësishme janë: së pari, të

kemi kohë për të shpërndarë materialin burimor *Eja, Më Ndiq* për individët dhe familjet, dhe së dyti, të lejojmë kohë për presidentët e kunejeve dhe peshkopët që t'i përshtatin oraret e mbledhjeve me synimin që më shumë lagje të mblidhen më herët gjatë ditës.

Ndërkohë që udhëheqësit kanë kërkuar zbuluesë, udhërrëfimi i marrë gjatë disa viteve të fundit është që ta forcojmë mbledhjen e sakramentit, ta nderojmë ditën e Shabatit dhe t'i nxitin e ndihmojmë prindërit dhe individët që t'i bëjnë shtëpitë e tyre një burim force shpirtërore dhe besimi të shtuar – një vend gëzimi e lumturie.

Bekime të Jashtëzakonshme

Çfarë domethënie kanë këto përshtatje për anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme? Jemi të sigurt që anëtarët do të bekohen në mënyra të jashtëzakonshme. E diela mund të jetë një ditë e të mësuarit dhe e mësimdhënies së ungjillit në kishë dhe në shtëpi. Teksa individët dhe familjet përfshihen në këshillat familjare, në historinë familjare, dhënien e shërbesës, shërbimin, adhurimin vetjak dhe kohën e gëzueshme familjare, dita e Shabatit do të jetë me të vërtetë një kënaqësi.

Pjesëtarët e një familjeje nga Brazili janë anëtarë të një kunji ku u vu në provë materiali i ri burimor i shtëpisë *Eja, Më Ndiq*. Babai, Fernandoja, një misionar i kthyer, i cili me bashkëshorten e tij, Nensin, janë prindër të katër fëmijëve të vegjël, raportoi: "Kur programi *Eja, Më Ndiq* iu paraqit kunjit tonë, isha kaq i emocionuar dhe mendova se 'do të ndryshojë mënyra se si i studiojmë shkrimet e shenjta në shtëpi'. Kjo vërtet ndodhi në shtëpinë time dhe si udhëheqës në Kishë pashë se ndodhi edhe në shtëpi të tjera. . . . Na ndihmoi vërtet që t'i diskutojmë shkrimet e shenjta në shtëpinë tonë. Bashkëshortja ime dhe unë patëm një kuptueshmëri më të thellë rreth temës që studiojmë. . . . Ajo na ndihmoi . . . që ta zgjeruam njohurinë tonë për ungjillin dhe ta rritnim besimin e dëshminë tonë. . . . Jap dëshminë time . . . që e di se ishte e frymëzuar nga Zoti në mënyrë që



studimi i vazhdueshëm dhe i efektshëm i parimeve dhe doktrinave që përmbahen në shkrimet e shenjta, t'u sjellë më shumë besim, dëshmi e dritë familjeve . . . në një botë gjithnjë e më të rënë."¹²

Në kunjat anembanë botës ku u bë provë, pati një përgjigje shumë të favorshme ndaj materialit të ri burimor të shtëpisë *Eja, Më Ndiq*. Shumë veta raportuan se përparuan nga leximi i shkrimeve të shenjta drejt studimit me të vërtetë të shkrimeve të shenjta. Gjithashtu përgjithësisht u ndie se përvoja ishte besimnxitëse dhe pati një ndikim të mrekullueshëm mbi lagjen.¹³

Kthim i Thellë dhe Afatgjatë në Besim

Synimi i këtyre përshtatjeve është të arrihet një kthim i thellë dhe afatgjatë në besim për të rriturit dhe brezin e ri. Faqja e parë e materialit burimor për individët dhe familjet vë në dukje: "Qëllimi i tërë mësimit dhe mësimdhënies së ungjillit është që ta forcojnë kthimin tonë në besim dhe të na ndihmojnë të bëhemi më shumë si Jezu Krishti. . . . Kjo do të thotë të mbështetemi te Krishti për t[a] ndryshuar zemrën tonë."¹⁴ Kjo ndihmohet nëpërmjet shtrirjes "përtej një mjedisi të klasës deri brenda zemrës dhe shtëpisë së një individi. Ai kërkon përpjekje të vazhdueshme, të përditshme për ta kuptuar dhe jetuar ungjillin. Kthimi i vërtetë në besim kërkon ndikimin e Frymës së Shenjtë."¹⁵

Synimi më i rëndësishëm dhe bekimi përfundimtar i kthimit të thellë dhe afatgjatë në besim është marrja me denjësi e besëlidhjeve dhe ordinancave të shtegut të besëlidhjeve.¹⁶

Ne kemi besim se ju do të këshilloheni së bashku dhe do të kërkoni zbuluesë për vënien në zbatim të këtyre përshtatjeve – ndërkohë që nuk shihni përtej shenjës ose përpiqeni të diktoni se çfarë duhet të bëjnë individët ose familjet. Informacion shtesë do të jepet në komunikimet e ardhshme, përfshirë një letër të Presidencës së Parë dhe një material të bashkëngjitur.

Unë ju dëshmoj se në diskutimet e Këshillit të Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve në tempull dhe pasi profeti ynë i dashur i bëri kërkesë Zotit për zbuluesë që të ecnim përpara me këto përshtatje, u mor një pohim i fuqishëm nga të gjithë. Rasëll M. Nelsoni është Presidenti dhe profeti ynë i gjallë. Shpalljet e bëra sot do të çojnë në bekime të thella për ata që i përqafojnë me entuziazëm përshtatjet dhe e kërkojnë udhërrëfimin e Frymës së Shenjtë. Ne do t'u afrohem më shumë Atit tonë Qiellor dhe Zotit e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, për të cilin unë jam një dëshmitar i sigurt. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, "Fjalët e Hapjes", *Liahona*, nëntor 2018, f. 6.
2. Gjithashtu jemi të vetëdijshëm që, në

shoqërinë në tërësi, shumica më e madhe e ngjarjeve për informim, edukim dhe madje argëtim janë shkurtuar në mënyrë të dukshme.

3. Ky program mësimor do të jetë i disponueshëm në formë dixhitale dhe të shtypur.
4. *Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet* (2019), f. vi.
5. Shih “Eja, Më Ndiq – Për Kuorumin e Pleqve dhe Shoqatën e Ndhmës”, *Liahona*, maj 2018, f. 140. Në vend të të dielave të dyta dhe të treta, mesazhet nga konferenca të përgjithshme do të diskutohen në të dielat e dyta dhe të katërta.
6. Shih *Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet*, f. 4. Individët dhe familjet vendosin se çfarë pjese të studimit të ungjillit në shtëpi, të mbrëmjes familjare dhe veprimtarive familjare do të jetë pjesë e mbrëmjes familjare të shtëpisë (të cilën shumë veta tashmë e quajnë *mbrëmja e shtëpisë*). Ngaqë individët dhe familjet do ta marrin këtë vendim, *mbrëmja e shtëpisë* dhe *mbrëmja familjare e shtëpisë* janë përdorur në mënyrë të ndërthurur në përshtatjet që janë shpallur.
7. Shih *Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet*, f. 29.
8. Shih Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 7.
9. Shih *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 2.2. Përgjegjësitë e caktuara në mënyrë hyjnore “përfshijnë ndihmën për anëtarët që të jetojnë ungjillin e Jezu Krishtit, mbledhjen e Izraelit nëpërmjet punës misionare, përkujdesjen për të varfrit e nevojtarët dhe mundësimin e shpëtimin për të vdekurit duke ndërtuar tempuj dhe duke kryer ordinanca mëkëmbëse”. Shih edhe Doktrina e Besëlidhje 110, që përmban tregimin e rivendosjes së gelësave thelbësorë.
10. Kushtojuni vëmendje të veçantë atyre fëmijëve prindërit e të cilëve nuk janë anëtarë ose nuk e frekuentojnë rregullisht kishën. Beqarët ose njerëz të tjerë gjithashtu mund të takohen me një familje nëse kjo është e dobishme për të gjithë njerëzit e përfshirë.
11. Ushtrimet e hapjes normalisht nuk do të jenë pjesë e mbledhjes së dytë.
12. Familja e Fernando dhe Nensi de Karvalhos, në Brazil.
13. Individët dhe familjet që u përfshinë në grupin e provës, mesatarisht e studiuin ungjillin më shpesh dhe patën studim më kuptimplotë të shkrimeve të shenja dhe diskutime më kuptimplota për ungjillin në shtëpi. Ata raportuan se kishin më shumë diskutime joformale për ungjillin me familjen dhe anëtarët e lagjes, dhe e panë me vlerë studimin e të njëjtit bllok të shkrimeve të shenja si edhe familjet e tyre. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për rininë.
14. *Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet*, f. v; shih edhe 2 Korintasve 5:17.
15. *Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet*, f. v.
16. Shih Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, f. 7.



Nga M. Xhozef Brof,

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rinjve

Ngrijeni Kokën dhe Gëzohuni

Ndërsa i përballojmë gjërat e vështira sipas mënyrës së Zotit, i ngritshim kokat dhe u gëzofshim!

Në vitin 1981, unë, babai im dhe dy miq të ngushtë shkuaam për një aventurë në Alaskë. Duhej të uleshim me aeroplan në një liqen të largët dhe të ngjiteshim në një vend të lartë e të bukur. Për ta zvogëluar ngarkesën që do të duhej të mbanim personalisht, i ambalazhuam furnizimet tona në kuti, i mbuluam me polisterol, iu ngjitëm shirita të mëdhenj me ngjyra dhe i hodhëm nga dritarja e aeroplanit tonë të vogël në vendmbërritjen e synuar.

Pasi mbërritëm, kërkuam e kërkuam, por për tmerrin tonë, nuk mundëm të

gjenim asnjë nga kutitë. Përfundimisht gjetëm një. Ajo përmbante një stufë të vogël gazi, një mushama, disa ëmbëlsira dhe disa kuti Hamburger Helper [makarona] – por jo hamburger. Nuk kishim asnjë mënyrë për të komunikuar me botën e jashtme dhe që planifikuar që të na merrnin mbas një jave.

Mora dy mësimë të vlefshme nga kjo përvojë: I pari, mos e hidhni ushqimin nga dritarja. I dyti, ndonjëherë duhet të përballemi me gjëra të vështira.

Shpesh reagimi ynë i parë ndaj gjërave të vështira është pyetja: “Përse mua?” Megjithatë, bërja e pyetjes



“Përse?”, nuk i largon asnjëherë gjërat e vështira. Zoti kërkon që ne t’i mposhtim sfidat dhe Ai ka treguar “se gjithë këto gjëra do të [na] japin përvojë dhe do të jenë për të mirën [tonë]”¹.

Ndonjëherë Zoti kërkon nga ne që të bëjmë një gjë të vështirë dhe nganjëherë sfidat tona krijohen nga vetë përdorimi i lirisë sonë të zgjedhjes ose asaj të të tjerëve. Nefi i provoi të dyja këto situata. Kur Lehi i ftoi djemtë e tij që të ktheheshin për të marrë fletët nga Labani, ai tha: “Vër re, vëllezërit e tu mermërisin, duke thënë se është një gjë e vështirë ajo që u kam kërkuar; por shiko, atë nuk ua kam kërkuar unë, por është një urdhërim i Zotit”². Në një rast tjetër, vëllezërit e Nefit e përdorën lirinë e tyre të zgjedhjes për të kufizuar lirinë e tij: “Më kapën, pasi, vini re, ata ishin jashtëzakonisht të zemëruar dhe më lidhën me litarë, sepse ata kërkuan të merrnin jetën time”³.

Jozef Smithi u përball me një gjë të vështirë në burgun e Libertisë. Pa kurrfarë lehtësime të pritshëm dhe i dëshpëruar, Jozefi thirri me zë të lartë: “O PERËNDI, ku je ti?”⁴ Pa dyshim që disa prej nesh janë ndier siç u ndje Jozefi.

Çdokush përball me gjëra të vështira: vdekjen e një të dashuri, divorcin, një fëmijë të pabindur, sëmundje, sprovat e besimit, humbjen e punës ose ndonjë vështirësi tjetër.

Unë ndryshova përgjithmonë kur dëgjova këto fjalë nga Plaku Nil A. Maksuell, i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, të thëna në mes të luftës së tij me leukeminë. Ai tha: “Po përsiatja thellë dhe këto 15 fjalë udhëzuese dhe siguroese më erdhën në mendje: “Të kam dhënë leukeminë që ti të mund t’i mësosh njerëzit e mi me vërtetësi.” Ai pastaj vijoi të shprehte se si kjo përvojë e kishte bekuar me “këndvështrim për të vërtetat e mëdha të përjetësisë. . . . Vështrime të tilla mbi përjetësinë mund të na ndihmojnë ta bëjmë edhe 100 metërshin tjetër, që mund të jetë shumë i vështirë.”⁵

Për të na ndihmuar të udhëtojmë dhe triumfojmë në kohët tona të vështira me vështrime të tilla mbi përjetësinë, më lejoni të sugjeroj dy gjëra. Ne mund



t’i përballojmë gjërat e vështira, së pari, duke i falur të tjerët dhe së dyti, duke ia nënshtruar vullnetin tonë vullnetit të Atit Qiellor.

T’i falësh ata të cilët mund të na i kenë shkaktuar gjërat e vështira dhe të pajtohesh “me vullnetin e Perëndisë”⁶ mund të jetë shumë e vështirë. Mund të të lëndojë më shumë kur gjëja e vështirë për ne shkaktohet nga një pjesëtar familjeje, një mik i ngushtë ose madje vetja jonë.

Kur isha peshkop i ri në moshë, mësova për faljen kur presidenti im i kunjtit, Brus M. Kuku, tregoi historinë në vijim. Ai shpjegoi:

“Gjatë fundit të viteve 1970, unë dhe disa kolegë nisëm një biznes. Ndonëse nuk bëmë asgjë të paligjshme, disa vendime të ngathëta, të ndërthurura me kohët sfiduese të ekonomisë, çuan në mospësuksin tonë.

Disa investitorë bënë një padi për t’i rimarrë humbjet e tyre. Avokati i tyre rastisi të ishte një këshilltar në peshkopatën e familjes sime. Ishte shumë e vështirë të mbështetje njeriun që dukej se po kërkonte të më shkatërronte. Pata antipati të vërtetë për të dhe e konsiderova armikun tim. Pas pesë vitesh lufte

ligjore, e humbëm gjithçka që zotëronim, përfshirë shtëpinë.

Në vitin 2002, unë dhe bashkëshortja ime morëm vesh se po riorganizohej presidenca e kunjtit në të cilën shërbeja si këshilltar. Ndërsa bëmë një udhëtim të shkurtër përpara lirimimit nga thirrja, ajo më pyeti se cilët do të zgjidhja si këshilltarët e mi po të thirrresha si president i ri i kunjtit. Nuk doja të flisja rreth kësaj, por ajo këmbënguli. Më në fund, më erdhi në mendje një emër. Ajo më pas përmendi emrin e avokatit që ne e konsideruam se kishte qenë arsyeja kryesore e vështirësive tona 20 vite më parë. Ndërsa ajo foli, Shpirti më pohoi se ai duhej të ishte këshilltari tjetër. A mund ta falja atë burrë?

Kur Plaku Dejvid E. Sorensen më dha thirrjen për të shërbyer si president kunji, ai më dha një orë kohë për të përzgjedhur këshilltarët. Përmes lotëve unë tregova se Zoti ma kishte dhënë tashmë atë zbuluesë. Ndërsa thashë emrin e njeriut që e kisha konsideruar armikun tim, zemërimi, antipatia dhe urrejtja që kisha ushqyer, u zhdukën. Në atë çast, mësova për paqen që vjen me faljen nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit.”

E thënë ndryshe, presidenti im i kunjtit e “fal[i] çiltërish” atë, sikurse Nefi i lashtësisë.⁷ I njihja Presidentin Kuk dhe këshilltarin e tij si dy udhëheqës të drejtë priftërie që e donin njëri-tjetrin. Vendosa të jem si ata.

Vite më parë, gjatë aksidentit tonë në Alaskë, shpejt mësova se fajësimi i të tjerëve për rrethanat tona – piloti që e hodhi ushqimin jashtë në dritën e venitur – nuk ishte zgjidhje. Megjithatë, ndërsa përjetuam drobitje fizike, mungesë ushqimi, sëmundje dhe fjetje në tokë gjatë një stuhie të madhe vetëm me një mushama për t’u mbuluar, mësova se “me Perëndinë asgjë s’është e pamundshme”⁸.

Të rinj, Perëndia kërkon gjëra të vështira nga ju. Një e re 14-vjeçare mori pjesë në basketboll konkurrues. Ajo ëndërronte që të luante basketboll në shkollën e mesme si motra e saj më e madhe. Më pas, ajo mori vesh se prindërit e saj ishin thirrur për të kryesuar në një mision në Guatemalë.

Pasi mbërritën, ajo zbuloi se disa nga orët e saj mësimore do të ishin në spanjisht, një gjuhë që ende nuk e fliste. Në shkollën e saj nuk kishte as edhe një ekip të vetëm sportiv për vajzat. Ajo jetonte në katin e 14-të të një ndërtese me nivel të lartë sigurie. Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, ajo nuk mund të dilte vetëm jashtë për arsye sigurie.

Prindërit e saj e dëgjuan atë të qante e vetme para se të flinte çdo natë për muaj të tërë. Kjo ua theu zemrën! Më në fund ata vendosën që do ta dërgonin në shtëpi te gjyshja e saj për shkollën e mesme.

Kur gruaja ime hyri në dhomën e vajzës sonë për t’i treguar vendimin tonë, ajo e pa vajzën tonë të gjunjëzuar në lutje me Librin e Mormonit të hapur mbi shtrat. Shpirti i pëshpëriti gruas sime: “Ajo do të jetë në rregull”, dhe gruaja ime u largua nga dhoma pa zhurmë.

Ne kurrë nuk e dëgjua më të qante para se të flinte. Me vendosmëri dhe me ndihmën e Zotit, ajo i përballoi ato tre vite me guxim.

Gjatë përfundimit të misionit tonë, e pyeta vajzën time nëse do të shërbente



në një mision kohëplotë. Përgjigjja e saj ishte: “Jo, Babi, kam shërbyer tashmë”.

U mjaftova me përgjigjen e saj! Por rreth gjashtë muaj më vonë, Shpirti më zgjoi natën nga gjumi me këtë mendim: “E kam thirrur vajzën tënde që të shërbejë në një mision”.

Reagimi im ishte: “Atë Qiellor, ajo ka dhënë aq shumë”. Shpejt Shpirti më korrigjoi dhe arrita të kuptoj se shërbimi i saj misionar kërkohej nga Zoti.

Pa vonuar e mora vajzën time për drekë. Nga ana tjetër e tavolinës thashë: “Ganzi, a e di përse jemi këtu?”

Ajo tha: “Po, Babi. Ti e di që unë duhet të shërbej në një mision. Nuk dua të shkoj, por do të shkoj.”

Për shkak se ajo iu nënshtroi vullnetit të Atit Qiellor, ajo i shërbeu Atij me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën e saj. Ajo i ka mësuar babit të saj se si ta bëjë një gjë të vështirë.

Në takimin shpirtëror mbarëbotëror të Presidentit Rasëll M. Nelson për rininë, ai i kërkoi rinisë disa gjëra të vështira. Presidenti Nelson tha: “Ftesa ime e pestë është që të dalloheni; të jeni të ndryshëm nga bota. . . . Zoti ka nevojë që ju të dukeni, të tingëlloni, të veproni e të visheni si një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit.”⁹ Kjo mund të jetë një gjë e vështirë, sidoqoftë e di se ju mund ta bëni atë – me gëzim.

Kujtoni se “njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim”¹⁰. Pavarësisht

nga gjithçka me të cilat u përball Lehi, ai përsëri gjeti gëzim. A e kujtoni kur Alma ishte “i rënduar me dhembje”¹¹ për shkak të popullit të Amonihës? Engjëlli i tha atij: “Qofsh i bekuar, ti, Alma; prandaj, ngrije kokën dhe gëzohu . . . pasi ti ke qenë besnik në zbatimin e urdhërimeve të Perëndisë”¹². Alma mësoi një të vërtetë të mrekullueshme: Ne mund të gëzohemi përherë kur i zbatojmë urdhërimet. Kujtoni se gjatë luftërave dhe sfidave të hasura gjatë kohës së kapiten Moronit, “nuk pati kurrë një kohë më të lumtur mes popullit të Nefit”¹³. Ne mund dhe duhet të gëjmë gëzim kur përballemi me gjëra të vështira.

Shpëtimtari u përball me gjëra të vështira: “Bota . . . do ta gjykojë atë të jetë një gjë pa vlerë; prandaj ata e fshikullojnë atë dhe ai e duron atë, dhe ata e godasin atë dhe ai e duron atë. Po, ata pështynë mbi të dhe ai e duron atë, për shkak të dashurisë së përzemërt të tij dhe të shpirtmirësisë së tij kundrejt fëmijëve të njerëzve.”¹⁴

Për shkak të asaj dashurie të përzemërt, Jezu Krishti vuajti Shlyerjen. Si rrjedhojë, Ai i thotë çdonjërit prej nesh: “Në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën”¹⁵. Për shkak të Krishtit, edhe ne mund ta mundim botën.

Ndërsa i përballojmë gjërat e vështira sipas mënyrës së Zotit, i ngritshim kokat dhe u gëzofshim! Në këtë mundësi të shenjtë për t’i dëshmuar botës, unë shpall se Shpëtimtari ynë jeton dhe e udhërrëfen Kishën e Tij. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 122:7.
2. 1 Nefi 3:5.
3. 1 Nefi 7:16.
4. Doktrina e Besëlidhje 121:1.
5. Neal A. Maxwell, “Revelation”, *First Worldwide Leadership Training Meeting*, 11 janar 2003, f. 6.
6. 2 Nefi 10:24.
7. 1 Nefi 7:21.
8. Lluca 1:37.
9. Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit” (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), HopeofIsrael.lids.org.
10. 2 Nefi 2:25.
11. Alma 8:14.
12. Alma 8:15.
13. Alma 50:23.
14. 1 Nefi 19:9.
15. Gjoni 16:33.



Nga Plaku Stiven R. Bangerter,
i Të Shtatëdhjetëve

Ngritja e Themelit të një Vepre të Madhe

Mësimet që merren nëpërmjet traditave që krijojmë në shtëpitë tona, ndonëse të vogla dhe të thjeshta, janë tejet të rëndësishme në botën e sotme.

Si prindër në Sion, ne kemi një detyrë të shenjtë për ta zgjuar dëshirën dhe zotimin të fëmijët tanë për gëzimin, dritën dhe të vërtetat e ungjillit të Jezu Krishtit. Ndërkohë që i rritim fëmijët tanë, ne krijojmë tradita brenda shtëpisë sonë dhe ndërtojmë modele komunikimi dhe sjelljeje në marrëdhëniet tona familjare. Kur e bëjmë këtë, traditat që krijojmë, duhet të ngulitin veçori të forta dhe të palëkundura të mirësisë të fëmijët tanë, që do t'i mbushin ata me forcë për t'u përballur me sfidat e jetës.

Prej shumë vitesh, familja jonë ka shijuar traditën vjetore të fushimit lart në malet Uintah në verilindje të Jutës. Ne udhëtojmë 32 km në një rrugë me gurë, të paasfaltuar, për të mbërritur në një luginë të bukur të gjelbër, me mure të larta kanionesh, përmes të cilëve rrjedh një lumë me ujë të ftohtë e të kulluar. Çdo vit, duke shprehur që të ripohojmë vlerën e doktrinës dhe praktikave të ungjillit në zemrën e fëmijëve dhe nipërve e mbesave tona, Suzana dhe unë i kërkojmë secilit prej gjashtë bijve tanë e familjeve të tyre që të përgatitin një mesazh të shkurtër mbi

një temë që ata mendojnë se është një element i rëndësishëm për themelet e një shtëpie të përqendruar te Krishti. Ne më pas mblidhemi për një takim shpirtëror familjar në një vend të veçuar dhe secili paraqet mesazhin e vet.

Këtë vit, nipërit e mbesat tona e shkruan temën e mesazhit të tyre në gurë dhe më pas një e nga një, i futën në gropë pranë njëri-tjetrit, duke

përfaqësuar një themel të sigurt mbi të cilin ndërtohet një jetë e lumtur. Thurur me të gjashta mesazhet e tyre ishte e vërteta e pandryshueshme dhe e përjetshme se Jezu Krishti është guri i qoshes së atij themeli.

Me fjalët e Isaia: "Prandaj kështu thotë Zoti, [Perëndi]: 'Ja, unë vendos si themel në Sion një gur, një gur të provuar, një kokë qosheje të çmuar, një themel të sigurt; ai që i beson atij nuk do të ngutet'".¹ Jezu Krishti është ai guri i çmuar i qoshes në themelin e Sionit. Ishte Ai që i zbuloi Profetit Jozef Smith: "Prandaj, mos u lodhni së bëri mirë, sepse ju po ngrini themelin e një vepre të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe."²

Mësimet që merren nëpërmjet traditave që krijojmë në shtëpitë tona, ndonëse të vogla dhe të thjeshta, janë tejet të rëndësishme në botën e sotme. Cilat janë gjërat e vogla dhe të thjeshta të cilat, kur krijohen, do të kryejnë një vepër të madhe në jetën e fëmijëve tanë?

Presidenti Rasëll M. Nelson kohët e fundit iu drejtua një bashkësie të madhe afër Torontos në Kanada dhe u solli fuqishëm ndër mend prindërve përgjegjësini e shenjtë që kemi për t'i mësuar fëmijët tanë. Midis përgjegjësive thelbësore që përcaktoi, Presidenti Nelson theksoi detyrat që kemi ne si prindër për t'i mësuar fëmijët që ta kuptojnë arsyen se përse e marrim sakramentin, domethënien e të lindurit në besëlidhje



Mesazhe që përfaqësojnë themelin e një jete të lumtur, me Jezu Krishtin si gurin e qoshes të atij themeli.



dhe rëndësinë e përgatitjes për bekimin patriarkal e për marrjen e tij, si dhe ai i nxiti prindërit që të prijnë drejt leximit të shkrimeve të shenjta së bashku si familje.³ Nëpërmjet këtyre përpjekjeve, profeti ynë i dashur na shtyn që t'i bëjmë shtëpitë tona “shenjtërore besimi”⁴.

Në Librin e Mormonit, Enosi shënon mirënjohjen e thellë që ndjeu për shembullin e atit të tij, i cili e “mësoi [atë] në gjuhën e tij dhe gjithashtu në kujdesin dhe këshillën e Zotit”. Me emocion të madh, Enosi thirri: “Dhe bekuar qoftë emri i Perëndisë tim për këtë”⁵.

Unë i çmoj traditat e vogla dhe të thjeshta që kemi arritur t'i mbajmë në shtëpinë tonë gjatë 35 vjetëve tona martesore. Shumë nga traditat tona janë të thjeshta e prapëseprapë domethënëse. Për shembull:

- Gjatë mbrëmjeve kur isha larg shtëpisë, gjithmonë e kam ditur se nën drejtimin e Suzanës, djali ynë më i madh do ta merrte vetë përgjegjësinë që ta printe familjen drejt studimit të shkrimeve të shenjta dhe lutjes familjare.⁶
- Një traditë tjetër – ne nuk largohemi kurrë nga shtëpia apo nuk e mbyllim bisedën telefonike pa thënë: “Të dua”.

- Jeta jonë është bekuar duke caktuar kohë rregullisht për të shijuar intervistat vetjake me secilin prej bijve tanë. Gjatë një interviste, unë e pyeta birin tonë rreth dëshirave dhe përgatitjes së tij për të shërbyer në një mision. Pas disa diskutimesh, pati një çast qetësie reflektimi, më pas u përkul përpara dhe mendueshëm shpalli: “Babi, a e mban mend kur isha i vogël dhe filluam të bënim intervista atërore?” Unë thashë: “Po”. “Epo”, tha ai, “atëherë të premtova se do të shërbeja në një mision dhe ti me mamën më premtuat se do të shërbenit në një mision kur të plakeshit.” Më pas pati sërish qetësi. “A po hasni ju njerëz ndonjë problem që do t’ju ndalojë së shërbyeri – sepse ndoshta mund t’ju ndihmoj?”

Traditat e vazhdueshme, të shëndosha familjare që përfshijnë lutjen, leximin e shkrimeve të shenjta, mbrëmjen familjare dhe pjesëmarrjen në mbledhjet e Kishës, ndonëse në dukje të vogla e të thjeshta, krijojnë një kulturë dashurie, respekti, uniteti dhe sigurie. Me shpirtin që i shoqëron këto përpjekje, fëmijët tanë bëhen të mbrojtur nga shigjetat e zjarra të kundërshtarit të rrenjosura në kulturën e botës në kohën tonë.

Neve na vjen ndërmend këshilla e urtë e Helamanit drejtuar bijve të tij: “Mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t’ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien”⁷.

Vite më parë, kur po shërbeja si peshkop në një moshë të re, një zotëri më në moshë kërkoi të takohej me mua. Ai përshkroi largimin e tij nga Kisha dhe nga traditat e drejta të prindërve të tij kur ishte në moshë të re. Ai përshkroi me hollësi dëshpërimin që provoi gjatë jetës së vet ndërsa kërkonte më kot gëzim të përhershëm mes lumturisë së çastit që bota ka për të ofruar. Tani, vite më vonë në jetën e tij, ai përjetoi ndjesitë pëshpëritëse të buta, herë-herë të vazhdueshme, të Shpirtit të Perëndisë duke e udhërrëfyer atë sërish te mësimet, praktikat, ndjenjat dhe siguria shpirtërore e rinisë së tij. Ai shprehu

mirënjohje për traditat e prindërve të tij dhe me fjalë bashkëkohore, ai përsëriti thirrjen e Enosit: “Bekuar qoftë emri i Perëndisë tim për këtë”.

Nga përvoja ime, rikthimi i këtij burri të dashur tek ungjilli është veçori e shumë njerëzve dhe përsëritet shpesh midis fëmijëve të Perëndisë që largohen për një periudhë për t’u kthyer më pas te mësimet dhe praktikat e rinisë së tyre. Në ato çaste, ne dëshmojmë urtësinë e shkruarit të fjalës së urtë, që i këshillon prindërit: “Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët”⁸.

Çdo prind përballët me çaste shqetësimi dhe shkallë të ndryshme vendosmërie dhe force teksa i rrit fëmijët. Sidoqoftë, kur prindërit ushtrojnë besim duke i mësuar fëmijët me ndershmëri, me dashamirësi dhe duke bërë gjithçka mundën për t’i ndihmuar ata gjatë rrugës, ata marrin shpresë më të madhe, saqë farat që po mbillen do të hedhin rrënjë në zemrën dhe mendjen e fëmijëve të tyre.

Moisiu e kuptoi më së miri nevojën themelore për mësimdhënie të vazhdueshme. Ai këshilloi: “Do t’ua ngulitësh bijve të tu [këto fjalë], do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh”⁹.

Ne gjunjëzohemi pranë fëmijëve tanë gjatë lutjes familjare, ne kujdesemi për ta nëpërmjet përpjekjeve tona për të bërë lexim kuptimplotë familjar të shkrimeve të shenjta, ne kujdesemi për ta me durim e me dashuri teksa marrim pjesë së bashku në mbremje familjare dhe brengosemi për ta kur gjunjëzohemi gjatë lutjeve tona vetjake drejtuar qiellit. O, sa dëshirojmë që farat që po mbjellim të hedhin rrënjë në zemrën dhe mendjen e fëmijëve tanë!

Besoj se pak rëndësi ka pyetja nëse fëmijët tanë po “e kuptojnë atë” gjatë mësimdhënies sonë, si në rastin kur mundohemi që t’i lexojmë shkrimet e shenjta ose kur bëjmë mbremje familjare apo marrim pjesë në veprimtaritë e përbashkëta dhe mbledhje të tjera të Kishës. Është më pak e rëndësishme [të shqetësohemi] nëse në ato çaste ata po e kuptojnë domethënien e atyre



veprimtarive dhe është më tepër e rëndësishme [të shqetësohemi] nëse ne si prindër jemi duke ushtuar besim aq sa për të ndjekur këshillën e Zotit që të jetojmë me zell, të japim mësim, t’i këshillojmë dhe të vendosim pritshmëri që janë të frymëzuara nga ungjilli i Jezu Krishtit. Ajo është një përpjekje që shtyhet nga besimi ynë – bindja jonë se një ditë farat e mbjella në rininë e tyre do të hedhin rrënjë dhe do të fillojnë të mbijnë e të rriten.

Gjërat për të cilat flasim, gjërat të cilat i predikojmë dhe i japim mësim, përcaktojnë gjërat që do të ndodhin mes nesh. Teksa krijojmë tradita të shëndosha që na mësojnë për doktrinën e Krishtit, Shpirti i Shenjtë jep dëshmi për vërtetësinë e mesazhit tonë

dhe i ushqen farat e ungjillit që janë mbjellë thellë në zemrën e fëmijëve tanë, me anë të përpjekjeve tona gjatë rrugës. Unë dëshmoj kështu, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Isaia 28:16.
2. Doktrina e Besëlidhje 64:33.
3. Shih faqen e facebook-ut të Nil L. Andersenit, postuar më 19 gusht 2018, [facebook.com/lds.neil.l.andersen](https://www.facebook.com/lds.neil.l.andersen).
4. Në Sarah Jane Weaver, “President Nelson Urges ‘Teach the Children’”, *Church News*, 23 shtator 2018, f. 11.
5. Enosi 1:1.
6. Shih Dallin H. Oaks, “Autoriteti i Piftërisë në Familje dhe në Kishë”, *Liahona*, nëntor 2005, f. 24–27 [Konferenca e Përgjithshme, tetor 2005, f. 35–39].
7. Helamani 5:12.
8. Fjalët e Urta 22:6.
9. Ligji i Përtërirë 6:7.



Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Mos u Shqetësoni

Merrni zemër, vëllezër e motra. Po, ne jetojmë në kohë të rrezikshme, por teksa qëndrojmë në shtegun e besëlidhjeve, nuk nevojitet të kemi frikë.

Unë ia shtoj dëshminë time mesazheve të Presidentit Rasëll M. Nelson dhe Plakut Kuentin L. Kuk, të dhëna çaste më parë rreth harmonisë dhe njëzëshmërisë së Këshillit të Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. E di se këto shpallje nëpërmjet zbulësës janë mendja dhe vullneti i Zotit dhe do t'i bekojnë e forcojnë individët, familjet dhe Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme për brezat që do të vijnë.

Disa vite më parë, njëra nga bijat tona, e re në moshë, e martuar, dhe bashkëshorti i saj i bënë Motrës Rasband dhe mua një pyetje shumë të rëndësishme, jetëndikuese: “A është akoma një gjë e sigurt dhe e urtë që të sjellim fëmijë në këtë botë të ligë dhe të frikshme ku ne jetojmë?”

Kjo ishte një pyetje e rëndësishme për një nënë e një baba që ta shqyrtonin me fëmijët e tyre të dashur, të martuar. Mund ta dëgjonim frikën në zërat e tyre dhe mund ta ndienim frikën në zemrat e tyre. Përgjigja jonë ndaj tyre ishte: “Po, është më se në rregull”, teksa flitnim për mesimet themelore të ungjillit dhe për mbresat tona të përzemërta dhe përvojat tona jetësore.

Frika nuk është gjë e re. Në Detin e Galilesë, dishepujt e Jezu Krishtit u

frikësuan nga “një furtunë e madhe dhe valët” në errësirën e natës.¹ Si dishepujt e Tij sot, edhe ne kemi frikë. Të rinjtë tanë në moshë madhore beqarë kanë frikë të bëjnë zotime të tilla si martesë. Çiftet e martuara që të rinj, sikurse fëmijët tanë, mund të kenë frikë të lindin fëmijë në një botë gjithnjë e më të ligë. Misionarët kanë frikë për shumë gjëra, veçanërisht që t'u afrohen njerëzve të panjohur. Të vejat kanë frikë ta vazhdojnë jetën vetëm. Adole-shentët kanë frikën se nuk pranohen nga bashkëmoshatarët; nxënësit kanë frikë ditën e parë të shkollës; studentët në universitete kanë frikë kur u jepet vlerësimi i një provimi. Ne kemi frikë nga dështimi, refuzimi, zhgënjimi dhe e panjohura. Ne kemi frikë nga uraganet, tërmetet dhe zjarret që e shkatërrojnë tokën dhe jetën tonë. Ne kemi frikë se nuk do të na zgjedhin dhe, nga ana tjetër, kemi frikë kur na zgjedhin. Ne kemi frikë se nuk jemi të mirë sa duhet; kemi frikë se Zoti nuk ka bekime për ne. Ne kemi frikë nga ndryshimi dhe frika jonë mund të shtohet deri në panik. A e kam përfshirë pothuajse çdo njeri?

Që nga kohët e lashta, frika e ka kufizuar largpamësinë e fëmijëve të Perëndisë. Gjithmonë më ka pëlqyer rrëfimi i Eliseut te 2 Mbretërve. Mbreti i Sirisë kishte dërguar një legjion ushtarësh që

“arritën natën dhe rrethuan qytetin”². Qëllimi i tyre ishte të kapnin dhe të vritnin profetin Elise. Ne lexojmë:

“Të nesërmen shërbëtori i njeriut të Perëndisë u ngrit në mëngjes dhe doli; dhe ja, qyteti ishte rrethuar nga një ushtri me kuaj dhe kalorës. Atëherë shërbëtori i tij i tha: ‘Oh, ç’do të bëjmë, imzot?’”³

Ishte frika që po fliste.

“[Eliseu] u përgjigj: ‘Mos ki frikë, sepse ata që janë me ne, janë më të shumtë se ata që janë me ta.’”⁴

Por ai nuk e la me kaq.

“Eliseu u lut dhe tha: ‘O Zot, të lutem, hap sytë e tij që të mund të shohë’. Atëherë Zoti ia hapi sytë të riut dhe ai pa; dhe ja, mali ishte plot me kuaj dhe me qerre të zjarra rreth e qark Eliseut.”⁵

Ne mund të kemi ose mund të mos kemi qerre të zjarra që dërgohen për ta larguar frikën tonë dhe për t'i mposhtur demonët tanë, por mësimi është i qartë. Zoti është me ne, tregon kujdes për ne dhe na bekon në mënyra që vetëm Ai mund të na bekojë. Lutja mund të vërë në dispozicion forcën dhe zbulësën që na nevojitet për t'i përqendruar mendimet tona te Jezu Krishti dhe flijimi i Tij shlyes. Zoti e dinte se nganjëherë do të kishim frikë. Unë e kam provuar atë, po ashtu e keni provuar edhe ju, dhe për këtë arsye shkrimet e shenjta janë plot me këshillën e Zotit:



“Merrni zemër dhe mos u frikësoni.”⁶

“Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë.”⁷

“Mos ki frikë, tufë e vogël.”⁸ Më pëlqen shumë shprehja e dhembshur “tufë e vogël”. Në këtë Kishë ne mund të jemi të paktë në numër për sa i përket mënyrës se si bota e llogarit ndikimin, por, kur i hapim sytë tanë shpirtërorë, “ata që janë me ne, janë më të shumtë se ata që janë me ta”⁹. Bariu ynë i dashur, Jezu Krishti, më pas vazhdoi: “Le të bashkohen toka e ferri kundër jush, sepse, nëse ju ndërtoheni mbi shkëmbin tim, ato s’mund të triumfojnë”¹⁰.

Si largohet frika? Për djaloshin, ai po qëndronte pikërisht në krah të Eliseut, një profeti të Perëndisë. Ne kemi po të njëjtin premtim. Kur e dëgjojmë Presidentin Rasëll M. Nelson, kur ia vëmë veshin këshillës së tij, ne po qëndrojmë me një profet të Perëndisë. Mbani mend fjalët e Jozef Smithit: “Dhe tani, pas shumë dëshmimeve që janë dhënë për të, kjo është dëshmia, e fundit e të gjithave, që ne japim për të: Se ai jeton!”¹¹ Jezu Krishti jeton. Dashuria jonë për Të dhe për ungjillin e Tij e largon frikën.

Dëshira jonë që “të ke[mil] gjithmonë Shpirtin e Tij”¹² me ne, do ta zëvendësojë frikën me një pamje më të përjetshme të jetës sonë në vdekshmëri. Presidenti Nelson ka këshilluar: “Në ditët e ardhshme, nuk do të jetë e mundur të mbijetojmë shpirtërisht pa ndikimin udhërrëfyes, drejtues, ngushëllues dhe të vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë”¹³.

Zoti tha, lidhur me mundimet që do t’i vijnë tokës dhe do ta ngurtësojnë zemrën e shumë njerëzve: “Dishepujt e mi do të qëndrojnë në vende të shenjta dhe nuk do të lëvizin”¹⁴.

Dhe më pas këtë këshillë hyjnore: “Mos u shqetësoni, sepse, kur gjithë këto gjëra të ndodhin, ju mund të dini se premtimet që ju janë bërë, do të përmbushen”¹⁵.

Qëndroni në vende të shenjta – mos u shqetësoni – dhe premtimet do të përmbushen. Le ta shohim secilën prej këtyre se si lidhet me frikën tonë.

Së pari, qëndroni në vende të shenjta. Kur qëndrojmë në vende të



shenjta – në shtëpitë tona plot drejtësi, në godinat tona të dedikuara kishtare, në tempujt tanë të përkushtuar – e ndiejmë Shpirtin e Zotit me ne. Ne gjejmë përgjigje për pyetjet që na shqetësojnë ose paqe që thjesht t’i lëmë ato mënjane. Ky është Shpirti në veprim. Këto vende të shenjta në mbretërinë e Perëndisë mbi tokë kërkojnë nderimin tonë, respektin tonë për të tjerët, sjelljet tona më të mira në të jetuarit e ungjillit dhe shpresat tona që të mos ndikohemi nga frika jonë dhe të kërkojmë fuqinë shëruese të Jezu Krishtit nëpërmjet Shlyerjes së Tij.

Nuk ka vend për frikë në këto vende të shenjta të Perëndisë ose në zemrën e fëmijëve të Tij. Përse? Për shkak të dashurisë. Perëndia na do – gjithmonë – dhe ne e duam Atë. Dashuria jonë për Perëndinë i kundërpërgjigjet gjithë frikës dhe dashuria e Tij ndihet fuqishëm në vendet e shenjta. Mendoni për këtë. Kur jemi të pasigurt në zotimet tona ndaj Zotit, kur largohemi nga shtegu i tij që çon drejt jetës së

përjetshme, kur e vëmë në pikëpyetje ose dyshim rëndësinë tonë në planin e Tij hyjnor, kur e lejojmë frikën të hapë derën për të gjitha ato që e shoqërojnë – shkurajimin, zemërimin, acarimin, zhgënjimin – Shpirti na largohet dhe ne jemi pa Zotin. Nëse e dini se me çfarë ngjan kjo, ju e dini se kjo nuk është gjendja ku doni të rri. Në dallim nga kjo, kur qëndrojmë në vende të shenjta, ne mund të ndiejmë dashurinë e Perëndisë dhe “dashuria e përkryer zhdok çdo frikë”¹⁶.

Premtimi pasues është: “Mos u shqetësoni”¹⁷. Pavarësisht se sa ligësi dhe kaos e mbushin tokën, nëpërmjet besnikërisë sonë të përditshme te Jezu Krishti neve na premtohet “paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarësie”¹⁸. Dhe kur Krishti të vijë me gjithë fuqinë e lavdinë, ligësia, rebelimi dhe padrejtësia do të mbarojnë.

Shumë kohë më parë Apostulli Pal profetizoi për kohën tonë, duke i thënë të riut Timote:

“Dhe dije këtë: në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira,



filozofive të njerëzve që e sulmojnë të vërtetën, ne duhet të mësojmë të marrim zbulesë”²².

Që të marrim zbulesë vetjake, ne duhet të vendosim përparësi tek të jetuarit e ungjillit dhe të nxitim besnikëri e shpirtshmëri tek të tjerët si edhe te vetja.

Spenser W. Kimballi ishte njëri nga profetët e rinisë time. Në këto pak vite të fundit, pasi u thirra si Apostull, unë kam gjetur paqe te mesazhi i tij i parë në konferencën e përgjithshme të tetorit 1943. Ai ndihej i mbingarkuar nga thirrja e vet; e di se si është ajo ndjesi. Plaku Kimballi tha: “Unë mendova shumë dhe u luta, dhe agjërova, dhe u luta. Pati mendime kundërshtuese që ngritën krye në mendjen time – zëra të ngjashëm që thonin: ‘Nuk mund ta bësh punën. Nuk je i denjë. Nuk e ke aftësinë’ – dhe në fund përherë vinte mendimi triumfues: ‘Duhet të bësh punën që të është caktuar – duhet të bëhesh i aftë, i denjë dhe i kualifikuar’. Dhe beteja vazhdoi.”²³

Marr zemër nga ajo dëshmi e përzemërt, e pastër e këtij Apostulli, i cili do të bëhej Presidenti i 12-të i kësaj Kise të fuqishme. Ai e kuptoi se duhej ta linte mënjanë frikën e vet që të “bë[nte] punën që [i ishte] caktuar” dhe atij iu desh të mbështetej te Zoti për forcë, që të bëhej “i aftë, i denjë dhe i kualifikuar”. Edhe ju mund të bëheni. Betejat do të vazhdojnë, por ne do t’u bëjmë

sepse njerëzit do të jenë egoistë, lakmues parash, mburravecë, krenarë, blasfemues, të pabindur ndaj prindërve, mosmirënjohës, të paudhë, . . . dëfrimdashës më fort se perëndidashës”¹⁹.

Mbani mend, “ata që janë me ne” në të dyja anët e velit, ata që e duan Zotin me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën e tyre, “janë më të shumtë se ata që janë me ta”²⁰. Nëse mirëbesojmë aktivisht te Zoti dhe udhët e Tij, nëse përfshihemi në punën e Tij, ne nuk do të kemi frikë nga tendencat e botës ose nuk do të shqetësohemi prej tyre. Ju lutem t’i lini mënjanë ndikimet dhe shtytjet e botës dhe të kërkonti shpirtshmëri në jetën tuaj të përditshme. Doni atë që e do Zoti – gjë që përfshin urdhërimet e Tij, shtëpitë e Tij të shenjta, besëlidhjet tona të shenjta me Të, sakramentin çdo ditë Shabati, komunikimin tonë nëpërmjet lutjes – dhe ju nuk do të shqetësoheni.

Pika e fundit: mirëbesoni te Zoti dhe premtimet e Tij. E di se të gjitha premtimet e Tij do të përmbushen. E di këtë me po aq siguri sa qëndroj këtu përpara jush në këtë mbledhje të shenjtë.

Zoti ka zbuluar: “Sepse ata që janë të urtë dhe e kanë pranuar të vërtetën, dhe kanë marrë Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin e tyre, dhe nuk janë mashtruar – në të vërtetë unë ju them, ata

nuk do të priten e nuk do të hidhen në zjarr, por do t’i qëndrojnë ditës”²¹.

Kjo është arsyeja përse nuk duhet të shqetësohemi nga trazira e sotme, nga ata që ndodhen në ndërtesën e gjerë dhe të madhe, nga ata që e përqeshin përpjekjen e ndershme dhe shërbimin e përkushtuar ndaj Zotit Jezu Krisht. Optimizmi, guximi, madje dashuria hyjnore vijnë nga një zemër që nuk rëndohet nga shqetësimet apo trazira. Presidenti Nelson, i cili është “optimist për të ardhmen”, na ka kujtuar: “Nëse duam të kemi ndonjë shpresë për ta shoshitur morinë e zërave dhe



ballë atyre me Shpirtin e Zotit. Ne nuk do të “shqetëso[hem]”, sepse kur qëndrojmë me Zotin dhe i mbrojmë parimet e Tij dhe planin e Tij të përjetshëm, ne po qëndrojmë në tokë të shenjtë.

Tani, çfarë mund të themi vallë për bijën dhe dhëndrin që bënë atë pyetje të përzemërt dhe intime, nisur nga frika, vite më parë? Ata e morën parasysh seriozisht bisedën tonë atë natë; u lutën, agjëruan dhe arritën në përfundimet e veta. Plot gëzim e ngazëllim për ta dhe për ne, gjyshërit, tani ata janë bekuar me shtatë fëmijë të bukur teksa ecin përpara me besim e dashuri.

Merrni zemër, vëllezër e motra. Po, ne jetojmë në kohë të rrezikshme, por teksa qëndrojmë në shtegun e besëlidhjeve, nuk nevojitet të kemi frikë. Ju bekoj që, teksa e bëni këtë gjë, ju nuk do të shqetësoheni nga kohët në të cilat jetojmë ose shqetësimet që na shfaqen në rrugën tonë. Ju bekoj të zgjidhni që të qëndroni në vende të shenjta dhe të mos lëvizni. Ju bekoj të besoni te premtimet e Jezu Krishtit, se Ai jeton dhe se Ai po vëzhgon mbi ne, kujdeset për ne dhe qëndron përkrah nesh. Në emrin e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Marku 4:37.
2. 2 Mbretërve 6:14.
3. 2 Mbretërve 6:15.
4. 2 Mbretërve 6:16.
5. 2 Mbretërve 6:17.
6. Doktrina e Besëlidhje 68:6.
7. Doktrina e Besëlidhje 6:36.
8. Doktrina e Besëlidhje 6:34.
9. 2 Mbretërve 6:16.
10. Doktrina e Besëlidhje 6:34.
11. Doktrina e Besëlidhje 76:22.
12. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
13. Rasëll M. Nelson, “Zbulesë për Kishën, Zbulesë për Jetën Tonë”, *Liahona*, maj 2018, f. 96.
14. Doktrina e Besëlidhje 45:32.
15. Doktrina e Besëlidhje 45:35.
16. Moroni 8:16.
17. Doktrina e Besëlidhje 45:35.
18. Filipianëve 4:7.
19. 2 Timoteut 3:1–2, 4.
20. 2 Mbretërve 6:16.
21. Doktrina e Besëlidhje 45:57.
22. Rasëll M. Nelson, “Zbulesë për Kishën, Zbulesë për Jetën Tonë”, f. 96.
23. Spencer W. Kimball, në Conference Report, tetor 1943, f. 16–17.



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

T’i Sjellim në një Krye të Vetëm, në Krishtin, të Gjitha Gjërat


Fuqia e ungjillit të Shpëtimtarit për të na shndërruar e për të na bekuar, rrjedh nga dallimi dhe zbatimi i ndërvarësisë së doktrinës, parimeve dhe praktikave të saj.

Një litar është një mjet i rëndësishëm të cilin të gjithë e njohim. Litarët përbëhen nga fije pëlhurash, bimësh, telash ose materialesh të tjera, ku secila individualisht thuret ose gërshetohet së bashku. Në mënyrë interesante, substancat që mund të jenë krejtësisht të zakonshme, mund të enden së bashku dhe të bëhen jashtëzakonisht të forta. Pra, bashkimi dhe lidhja në mënyrë të efektshme e materialeve, mund të prodhojnë një mjet të shkëlqyer.

Ashtu si një litar e merr forcën e vet nga shumë fije të veçanta të ndërthurura, po kështu ungjilli i Jezu Krishtit siguron perspektivën më të madhe të së vërtetës dhe ofron bekimet më të pasura, ndërsa ia vëmë veshin këshillës së Palit që t’i “sjellim] në një krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato që janë mbi dhe”¹. Më e rëndësishmja, kjo sjellje së bashku dhe jetike e së vërtetës qendërohet dhe përqendrohet te Zoti Jezu

Krisht sepse Ai është “udha, e vërteta dhe jeta”².

Unë lutem që Fryma e Shenjtë do ta ndriçojë secilin prej nesh ndërsa marrim në shqyrtim mënyrën se si parimi i *sjelljes në një krye të vetëm*,





në Krishtin, i të gjitha gjërave gjen zbatim në mënyra praktike për të mësuarit dhe të jetuarit e Ungjillit të Tij të rivendosur në jetën tonë të përditshme.

Një Stinë Zbulesë

Ne jetojmë në një stinë të jashtëzakonshme dhe zbulesë të Kishës së rivendosur të Jezu Krishtit. Përshtatjet historike që u shpallën sot, kanë vetëm një qëllim gjithëpërfshirës: të forcojnë besimin tek Ati Qellor e te plani i Tij dhe te Biri i Tij, Jezu Krishti, e Shlyerja e Tij. Programi i mbledhjes të së dielës jo thjesht u shkurtua. Për më tepër, tani kemi mundësi dhe përgjegjësi të shtuara si individë dhe familje për ta përdorur kohën tonë për përforcimin e Shabatit si një kënaqësi në shtëpi dhe në Kishë.

Prillin e kaluar, struktura organizative e kuorumeve të priftërisë jo thjesht u ndryshua. Përkundrazi, dhënies së shërbesës ndaj vëllezërve dhe motrave tona iu vu theks dhe iu dha forcë në mënyrë më të lartë e më të shenjtë.

Sikurse fjetet e thurura të një litari prodhojnë një mjet të fuqishëm e të qëndrueshëm, të gjitha këto veprime

të ndërlidhura janë pjesë e një përpjekjeje të bashkuar për t'i përpëthur më mirë përqendrimin, burimet dhe punën e Kishës së rivendosur të Shpëtimtarit me misionin e saj themelor: për ta ndihmuar Perëndinë në veprën e Tij, për t'u sjellë shpëtimin dhe ekzaltimin fëmijëve të Tij. Ju lutem, mos u përqendroni kryesisht tek aspektet logjistike të asaj që është shpallur. Ne nuk duhet të lejojmë që hollësitë e procedurave të errësojnë arsyet shpirtërore gjithëpërfshirëse të këtyre ndryshimeve që po bëhen tani.

Dëshira jonë është që besimi në planin e Atit dhe në misionin shëlbues të Shpëtimtarit të mund të rritet në tokë dhe që të mund të vendoset besëlidhja e përyetshme e Perëndisë.³ Objektivat tona të vetme janë që ta lehtësojnë kthimin e vazhdueshëm në besim te Zoti dhe t'i duam më plotësisht e t'u shërbejmë në mënyrë më të efektshme vëllezërve dhe motrave tona.

Segmentimi dhe Ndarja

Ndonjëherë si anëtarë të Kishës ne e segmentojmë, e ndajmë dhe e vëmë në zbatim Ungjillin në jetën tonë duke

krijuar lista të gjata kontrolli të temave individuale që duhen studiuar e detyrave që duhen përbushur. Por një qasje e tillë mund ta kufizojë kuptimin dhe vizionin tonë. Duhet të jemi të kujdesshëm sepse një përqendrim si ai i farisenjve te listat e kontrollit mund të na devijojë nga afrimi më pranë Zotit.

Qëllimi dhe pastrimi, lumturia dhe gëzimi, dhe kthimi në besim e mbrojtja e vazhdueshme që vijnë nga “dhëni[a] e zemrave . . . [tona] Perëndisë”⁴ dhe marrja e shëmbëlltyrës së Tij në pamjen [tonë]⁵, nuk mund të merren thjesht duke kryer dhe duke shenjuar të gjitha gjërat shpirtërore që supozohet të bëjmë. Përkundrazi, fuqia e Ungjillit të Shpëtimtarit për të na shndërruar e për të na bekuar, rrjedh nga dallimi dhe zbatimi i ndërvarësisë së doktrinës, parimeve dhe praktikave të saj. Vetëm kur i sjellim në një krye të vetëm, *në Krishtin, të gjitha gjërat*, me një përqendrim të vendosur tek Ai, të vërtetat e Ungjillit në mënyrë bashkëvepruese mund të na aftësojnë që të bëhemi çka Perëndia dëshiron që të bëhemi⁶ dhe të durojmë me guxim deri në fund.⁷

Të Mësuarit dhe Lidhja e të Vërtetave të Ungjillit

Ungjilli i Jezu Krishtit është një sixhade madhështore e së vërtetës që është “lidhur mirë”⁸ dhe është endur së bashku. Ndërsa i mësojmë dhe i lidhim së bashku të vërtetat e zbuluara të Ungjillit, ne bekojemi që të fitojmë një perspektivë të çmuar dhe një aftësi të shtuar shpirtërore nëpërmjet syve që mund ta shohin ndikimin e Zotit në jetën tonë dhe veshëve që mund ta dëgjojnë zërin e Tij.⁹ Dhe parimi i *sjelljes në një krye të vetëm – madje në Të* – mund të na ndihmojë për t'i ndryshuar listat tradicionale të kontrollit në një listë të vetme të bashkuar, të integruar e të plotë. Më lejoni t'ju jap një shembull doktrinor si edhe një shembull të Kishës për atë që jam duke sugjeruar.

Shembulli 1. Neni i katërt i besimit është një nga ilustrimet më të mëdha të sjelljes në një krye të vetëm, në Krishtin, të të gjitha gjërave: “Ne besojmë se parimet dhe ordinancat e para të Ungjillit janë: së pari, Besimi

në Zotin Jezu Krisht; së dyti, Pendimi; së treti, Pagëzimi me anë të zhytjes për heqjen e mëkateve; së katërti, Vënia e duarve për dhuratën e Frymës së Shenjtë”¹⁰.

Besimi i vërtetë përqendrohet në dhe te Zoti Jezu Krisht – tek Ai si Biri Hyjnor dhe i Vetëmlindur i Atit dhe tek Ai e misioni shëlbues që Ai përmbushi. “Pasi ai ka përmbushur qëllimet e ligjit dhe kërkon të gjithë ata që kanë besim në të; dhe ata që kanë besim në të, do të kapen pas çdo gjëje të mirë; prandaj ai [e] përkrah çështjen e fëmijëve të njerëzve.”¹¹ Të ushtrojmë besim në Krisht do të thotë *t’i mirëbesojmë* dhe ta vendosim besimin tonë tek Ai si Shpëtimtari ynë, tek emri i Tij dhe te premtimet e Tij.

Pasoja e parë dhe e natyrshme e mirëbesimit në Shpëtimtarin është pendimi dhe largimi nga e keqja. Ndërsa ushtrojmë besim në dhe te Zoti, ne natyrshëm kthehemi drejt Tij, vijmë tek Ai dhe varemë prej Tij. Pra, pendim

do të thotë *t’i mirëbesojmë* Shëlbuesit dhe *të mbështetemi* tek Ai që të bëjë për ne atë që nuk mund ta bëjmë vetë. Secili prej nesh duhet të “[*mbështetet*] tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë”¹², pasi vetëm “nëpërmjet meritave dhe mëshirës dhe hirit të Mesias së Shenjtë”¹³, ne mund të bëhemi krijesa të reja në Krishtin¹⁴ dhe përfundimisht të kthehemi e të banojmë në praninë e Perëndisë.

Ordinanca e pagëzimit me anë të zhytjes për heqjen e mëkateve kërkon që ne t’i *mirëbesojmë* Atij, të *mbështetemi* tek Ai dhe ta *ndjekim* Atë. Nefi deklaroi: “Unë e di se, në qoftë se ju do të *ndiqni Birin*, me qëllim të plotë të zemrës, pa bërë hipokrizi dhe mashtrim para Perëndisë, por me bindje të vërtetë, duke u penduar për mëkatet tuaja, duke i dëshmuar Atit se jeni të gatshëm të merrni mbi vete emrin e Krishtit, me anë të pagëzimit – po, *duke ndjekur Zotin tuaj dhe Shpëtimtarin tuaj* poshtë në ujë sipas

fjalës së tij, vini re, atëherë ju do të merrni Frymën e Shenjtë; po, atëherë vjen pagëzimi i zjarrit dhe i Frymës së Shenjtë”¹⁵.

Ordinanca e vendosjes së duarve për dhuratën e Frymës së Shenjtë kërkon që ne t’i *mirëbesojmë* Atij, të *mbështetemi* tek Ai, ta *ndjekim* Atë dhe të *shkojmë përpara* në Të me ndihmën e Shpirtit të Tij të Shenjtë. Ashtu siç shpalli Nefi: “Dhe tani, . . . e di se në qoftë se një njeri nuk duron deri në fund, duke ndjekur shembullin e Birit të Perëndisë së gjallë, ai nuk mund të shpëtohet”¹⁶.

Neni i katërt i besimit nuk përcakton thjesht parimet dhe ordinancat themelore të ungjillit të rivendosur. Përkundrazi, kjo thënie e frymëzuar për bindjen, i sjell në një krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat: *mirëbesimin* tek Ai dhe në Të, *mbështetjen* tek Ai, *ndjekjen* e Tij dhe *të shkuarit përpara* me Të – madje në Të.

Shembulli 2. Tani dua të përshkruaj mënyrën se si të gjitha programet dhe nismat e Kishës janë sjellë në një krye të vetëm, në Krishtin. Mund të paraqiten shumë ilustrime shtesë; unë do të përdor vetëm disa nga ato që kam përzgjedhur.

Në vitin 1978, Presidenti Spenser W. Kimball i udhëzoi anëtarët e Kishës që ta ndërtonin forcën e Sionit në mbarë botën. Ai i këshilloi shenjtorët të qëndronin në vendet e tyre të lindjes dhe të krijonin kunje të forta duke e mbledhur së bashku familjen e Perëndisë dhe duke u mësuar atyre udhët e Zotit. Ai më tej njoftoi se më shumë tempuj do të ndërtoheshin dhe premtoi beki-me për shenjtorët kudo që ata jetonin në botë.¹⁷

Ndërsa numri i kunjeve u rrit, u intensifikua nevoja që shtëpitë e anëtarëve të “bëheshin [vendet] ku pjesëtarët e familjes [donin shumë] të ishin, ku ata [mund] ta pasuronin jetën e tyre dhe të gjenin dashuri, përkrahje, mirënjohje dhe nxitje”¹⁸. Rrjedhimisht, në vitin 1980, takimet e së dielës u konsoliduan në një bllok tre orësh për të “ritheksuar përgjegjësinë vetjake dhe familjare për të mësuarit, të jetuarit dhe dhënien mësim të ungjillit”¹⁹. Ky theks te familja





dhe shtëpia u pohua sërish te dokumenti “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, të paraqitur nga Presidenti Gordon B. Hinkli në vitin 1995.²⁰

Në prill të vitit 1998, Presidenti Hinkli njoftoi ndërtimin e shumë tempujve më të vegjël, duke i sjellë në këtë mënyrë ordinancat e shenjta të shtëpisë së Zotit më pranë individëve dhe familjeve shenjtoje të ditëve të mëvonshme në mbarë botën.²¹ Dhe këto mundësi të shtuara për rritjen dhe zhvillimin shpirtëror, u plotësuan nga rritja që lidhet me mbështetjen materiale te vetja nëpërmjet paraqitjes së programit të Fondit të Qarkullueshëm Arsimor në vitin 2001.²²

Gjatë ushtrimit të detyrës të tij, Presidenti Tomas S. Monson në mënyrë të përsëritur i këshilloi shenjtorët të shkonin “në shpëtim [të të tjerëve]” dhe theksoi kujdesin për të varfrit e nevojtarët si një nga përgjegjësitë hyjnore caktuar Kishës. Duke e vazhduar vënien e theksit të përgatitja materiale, nisma për Shërbimet e Mbështetjes te Vetja u vu në zbatim në vitin 2012.

Gjatë viteve të kaluara, parimet themelore të bërjes së ditës së Shabatit një kënaqësi në shtëpi e në Kishë janë theksuar e përforcuar²³, duke na përgatitur në këtë mënyrë për përshtatjen e programit të mbledhjes të së dielës që u shpall në këtë sesion të konferencës së përgjithshme.

Dhe gjashtë muaj më parë, kuorimet e Priftërisë Melkizedeke u forcuan

dhe u rreshtuan në mënyrë më të efektshme me organizatat ndihmëse për të arritur një qasje më të lartë e më të shenjtë për të dhënë shërbesë.

Unë besoj se rendi dhe koha e këtyre veprimeve gjatë shumë dekadave, mund të na ndihmojnë të shohim një punë të bashkuar e tërësore dhe jo thjesht një sërë nismash të pavarura e të veçanta. “Perëndia ka zbuluar një model të përparimit shpirtëror për individët dhe familjet nëpërmjet ordinancave, mësimdhënies, programeve dhe veprimtarive që janë **të përqendruara te shtëpia dhe të mbështetura nga Kisha**. Organizatat dhe programet e Kishës ekzistojnë për t’i bekuar individët dhe familjet dhe nuk janë qëllime në vetvete.”²⁴

Lutem që të mund ta vlerësojmë punën e Zotit si një punë të madhe mbarëbotërore që po bëhet gjithnjë e më shumë e përqendruar te shtëpia dhe e mbështetur nga Kisha. Unë e di dhe dëshmoj se Zoti po zbulon dhe “përsëri do të zbulojë shumë gjëra të mëdha dhe të rëndësishme lidhur me Mbretërinë e Perëndisë.”²⁵

Premtim dhe Dëshmi

E fillova mesazhin tim duke theksuar fuqinë që krijohet teksa fjet individuale të materialit thuren ose gërshetohen së bashku në një litar. Në mënyrë të ngjashme, premtoj se perspektiva, qëllimi dhe fuqia e shtuar do të jenë të dukshme në të mësuarit dhe të jetuarit

e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit, ndërsa përpiqemi fort t’i sjellim në krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat – madje në Të.

Të gjitha mundësitë dhe bekimet që kanë pasojë të përjetshme e kanë origjinën, janë të mundshme dhe kanë qëllim në saje të Zotit Jezu Krisht dhe ato mbahen nëpërmjet Tij. Ashtu siç Alma dëshmoi: “Nuk ka udhë ose mjet tjetër, nëpërmjet të cilit njeriu mund të shpëtojë, por vetëm në dhe nëpërmjet Krishtit. Vër re, ai është jeta dhe drita e botës.”²⁶

Unë shpall plot gëzim dëshminë time për hyjinë dhe realitetin e gjallë të Atit të Amshuar dhe të Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit. Në Shpëtimtarin tonë, ne gjejmë gëzim. Dhe në Të ne gjejmë sigurinë e “paq[es] në këtë botë dhe [të] jet[ës] s[ë]l përjetshme në botën që vjen”²⁷. Kështu dëshmoj në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Efesianëve 1:10.
2. Gjoni 14:6.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:21–22.
4. Helamani 3:35.
5. Alma 5:14.
6. Shih Mateu 5:48; 3 Nefi 12:48.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:29.
8. Efesianëve 2:21.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 136:32.
10. Nenet e Besimit 1:4.
11. Moroni 7:28.
12. 2 Nefi 31:19.
13. 2 Nefi 2:8.
14. Shih 2 Korintasve 5:17.
15. 2 Nefi 31:13; theksimi i shtuar.
16. 2 Nefi 31:16.
17. Shih Spencer W. Kimball, “The Fruit of Our Welfare Services Labors”, *Ensign*, nëntor 1978, f. 76.
18. Udhëzime për presidencat e kunjit dhe peshkopatat, në “Church Consolidates Meeting Schedules”, *Ensign*, mars 1980, f. 73.
19. Udhëzime, në “Church Consolidates Meeting Schedules”, f. 73.
20. Shih “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145.
21. Shih Gordon B. Hinckley, “New Temples to Provide ‘Crowning Blessings’ of the Gospel”, *Ensign*, maj 1998, f. 87–88.
22. Shih Gordon B. Hinckley, “The Perpetual Education Fund”, *Liahona*, korrik 2001, f. 60–62, 67.
23. Shih Rasëll M. Nelson, “Shabati Është një Kënaqësi”, *Liahona*, maj 2015, f. 129–132.
24. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 1.4; theksimi i shtuar.
25. Nenet e Besimit 1:9.
26. Alma 38:9.
27. Doktrina e Besëlidhje 59:23.



Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

E Vërteta dhe Plani

Kur kërkojmë të vërtetën rreth fesë, ne duhet të përdorim metoda shpirtërore të përshtatshme për atë kërkim.

Zbulesa moderne e përcakton të vërtetën si “dituri për gjërat siç janë dhe siç ishin, dhe siç do të jenë” (Doktrina e Besëlidhje 93:24). Ky është një përkufizim i përsosur për planin e shpëtimit dhe deklaratën “Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës”.

Ne jetojmë në një kohë kur informacioni përhapet dhe komunikohet gjerësisht. Por jo i gjithë ky informacion është i vërtetë. Ne kemi nevojë të jemi të vëmendshëm kur e kërkojmë të vërtetën dhe kur zgjedhim burime për atë kërkim. Nuk duhet ta konsiderojmë famën ose pozitën laike si burime të kualifikuara të së vërtetës. Ne duhet të jemi të vëmendshëm kur mbështetemi tek informacioni ose këshilla e ofruar nga yjet e fushave të argëtimit, sportistët me famë apo burime anonime në internet. Ekspertiza në një fushë nuk duhet të merret si ekspertizë mbi të vërtetën për tema të tjera.

Ne gjithashtu duhet të jemi të vëmendshëm rreth shtysës së atij që e jep informacionin. Kjo është arsyeja përse shkrimet e shenjta na paralajmërojnë kundrejt intrigave të priftërinjve (shih 2 Nefi 26:29). Nëse burimi është anonim ose i panjohur, informacioni mund të jetë gjithashtu i dyshimtë.

Vendimet tona vetjake duhet të bazohen mbi informacione nga burime

që janë të kualifikuara për temën dhe të çliruara nga shtysat egoiste.

1.

Kur kërkojmë të vërtetën rreth fesë, ne duhet të përdorim metoda shpirtërore të përshtatshme për atë kërkim: lutjen, dëshminë e Frymës së Shenjtë dhe studimin e shkrimeve të shenjta dhe të fjalëve të profetëve modernë. Jam gjithmonë i trishtuar kur dëgjoj për dikë që raporton humbje të besimit fetar për shkak të mësimave laike.

Ata që dikur patën largpamësi shpirtërore, mund të vuajnë nga verbëria shpirtërore e vetëshkaktuar. Siç tha Presidenti Henri B. Ajring: “Problemi i tyre nuk qëndron tek ajo që mendojnë se e shohin; ai qëndron tek ajo që ende nuk mund ta shohin”¹.

Metodat e shkencës na çojnë drejt asaj që ne e quajmë e vërtetë shkencore. Por “e vërteta shkencore” nuk është tërësia e jetës. Ata që nuk mësojnë “me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (Doktrina e Besëlidhje 88:118), e kufizojnë kuptueshmërinë e tyre për të vërtetën në atë që mund ta vërtetojnë nëpërmjet mjeteve shkencore. Kjo vendos kufizime artificiale në kërkimin e tyre për të vërtetën.

Presidenti Xhejms E. Faust tha: “Ata që janë [pagëzuar], e vënë në rrezik qenien e tyre të përjetshme duke ndjekur pa kujdes vetëm burimin laik të të mësuarit. Ne besojmë se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme ka plotësinë e ungjillit të Krishtit, ungjill i cili është thelbi i së vërtetës dhe njohuria e përjetshme.”²

Ne gjejmë gëzim të vërtetë dhe afatgjatë duke arritur të dimë dhe të veprojmë sipas së vërtetës se kush jemi, cili është kuptimi i jetës në vdekshmëri dhe ku do të shkojmë kur vdesim. Ato të vërteta nuk mund të mësohen me anë të metodave shkencore ose laike.





II.

Tani do të flas për të vërtetat e ungjillit të rivendosur, të cilat janë themelore për doktrinën e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ju lutem, shqyrtojini këto të vërteta me kujdes. Ato shpjegojnë shumë rreth doktrinës dhe praktikave tona, ndofta duke përfshirë disa gjëra që ende nuk kuptohen.

Ka një Perëndi, i cili është Ati i dashur i shpirtave të të gjithë atyre që kanë jetuar ose që do të jetojnë ndonjëherë.

Gjinia është e përjetshme. Përpara se të lindeshim në këtë tokë, ne të gjithë jetuam si shpirta meshkuj ose femra në praninë e Perëndisë.

Sapo e kemi dëgjuar Korin e Tabernakullit të Sheshi i Tempullit të këndojë “I Will Follow God’s Plan” [“Do Ndjek Planin e Perëndisë”]³. Ai është plani që krijoi Perëndia, në mënyrë që të gjithë fëmijët e Tij shpirtërorë të mund të përparonin përjetësisht. Ai plan është jetik për secilin prej nesh.

Sipas atij plani, Perëndia e krijoi këtë tokë si një vend ku fëmijët e Tij të dashur shpirtërorë të mund të lindeshin në vdekshmëri për të marrë një trup fizik dhe për të pasur mundësinë për përparim të përjetshëm duke bërë zgjedhje të drejta.

Që të jenë domethënëse, zgjedhjet në vdekshmëri duhej të bëheshin midis forcave kundërshtuese të së mirës dhe së keqes. Duhej të kishte kundërshtim

dhe, si rrjedhojë, një kundërshtar, i cili u flak tej për shkak të rebelimit dhe u lejua t’i tundonte fëmijët e Perëndisë që të vepronin në kundërshtim me planin e Perëndisë.

Qëllimi i planit të Perëndisë ishte që t’u jepte fëmijëve të Tij mundësinë që të zgjidhnin jetë të përjetshme. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet përvojës në vdekshmëri dhe, pas vdekjes, nëpërmjet rritjes pas vdekshmërisë në botën e shpirtave.

Gjatë jetës në vdekshmëri, ne të gjithë do të ndoteshim nga mëkati kur u hapnim udhë tundimeve të liga të kundërshtarit dhe përfundimisht do të vdisnim. Ne i pranuan ato sfida duke u mbështetur te siguria e planit se Perëndia, Ati ynë, do të jepte një Shpëtimtar, Birin e Tij të Vetëmlindur, i cili do të na shpëtonte nëpërmjet një ringjalljeje të përbotshme drejt një jete me një trup pas vdekjes. Shpëtimtari gjithashtu do të siguronte një shlyerje për të paguar çmimin që të gjithë të pastroheshin nga mëkati sipas kushteve që caktoi Ai. Ato kushte përfshinin besimin te Krishti, pendimin, pagëzimin, dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe ordianca të tjera të kryera nëpërmjet autoritetit të priftërisë.

Plani i madh i Perëndisë për lumturinë siguron një baraspeshim të përsosur midis drejtësisë së përjetshme dhe mëshirës që mund ta marrim nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ai gjithashtu na aftëson të shndërrohemi në krijesa të reja në Krishtin.

Një Perëndi i dashur ia shtrin dorën secilit prej nesh. Ne e dimë se nëpërmjet dashurisë së Tij dhe për shkak të Shlyerjes së Birit të Tij të Vetëmlindur, “*i gjithë* njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordiancave të Ungjillit [të Tij]” (Nenet e Besimit 1:3; theksimi i shtuar).

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme njihet me të drejtë si një Kishë e përqendruar te familja. Por ajo që nuk kuptohet mirë, është se përqendrimi i vëmendjes sonë te familja vendoset mbi diçka më shumë sesa marrëdhëniet në vdekshmëri. Marrëdhëniet e përjetshme janë gjithashtu themelore për teologjinë tonë. “Familja shugurohet nga Perëndia.”⁴ Sipas planit të madh të Krijuesit tonë të dashur, misioni i Kishës së Tij të rivendosur është që t’i ndihmojë fëmijët e Perëndisë për të arritur bekimin hyjnor të ekzaltimit në mbretërinë çelestiale, i cili mund të merret vetëm nëpërmjet një martese të përjetshme midis një burri dhe një gruaje (shih Doktrina e Besëlidhje 131:1–3). Ne i pohojmë mësimet e Zotit se “gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme” dhe se “martesa midis burrit dhe gruas është thelbësore në planin e Tij të përjetshëm”⁵.

Së fundi, dashuria e Perëndisë është kaq e madhe sa, përveç disave që me dëshirë bëhen bij të humbjes, Ai ka siguruar një fat lavdie për të gjithë fëmijët e Tij. Fraza “të gjithë fëmijët e Tij” përfshin të gjithë ata që kanë vdekur. Ne kryejmë ordianca për ta në mënyrë mëkëmbëse në tempujt tanë. Qëllimi i Kishës së Jezu Krishtit është t’i kualifikojë fëmijët e Tij për shkallën më të lartë të lavdisë, që është ekzaltimi ose jeta e përjetshme. Për ata që nuk kanë dëshirë ose që nuk janë të denjë për të, Perëndia ka siguruar mbretëri të tjera, edhe pse më të pakta, lavdie.

Kushdo që i kupton këto të vërteta të përjetshme, mund ta kuptojë përse ne anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme mendojmë në mënyrën që mendojmë dhe sillemi në mënyrën që sillemi.

III.

Tani do të përmend disa zbatime të këtyre të vërtetave të përrjetshme, të cilat mund të kuptohen vetëm nën dritën e planit të Perëndisë.

Së pari, ne e nderojmë lirinë individuale të zgjedhjes. Shumica e njerëzve janë të vetëdijshëm për përpjekjet e mëdha të Kishës së rivendosur që të nxitë lirinë fetare në Shtetet e Bashkuara dhe anëmbanë botës. Këto përpjekje nuk nxitin thjesht interesat tona vetjake, por, në përputhje me planin e Tij, ato përpiqen t'i ndihmojnë të gjithë fëmijët e Perëndisë që të gëzojnë lirinë për të zgjedhur.

Së dyti, ne jemi një popull misionar. Nganjëherë na pyetin përse dërgojmë misionarë në kaq shumë vende, edhe mes popullatave të krishtera. E njëjta pyetje na bëhet rreth arsyes se përse u japim shumë miliona dollarë si ndihmë humanitare njerëzve që nuk janë anëtarë të Kishës sonë dhe përse nuk e lidhim këtë ndihmë me përpjekjet tona misionare. E bëjmë këtë ngaqë ne i vlerësojmë të gjithë njerëzit e vdekshëm si fëmijë të Perëndisë – si vëllezërit e motrat tona – dhe duam ta ndajmë begatinë tonë shpirtërore dhe materiale me çdo njeri.

Së treti, jeta në vdekshmëri është e shenjtë për ne. Zotimi ynë ndaj planit të Perëndisë na kërkoi që ta kundërshtojmë abortin dhe eutanazinë [vdekjen pa vuajtje].

Së katërti, disa njerëz shqetësohen nga disa prej qëndrimeve të Kishës sonë mbi martesën dhe fëmijët. Njohuria jonë për planin e zbuluar nga Perëndia për shpëtimin na kërkoi që t'i kundërshtojmë trysnitë e tanishme shoqërore dhe ligjore për t'u larguar prej martesës tradicionale dhe për të bërë ndryshime që e ngatërrojnë ose ndryshojnë gjininë apo që i njëtrajtësojnë dallimet midis burrave dhe grave. Ne e dimë se marrëdhëniet, identitetet dhe funksionet e burrave dhe të grave janë thelbësore për ta përmbushur planin e madh të Perëndisë.

Së pesti, ne gjithashtu kemi një këndvështrim të dallueshëm lidhur me fëmijët. Ne e shohim lindjen dhe rritjen e fëmijëve si pjesë të planit të Perëndisë



dhe si një detyrë të gëzueshme dhe të shenjtë për ata të cilëve u është dhënë fuqia të marrin pjesë në të. Sipas pikëpamjes sonë, thesaret më të mëdha në tokë dhe në qiell janë fëmijët tanë dhe pasardhësit tanë. Si rrjedhim, ne duhet të japim mësim dhe të mbrojmë parime e praktika që sigurojnë kushtet më të mira për zhvillimin dhe lumturinë e fëmijëve – të të gjithë fëmijëve.

Së fundi, ne jemi fëmijë të dashur të një Ati Qiellor, i cili na ka mësuar se të qenit mashkull e femër, martesë midis një burri e një gruaje, lindja dhe rritja e fëmijëve janë të gjitha thelbësore në planin e Tij të madh për lumturinë. Qëndrimet tona ndaj këtyre pjesëve thelbësore shpesh shkaktojnë kundërshtim ndaj Kishës. Ne e konsiderojmë këtë të pashmangshme. Kundërshtimi është pjesë e planit dhe kundërshtimi më i madh i Satanit drejtohet ndaj çdo gjëje që është më e rëndësishmja për planin e Perëndisë. Ai përpiket ta shkatërrojë veprën e Perëndisë. Metodat e tij kryesore janë që të diskreditojë Shpëtimtarin dhe autoritetin e Tij hyjnor, të fshijë efektet e Shlyerjes së Jezu Krishtit, të shkurajojë pendimin,

të falsifikojë zbuluesin dhe të kundërshtojë përgjegjshmërinë individuale. Ai gjithashtu përpiket ta ngatërrojë gjininë, ta shtrembërojë martesën dhe ta shkurajojë lindjen e fëmijëve – veçanërisht nga prindërit që do t'i rritin fëmijët me të vërtetën.

IV.

Vepra e Zotit po ecën përpara pavarësisht nga kundërshtimi i organizuar dhe i vazhdueshëm me të cilin përballlemi, teksa përpiqemi fort të ushtrojmë mësimet e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Për ata që lëkunden për shkak të atij kundërshtim, unë ofroj këto sugjerime.

Mbani mend parimin e pendimit që u bë i mundur nga fuqia e Shlyerjes së Jezu Krishtit. Siç na nxiti Plaku Nil A. Maksuell, mos jini mes atyre “të cilët do të donin të përpiqeshin të ndryshonin Kishën, në vend që të ndryshonin vetveten”⁶.

Ashtu siç na nxiti Plaku Xhefri R. Holland:

“Mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa vjen dija e mëtejshme. . . .

... Në këtë Kishë, ajo që dimë gjithmonë do ta kapërcejë atë që nuk e dimë.”⁷

Ushtroni besim te Zoti Jezu Krisht, që është parimi i parë i ungjillit.

Së fundi, kërkoni ndihmë. Udhëheqësit tanë të Kishës ju duan dhe kërkojnë udhërrëfim shpirtëror për t’ju ndihmuar. Ne sigurojmë shumë burime si ato që do t’i gjeni nëpërmjet faqes LDS.org në internet dhe përkrahje të tjera për studimin e ungjillit në shtëpi. Ne gjithashtu kemi vëllezër e motra shërbestare, që janë thirrur të japin ndihmë plot dashuri.

Ati ynë i dashur Qiellor dëshiron që fëmijët e Tij të kenë gëzimin që është qëllimi i krijimit tonë. Ai fat plot gëzim është jeta e përjetshme, të cilën mund ta fitojmë duke shkuar përpara nëpër atë shteg që profeti ynë, Presidenti Rasëll M. Nelson, shpesh e quan “shtegu i besëlidhjeve”. Ja se çfarë tha ai në mesazhin e tij të parë si President i Kishës: “Qëndroni në shtegun e besëlidhjeve. Zotimi juaj për ta ndjekur Shpëtimtarin nëpërmjet bërjes së besëlidhjeve me Të dhe më pas nëpërmjet mbajtjes së atyre besëlidhjeve, do ta hapë derën drejt çdo bekimi dhe privilegji shpirtëror në dispozicion të burrave, grave dhe fëmijëve kudo.”⁸

Unë dëshmoj solemnisht se gjërat që kam thënë, janë të vërteta dhe ato janë bërë të mundura nëpërmjet mësimëve dhe Shlyerjes së Jezu Krishtit, i cili e bën gjithçka të mundur sipas planit të madh të Perëndisë, Atit tonë të Amshuar. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Henry B. Eyring, *To Draw Closer to God: A Collection of Discourses* (1997), f. 143.
2. James E. Faust, “The Abundant Life”, *Ensign*, nëntor 1985, f. 9.
3. “I Will Follow God’s Plan”, *Children’s Songbook*, f. 164–165.
4. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145.
5. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, f. 145.
6. Neal A. Maxwell, *If Thou Endure It Well* (1996), f. 101.
7. Xhefri R. Holland, “Unë Besoj, o Zot”, *Liahona*, maj 2013, f. 94; theksimi në origjinal.
8. Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 7.



Paraqitur nga Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Vëllezër dhe motra, unë tani do t’ju paraqit Autoritetet e Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndhmëse të Kishës për votën tuaj mbështetëse.

Propozohet që ne të mbështetim: Rasëll Marion Nelson, si profet, shikues e zbulues dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Dallin Harris Ouks, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta shfaqin atë.

Propozohet që ne të mbështetim Dallin H. Ouks si President të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe M. Rasëll Ballard si President Veprues të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta shfaqë.

Propozohet që ne të mbështetim sa vijojnë si anëtarë të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk,

D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson,



Dejll G. Renland, Gerit W. Gong dhe Ulises Soares.

Atyre që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ndonjë kundër, mund ta bëjë të ditur po ashtu.

Propozohet që ne t'i mbështetim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Kundër, në qoftë se ka ndonjë, me të njëjtën shenjë.

Propozohet që ne të mbështetim Bruk P. Hejlsin, i cili është thirrur të shërbejë si Autoritet i Përgjithshëm, I Shtatëdhjetë.

Atyre që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta shfaqin po ashtu.

Propozohet që ne t'i lirojmë nga thirrja me vlerësim për shërbimin e tyre të përkushtuar Pleqtë Mervin B. Arnold, Krejg A. Kardon, Leri J. Eko Houk,

C. Skot Grou, Alen F. Paker, Gregori A. Shvicer dhe Klaudio D. Zivic si Autoritete të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë, si dhe t'u japim atyre pozicion nderi.

Atyre që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohje këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre të shquar, u lutemi ta shfaqin.

Propozohet që ne t'i lirojmë nga thirrjet sa vijojnë si Të Shtatëdhjetë Zonalë: B. Serhio Antunes, Alan C. Bat, R. Randall Bluth, Hans T. Bum, Fernando E. Kalderon, H. Marselo Kardus, Pol R. Kauërd, Marion B. De Antunjano, Robert A. Drajden, Daniel F. Danigën, Xhefri D. Eriksën, Mervin C. Gidi, Zhoao Roberto Gral, Riçard K. Hansen, Tod B. Hansen, Majkëll R. Xhensen, Daniel W. Xhons, Stiven O. Leng, Aksel H. Lajmer, Tasara Makasi, Alvin F. Meredith III, Adonai S. Obando, Kacujuki Otahara, Fred A. Parker, Hoze C. Pineda, Geri S. Prais, Migel A. Rejes, Alfredo L. Salas, Netsahualkojotëll Salinas, Majkëll L. Sauthuërd, G. Lorens Spekmen,

Uilliam H. Stodard, Stiven E. Tompson, Dejvid J. Tomson, Xhorxh J. Tobajas, Zhak A. Van Renen, Raul Edgardo A. Vicensio, Kith P. Uolker dhe Daniel Jirenia-Tauia.

Atyre që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin për shërbimin e tyre të shkëlqyer, u lutemi ta shfaqin.

Propozohet që ne t'i mbështetim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetë Zonalë dhe Presidentat e Përgjithshme të Organizatave Ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Kundër, në qoftë se ka ndonjë, me të njëjtën shenjë.

Ata që ishin kundër ndonjërit prej propozimeve, duhet të vihen në kontakt me presidentin e kunjtit të tyre.

Vëllezër dhe motra, ne jemi mirënjohës për besimin dhe lutjet tuaja të vazhdueshme në emrin e udhëheqësve të Kishës. ■





Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

I Vendosur dhe i Paepur në Besimin te Krishti

Për të qëndruar i vendosur dhe i paepur në besimin te Krishti kërkohet që ungjilli i Jezu Krishtit të depërtojë në zemrën dhe shpirtin e individit.

Në historinë e Dhiatës së Vjetër, lexojmë për periudha të njëpasnjëshme kur fëmijët e Izraelit e nderuan besëlidhjen e tyre me Jehovën dhe e adhuruan Atë dhe raste të tjera kur e shpërfillën atë besëlidhje dhe adhuruan idhuj ose Baalin.¹

Mbretërimi i Ashabit ishte një nga periudhat e braktisjes në mbretërinë veriore të Izraelit. Profeti Elia në një rast i tha mbretit Ashab që ta mblidhte popullin e Izraelit si edhe profetët ose priftërinjtë e Baalit në malin e Karmelit. Kur populli ishte mbledhur tok, Elia u tha atyre: “Deri kur do të lëkundeni midis dy mendimeve? [ose me fjalë të tjera: ‘Kur do të vendosni një herë e mirë?'] Në qoftë se Zoti është Perëndia, shkoni pas tij; por në qoftë se përkundrazi është Baali, atëherë ndiqni atë. Populli nuk tha asnjë fjalë.”² Ndaj Elia udhëzoi që si ai edhe profetët e Baalit të copëtonin një viç dhe ta vendosnin në një shtrat prej druri në altarët e tyre përkatës, por “pa i ndezur ato”.³ Pastaj “ju do t’i bëni thirrje perëndisë suaj dhe unë do të thërres Zotin; perëndia që do të përgjigjet me anë të zjarrit është Perëndia. Tërë populli u përgjigj dhe tha: ‘E the bukur!’”⁴

Do t’ju kujtohet se priftërinjtë e Baalit i thirrën me zë të fortë për orë të tëra perëndisë së tyre që nuk ekzistonte, që të dërgonte zjarr, por “nuk u dëgjua asnjë zë, asnjëri nuk u përgjigj dhe askush nuk ua vuri veshin”.⁵ Kur erdhi radha e Elias, ai e rregulloi altarin e thyer të Zotit, vendosi drunjtë dhe blatimin mbi të dhe pastaj urdhëroi që e gjitha të mbushej me ujë, jo një herë por tri herë. Nuk kishte fare dyshim që as ai, as ndonjë fuqi tjetër njerëzore nuk mund ta ndizte zjarrin.

“Në orën që ofrohej blatimi, profeti Elia u afrua dhe tha: ‘O Zot, Perëndia i Abrahamit, i Isakut dhe i Izraelit, vepronë mënyrë të tillë që të dihet që ti je Perëndi në Izrael, që unë jam shërbëtori yt që i bëra tërë këto gjëra me urdhrin tënd’. . . .

Atëherë ra zjarri i Zotit dhe konsumoi olokaustin, drutë, gurët dhe pluhurin, si dhe thau ujin që ishte në gropë.

Para kësaj pamjeje tërë populli u shtri me fytyrën për tokë dhe tha: ‘Zoti është Perëndia!’”⁶

Sot Elia mund të thotë:

- Ose Perëndia, Ati ynë Qiellor, ekziston, ose Ai nuk ekziston, por nëse ekziston, adhurojeni Atë.
- Ose Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, Shëlbuesi i ringjallur i njerëzimit, ose Ai nuk është, por nëse është, ndiqeni Atë.
- Ose Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë ose nuk është, por nëse është, atëherë “afro[juni] më shumë Perëndisë duke [i studiuar dhe] duke iu bindur porosive të tij”⁷.
- Ose Jozef Smithi i pa dhe bisedoi me Atin dhe Birin atë ditë pranverë të vitit 1820, ose nuk i pa dhe nuk bisedoi, por nëse i pa dhe bisedoi, atëherë ndiqeni mantelin profetik, duke përfshirë çelësat e vulosjes që unë, Elia, ia dhashë atij.

Në konferencën e përgjithshme më të fundit, Presidenti Rasëll M. Nelson shpalli: “Nuk keni përse ta pyesni veten



se çfarë është e vërtetë [shih Moroni 10:5]. Nuk keni përse ta pyesni veten se kujt mund t'i mirëbesoni me siguri. Nëpërmjet zbulesës vetjake, ju mund të merrni vetë dëshminë tuaj se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë, se Jozef Smithi është një profet dhe se kjo është Kisha e Zotit. Pavarësisht nga ajo që mund të thonë ose bëjnë të tjerët, askush nuk mund ta largojë asnjëherë një dëshmi të lindur në zemrën dhe mendjen tuaj për atë që është e vërtetë.”⁸

Kur Jakobi premtoi se Perëndia “u jep të gjithëve pa kursim”, që e kërkojnë urtësinë e Tij⁹, ai gjithashtu paralajmëroi:

“Por le ta kërkojë me besim, pa dyshuar, sepse ai që dyshon i ngjan valës së detit, të cilën e ngre dhe e përplas era.

Dhe ky njeri të mos pandehë se do të marrë diçka nga Zoti, sepse është një njeri me dy mendje, i paqëndrueshëm në gjithë rrugët e veta.”¹⁰

Shpëtimtari ynë, nga ana tjetër, ishte shembulli i përsosur i qëndrueshmërisë. Ai tha: “Ati s’më ka lënë vetëm, sepse bëj *vazhdimisht* gjërat që i pëlqejnë”¹¹. Merrini parasysh këto përshkrime nga shkrimet e shenjta të burrave dhe grave që, sikurse Shpëtimtari, ishin të vendosur dhe të paepur:

Ata “ishin kthyer në besimin e vërtetë; dhe ata nuk donin të ndahehin prej saj, pasi ishin të vendosur dhe të paepur dhe të palëkundshëm, duke dashur me gjithë zell të zbatonin urdhërimet e Zotit”¹².

“Mendjet e tyre janë të vendosura dhe ata e vendosin përherë besimin e tyre në Perëndi.”¹³

“Dhe vini re, ju vetë e dini, pasi ju e keni dëshmuar atë, se të gjithë ata që janë sjellë në njohurinë e së vërtetës . . . janë të vendosur dhe të paepur në besimin dhe në gjënë me të cilën ata janë bërë të lirë.”¹⁴

“Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje.”¹⁵

Për të qëndruar i vendosur dhe i paepur në besimin te Krishti kërkohet që ungjilli i Jezu Krishtit të depërtojë në



zemrën dhe shpirtin e individit, që do të thotë që ungjilli bëhet jo vetëm një nga shumë prej ndikimeve në jetën e një personi, por përqendrimi përcaktues i jetës ose karakterit të tij apo të saj. Zoti thotë:

“Do t’ju jap një zemër të re dhe do të shtie brenda jush një shpirt të ri; do të heq nga mishi juaj zemrën prej guri dhe do t’ju jap zemër prej mishi.

Do të vë brenda jush Shpirtin tim dhe do të bëj që ju të ecni sipas statuteve të mia, dhe ju do të respektoni dhe do të zbatoni në praktikë dekretet e mia.

. . . Ju do të jeni populli im dhe unë do të jem Perëndia juaj.”¹⁶

Kjo është besëlidhja që bëjmë nëpërmjet pagëzimit tonë dhe në ordnancat e tempullit. Por disa njerëz nuk e kanë marrë ende plotësisht ungjillin e Jezu Krishtit në jetën e tyre. Ndonëse, sikurse thotë Pali, ata u “varrosë[n] me [Krishtin] me anë të pagëzimit”, atyre u mungon ende pjesa “ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish . . . , kështu edhe ne . . . [duhet] të ecim në risinë e jetës”¹⁷. Ungjilli ende nuk

i përkufizon ata. Ata ende nuk janë përqendruar te Krishti. Ata janë përzgjedhës për doktrinat dhe urdhërimet që do të zbatojnë, dhe për vendin ku e kohën kur do të shërbejnë në Kishë. Në kontrast, është nga mbajtja e besëlidhjeve të tyre me saktësi që ata “që janë të zgjedhurit sipas besëlidhjes”¹⁸, e shmangin mashtrimin dhe qëndrojnë të vendosur në besimin te Krishti.

Shumica prej nesh në këtë çast e gjejnë veten në vazhden midis një pjesëmarrjeje të nxitur nga shoqëria në ritualet e ungjillit nga njëra anë dhe një zotimi të zhvilluar plotësisht e si të Krishtit ndaj vullnetit të Perëndisë nga ana tjetër. Diku gjatë asaj vazhde, lajmi i mirë i ungjillit të Jezu Krishtit hyn në zemrën tonë dhe e merr në zotërim shpirtin tonë. Kjo mund të mos ndodhë në një çast, por ne të gjithë duhet të lëvizim drejt asaj gjendjeje të bekuar.

Është sfiduese por jetike të qëndrosh i vendosur dhe i paepur kur e gjen veten të rafinuar “në furrën e pikëllimit”¹⁹, diçka që vjen herët a vonë tek të gjithë ne në vdekshmëri. Pa Perëndinë, këto përvoja të errëta



priren drejt shkurajimit, dëshpërimin dhe madje hidhërimin. Me Perëndinë, qetësimi e zëvendëson dhembjen, paqja e zëvendëson trazirën dhe shpresa e zëvendëson pikëllimin. Të qëndruarit i vendosur në besimin te Krishti do të sjellë hirin dhe përkrahjen mbështetëse të Tij.²⁰ Ai do ta shndërrojë sprovën në bekim dhe sipas fjalëve të Isaia, do të “[japë] . . . një diademë në vend të hirit”²¹.

Më lejoni të përmend tre shembuj për të cilët kam njohuri vetjake:

Është një grua e cila vuan nga një sëmundje ligështuese dhe kronike, që këmbëngul pavarësisht nga vëmendja mjekësore, bekimet e priftërisë dhe agjërimit e lutjet. Prapëseprapë, besimi i saj te fuqia e lutjes dhe realiteti i dashurisë që Perëndia ka për të, nuk janë zvogëluar. Ajo ngulmon ditë pas dite (dhe ndonjëherë orë pas ore) të shërbejë në thirrjet që merr në Kishë, dhe bashkë me bashkëshortin e saj, kujdeset për familjen e saj të re, duke buzëqeshur aq sa mundet. Dhembshuria e saj për të tjerët i ka rrënjët e thella, e rafinuar nga vetë vuajtja e saj, dhe

ajo shpesh e humb veten në dhënien e shërbesës ndaj të tjerëve. Ajo vazhdon e paepur dhe njerëzit ndihen të lumtur kur janë rreth saj.

Një burrë që u rrit në Kishë, shërbeu si misionar kohëplotë dhe u martua me një grua të hijshme, u befasua kur disa prej motrave dhe vëllezërve të tij filluan të flisnin me kritika për Kishën dhe Profetin Jozef Smith. Pas njëfarë kohe ata u larguan nga Kisha dhe u përpoqën ta bindnin atë që t'i ndiqte. Siç ndodh shpesh në të tilla raste, ata e bombarduan me ese, transmetime dhe materiale filmike të krijuara nga kritikët, shumë prej të cilëve ishin vetë ish-anëtarë të pakënaqur të Kishës. Motrat dhe vëllezërit e tij e përqeshën për besimin që kishte, duke i thënë se ishte sylesh dhe i shpërkënditur. Ai nuk kishte përgjigje për të gjitha pohimet e tyre dhe besimi i tij filloi të lëkundej nga kundërshtimi i pamëshirshëm. Ai pyeste veten nëse duhet të ndalonte së shkuari në kishë. Foli me bashkëshorten. Foli me njerëz të cilëve u besonte. U lut. Ndërsa meditoi për këtë gjendje mendore të trazuar, ai solli ndërmend

rastet kur e kishte ndier Shpirtin e Shenjtë dhe kishte marrë një dëshmi për të vërtetën me anë të Shpirtit. Ai doli në përfundimin: “Nëse jam i ndershëm me veten, duhet ta pranoj se Shpirti më ka prekur më shumë se një herë dhe dëshmia nga Shpirti është e vërtetë”. Ai ka një ndjenjë të përtëritur lumturie dhe paqeje që e ka edhe bashkëshortja dhe fëmijët e tij.

Një bashkëshort dhe bashkëshorte që e kanë ndjekur vazhdimisht dhe me gëzim këshillën e Vëllezërve në jetën e tyre, u vrerosën nga vështirësia që përjetuan për të pasur fëmijë. Ata shpenzuan fonde të konsiderueshme duke punuar me profesionistë mjekësorë të aftë dhe pas njëfarë kohe, ata u bekuan me një djalë. Tragjikisht, sidoqoftë, pas afro vetëm një viti, foshnja ishte viktimë e një aksidenti që nuk ishte faji i askujt, por që e la atë në gjendje thuajse të pandërgjegjshme, me dëme të konsiderueshme në tru. Ai ka marrë kurimin më të mirë, por doktorët nuk mund ta parashikojnë se si do të shpalosen gjërat në të ardhmen. Fëmija për të cilin ky çift punoi dhe u

lut kaq shumë për të ardhur në botë, në njëfarë mënyre u është marrë dhe ata nuk e dinë nëse ai do t'u kthehet atyre. Tani ata përpiqen të kujdesen për nevojat kritike të foshnjës së tyre, ndërsa përmbushin përgjegjësitë e tyre të tjera. Në këtë çast jashtëzakonisht të vështirë, ata janë kthyer te Zoti. Ata mbështeten te “buk[la e] nevojshme” që marrin prej Tij. Ata ndihmohen nga miqtë dhe familja e dhembshur dhe forcohen nga bekimet e priftërisë. Ata janë afruar më pranë njëri-tjetrit, bashkimi i tyre ndoshta tani është më i thellë dhe më i plotë sesa mund të kishte qenë i mundur në të kundërt.

Më 23 korrik 1837, Zoti i dha një zbulësë Presidentit të dikurshëm të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, Tomas B. Marshit. Ajo përfshiu sa vijon:

“Dhe lutu për vëllezërit e tu të të Dymbëdhjetëve. Këshilloji ata fort për hir të emrit tim dhe ata duhet të qortohen për gjithë mëkatet e tyre dhe ti duhet të jesh besnik përpara meje për emrin tim.

Dhe pas tundimeve të tyre dhe shumë shqetësimi, vër re, unë, Zoti, do t'u afrohem atyre dhe nëse ata nuk i ngurtësojnë zemrat e tyre dhe nuk i forcojnë kokat e tyre kundër meje, ata do të kthehen në besim dhe unë do t'i shëroj.”²²

Unë besoj se parimet që janë shprehur te këto vargje, gjejnë zbatim për të gjithë ne. Tundimet dhe fatkeqësitë që ne përjetojmë, bashkë me çdo provë që Zoti sheh të përshtatshme të na i ngarkojë, mund të çojnë në shërimin dhe kthimin tonë të plotë në besim. Por kjo ndodh nëse, dhe vetëm nëse, nuk i ngurtësojmë zemrat tona apo bëhemi kryelartë kundrejt Tij. Nëse qëndrojmë të vendosur dhe të paepur, pavarësisht se çfarë ndodh, ne e arrijmë kthimin në besim që kishte ndër mend Shpëtimtari kur i tha Pjetrit: “Kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu”²³, një kthim në besim aq i plotë sa që nuk mund të zhbëhet. Shërimi i premtuar është pastrimi dhe shenjtërimi i shpirtrave tanë të plagosur nga mëkati, duke na bërë të shenjtë.

Më kujtohet këshilla e mamasë sime: “Haji perimet; do të të bëjnë mirë”.



Nënat tona kanë të drejtë, dhe në kontekstin e vendosmërisë në besim, “të hash perimet” do të thotë të lutesh vazhdimisht, të ushqehesh me bollëk çdo ditë me shkrimet e shenjtë, të shërbesh dhe të adhurosh në Kishë, të marrësh denjësisht sakramentin çdo javë, të duash fqinjin tënd dhe të marrësh mbi vete kryqin si bindje ndaj Perëndisë çdo ditë.²⁴

Gjithmonë mbajeni mend premtimin se gjëra të mira do të vijnë, si tani edhe në të ardhmen, për ata që janë të vendosur dhe të paepur në besimin te Krishti. Kujtojeni “jetën e përjetshme dhe . . . gëzimin e shenjtoreve”²⁵. “O të gjithë ju që jeni të kulluar në zemër, ngrini lart kokat tuaja dhe merrni fjalën e këndshme të Perëndisë dhe ushqehuni me bollëk me dashurinë e tij; pasi ju mund ta bëni, në qoftë se mendjet tuaja janë të forta përgjithmonë.”²⁶ Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta, “Baal”.
2. 1 Mbretërve 18:21.
3. 1 Mbretërve 18:23.
4. 1 Mbretërve 18:24.
5. 1 Mbretërve 18:29.
6. 1 Mbretërve 18:36, 38–39.
7. Parathënia për Librin e Mormonit.
8. Rasëll M. Nelson, “Zbulësë për Kishën, Zbulësë për Jetën Tonë”, *Liahona*, maj 2018, f. 95.
9. Shih Jakob [Bibël] 1:5.
10. Jakob [Bibël] 1:6–8.

11. Gjoni 8:29; theksimi i shtuar.
12. 3 Nefi 6:14; shih edhe Alma 27:27.
13. Alma 57:27.
14. Helamani 15:7–8.
15. Veprat e Apostujve 2:42.
16. Ezekiel 36:26–28; shih edhe 2 Korintasve 3:3.
17. Romakëve 6:4.
18. Shih Joseph Smith – Mateu 1:22–23; shih edhe Mateu 24:24–25.
19. 1 Nefi 20:10; shih edhe Isaia 48:10.
20. Ashtu si Zoti i tha Jozef Smithit 22-vjeçar pas humbjes së një pjese të përkthimit të Librit të Mormonit: “Nuk duhet të frikësohesh më shumë nga njeriu sesa nga Perëndia. . . . Ai do të të kishte shtrirë krahan e tij dhe do të të kishte mbështetur ndaj gjithë shigjetave të zjarra të të ligut; dhe ai do të kishte qenë me ty në çdo kohë shqetësimi” (Doktrina e Besëlidhje 3:7–8). Alma dëshmoi se pas kthimit të tij në besim: “Jam përkrahur në sprovë dhe në shqetësime të çdo lloji, po, dhe në të gjitha llojet e fatkeqësive; po, Perëndia më shpëtoi nga burgu, nga robëria dhe nga vdekja; po, dhe unë vë besimin tim në të dhe ai gjithnjë do të më çlirojë. Dhe e di se ai do të më ngrejë në ditën e fundit, që të banoj me të në lavdi” (Alma 36:27–28).
21. Isaia 61:3.
22. Doktrina e Besëlidhje 112:12–13.
23. Lluca 22:32.
24. Shih Lluca 9:23. Presidenti Rasëll M. Nelson na kujton: “Asgjë nuk i hap qiejt ashtu si ndërthurja e pastërtisë më të madhe, bindjes së përpiktë, kërkimit të zellshëm, ushqimit me bollëk me fjalët e Krishtit në Librin e Mormonit [shih 2 Nefi 32:3] dhe kohës së vazhdueshme, të zotuar për punën në tempull dhe punën e historisë familjare” (“Zbulësë për Kishën, Zbulësë për Jetën Tonë”, f. 96).
25. Enosi 1:3.
26. Jakobi [LiM] 3:2.



Nga Peshkopi Din M. Dejvis,
Këshilltar i Parë në Peshkopatën Kryesuese

Ejani, Dëgjojeni Zërin e Profetit

Teksa e përforcojmë në jetën tonë praktikën e të dëgjuarit dhe vënies së veshit ndaj zërit të profetëve të gjallë, ne do të korrim bekimet e përjetshme.

Duke folur për Presidentin e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Zoti shpalli:

“Dhe përsëri, detyra e Presidentit të detyrës së Priftërisë së Lartë është të kryesojë mbi gjithë kishën dhe të jetë si Moisiu—

. . . Po, që të jetë një shikues, një zbulues, një përkthyes dhe një profet, *duke patur të gjitha dhuratat e Perëndisë, të cilat ai i dhuron mbi kreun e kishës*” (Doktrina e Besëlidhje 107:91–92; theksimi i shtuar).

Kam qenë i bekuar që kam dëshmuar disa nga dhuratat e Perëndisë te profetët e Tij. A mund t’ju tregoj një përvojë të tillë të shenjtë? Përpara thirrjes sime të tanishme, unë mora pjesë në përcaktimin dhe rekomandimin e vendndodhjeve të tempujve të ardhshëm. Pas 11 shtatorit të vitit 2001, kalimet nëpër kufijtë e Shteteve të Bashkuara u bënë më të kontrolluara. Si rrjedhojë, shumë anëtarëve të Kishës u duhej dy deri në tri orë që të kalonin kufirin nga Vankuveri i Kanadasë, për të shkuar në Tempullin e Siatëllit në Uashington. Presidenti Gordon B. Hinkli, Presidenti

i Kishës në atë kohë, sugjeroi se një tempull në Vankuver do t’i bekonte anëtarët e Kishës. U autorizua kërkimi për një vendndodhje dhe pasi shqyrtuam imtësisht disa prona që zotëronte Kisha, hetuam edhe vendndodhje të tjera që nuk ishin në pronësi të Kishës.

U gjet një vendndodhje e bukur në një zonë të përcaktuar për godina



fetare pranë autostradës ndërurbane kanadeze. Te ajo pronë mund të shkoje fare lehtë, ishte plot e përplot me pisha kanadeze dhe kishte një vendndodhje të spikatur gjë që do ta bënte të dukshme për mijëra shoferë që kalonin.

Ne e paraqitëm vendndodhjen me fotografi dhe harta në mbledhjen mujore të Komitetit për Vendndodhjet e Tempujve. Presidenti Hinkli na autorizoi që të përgatitnim çmimin e ofertës për ta blerë dhe t’i përfundonim studimet e nevojshme. Në dhjetor të atij viti, ne i raportuam sërish komitetit se studimet kishin përfunduar dhe kërkua miratim për të vijuar me blerjen. Pasi e dëgjoim raportimin tonë, Presidenti Hinkli tha: “Ndiej se duhet ta shikoj këtë vendndodhje”.

Nga fundi i muajit, dy ditë pas Krishtlindjes, ne u nisëm për në Vankuver me Presidentin Hinkli; Presidentin Tomas S. Monson dhe Bill Uilliamsin, një arkitekt tempujsh. Ne u takuam me Pol Kristensenin, presidentin vendor të kunjit, i cili na çoi te vendndodhja. Kishte paksa lagështirë dhe mjegull atë ditë, por Presidenti Hinkli doli nga makina dhe filloi t’i binte kryq e tërthor vendndodhjes.

Pasi kaloi kohë në vendndodhje, e pyeta Presidentin Hinkli nëse donte të shihte disa nga vendndodhjet e tjera që ishin marrë parasysh. Ai tha ‘po’, se donte. Kështu pra, duke parë vendndodhjet e tjera, ne ishim në gjendje të bënim një krahasim të veçorive të tyre.

Ne bëmë një xhiro të gjatë me makinë rreth e përqark Vankuverit duke parë prona të tjera e duke u kthyer si përfundim në vendndodhjen fillestare. Presidenti Hinkli tha: “Kjo është një vendndodhje e bukur”. Më pas ai pyeti: “A mund të shkojmë në shtëpinë e mbledhjeve që është në pronësi të Kishës afërsisht 0.4 km larg?”

“Patjetër, President”, u përgjigëm ne.

U kthyem nëpër makina dhe i ngamë ato për në shtëpinë e mbledhjeve aty pranë. Teksa mbërritëm në ndërtesën kishtarë, Presidenti Hinkli tha: “Këtu, kthehu majtas”. Ne u kthyem dhe ndoqëm rrugën siç u udhëzuam. Rruga sa vinte e bëhej më e përpjetë.

Sapo makina mbërriti në pikën më të lartë, Presidenti Hinkli tha: “Ndale makinën, ndale makinën”. Më pas e drejtoi gishtin në të djathtë te një ngastër toke dhe tha: “Po kjo prona? Ky është vendi ku duhet të ndërtohet tempulli. Ky është vendi ku Zoti do që të jetë tempulli. A mund ta blini këtë tokë? A mund ta blini këtë tokë?”

Ne nuk e kishim parë këtë pronë. Ishte shumë prapa dhe larg rrugës kryesore dhe nuk ishte vënë për shitje. Kur u përgjigjëm se nuk e dinim, Presidenti Hinkli e drejtoi gishtin nga prona dhe tha sërish: “Ky është vendi ku duhet të ndërtohet tempulli”. Qëndruam për disa minuta dhe më pas u nisëm drejt aeroportit për t’u kthyer në shtëpi.

Të nesërmen, mua dhe Vëllanë Uilliams na thirrën në zyrën e Presidentit Hinkli. Ai kishte vizatuar gjithçka në një copë letër: rrugët, godinën e kishës, [shënimin] “kthehu djathtas këtu”, e kishte shenjuar me një x vendin për tempullin. Ai pyeti se çfarë kishim zbuluar. Ne i thamë se nuk mund të kishte zgjedhur një pronë më të vështirë se kjo. Ajo ishte në pronësi të tre individëve: njërit nga Kanadaja, njërit nga India dhe njërit nga Kina! Dhe nuk ishte në zonën e duhur të përcaktuar për godina fetare.

“Epo, bëni më të mirën”, tha ai.

Më pas mrekullia ndodhi. Brenda disa muajve ne e morëm në zotërim pronën dhe më pas qyteti i Lenglit në Kolumbinë Britanike dha lejen për të ndërtuar tempullin.

Kur reflektoj mbi këtë përvojë, përulem që kuptova se ndonëse Vëllai Uilliams dhe unë kishim arsimimin profesional dhe vite përvojë me prona të paluajtshme dhe projekte tempujsh, Presidenti Hinkli nuk kishte një arsimim të tillë profesional, por kishte diçka shumë më të madhe – dhuratën e parashikimit profetik. Ai ishte në gjendje të parashikonte se ku duhej të ngrihej tempulli i Perëndisë.

Kur Zoti i urdhëroi shenjtorët e hershëm në këtë periudhë ungjillore për të ndërtuar një tempull, Ai shpalli:

“Por një shtëpi duhet të ndërtohet për emrin tim sipas modelit që unë do t’ua tregoj.



Dhe në qoftë se njerëzit e mi nuk e ndërtojnë atë sipas modelit që do t’ia tregoj . . . , unë nuk do ta pranoj atë nga duart e tyre” (Doktrina e Besëlidhje 115:14–15).


Sikurse me shenjtorët e hershëm, ashtu ndodh edhe me ne sot: Zoti ia ka zbuluar dhe vazhdon t’ia zbulojë Presidentit të Kishës modelet sipas të cilave duhet të drejtohet mbretëria e Perëndisë në kohën tonë. Dhe sipas jetës vetjake, ai jep udhërrëfim për mënyrën se si secili prej nesh duhet ta drejtojë jetën e vet, në mënyrë të tillë që sjellja jonë të mund të jetë gjithashtu e pranueshme për Zotin.

Në prill të 2013-ës unë fola rreth përpjekjeve që përfshihen për përgatitjen e çdo themeli të tempullit, për t’u siguruar që ai mund t’u bëjë ballë stuhive dhe katastrofave ndaj të cilave do të ekspozohet. Por themeli është vetëm fillimi. Një tempull përbëhet nga shumë blloqe konstruktive, të bashkuara bashkë sipas modeleve të projektuara më parë. Nëse jeta jonë duhet të bëhet tempulli që secili prej nesh po përpiqet të ndërtojë siç na e ka mësuar Zoti (shih te 1 Korintasve 3:16–17), ne me të

drejtë, mund t’i bënim vetes një pyetje: “Çfarë blloqesh konstruktive duhet të vendosim me qëllim që ta bëjmë jetën tonë të bukur, madhështore dhe të qëndrueshme ndaj stuhive të botës?”

Ne mund ta gjejmë përgjigjen për këtë pyetje te Libri i Mormonit. Në lidhje me Librin e Mormonit, Profeti Jozef Smith tha: “Unë u thashë vëllezërve se Libri i Mormonit ishte më i sakti nga ndonjë libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë, dhe se një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër” (parathënia e Librit të Mormonit). Në parathënien e Librit të Mormonit, neve na mësohet se “ata që marrin [një] dëshmi hyjnore nga Shpirti i Shenjtë [se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë], do të mësojnë gjithashtu, nga e njëjta fuqi, se Jezu Krishti është Shpëtimtari i botës, se Joseph Smithi është zbuluesi dhe [profeti i Tij i Rivendosjes] dhe se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është mbretëria e Zotit e ngritur sërish mbi tokë”.

Atëherë këto janë disa blloqe themelore konstruktive të besimit dhe dëshmisë sonë individuale:



1. Jezu Krishti është Shpëtimtari i botës.
2. Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë.
3. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është mbretëria e Perëndisë në tokë.
4. Jozef Smithi është një profet dhe ne kemi profetë të gjallë në tokë sot.

Muajt e fundit, unë kam dëgjuar çdo bisedë të konferencës së përgjithshme që ka dhënë Presidenti Nelson qëkurse u thirr si Apostull për herë të parë. Kjo praktikë e ka ndryshuar jetën time. Teksa studiova dhe përsi-ata 34 vjet nga njohuria e mbledhur e Presidentit Nelson, nga mësimet e tij dolën në pah tema të qarta dhe me vijueshmëri. Secila nga këto tema lidhet me ato blloqe konstruktive që sapo i përmenda ose është një bllok tjetër kyç konstruktiv për tempujt tanë vetjakë. Ato përfshijnë besimin në Zotin Jezu Krisht, pendimin, pagëzimin për heqjen e mëkatëve, dhuratën e Frymës së Shenjtë, shëlbimin për të vdekurit dhe punën në tempull, mbajtjen të shenjtë të ditës së Shabatit, duke filluar me një synim në mendje dhe duke qëndruar në shtegun e besëlidhjes. Presidenti Nelson ka folur për të gjitha ato me dashuri dhe përkushtim.

Guri kryesor i qoshes dhe blloku konstruktiv i Kishës dhe për jetën tonë është Jezu Krishti. Kjo është Kisha e Tij. Presidenti Nelson është profeti i Tij. Mësimet e Presidentit Nelson dëshmojnë për jetën dhe karakterin e Jezu Krishtit dhe e zbulojnë atë për dobinë tonë. Ai flet me dashuri dhe njohuri për natyrën e Shpëtimtarit dhe misionin e Tij. Ai gjithashtu ka dhënë dëshmi të vazhdueshme dhe të zjarra për thirrjen hyjnore të profetëve të gjallë – Presidentëve të Kishës – nën kryesimin e të cilëve ka shërbyer.

Tani, sot, është privilegji ynë që ta mbështetim *atë* si profetin e gjallë të Zotit në tokë. Ne jemi mësuar me [praktikën] e mbështetjes së udhëheqësve të Kishës nëpërmjet modelit hyjnor të ngritjes së dorës në kënd të drejtë për të treguar pranimin dhe mbështetjen tonë. Këtë gjë e bëmë vetëm pak minuta më parë. Por mbështetja e vërtetë shkon përtej kësaj shenje fizike. Siç shënohet te Doktrina e Besëlidhje 107:22, Presidencia e Parë duhet të “mbështet[et] nga mirëbesimi, besimi dhe lutja e kishës”. Ne arrijmë ta mbështetim plotësisht e me të vërtetë profetin e gjallë teksta e zhvillojmë modelin e mirëbesimit në fjalët e tij, duke pasur besimin për vepruar sipas tyre dhe më pas duke u lutur për bekimet e vazhdueshme të Zotit mbi të.

Kur mendoj për Presidentin Rasëll M. Nelson, ngushëllohem nga fjalët e Shpëtimtarit kur Ai tha: “Dhe nëse njerëzit e mi do t’i binden zërit tim dhe zërit të shërbëtorëve të mi të cilët i kam caktuar ta udhëheqin popullin tim, vini re, në të vërtetë unë ju them, ata nuk do të nxirren jashtë vendit të tyre” (Doktrina e Besëlidhje 124:45).

Dëgjimi dhe mbajtja vesh e profetëve të gjallë do të ketë ndikime të thella, madje ndikime që na e ndryshojnë jetën. Ne forcohemi [prej tyre]. Jemi më të sigurt dhe më mirëbesues ndaj Zotit. E dëgjojmë fjalën e Zotit. E ndiejmë dashurinë e Perëndisë. Ne do ta dimë se si ta jetojmë jetën tonë duke pasur qëllim.

Unë e dua dhe e mbështet Presidentin Rasëll M. Nelson dhe të tjerët që janë thirrur si profetë, shikues dhe zbulues. Unë dëshmoj se ai ka dhuratat që Zoti i ka derdhur mbi kokën e tij dhe unë dëshmoj se teksta e përforcojmë në jetën tonë praktikën e të dëgjuarit dhe të vënies së veshit ndaj zërit të profetëve të gjallë, jeta jonë do të ndërtohet sipas modelit hyjnor të Zotit për ne dhe ne do të korrim bekimet e përjetshme. Ftesa u drejtohet të gjithëve. Ejani, dëgjojeni zërin e profetit; po ejani te Krishti e jetoni. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Ulises Soares,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Një në ... Krishtin

Shokët e mi të dashur në punën e Zotit, besoj se mund ta bëjmë shumë më mirë dhe duhet ta bëjmë më mirë mirëpritjen e miqve të rinj në Kishë.

Mirëdita, të dashur vëllezër e motra. Siç e themi në portugalishten time amtare braziliane, “Boa tarde!” Ndiheh i bekuar që jemi mbledhur së bashku në këtë konferencë të mrekullueshme të përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nën drejtimin e profetit tonë të dashur, Presidentit Rasëll M. Nelson. Mahnitëm nga mundësia e mrekullueshme që ka secili prej nesh për ta dëgjuar zërin e Zotit nëpërmjet shërbëtorëve të Tij në tokë, në këto ditë të fundit në të cilat po jetojmë.

Vendi im i lindjes, Brazili, është shumë i pasur me burime natyrore. Njëri prej tyre është lumi i famshëm i Amazonës, një nga lumenjtë më të mëdhenj e më të gjatë në botë. Ai formohet nga dy lumenj të ndarë, Solimoes dhe Negro. Në mënyrë interesante, ata rrjedhin së bashku për disa kilometra përpara se ujërat të përzien, për shkak se lumenjtë kanë origjinë, shpejtësi, temperatura dhe përbërje kimike shumë të ndryshme. Pas disa kilometrash, ujërat përfundimisht përzien së bashku, duke u bërë një lumë i ndryshëm nga pjesët e tij individuale. Vetëm pasi këto pjesë bashkohen, lumi i Amazonës bëhet aq i fuqishëm saqë, kur arrin në Oqeanin

Atlantik, ai e shtyn ujin e detit, kështu që brenda oqeanit për shumë kilometra ka ende ujëra të ëmbla.


Në të njëjtën mënyrë si lumenjtë Solimoes dhe Negro rrjedhin së bashku për të krijuar lumin e madh të Amazonës, fëmijë të Perëndisë me prejardhje shoqërore, tradita dhe kultura të ndryshme, grumbullohen së bashku në Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit duke formuar këtë bashkësi të mrekullueshme të shenjtorëve në Krisht. Përfundimisht, ndërsa e nxitim, mbështetim dhe e duam njëri-tjetrin,

ne bashkohemi për të formuar një forcë të fuqishme për mirë në botë. Si pases të Jezu Krishtit, duke rrjedhur të bashkuar në këtë lumë mirësie, ne do të jemi në gjendje të sigurojmë “ujin e ëmbël” të ungjillit për një botë të etur.

Zoti i ka frymëzuar profetët e Tij që të na mësojnë se si mund ta mbështetim dhe duam njëri-tjetrin, që të mund bëhemi të bashkuar në besim e qëllim në ndjekjen e Jezu Krishtit. Pali, Apostulli i Dhiatës së Re, dha mësim se ata që “j[anë] pagëzuar në Krishtin, Krishtin k[anë] veshur . . . sepse të gjithë jeni një në Jezu Krishtin”¹.

Kur pretojme në pagëzim se do ta ndjekim Shpëtimtarin, ne dëshmojmë përpara Atit se jemi të gatshëm ta marrim mbi vete emrin e Krishtit.² Ndërsa përpiqemi fort t’i fitojmë cilësitë e Tij hyjnore në jetën tonë, nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, Zotit, ne bëhemi ndryshe nga sa ishim dhe dashuria jonë për të gjithë njerëzit shtohet natyrshëm.³ Ne ndiejmë një dëshirë të sinqertë për mirëqenien dhe lumturinë e gjithsecilit. Ne e shohim njëri-tjetrin si vëllezër e motra, si fëmijë të Perëndisë me origjinë, cilësi dhe potencial hyjnor. Ne dëshirojmë të përkujdesemi për njëri-tjetrin dhe t’i mbajmë barrët e njëri-tjetrit.⁴

Kjo është ajo që Pali e përshkroi si dashuria hyjnore.⁵ Mormoni, një profet i Librit të Mormonit, e përshkroi atë si “dashuria e pastër e Krishtit”⁶, e cila është forma më e lartë, më fisnike dhe më e fuqishme e dashurisë. Profeti ynë



Ashtu si lumi i fuqishëm Amazona, që e shtyn ujin e detit kur mbërrin në Oqeanin Atlantik, ndjekësit e Jezu Krishtit e sigurojnë “ujin e ëmbël” të ungjillit për një botë të etur.

i tanishëm, Presidenti Rasëll M. Nelson, kohët e fundit e përshkroi një shfaqje të kësaj dashurie të pastër të Krishtit si dhënie shërbese, e cila është një qasje më e përqendruar dhe më e shenjtë e dashurisë dhe përkujdesjes për individë të tjerë ashtu siç e dha Shpëtimtari.⁷

Le ta shqyrtojmë këtë parim të dashurisë e përkujdesjes, ashtu siç e dha Shpëtimtari, në kuadër të nxitjes, ndihmës dhe mbështetjes së atyre që sapo janë kthyer në besim dhe të atyre që po fillojnë të tregojnë interes për të marrë pjesë në shërbesat tona në Kishë.

Kur këta miq të rinj dalin nga bota dhe e përqafojnë ungjillin e Jezu Krishtit, duke iu bashkuar Kishës së Tij, ata bëhen dishepuj të Tij, duke u lindur përsëri nëpërmjet Tij.⁸ Ata lënë pas një botë që e njihnin mirë, dhe zgjedhin ta ndjekin Jezu Krishtin, me qëllim të plotë të zemrës, duke iu bashkuar një “lumi” të ri, si lumi i fuqishëm i Amazonës – lumë që është një forcë e guximshme mirësie dhe drejtësie që rrjedh drejt pranisë së Perëndisë. Apostulli Pjetër e përshkruan atë si një “fis [të] zgjedhur, priftëri mbretërore, një komb [të] shenjtë, një popull [të] fituar”.⁹ Ndërsa këta miq të rinj bashkohen me këtë lumë të ri e të panjohur, ata mund të ndihen paksa të humbur fillimisht. Këta miq të rinj e gjejnë veten të përzier në një lumë me origjina, temperatura dhe përbërje kimike të pashoqe – një lumë që ka traditat, kulturën dhe fjalorin e vet. Kjo jetë e re në Krisht mund të duket dërrmuese për ta. Mendoni për një çast se si mund të ndihen ata kur dëgjojnë për herë të parë shprehje të tilla si “MBF”, “KPR”, “e diela e agjërimit”, “pagëzimi për të vdekurit”, “kombinimi tresh” e kështu me radhë.

Është e lehtë ta kuptosh përse ata mund të ndihen sikur nuk i përkasin asaj. Në situata të tilla, ata mund ta pyetin veten: “A ka vend për mua këtu? A i përkas Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme? A ka nevojë Kisha për mua? A do të gjej miq të rinj të gatshëm për të më ndihmuar e për të më mbështetur?”

Miqtë e mi të dashur, në çaste të tilla, ne që jemi në pika të ndryshme



në udhëtimin e gjatë të dishepullimit, duhet t’u shtrijmë dorën e ngrohtë të miqësisë miqve tanë të rinj, t’i pranojmë atje ku janë, t’i ndihmojmë, t’i duam dhe t’i përfshijmë në jetën tonë. Të gjithë këta miq të rinj janë bij dhe bija të çmuara të Perëndisë.¹⁰ Nuk mund ta përballojmë që të humbasim qoftë edhe njërin prej tyre, sepse, ashtu si lumi i Amazonës varet nga degët e tij për ushqim, ashtu edhe ne kemi nevojë për ta, po aq shumë sa ata kanë nevojë për ne, që të bëhemi një forcë e fuqishme për mirë në botë.

Miqtë tanë të rinj sjellin talente të dhëna nga Perëndia, emocione dhe mirësi nga vetja e tyre. Entuziazmi i tyre për ungjillin mund të jetë ngjites, duke na ndihmuar në këtë mënyrë që të rigjallërojmë vetë dëshmitë tona. Ata gjithashtu sjellin këndvështrime të freskëta për kuptimin tonë mbi jetën dhe ungjillin.

Na është mësuar me kohë se si mund t’i ndihmojmë miqtë tanë të rinj të ndihen të mirëpritur dhe të ndiejnë se i duan në Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit. Ata kanë nevojë për tri gjëra që të mund të qëndrojnë të fortë e besnikë gjatë gjithë jetës së tyre:

Së pari, ata kanë nevojë për vëllezër e motra në Kishë të cilët janë sinqerisht të interesuar për ta, miq të vërtetë e besnikë tek të cilët ata vazhdimisht mund të drejtohen, të cilët do të ecin krahu tyre dhe që do t’u përgjigjen pyetjeve të tyre. Si anëtarë, ne duhet të jemi

gjithmonë të vëmendshëm dhe të kërkojmë fytyra të reja kur marrim pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Kishës, pavarësisht nga përgjegjësitë, detyrat ose shqetësimet që mund të kemi. Ne mund të bëjmë gjëra të thjeshta për t’i ndihmuar këta miq të rinj të ndihen të përfshirë e të mirëpritur në Kishë, të tilla si t’i japim një përshëndetje të ngrohtë, t’u buzëqeshim sinqerisht atyre, të ulemi së bashku për të kënduar e adhuruar, t’i njohim me anëtarët e tjerë e kështu me radhë. Ndërsa ua hapim zemrën tonë miqve tanë të rinj në disa nga këto mënyra, ne po veprojmë në frymën e dhënies së shërbesës. Kur u japim shërbesë ashtu siç bëri Shpëtimtari, ata nuk do të ndihen si “të huaj brenda portave tona”. Ata do të ndiejnë se mund të përshtaten dhe të zënë miq të rinj dhe, më e rëndësishmja, ata do ta ndiejnë dashurinë e Shpëtimtarit nëpërmjet përkujdesjes sonë të vërtetë.

Së dyti, miqtë e rinj kanë nevojë për një detyrë – një mundësi për t’u shërbyer të tjerëve. Shërbimi është një nga aspektet e shkëlqyera të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Është një proces me anë të të cilit besimi ynë mund të bëhet më i fortë. Çdo mik i ri e meriton këtë mundësi. Ndërsa peshkopi dhe këshilli i lagjes kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për t’u dhënë detyra menjëherë pas pagëzimit të tyre, asgjë nuk na pengon, si anëtarë, që t’i ftojme miqtë tanë të rinj për të na ndihmuar që t’u shërbejmë të tjerëve në mënyrë joformale ose përmes projekteve të shërbimit.

E treta, miqtë e rinj duhet të “ushqehe[n] nga fjala e mirë e Perëndisë”¹¹. Ne mund t’i ndihmojmë ata që t’i duan shkrimet e shenjta dhe të njihen me to ndërsa i lexojmë dhe i diskutojmë mësimet me ta, duke dhënë kontekstin e historive dhe duke shpjeguar fjalë të vështira. Ne gjithashtu mund t’u mësojmë atyre se si të marrin udhëheqje vetjake nëpërmjet studimit të rregullt të shkrimeve të shenjta. Përveç kësaj, me raste, jashtë mbledhjeve dhe veprimtarive tona të rregullta të programuara të Kishës, ne mund t’u shkojmë miqve tanë të rinj në shtëpitë e tyre dhe t’i ftojme ata në tonat, duke i

ndihmuar që të bashkohen me lumin e fuqishëm të komunitetit të shenjtoreve.

Duke i njohur përshtatjet dhe sfidat që miqtë tanë të rinj hasin duke u bërë pjesëtarë të familjes së Perëndisë, si vëllezërit dhe motrat tona, ne mund t'u tregojmë mënyrën se si i kemi kapërcyer sfida të ngjashme në jetën tonë. Kjo do t'i ndihmojë ata të dinë se nuk janë vetëm dhe se Perëndia do t'i bekojë kur ushtrojnë besim te premtimet e Tij.¹²

Kur lumenjtë Solimoe dhe Negro përzien së bashku, lumi i Amazonës bëhet i fuqishëm e i fortë. Në mënyrë të ngjashme, kur ne dhe miqtë tanë të rinj me të vërtetë bashkohemi, Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit bëhet edhe më e fortë dhe më e qëndrueshme. Unë dhe bashkëshortja ime e dashur, Rosana, jemi kaq mirënjohës për të gjithë ata që na ndihmuar të përzihemi me këtë lumë të ri shumë vite më parë, kur e përqafuam ungjillin e Jezu Krishtit në vendin tonë të lindjes në Brazil. Gjatë gjithë këtyre viteve, këta njerëz të mrekullueshëm na kanë dhënë me të vërtetë shërbesë dhe na kanë ndihmuar që të vazhdojmë të rrjedhim në drejtësi. Jemi shumë mirënjohës për ta.

Profetët në hemisferën perëndimore e dinin mirë se si të bënin që miqtë e rinj të rridhnin me besnikëri së bashku në këtë lumë të ri të mirësisë drejt jetës së përjetshme. Për shembull, duke e parë kohën tonë dhe duke e ditur se do të përballeshim me sfida të ngjashme¹³, Moroni i përfshiu disa nga ato hapa të rëndësishëm në shkrimet e tij në Librin e Mormonit:

“Dhe pasi u pranuan në pagëzim dhe u ndikuan dhe u pastruan nga fuqia e Frymës së Shenjtë, ata u numëruan mes njerëzve të kishës së Krishtit; dhe emrat e tyre u morën kështu që ata të mund të kujtoheshin dhe të ushqeheshin nga fjala e mirë e Perëndisë, për t'i mbajtur në udhën e drejtë, për t'i mbajtur përherë të kujdesshëm në lutje, duke u mbështetur vetëm në meritat e Krishtit që ishte autori dhe plotësuesi i besimit të tyre.

Dhe kisha mbledhjet së bashku shpesh për të agjëruar, për t'u lutur dhe për të folur me njëri-tjetrin, në lidhje me mirëqenien e shpirtit të tyre.”¹⁴



Shokët e mi të dashur në punën e Zotit, besoj se mund ta bëjmë shumë më mirë dhe duhet ta bëjmë më mirë mirëpritjen e miqve të rinj në Kishë. Ju ftoj ta shqyrtoni se çfarë mund të bëjmë për të qenë më përfshirës, pranues e të dobishëm për ta, duke filluar që nga e diela që vjen. Kini kujdes që të mos i lini detyrat tuaja në Kishë t'ju pengojnë për t'i mirëpritur miqtë e rinj në mbledhjet dhe veprimtaritë e Kishës. Në fund të fundit, këta shpirta janë të çmuar përpara syve të Perëndisë dhe janë shumë më të rëndësishëm sesa programet dhe veprimtaritë. Nëse u japim shërbesë miqve tanë të rinj, me zemrat tona të mbushura me dashuri të pastër ashtu siç bëri Shpëtimtari, unë ju premtoj, në emrin e Tij, se Ai do të na ndihmojë në përpjekjet tona. Kur veprojmë si shërbëtarë besnikë, ashtu siç bëri Shpëtimtari, miqtë tanë të rinj do të kenë ndihmën që u nevojitet që të qëndrojnë të fortë, të përkushtuar e besnikë deri në fund. Ata do të bashkohen me ne teksa bëhemi një popull i fuqishëm i Perëndisë dhe do të na ndihmojnë t'i sjellim ujë të ëmbël një bote që ka nevojë të dëshpëruar për bekimet e ungjillit të Jezu Krishtit. Këta fëmijë të Perëndisë do të ndiejnë sikur “nuk [janë] më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtoreve”¹⁵. Unë ju premtoj se ata do ta dallojnë praninë e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, në vetë Kishën e Tij. Ata do të vazhdojnë të rrjedhin bashkë me ne si një lumë

drejt burimit të gjithë mirësisë derisa ata të pranohen me krahë hapur nga Zoti ynë, Jezu Krishti, dhe ata e dëgjojnë Atin të thotë: “Ju *do të* keni jetën e përjetshme”¹⁶.

Ju ftoj ta kërkonti ndihmën e Zotit për t'i dashur të tjerët, ashtu siç ju ka dashur Ai. Le ta ndjekim të gjithë këshillën e dhënë nga Mormoni: “Prandaj, vëllezër [dhe motra] të mi[a] të dashur[a], lutiuini Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij, Jezu Krishtit”.¹⁷ Për këto të vërteta unë jap dëshmi dhe e bëj këtë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- Galatasve 3:27–28; theksimi i shtuar.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 20:37.
- Shih Mosia 3:19.
- Shih Mosia 18:8.
- Shih 1 Korintasve 13.
- Moroni 7:47.
- Shih Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë”, *Liahona*, maj 2018, f. 68–75.
- Shih Mosia 27:25.
- 1 Pjetër 2:9.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 18:10.
- Moroni 6:4; shih gjithashtu “How Do I Work with Stake and Ward Leaders?” *Preach My Gospel: A Guide to Missionary Service*, rishik. [2018], lds.org/manual/m/missionary; [Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar (2005), f. 1–16].
- Shih 1 Nefi 7:12.
- Shih Mormoni 8:35.
- Moroni 6:4–5.
- Efesianëve 2:19.
- 2 Nefi 31:20; theksimi i shtuar.
- Moroni 7:48.



Nga Plaku Gerit W. Gong,
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Zjarri Ynë i Kampit të Besimit

Për ata që e kërkojnë, e lejojnë dhe jetojnë për të, agimi i besimit, nganjëherë dalëngadalë, do të vijë ose mund të kthehet.

Të dashur vëllezër e motra, a nuk është e mrekullueshme të marrim zbulesë të vazhdueshme nga qielli nëpërmjet Presidentit Rasëll M. Nelson dhe udhëheqësve tanë të Kishës, e cila na fton të jetojmë në mënyra të reja dhe më të shenjta¹, në shtëpi dhe në kishë, me gjithë zemrën, mendjen dhe forcën tonë?

A keni pasur ndonjëherë mundësi të bëni diçka për të cilën u ndiet të papërgatitur ose të papërshtatshëm, por që ju u bekuat për përpjekjen?

Unë po. Ja një shembull.

Disa vite më parë, Plaku Riçard G. Skot, një anëtar i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, plot mirësi më ftoi: “Gerit, a do të pëlqente të pikturoje me bojëra uji me mua?”

Plaku Skot tha se pikturimi e ndihmonte të vëzhgonte dhe të krijonte. Ai ka shkruar: “Përpiquni të jeni krijues, edhe nëse rezultatet janë të thjeshta. . . . Krijimtaria mund të sjellë një shpirt mirënjohjeje për jetën dhe për atë që Zoti ka ndërthurur brenda qenies suaj.

. . . Nëse zgjidhni me urtësi, ajo nuk ka pse të zërë shumë kohë.”²

Presidenti Henri B. Ajring i përshkroi meditimet e tij artistike si të nxitura nga “një ndjenjë dashurie”, përfshirë “dashurinë e një Krijuesi i cili pret që fëmijët e Tij të bëhen si Ai – të krijojnë dhe të ndërtojnë”³. Veprat krijuese të Presidentit Ajring sigurojnë një “këndvështrim të pashoq shpirtëror mbi dëshminë dhe besimin”⁴.

Veprat artistike të Presidentit Bojd K. Paker ilustrojnë një mesazh themelor të ungjillit: “Perëndia është Krijuesi i qiejve, tokës dhe të gjitha gjërave që janë në to, që e tërë natyra jep dëshmi për atë krijim të drejtuar në mënyrë hyjnore dhe që ka [njël] harmoni të plotë midis natyrës, shkencës dhe ungjillit të Jezu Krishtit”⁵.

Alma dëshmon: “Të gjitha gjërat tregojnë se ka një Perëndi”⁶. Fëmijët tanë të Fillores këndojnë: “Sa her’ që dëgjoj këngën e zogut ose shikoj qiellin shumë blu, . . . gëzohem që jetoj në k’ të tok’ t’bukur, [qël] për mua Ati Qiellor krijoi”⁷. Autori Viktor Hygo kremton se “midis qenieve dhe sendeve ka marrëdhënie të çuditshme; në këtë bashkësi të pashtershme, nga dielli te pleshti. . . . Të gjithë shpendët që fluturojnë, kanë në këmbët e tyre fillin e pambarimit. . . . Një mjegullnajë është një mori yjesh.”⁸

Dhe kjo na kthen sërish te ftesa e Plakut Skot.

“Plaku Skot”, u përgjigja, “do të doja të bëhesha më vëzhgues dhe më krijues. Emocionohem kur përfytyroj se Ati Qiellor pikturon me re plot tallaz e me çdo ngjyrë të qiellit dhe të ujit. Por”, këtu pati një heshtje të gjatë, “Plaku Skot”, thashë, “unë s’kam asnjë aftësi për të pikturuar me bojëra uji. Shqetësohem se mund të bezdisesh kur të përpiqesh të më mësosh.”

Plaku Skot buzëqeshi dhe caktuam ditën kur do të takoheshim. Në ditën e caktuar ai përgatiti letrat, bojërat dhe furçat. Ai bëri disa skica dhe më ndihmoi ta lagia letrën.

Ne përdorëm si model një pikturë të tij të bukur me bojëra uji, të titulluar *Campfire at Sunset [Zjarr Kampi në Perëndimin e Diellit]*. Teksa pikturonim,



Zjarr Kampi në Perëndimin e Diellit, nga Plaku Riçard G. Skot

folëm rreth besimit – se si kur jemi përballë dritës dhe ngrohtësisë së një zjarri të kampit, ne e lëmë pas errësirën dhe pasigurinë – se si nganjëherë në netët e gjata, të vetmuara, zjarri i kampit tonë të besimit mund të na japë shpresë e siguri. Dhe agimi vërtet vjen. Zjarri i kampit tonë të besimit – kujtimet, përvojat dhe trashëgimia jonë e besimit për mirësinë e Perëndisë dhe mëshirat e dhembshura të Perëndisë në jetën tonë – na kanë forcuar përgjatë natës.

Dëshmia ime është – për ata që e kërkojnë, e lejojnë dhe jetojnë për të – se agimi i besimit, nganjëherë dalëngadalë, do të vijë ose mund të kthehet. Drita do të vijë kur ne e dëshirojmë dhe e kërkojmë atë, kur jemi të duruar dhe të bindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë, kur jemi të gatshëm të pranojmë hirin, shërimin dhe besëlidhjet e Perëndisë.

Teksa filluam të pikturonim, Plaku Skot më nxiti: “Gerit, edhe me një mësim ti do të pikturosh diçka që do të dëshirosh ta ruash dhe ta kujtosh”. Plaku Skot kishte të drejtë. E çmoj shumë pikturën me bojëra uji të zjarrit tonë të kampit të besimit, të cilën Plaku Skot më ndihmoi ta pikturoja. Aftësia ime artistike ishte dhe mbetet e kufizuar, por kujtimi i zjarrit tonë të kampit të besimit mund të na nxitë në pesë mënyra.

Së pari, zjarri ynë i kampit të besimit mund të na nxitë të gjejmë gëzim në krijimtarinë e shëndetshme.

Imagjinata, të mësuarit, bërja e gjërave të reja me vlerë na sjellin gëzim. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur e thellojmë besimin dhe mirëbesimin tek Ati Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti. Sado që mund ta duam veten tonë, ajo nuk mjafton që të shpëtohem. Por Ati Qiellor na do më shumë nga sa e duam ne veten tonë dhe na njeh më mirë nga sa e njohim ne veten tonë. Ne mund të kemi besim te Zoti dhe të mos mbështetemi në gjykimin tonë.⁹

A keni qenë ndonjëherë i vetmi që nuk u ftuat në festimin e ditëlindjes së dikujt?

A jeni zgjedhur ndonjëherë i fundit, ose nuk jeni zgjedhur fare, kur u përzgjedhën skuadrat?

A jeni përgatitur për një provim në shkollë, një intervistë për punë, një



mundësi që vërtet e dëshironit – dhe ndiet se dështuat?

A jeni lutur për një marrëdhënie që, për çfarëdo arsye, nuk ka shkuar mirë?

A jeni ndeshur me sëmundje kronike, jeni braktisur nga një bashkëshort/e, keni përjetuar agoni për familjen?

Shpëtimtari ynë i njeh rrethanat tona. Kur e ushtrojmë lirinë e zgjedhjes që na jepet nga Perëndia, dhe i përfshijmë të gjitha aftësitë tona me përlësi e besim, Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, mund të na ndihmojë të ndeshemi me sfidat e jetës dhe të përjetojmë gëzimet e saj. Besimi përfshin një dëshirë dhe zgjedhje për të besuar. Besimi gjithashtu vjen nga bindja ndaj urdhërimeve të Perëndisë, të cilat jepen për të na bekuar, ndërkohë që e ndjekim shtegun e Tij të besëlidhjeve.

Kur u ndiem, ose ndihemi, të pasigurt, të vetmuar, të acaruar, të zemëruar, të lënë në baltë, të zhgënjyer ose të veçuar nga Perëndia dhe Kisha e Tij e rivendosur, mund të kërkohet një shka llë më e madhe përpjekjesh dhe besimi për t'u futur sërish në shtegun e Tij të besëlidhjeve. Por ia vlen! Ju lutem ejani, ose ejani sërish, te Zoti Jezu Krisht! Dashuria e Perëndisë është më e fortë se zinxhirët e vdekjes – fizike ose shpirtërore.¹⁰ Shlyerja e Shpëtimtarit

tonë është e pafundme dhe e përjetshme. Secili prej nesh shkon në udhë të gabuar dhe dështon. Për njëfarë kohe, ne mund ta humbasim udhën. Perëndia plot dashuri na siguron, pavarësisht se ku jemi ose çfarë kemi bërë, që nuk ka udhë pa kthim. Ai pret i gatshëm për të na përqafuar.¹¹

Së dyti, zjarri ynë i kampit të besimit mund të na nxitë të japim shërbesë në mënyra të reja, më të larta dhe më të shenjta, të mbushura me Shpirtin.

Kjo dhënie shërbese sjell mrekullitë dhe bekimet e ndjesisë se i përkasim besëlidhjes – ku ndiejmë dashurinë e Perëndisë dhe kërkojmë t'u japim shërbesë të tjerëve në atë frymë.

Jo shumë kohë më parë unë dhe Motra Gong u njohëm me një baba dhe një familje që u bekuan nëpërmjet një vëllai besnik që kishte priftërinë, i cili shkoi te peshkopi i tyre dhe pyeti a mund të ishte ai (vëllai që kishte priftërinë) në një dyshe si mësues shtëpie me atë baba. Babai nuk ishte aktiv dhe nuk kishte interes të ishte një mësues shtëpie. Por teksa zemra e babait ndryshonte, ai dhe ky vëlla i dashur që kishte priftërinë, filluan t'i vizitonin familjet “e tyre”. Pas një vizite të tillë, bashkëshortja e tij – ajo vetë në atë kohë nuk e frekuentonte kishën – e pyeti burrin e saj se si kishin shkuar



gjërat. Babai pohoi: “Mund të kem ndier diçka” – dhe më pas shkoi në kuzhinë për të marrë një birra.¹²

Por gjërat pasuan njëra-tjetrën: përvoja të dhembshura, dhënie shërbese, ndryshim zemrash, klasë përgatitjeje për në tempull, ardhje në kishë, vulosje si familje në tempullin e shenjtë. Përfytyroni se sa mirënjohës u janë fëmijët dhe nipërit e mbesat babait dhe nënës së tyre, si edhe vëllait shërbestar, i cili shkoi si një mik dhe shoqëruar me babanë e tyre për t’u dhënë shërbesë të tjerëve dhe për t’i dashur ata.

Një zjarr i tretë i kampit të besimit është nxitja: gëzimi dhe bekimet krijuese të ungjillit vijnë kur ne përpiqemi ta duam Zotin dhe të tjerët me gjithë zemrën dhe shpirtin tonë.

Shkrimet e shenjta na ftojnë ta vendosim gjithçka që jemi dhe që po bëhemi mbi altarin e dashurisë dhe të shërbimit. Në Dhiatën e Vjetër, Ligji i Përtërirë na këshillon ta “dua[m] . . . Zotin, Perëndinë [tonë]” me gjithë zemrën, shpirtin dhe forcën tonë.¹³ Jozueu këshillon: “[Duajeni] Zotin, Perëndinë tuaj, . . . ec[ni] në të gjitha rrugët e tij, . . . zbat[oni] të gjitha urdhërimet e tij,

. . . qendroni sa më afër tij dhe . . . i shërbëni me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt”¹⁴.

Në Dhiatën e Re, Shpëtimtari ynë i shpreh qartë dy urdhërimet e mëdha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde . . . edhe të afërmin tënd porsivetveten”¹⁵.

Në Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit, mbreti Beniamin punoi “me të gjithë fuqinë e trupit të tij dhe me aftësinë e tërë shpirtit të tij” dhe vendosi paqe në tokë.¹⁶ Te Doktrina e Besëlidhje, sikurse e di çdo misionar, Zoti na kërkon t’i shërbejmë Atij me gjithë “zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën”¹⁷ tonë. Kur shenjtoret hynë në kontenë Xhekson, Zoti i urdhëroi ta mbanin të shenjtë Shabatën duke e dashur “Zotin, Perëndinë [e tyre], me gjithë zemrën [e tyre], me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën [e tyre]; dhe në emër të Jezu Krishtit duhet t’i shërbe[nin] atij”¹⁸.

Ne gëzohemi nga ftesa për t’ia përkushtuar tërë qenien tonë kërkimit të udhëve më të larta dhe më të shenjta për ta dashur Perëndinë, për t’i dashur njerëzit përreth nesh dhe për ta forcuar besimin tonë tek Ati Qiuellor dhe Jezu Krishti në zemrat tona, në shtëpitë tona dhe në kishë.

Së katërti, zjarri ynë i kampit të besimit na nxit të krijojmë modele të rregullta të të jetuarit me drejtësi, të cilat e thellojnë besimin dhe shpirtshmërinë.

Këto zakone të shenjta, rutina të drejta ose modele plot lutje mund të përfshijnë lutjen; studimin e shkrimeve të shenjta; agjërimin; të kujtuarit e Shpëtimtarit dhe të besëlidhjeve tona nëpërmjet ordinancës së sakramentit; përhapjen e bekimeve të ungjillit nëpërmjet shërbimit misionar, shërbimit në tempull, historisë familjare dhe shërbimeve të tjera; mbajtjen e një ditari vetjak plot mendim dhe kështu me radhë.

Kur bashkohen modele të drejta dhe dëshira shpirtërore, koha dhe përjetësia takohen së bashku. Drita shpirtërore dhe të jetuarit vijnë kur mbajta e rregullt e veprimtarive fetare na afron më pranë Atit tonë Qiuellor dhe Shpëtimtarit tonë,

Jezu Krishtit. Kur i duam shpirtin dhe mësimet e ligjit, gjërat e përjetësisë mund të pikojnë mbi shpirtat tanë si kurse vesa nga qiejt.¹⁹ Me bindjen e përditshme dhe ujin e gjallë që na freskon, ne gjejmë përgjigje, besim e forcë për t’u bërë ballë sfidave dhe për t’i plotësuar mundësitë e përditshme me durimin, këndvështrimin dhe gëzimin e ungjillit.

Së pesti, kur i ruajmë në mënyrën më të mirë modelet që i njohim, tekna kërkojmë mënyra të reja dhe më të shenjta për ta dashur Perëndinë, për të ndihmuar veten dhe të tjerët që të përgatitemi për ta takuar Atë, zjarri ynë i kampit të besimit mund të na nxitë të sjellim ndërmend se përsosja është në Krisht, jo brenda nesh ose në përsosjen e botës.

Ftesat e Perëndisë janë plot dashuri e mundësi, sepse Jezu Krishti është “udha, e vërteta dhe jeta”²⁰. Ata të cilët ndihen të rënduar, Ai i fton: “Ejani tek unë” dhe atyre që vijnë tek Ai, Ai u premton: “Unë do t’ju jap çlodhje”²¹. “Ejani te Krishti dhe përsosuni në të, . . . [duajeni] Perëndinë me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj, atëherë hiri i tij mjafton për ju, se me anë të hirit të tij ju mund të bëheni të përsosur në Krisht.”²²

Tek ajo siguri se “me anë të hirit të tij ju mund të bëheni të përsosur në Krisht”, gjenden gjithashtu ngushëllimi, paqja dhe premtimi që mund të vazhdojmë të shkojmë përpara me besim e vetëbesim në Zotin, edhe kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç shpresojmë, siç presim ose ndoshta siç dëshirojmë, pa asnjë faj nga ana jonë, edhe pasi të kemi bërë gjithçka mundemi.

Në raste dhe mënyra të ndryshme, ne të gjithë ndihemi të papërshtatshëm, të pasigurt, ndoshta të padenjë. Prapëseprapë në përpjekjet tona besnike për ta dashur Perëndinë dhe për t’i dhënë shërbesë të afërmit tonë, ne mund ta ndiejmë dashurinë e Perëndisë dhe frymëzimin që nevojitet për jetën e tyre dhe tonën në mënyra të reja dhe më të shenjta.

Me dhembshuri, Shpëtimtari ynë na nxit dhe premton që ne mund “të shkojmë” përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të

përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit”²³. Doktrina e Krishtit, Shlyerja e Shpëtimtarit tonë dhe ndjekja nga ana jonë me gjithë shpirt e shtegut të Tij të besëlidhjeve mund të na ndihmojnë t’i dimë të vërtetat e Tij dhe mund të na bëjnë të lirë.²⁴

Unë dëshmoj se plotësia e ungjillit të Tij dhe plani i Tij i lumturisë janë rivendosur dhe janë dhënë mësim në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, në shkrimin e shenjtë dhe prej profetëve, që nga Profeti Jozef Smith dhe deri sot nga Profeti Rasëll M. Nelson. Unë dëshmoj se shtegu i Tij i besëlidhjeve çon drejt dhuratës më të madhe që premton Ati ynë i dashur Qiellor: “Ju do të keni jetën e përjetshme”²⁵.

Qofshin tonat bekimet e Tij dhe gëzimi durues kur i ngrohim zemrën, shpresat dhe zotimin tonë të zjarri i kampit tonë të besimit, unë lutem në emrin e shenjtë dhe të shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës”, *Liahona*, maj 2018, f. 100.
2. Richard G. Scott, *Finding Peace, Happiness, and Joy* (2007), f. 162–163; cituar tek *Elder Richard G. Scott Art Exhibit: A Self-Guided Tour* (pamflet, 2010).
3. *A Visual Journal: Artwork of Henry B. Eyring* (broshurë, 2017), f. 2.
4. *A Visual Journal*, f. 28.
5. Boyd K. Packer, *The Earth Shall Teach Thee: The Lifework of an Amateur Artist* (2012), f. ix.
6. Alma 30:44.
7. “My Heavenly Father Loves Me” [“Ati Im Qiellor më Do”], *Children’s Songbook*, f. 228–229.
8. Viktor Hygo, *Të Mjerët*, përkth. nga Misto Treska [1983], Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, vëll. 2, f. 535.
9. Shih Fjalët e Urta 3:5–6.
10. Shih Doktrina e Besëlidhjeve 121:44.
11. Shih Lluca 15:20.
12. Përvojë e përdorur me leje.
13. Ligji i Përtërirë 6:5.
14. Jozueut 22:5.
15. Lluca 10:27.
16. Fjalët e Mormonit 1:18.
17. Doktrina e Besëlidhjeve 4:2.
18. Doktrina e Besëlidhjeve 59:5.
19. Shih Doktrina e Besëlidhjeve 121:45–46.
20. Gjoni 14:6.
21. Mateu 11:28.
22. Moroni 10:32.
23. 2 Nefi 31:20.
24. Shih Gjoni 8:32.
25. 2 Nefi 31:20.



Nga Plaku Pol B. Pajper,
i Të Shtatëdhjetëve

Të Gjithë Duhet të Marrin mbi Vete Emrin e Dhënë prej Atit

Emri i Shpëtimtarit ka fuqi të pashoqe dhe thelbësore. Është i vetmi emër nëpërmjet të cilit është i mundur shpëtimi.

Disa javë më parë, mora pjesë në pagëzimin e disa fëmijëve tetëvjeçarë. Ata kishin filluar ta mësonin ungjillin e Jezu Krishtit nga prindërit dhe mësuesit e tyre. Fara e besimit të tyre tek Ai kishte filluar të rritej. Dhe tani ata donin ta ndiqnin Atë në ujërat e pagëzimit për t’u bërë anëtarë të Kishës së Tij të rivendosur. Teksa vështroja padurimin e tyre, pyeta veten sa e kuptonin ata njërin prej aspekteve të rëndësishme të besëlidhjes së tyre të pagëzimit: zotimin e tyre

për të marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit.

Prej fillimit, Perëndia e ka shpallur epërsinë e emrit të Jezu Krishtit në planin e Tij për ne. Një engjëll i dha mësim atit tonë të parë, Adamit: “Ti do të bësh gjithçka që bën, në emër të Birit dhe do të pendohesh e do t’i thërrasësh Perëndisë në emër të Birit përgjithmonë”¹.

Profeti i Librit të Mormonit, Mbreti Beniamin, i dha mësim popullit të tij: “Nuk do të ketë asnjë emër tjetër të



dhënë, as ndonjë mënyrë tjetër nëpërmjet së cilës shpëtimi mund të vijë”².

Zoti ia përsëriti këtë të vërtetë Profetit Jozef Smith: “Vini re, Jezu Krishti është emri që jepet nga Ati dhe nuk ka asnjë emër tjetër të dhënë, me anë të të cilit njeriu mund të shpëtohet”³.

Në kohën tonë, Presidenti Dallin H. Oaks na mësoi se “ata që ushtrojnë besim në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit dhe . . . hyjnë në besëlidhjen e tij dhe i mbajnë urdhërimet e tij . . . mund të kenë pretendim mbi sakrificën shlyese të Jezu Krishtit”⁴.

Ati ynë Qiellor dëshiron ta bëjë absolutisht të qartë që emri i Birit të Tij, Jezu Krishtit, nuk është thjesht një emër mes shumë të tjerëve. Emri i Shpëtimtarit ka fuqi të pashoqe dhe thelbësore. Është i vetmi emër nëpërmjet të cilit është i mundur shpëtimi. Duke e theksuar këtë të vërtetë në çdo periudhë unguillore, Ati ynë i dashur i siguron të gjithë fëmijët e Tij që ka një udhë kthimi për tek Ai. Por, pasja e një udhe të sigurt në dispozicion nuk do të thotë që kthimi ynë është automatikisht i siguruar. Perëndia na thotë se çfarë veprimi kërkohet: “Prandaj, gjithë njerëzit duhet të *marrin* mbi vete emrin që është dhënë nga Ati”⁵.

Në mënyrë që të kemi qasje të fuqia shpëtuese që vjen vetëm nëpërmjet emrit të Krishtit, ne duhet: “[të] përulë[m] para Perëndisë . . . dhe [të] vij[m]ë me zemra të thyera e shpirtra të penduar . . . dhe [të] jemi] të gatshëm të *marrim] mbi vete emrin e Jezu Krishtit*”, . . . e në këtë mënyrë të kualifikohemi si miqtë e mi tetëvjeçarë, që të “merre[m] me anë të pagëzimit në kishën e tij”⁶.

Të gjithë ata që dëshirojnë sinqerisht ta marrin emrin e Shpëtimtarit mbi vete, duhet të kualifikohen për ordinancën e pagëzimit dhe ta marrin atë si një dëshmi fizike ndaj Perëndisë për vendimin e tyre.⁷ Por pagëzimi është vetëm fillimi.

Folja *marr* nuk është joveprorë. Ajo është një folje veprorë me përkufizime të shumta.⁸ Po ashtu, Zotimi ynë për ta marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit kërkon veprim dhe ka përmasa të shumta.

Për shembull, një kuptim i fjalës *marr* është të *hash ose pish* ose të



futësh në trup, e tillë si kur ne *pimë* një pije. Duke e marrë mbi vete emrin e Krishtit, ne zotohemi t’i *futim* mësimet e Tij, karakteristikat e Tij dhe përfundimisht dashurinë e Tij thellë në qenien tonë që ato të bëhen pjesë e asaj që jemi. Pra, është e rëndësishme ftesa e Presidentit Nelson drejtuar të rinjve në moshë madhore që ata “të [kërkojnë] ta kuptojnë me lutje dhe vull se çfarë do të thotë për [ata] *vetë* secili prej titujve dhe emrave . . . të ndryshëm [të Shpëtimtarit]”⁹ dhe të ushqehen me bollëk me fjalët e Krishtit në shkrimet e shenjta, veçanërisht në Librin e Mormonit.¹⁰

Një kuptim tjetër i fjalës *marr* është ta pranosh një person në një rol të caktuar ose të përqafosh vërtetësinë e një ideje ose parimi. Kur e marrim mbi vete emrin e Krishtit, ne e pranojmë Atë si Shpëtimtarin tonë dhe i përqafojmë në vazhdimësi mësimet e Tij si udhërrëfyes për jetën tonë. Në çdo vendim kuptimplotë që marrim, ne mund ta *pranojmë* se unguilli i Tij është i vërtetë dhe ta jetojmë atë me bindje me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tonë.

Së fundi, fjala *marr* mund të nënkuptojë t’i bashkëngjitesh një emri ose kauze. Shumica prej nesh e ka pasur përvojën e *marrjes përsipër* të një përgjegjësie në punë ose të *marrjes me një kauzë* ose lëvizje. Kur e marrim

mbi vete emrin e Krishtit, ne marrim përsipër përgjegjësitë e një dishepulli të vërtetë, përfaqësojmë kauzën e Tij dhe “qëndrojmë si dëshmitarë të [Tij] në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që [ne] të gjende[m]”¹¹. Presidenti Nelson e ka thirrur “*çdo* të re dhe *çdo* të ri . . . që të rekrutohet në batalionin e rinisë së Zotit për të ndihmuar që Izraeli të mblidhet”¹². Dhe të gjithë ne jemi mirënjohës që mund të angazhohemi ndaj thirrjes profetike për ta përdorur emrin e Kishës së Tij të rivendosur sikurse u zbulua nga Vetë Shpëtimtari: Kisha e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.¹³

Në procesin e marrjes së emrit të Shpëtimtarit mbi vete, ne duhet ta kuptojmë se kauza e Krishtit dhe Kisha e Tij janë një dhe e njëjta gjë. Ato nuk mund të ndahen. Ngjashëm me këtë, dishepullimi ynë vetjak ndaj Shpëtimtarit dhe anëtarësia jonë aktive në Kishën e Tij janë gjithashtu të pandashme. Nëse zotimi ynë ndaj njërës ligësohet, zotimi ynë ndaj tjetrës do të zbehet, me aq siguri sa fakti që pas ditës vjen nata.

Disa ngurrojnë ta marrin përsipër emrin e Jezu Krishtit dhe kauzën e tij sepse e konsiderojnë si tepër të ngushtë, kufizuese dhe ndrydhëse. Në të vërtetë, marrja e emrit të Krishtit mbi vete

është edhe çliruese, edhe zgjeruese. Ajo na zgjon dëshirën që ndiem kur e pranuar planin e Perëndisë nëpërmjet besimit të Shpëtimtari. Me këtë dëshirë të gjallë në zemrat tona, ne mund ta zbulojmë qëllimin e vërtetë të dhuntive dhe talenteve tona të dhëna në mënyrë hyjnore, mund ta përjetojmë dashurinë e Tij fuqizuese dhe ta rritim interesimin tonë për mirëqenien e të tjerëve. Kur e marrim mbi vete emrin e Shpëtimtarit, ne vërtet do të mbështete[m]i në çdo gjë të mirë dhe do të bëhemi si Ai.¹⁴

Është e rëndësishme ta mbajmë mend që marrja e emrit të Shpëtimtarit mbi vete është një zotim besëlidhës që fillon me besëlidhjen që bëjmë në pagëzim. Presidenti Nelson ka dhënë mësim: “Zotimi [ynë] për ta ndjekur Shpëtimtarin nëpërmjet bërjes së besëlidhjeve me Të dhe më pas nëpërmjet mbajtjes së atyre besëlidhjeve, do ta hapë derën drejt çdo bekimi dhe privilegji shpirtëror në dispozicion”¹⁵. Një nga privilegjet hyjnore të marrjes së emrit të Shpëtimtarit mbi vete me anë të pagëzimit është qasja që ai siguron tek ordianca e radhës në shtegun tonë të besëlidhjes: konfirmimi ynë. Kur e pyeta një nga miket e mia tetëvjeçare se çfarë kuptimi kishte për të marrja e emrit të Krishtit mbi vete, ajo u përgjigj thjesht: “Do të thotë që mund të kem Frymën e Shenjtë”. Kishte të drejtë.

Dhurata e Frymës së Shenjtë merret me anë të konfirmimit pasi të kemi marrë ordiancën e pagëzimit. Kjo dhuratë është e drejta dhe mundësia për ta pasur Frymën e Shenjtë si shoqërues të vazhdueshëm. Nëse e dëgjojmë dhe i bindemi zërit të Tij të qetë e të vogël, Ai do të na mbajë në shtegun e besëlidhjes në të cilin hymë nëpërmjet pagëzimit, do të na paralajmërojë kur të tundohejmë për t’u larguar prej tij dhe do të na nxitë të pendohejmë dhe të ndreqemi sipas nevojës. Pikëpërqendrimi ynë pas pagëzimit është mbajtja e Frymës së Shenjtë gjithnjë me vete në mënyrë që të mund të vazhdojmë të përparojmë përgjatë shtegut të besëlidhjes. Fryma e Shenjtë mund të jetë me ne vetëm për aq sa ne e mbajmë jetën tonë të pastër e të lirë nga mëkati.



Për këtë arsye, Zoti ka siguruar një mënyrë që ne ta rifreskojmë vazhdimisht efektin pastrues të pagëzimit tonë nëpërmjet një ordiance tjetër: sakramentit. Çdo javë ne mund të “dëshmojmë . . . se [ne] jemi të gatshëm të marrim mbi vete emrin e Birit”¹⁶ sërish duke u zgjatur dhe duke i marrë emblemat e mishit dhe gjakut të Zotit në duart tona – bukën dhe ujin – dhe duke i futur ato në vetë shpirtin tonë. Në këmbim, Shpëtimtari bën sërish mrekullinë e Tij pastruese dhe na kualifikon kështu për ta pasur ndikimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë. A nuk është kjo një provë e mëshirës së pafundme që gjendet vetëm në emrin e Jezu Krishtit? Ashtu siç ne e marrim emrin e Tij mbi vete, Ai i merr mëkatet dhe pikëllimet tona mbi Vete dhe prapëseprapë krahu i Tij është “akoma [i] shtrirë”¹⁷ për të na rrethuar në krahët e dashurisë së Tij.¹⁸

Sakramenti është një kujtues i përjavshëm që marrja mbi vete e emrit të Jezu Krishtit është një zotim i gjallë e i vazhdueshëm, jo një ngjarje e vetme që ndodh vetëm një herë ditën e pagëzimit tonë.¹⁹ Ne mund ta gëzojmë në vazhdimësi dhe në mënyrë të përsëritur “atë flimj të shenjtë, që njer’zit s’kuptonin, që fajet të na falen [dhe] trupin [dhe] gjakun [e tij të] marrim”²⁰. Nuk është çudi më pas që kurdoherë që fëmijët e Perëndisë i kuptojnë bekimet e fuqishme, shpirtërore që mund të vijnë nga marrja e emrit të Krishtit mbi vete, ndjenja e tyre është përherë ndjenjë gëzimi dhe dëshira e tyre është

përherë që të hyjnë në një besëlidhje me Perëndinë e tyre.²¹

Teksa e ndjekim këtë shteg besëlidhjeje të projektuar hyjnisht, zotimi dhe përpjekjet tona për ta marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit do të na japin fuqi “ta mbajmë emrin [e Tij] gjithmonë të shkruar në zemrat tona”²². Do ta duam Perëndinë dhe të afërmit tanë dhe do të ndiejmë një dëshirë për t’u dhënë shërbesë atyre. Do t’i mbajmë urdhërimet e Tij dhe do të dëshirojmë fort që t’i shkojmë më pranë Atij me anë të hyrjes në besëlidhje të Tjera me Të. Kur na duket vetja të dobët e të pazotë për të vepruar sipas dëshirave tona, do të përgjrohemi për forcën që vjen vetëm nëpërmjet emrit të Tij dhe Ai do të na vijë në ndihmë. Teksa durojmë me besnikëri, do të vijë dita kur do ta shohim Atë e do të jemi me Të dhe do të zbulojmë që jemi bërë si Ai, duke u kualifikuar kështu për t’u rikthyer në praninë e Atit.

Pasi premtimi i Shpëtimtarit është i sigurt: ata që “besojnë në emrin e Jezu Krishtit, dhe ta adhurojnë Atin në emrin e tij, dhe të durojnë me besim në emrin e tij deri në fund”²³, do të shpëtohen në mbretërinë e Perëndisë. Me ju, unë gëzohem që këto bekime të pakrahasueshme janë të mundura me anë të marrjes mbi vete të emrit të Jezu Krishtit, për të Cilin dhe në emrin e të Cilit unë dëshmoj, amen. ■

SHËNIME

1. Moisiu 5:8.
2. Mosia 3:17.
3. Doktrina e Besëlidhje 18:23.

4. Dallin H. Oaks, "Taking upon Us the Name of Jesus Christ", *Ensign*, maj 1985, f. 82.
5. Doktrina e Besëlidhje 18:24; theksimi i shtuar.
6. Doktrina e Besëlidhje 20:37; theksimi i shtuar.
7. Presidenti Dallin H. Oaks ka dhënë mësim: "Ne e marrim mbi vete emrin e Shpëtimtarit tonë kur bëhemi anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. . . . Si besimtarë të vërtetë në Krisht, si të krishterë, ne e kemi marrë me gëzim këtë emër mbi vete" ("Taking upon Us the Name of Jesus Christ", f. 80).
8. Fjalori i autorëve Merriam-Webster në internet, rendit 20 përkufizime të formës kalimtare të foljes *marr*, që është forma në të cilën përdoret folja te fraza "marrim mbi vete emrin e Jezu Krishtit" (shih merriam-webster.com/dictionary/take).
9. Rasëll M. Nelson, "Profetët, Udhëheqja dhe Ligji Hyjnor" (takimi shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë në moshë madhore, 8 janar 2017), broadcasts.lds.org.
10. Shih Rasëll M. Nelson, "Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?" *Liahona*, nëntor 2017, f. 60–63.
11. Mosia 18:9.
12. Rasëll M. Nelson, "Shpresa e Izraelit" (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), hopeofisrael.lds.org.
13. "Zoti ka ngulitur në mendjen time rëndësinë e emrit që Ai ka zbuluar për Kishën e Tij, madje Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kemi punë përpara vetes, për ta sjellë vetveten në harmoni me vullnetin e Tij." (Rasëll M. Nelson, tek "Emri i Kishës" [deklarata zyrtare, 16 gusht, 2018], mormonnewsroom.org).
14. Shih Moroni 7:19.
15. Rasëll M. Nelson, "Teksa Ecim Përpara së Bashku", *Liahona*, prill 2018, f. 7.
16. Doktrina e Besëlidhje 20:77; theksimi i shtuar.
17. 3 Nefi 9:14; shih edhe Alma 5:33–34.
18. Shih 2 Nefi 1:15.
19. "Kur e dëshmojmë *gatishmërinë* tonë për ta marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit, ne po e tregojmë zotimin tonë për të bërë gjithçka që mundemi që të arrijmë jetën e përjetshme në mbretërinë e Atit tonë. Ne po shprehim kandidaturën – vendosmërinë tonë për t'u përpjekur fort për – ekzaltimin tonë në mbretërinë celestiale. . . .
. . . Ajo që dëshmojmë nuk është që ne e *marrim* mbi vete emrin e Tij, por që jemi *të gatshëm* ta bëjmë këtë. Në këtë kuptim, dëshmia jonë lidhet me njëfarë ngjarjeje ose gjendjeje të ardhshme, fitimi i së cilës nuk merret me mend vetë, por varet nga autoriteti ose nisma e Vetë Shpëtimtarit" (Dallin H. Oaks, "Taking upon Us the Name of Jesus Christ", f. 82, 83).
20. "Per'ndi, At' i Përjetshëm", *Himne*, nr. 101.
21. Shih Mosia 5; 6; 18; 3 Nefi 19.
22. Mosia 5:12.
23. Doktrina e Besëlidhje 20:29.



Nga Plaku Diter F. Uhtdorf,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Beso, Duaj, Bëj

Ne e arrijmë jetën plot bollëk duke u bërë dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit – duke ndjekur shtigjet e Tij dhe duke u përfshirë në veprën e Tij.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, është një rast kaq i mrekullueshëm që të jem me ju në këtë sesion të mahnitshëm të konferencës së përgjithshme sot: për të dëgjuar mesazhe të frymëzuara, për të dëgjuar këtë kor të mahnitshëm, të hatashëm, misionarësh që përfaqësojnë mijëra misionarë nga mbarë bota – bijat tona, bijtë tanë – dhe veçanërisht për të qenë të bashkuar në besimin tonë sot, sërish duke e mbështetur Presidentin dhe profetin tonë të dashur, Presidentin Rasëll M. Nelson, Presidencën e Parë dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës. Sa ditë e gëzueshme është kjo e sotmja ngaqë jam me ju!



Mbreti i lashtësisë Salomoni, në dukje, qe një nga qeniet njerëzore më të suksesshme në histori.¹ Ai dukej se kishte gjithçka – para, pushtet, adhurim, nderim. Por pas dekadash vetëkënaqjeje dhe luksi, si e përmbodhi mbreti Salomon jetën e Tij?

"Gjithçka është kotësi"², tha ai.

Ky njeri, që i kishte të gjitha, përfundoi i zhgënjyer, pesimist dhe i palumtur, pavarësisht nga gjithçka që kishte arritur.³

Ka një fjalë në gjermanisht: *Weltschmerz*. Me një përkufizim të përciptë do të thotë një trishtim që vjen nga bluajtja në mendje e faktit se bota nuk është në lartësinë e asaj që ne mendojmë se duhet të jetë.

Ndoshta ka pakëz *Weltschmerz* brenda të gjithëve ne.

Kur pikëllimet hyjnë shkarazi pa u ndier në skutat e jetës sonë. Kur trishtimi na i mbush ditët dhe na i mbulon netët me hije të rënda. Kur tragjedia dhe padrejtësitë hyjnë në botën përreth nesh, përfshirë jetën e njerëzve që duam. Kur rrugëtojmë përgjatë shtegut tonë vetjak e të vetmuar të mjerimit dhe dhembja na e zymton prehjen dhe na e prish qetësinë – mund të tundohej për t'u pajtuar me Salomonin se jeta është kotësi dhe pa asnjë kuptim.

Shpresa e Madhërishme

Lajmi i mirë është se ka shpresë. Ka një zgjidhje për zbrazëtinë, kotësinë dhe *Weltschmerz-in* e jetës. Ka një zgjidhje madje edhe për humbjen e shpresës dhe shkurajimin më të thellë që mund të ndieni.

Kjo shpresë gjendet te fuqia shndërruese e ungjillit të Jezu Krishtit dhe te fuqia shëlbuese e Shpëtimtarit për të na shëruar nga sëmundjet e shpirtit tonë.

“Unë kam ardhur”, shpalli Jezusi, “që të kenë jetë e ta kenë me bollëk”⁴.

Ne e arrijmë atë jetë plot bollëk, jo duke u përqendruar te nevojat tona vetjake ose tek arritjet tona vetjake por duke u bërë dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit – duke ndjekur shtigjet e Tij dhe duke u përfshirë në veprën e Tij. Ne e gjejmë jetën me bollëk duke e harruar veten dhe duke u përfshirë në kauzën e madhërishme të Krishtit.

Dhe cila është kauza e Krishtit? Është të besosh në Të, t’i duash të tjerët siç i deshi Ai dhe të bësh ato që bëri Ai.

Jezusi “e përshkoi vendin duke bërë mirë”⁵. Ai eci mes të varfërve, të dëbuarve, të sëmurëve e të turpëruarve. Ai u dha shërbesë të pafuqishmëve, të dobtëve dhe të mbeturve pa miq. Ai kaloi kohë me ta; Ai foli me ta. “Dhe ai i shëroi të gjithë.”⁶

Kudo që shkoi, Shpëtimtari e dha mësim “lajmin e mirë”⁷ të ungjillit. Ai tregoi të vërtetën të përjetshme që i bënë njerëzit të lirë shpirtërisht, si edhe fizikisht.

Ata që ia përkushtojnë veten kauzës së Krishtit, e zbulojnë të vërtetën e premtimit të Shpëtimtarit: “Ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë atë”⁸.

Salomoni e kishte gabim, vëllezërit dhe motrat e mia të dashura – jeta nuk është “kotësi”. Përkundrazi, ajo mund të jetë plot qëllim, kuptim dhe paqe.

Duart shëruese të Jezu Krishtit zgjaten për të dhënë ndihmë ndaj të gjithë atyre që e kërkojnë Atë. Kam arritur të di pa asnjë dyshim që besimi te Perëndia e dashuria për Të, si dhe përpjekja për ta ndjekur Krishtin, mund të na e ndryshojë zemrën⁹, të na e zbutë dhembjen e të na e mbushë shpirtin me “gëzim jashtëzakonisht të madh”¹⁰.



Beso, Duaj, Bëj

Patjetër që ne duhet të bëjmë më tepër sesa thjesht të kemi një kuptuesmëri intelektuale për ungjillin që ai ta ketë këtë ndikim shërues në jetën tonë. Ne duhet ta kemi pjesë përbërëse të jetës sonë – ta bëjmë atë pjesë të asaj që jemi dhe të asaj që bëjmë.

Më lejoni të sugjeroj se dishepullimi fillon me tri fjalë të thjeshta:

Beso, duaj dhe bëj.

Vendimi për t’i besuar Perëndisë të çon te pasja e besimit tek Ai dhe zhvillimi i mirëbesimit në fjalën e Tij. Besimi bën që në zemrën tonë të shtohet dashuria për Perëndinë dhe të tjerët. Teksa ajo dashuri shtohet, ne frymëzo-hemi për t’i ngjarë Shpëtimtarit teksa e vazhdojmë rrugëtimin tonë vetjak e të madhërishëm në shtegun e dishepullimit.

“Por”, do të thoni ju, “ajo duket disi e thjeshtuar. Problemet e jetës, me siguri problemet e mia, janë tejet të ndërlikuara për një recetë kaq të thjeshtë. Nuk mund të shërohet *Weltschmerz-i* me tri fjalë të thjeshta: *Beso, duaj, bëj.*”

Nuk është aforizma ajo që ju shëron. Është dashuria e Perëndisë ajo që ju shpëton nga mëkati, ju rikthen në gjendje drejtësie dhe ju ringjall shpirtërisht.

Perëndia ju njeh. Ju jeni fëmija i Tij. Ai ju do.

Edhe kur mendoni se nuk e merito-ni t’ju duan, Ai ju vjen në ndihmë.

Këtë ditë – çdo ditë – Ai ju vjen në ndihmë, duke dëshiruar t’ju shërojë, t’ju ngrejë moralisht dhe ta zëvendësojë zbrazëtinë e zemrës suaj me një gëzim të përhershëm. Ai dëshiron ta fshijë çdo errësi që jua mjegullon jetën, dhe ta mbushë atë me dritën e shenjtë e të shndritshme të lavdisë së Tij të pashtershme.

E kam përjetuar këtë vetë.

Dhe është dëshmia ime si një Apostull i Zotit Jezu Krisht që të gjithë ata që vijnë te Perëndia – të gjithë ata që vërtet *besojnë, duan dhe bëjnë* – mund të përjetojnë të njëjtën gjë.

Ne Besojmë

Shkrimet e shenjta na mësojnë se “pa besim është e pamundur t’i pëlqesh [Perëndisë], sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është”¹¹.

Për disa, akti i të besuarit është i vështirë. Nganjëherë, krenaria jonë bëhet pengesë. Ndoshta mendojmë se ngaqë jemi inteligjentë, të arsimuar ose me përvojë, ne thjesht nuk mund të besojmë në Perëndi. Dhe fillojmë ta shohim fenë si një traditë të marrë.¹²

Nga përvoja ime, besimi nuk është dhe aq si një pikturë mbresëlënëse të cilën e kundrojmë, e admirojmë dhe rreth së cilës diskutojmë e bëjmë

teori. Ai është më shumë si një plug që ngulim në fusha dhe, me djersën e ballit, krijojmë brazda në tokë që pranojnë fara dhe japin fryt që të jetë i qëndrueshëm.¹⁵

Afrohuni te Perëndia dhe Ai do t'ju afrohet juve.¹⁴ Ky është premtimi ndaj të gjithë atyre që kërkojnë të besojnë.

Ne Duam

Shkrimet e shenjta nxjerrin në pah faktin se sa më shumë [i] duam Perëndinë dhe fëmijët e Tij, aq më të lumtur bëhemi.¹⁵ Dashuria për të cilën foli Jezusi, sidoqoftë nuk është një kartë dhuratë për blerje, njëpërdorimshme, apo që e lëmë mënjanë për t'u marrë me diçka tjetër. Nuk është një dashuri që thuhet e më pas harrohet. Nuk është lloji i dashurisë “më vër në dijeni nëse mund të bëj diçka”.

Dashuria për të cilën flet Perëndia, është lloji i dashurisë që hyn në zemrën tonë kur zgjohemi në mëngjes, që qëndron brenda nesh gjatë gjithë ditës dhe që bymehet në zemrën tonë teksa shprehim lutjet tona në fund të mbrëmjes.

Ajo është dashuria e pashprehshme që Ati Qiellor ka për ne.

Është kjo dhembshuri e pafundme që na lejon t'i shohim të tjerët më qartë ashtu siç janë. Përmes thjerrave të dashurisë së pastër, ne shohim qenie të pavdekshme me potencial e vlerë të pafundme dhe bij e bija të dashura të Perëndisë të Gjithëfuqishëm.

Pasi shohim përmes asaj thjerre, nuk mund të zhvlerësojmë, shpërfillim ose diskriminojmë askënd.

Ne Bëjmë

Në veprën e Shpëtimtarit, shpesh ndodh që “nëpërmjet gjërave të vogla dhe të thjeshta gjëra të mëdha bëhen”¹⁶.

Ne e dimë se kërkohet ushtrim i përsëritur për t'u bërë të zotë për çfarëdo lloj gjëje. Qoftë nëse është për rënien e klarinetës, goditjen e një topi në rrjetë, riparimin e një makine ose madje pilotimin e një avioni, veç nëpërmjet ushtrimit mund të bëhemi gjithnjë e më të zotë.¹⁷

Organizata që Shpëtimtari ynë krijoi në tokë – Kisha e Jezu Krishtit

e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme – na ndihmon të bëjmë pikërisht atë. Na ofron një vend për ta ushtruar të jetuarit sipas mënyrës që na mësoi Ai, dhe bekimin e të tjerëve ashtu siç bëri Ai.

Si anëtarë të Kishës, na jepen thirrje, përgjegjësi dhe mundësi për t'u shkuar në ndihmë të tjerëve me dhembshuri dhe për t'u dhënë shërbesë.

Kohët e fundit, Kisha ka vënë një theks të përtëritur te dhënia e shërbesës ose shërbimi ndaj të tjerëve ose te dashuria për të tjerët. Është menduar shumë për të vendosur se si duhet ta quajmë këtë theks të veçantë.

Një nga emrat e marrë parasysh [në anglisht] qe *shepherding* [kujdestari baritore], një referencë e përshtatshme me ftesën e Krishtit: “Kulloti delet e mia”¹⁸. Sidoqoftë, kishte së paku një ndërlirim: përdorimi i atij termi do të më bënte mua një qen të racës *German shepherd* [pastor gjerman]. Për pasojë, jam mjaft i kënaqur me termin *dhënie shërbese*.

Kjo Punë Është për Gjithsecilin

Sigurisht, ky theksim nuk është diçka e re. Ai thjesht na siguron një mundësi të përtëritur e të përmirësuar për ta ushtruar urdhërimin e Shpëtimtarit për “ta [dashur] njëri-tjetrin”¹⁹, një mënyrë të përtëritur për ta vënë në zbatim e për ta ushtruar qëllimin e Kishës.

Thjesht mendoni për punën misionare; shpërndarja e guximshme, e përlulur dhe me vetëbesim e ungjillit është një shembull i mrekullueshëm i dhënies së shërbesës për nevojat shpirtërore të të tjerëve, kushdo qofshin ata.

Ose bërja e punës në tempull – kërkimi i emrave të paraardhësve tanë dhe ofrimi i bekimeve të përjetësisë për ta. Çfarë mënyrë hyjnore për të dhënë shërbesë!

Merreni parasysh aktin e shkuarjes në kërkim të të varfërve e nevojtarëve, ngritjes së duarve të varura ose të bekimit të të sëmurëve e të munduarve. A nuk janë këto vetë aktet e dhënies së shërbesës së pastër që Zoti ushtroi kur eci në tokë?

Nëse nuk jeni anëtar i Kishës, unë ju ftoj të “[vini] e shikoni”²⁰. Ejani dhe bashkohuni me ne. Nëse jeni anëtarë të Kishës, por nuk po merrni pjesë aktivisht në të tashmen, unë ju ftoj: ju lutem kthehuni. Ne kemi nevojë për ju!

Ejani, bashkoni forcat tuaja me tonat.

Për shkak të talenteve, aftësive dhe personalitetit tuaj të pasqorë, ju do të na ndihmoni të bëhemi më të mirë e më të lumtur. Në këmbim, edhe ne do t'ju ndihmojmë ju të bëheni më të mirë e më të lumtur.

Ejani, na ndihmoni të ndërtojmë dhe forcojmë një kulturë shërimi, mirëdashjeje dhe mëshire kundrejt të gjithë



fëmijëve të Perëndisë. Sepse ne të gjithë po përpiqemi të bëhemi krijesa të reja ku “gjërat e vjetra kishin kaluar” dhe . . . “të gjitha gjërat ishin bërë të reja”²¹. Perëndia na tregon drejtimin nga duhet të lëvizim – përpara dhe për lart. Ai thotë: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”²². Le të punojmë të gjithë së bashku për t’u bërë populli që Perëndia kishte për qëllim që të bëheshim.

Ky është lloji i kulturës së ungjillit që dëshirojmë të kultivojmë në mbarë Kishën e Jezu Krishtit. Ne kërkojmë ta forcojmë Kishën si një vend ku ne falim njëri-tjetrin. Ku i bëjmë qëndresë tundimit për të gjetur faj, për të bërë thashe dhe për ta ulur dikë moralisht. Ku, në vend që të tregojmë me gisht cenet, ne e ngremë dhe e ndihmojmë njëri-tjetrin për t’u bërë më të mirët që mundemi.

Më lini t’ju ftoj sërish. Ejani e shikoni. Bashkohuni me ne. Ne kemi nevojë për ju.

Njerëz të Papërsosur

Do të zbuloni se kjo Kishë është e mbushur me disa prej njerëzve më të mirë që kjo botë ka për të ofruar. Ata janë mikpritës, të dashur, të sjellshëm e të sinqertë. Ata janë punëtorë, të gatshëm për të sakrifikuar e madje nganjëherë edhe heroikë.

Dhe ata janë gjithashtu të papërsosur gjer në dhembje.

Ata bëjnë gabime.

Herë pas here ata thonë gjëra që nuk duhet t’i thonë. Ata bëjnë gjëra që urojnë të mos i kishin bërë.

Por ata kanë të përbashkët këtë gjë – dëshirojnë të përmirësohen dhe t’i afrohen më shumë Zotit, Shpëtimtarit tonë, madje Jezu Krishtit.

Ata po përpiqen t’i bëjnë gjërat siç duhet.

Ata *besojnë*. Ata *duan*. Ata *bëjnë*.

Ata dëshirojnë të bëhen më pak vetëdashës, më të dhembshur, më të përmirësuar, më të ngjashëm me Jezusin.

Projekti për Lumturinë

Po, jeta mund të jetë e vështirë nganjëherë. Me siguri, ne të gjithë kemi castet tona të dëshpërimit e shkurajimit.



Por ungjilli i Jezu Krishtit ofron shpresë. Dhe, në Kishën e Jezu Krishtit, u bashkohemi të tjerëve që kërkojnë një vend ku mund të ndihemi në shtëpi – një vend rritjeje ku, së bashku, mund të *besojmë*, të *duam* dhe të *bëjmë*.

Pavarësisht nga ndryshimet tona, ne synojmë ta përqafojmë njëri-tjetrin si bij e bija të Atit tonë të dashur Qiellor.

Jam mirënjohës pa masë që jam anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe që e di se Perëndia i do fëmijët e Tij aq sa për t’u dhënë atyre një projekt për lumturi e kuptim në këtë jetë dhe një mënyrë për të përjetuar gëzim të përjetshëm në paradhomat e lavdisë në jetën tjetër.

Jam mirënjohës që Perëndia na ka dhënë një mënyrë për t’i shëruar sëmundjet e shpirtit dhe *Weltschmerz-in* e jetës.

Unë dëshmoj dhe ju jap bekimin tim se, kur ne *besojmë* në Perëndi, kur e *duam* Atë dhe *i duam* fëmijët e Tij me gjithë zemër, si dhe përpiqemi të *bëjmë* ato gjëra për të cilat na ka udhëzuar Perëndia, do të gjejmë shërim e paqe, lumturi e kuptim. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Një sondazh në msn.com e renditi Salomonin të pestin në renditjen e

njerëzve më të pasur që kanë jetuar ndonjëherë. “Sipas Biblës, mbreti Salomon sundoi nga viti 970 pr.K. deri në 931 pr.K., dhe gjatë kësaj kohe thuhet se ka marrë 25 ton ar për secilin nga 39 vjetët e mbretërimit të tij, që duhet të kishin vlerën e miliarda dollarëve në vitin 2016. Përveç pasurive të pamundura për t’u llogaritur të grumbulluara nga taksat dhe tregtia, pasuria vetjake e sundimtarit biblik mund ta ketë kaluar shumë e 2 trilionë dollarëve me paratë e sotme” (“The 20 Richest People of All Time”, 25 prill 2017, msn.com).

2. Shih Predikuesit 1:1-3.
3. Shih Predikuesit 2:17.
4. Gjoni 10:10.
5. Veprat e Apostujve 10:38.
6. Mateu 12:15; shih edhe Mateu 15:30.
7. Fjala *ungjill* i ka rrënjët në një fjalë greke që fjalë për fjalë do të thotë “lajm i mirë” (shih Bible Dictionary, “Gospels”).
8. Mateu 16:25.
9. Shih Ezekieli 36:26; Jeremia 24:7.
10. 1 Nefi 8:12.
11. Hebrenjve 11:6.
12. Shih 2 Nefi 9:28.
13. Shih Gjoni 15:16.
14. Shih Jakob [Bibël] 4:8.
15. Shih 4 Nefi 1:15-16.
16. Alma 37:6.
17. Aristoteli besonte se “njeriu i drejtë bëhet vetëm me anë të veprimeve të drejta” (*The Nicomachean Ethics*, përkth. David Ross, rish. Lesley Brown [2009], f. 28).
18. Shih Gjoni 21:15-17.
19. Gjoni 15:12.
20. Gjoni 1:39.
21. 2 Korintasve 5:17.
22. Gjoni 14:15.



Nga Xhoi D. Xhons,
Presidente e Përgjithshme e Fillores

Për Të

Në shërbimin ndaj të tjerëve, dijenia se kujt dhe përse shërbejmë, na ndihmon të kuptojmë se shfaqja më kulmore e dashurisë është përkushtimi ndaj Perëndisë.

Në këtë mbrëmje historike, shpreh dashurinë dhe vlerësimin tim për secilën prej jush, motra të mia të dashura. Cilado qofshin mosha, vendndodhja apo rrethanat tona, ne mbliidhemi sonte në unitet, në forcë, në qëllim dhe në dëshminë se ne kemi dashurinë dhe udhërrëfimin e Atit tonë Qiellor, të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, dhe të profetit tonë të gjallë, Presidentit Rasëll M. Nelson.

Kur ishim çift i ri, unë dhe bashkëshorti im u thirrëm nga peshkopi ynë për ta vizituar dhe për t'i dhënë shërbesë një familjeje që nuk kishte qenë në Kishë për shumë vite. Me gatishmëri e pranua detyrën dhe shkuam në shtëpinë e tyre disa ditë më vonë. Ishte menjëherë e qartë për ne se ata nuk donin vizitorë nga Kisha.

Prandaj, në vizitën tonë të ardhshme, iu afroam atyre me një pjatë biskotash, të bindur se ëmbëlsirat me copa çokollate do t'ua shkrinin zemrat. Kjo nuk ndodhi. Çifti na foli nëpërmjet derës me rrjetë, duke e bërë edhe më të qartë se ne nuk ishim të mirëpritur. Por, kur po shkonim me makinë për në shtëpi, ne ishim mjaft të sigurt se mund të kishim pasur sukses sikur në vend të ëmbëlsirave me çokollatë t'u kishim ofruar ëmbëlsira me oriz që të kërcisnin në gojë.

Mungesa e largpamësisë shpirtërore nga ana jonë i bëri acaruese përpjekjet e tjera të dështuara. Refuzimi nuk është kurrë i lehtë. Me kalimin e kohës filluam t'i bënim vetes pyetjet: "Përse po e bëjmë këtë? Cili është qëllimi ynë?"

Plaku Karl B. Kuk bëri këtë vëzhgim: "Shërbimi në Kishë mund të jetë sfidues nëse na kërkohet të bëjmë diçka që na frikëson, nëse fillojmë të lodhemi nga shërbimi, apo nëse thirrëmi të bëjmë diçka që fillimisht nuk na duket tërheqëse"¹. Ne po përjetonim të vërtetën e fjalëve të Plakut Kuk kur vendosëm se duhej të kërkonim drejtim nga Dikush me një këndvështrim më të gjerë sesa i joni.

Ndaj, pas shumë lutjesh dhe një studimi të sinqertë, ne e morëm përgjigjen e përsesë së shërbimit tonë. Ne përjetuam një ndryshim të të kuptuarit tonë, një ndryshim zemre, në fakt një përvojë që sjell zbuluesë.² Teksa kërkua udhërrëfim nga shkrimet e shenjtja, Zoti na mësoi se si ta bënim procesin e shërbesës ndaj të tjerëve më të lehtë e më kuptimplotë. Ja ku është vargu që lexuam, i cili ndryshoi si zemrat tona, edhe qasjen tonë: "Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tënde; dhe në emër të Jezu Krishtit *duhet*

t'i shërbesh atij"³. Ndonëse ky varg ishte aq i njohur, dukej sikur na foli në një mënyrë të re dhe të rëndësishme.

Ne kuptuam se po përpiqeshim me çiltërsi për t'i shërbyer kësaj familjeje dhe për t'i shërbyer peshkopit tonë, por na u desh ta pyetnim veten nëse po shërbenim me të vërtetë nga dashuria për Zotin. Mbreti Benjamin e bëri të qartë këtë dallim kur shpalli: "Vini re, unë ju them se pasi ju thashë se kisha kaluar ditët e mia në shërbimin tuaj, unë nuk dua të mburrem, pasi *kam qenë vetëm në shërbimin e Perëndisë*"⁴.

Pra, kujt po i shërbente në të vërtetë mbreti Benjamin? Atit Qiellor dhe Shpëtimtarit. Në shërbimin ndaj të tjerëve, dijenia se *kujt* dhe *përse* shërbejmë, na ndihmon të kuptojmë se shfaqja më kulmore e dashurisë është përkushtimi ndaj Perëndisë.

Teksa qendra e vëmendjes sonë gradualisht ndryshoi, kështu ndryshuan edhe lutjet tona. Filluam që t'i pritnim me padurim vizitat tona te kjo familje e dashur për shkak të dashurisë sonë për Zotin.⁵ Ne po e bënim këtë për Të. Ai bëri që vështirësia të mos ishte më një vështirësi. Pasi qëndruam për shumë muaj te pragu i derës, familja filloi të na linte të hynim brenda. Përfundimisht, ne bëmë së bashku lutje të rregullta dhe diskutime me ndjenjë mbi ungjillin. U krijua një miqësi afatgjatë. Ne po e adhuronim dhe po e donim Atë duke i dashur fëmijët e Tij.

A mund të mendoni për një rast në të kaluarën kur ju me dashuri e shtritë dorën e ndihmës në një përpjekje të sinqertë për ta ndihmuar dikë në nevojë dhe ndiet se përpjekjet tuaja shkuan pa u vënë re apo ndoshta nuk u vlerësuan ose edhe ishin të padëshiruara? Në atë çast, a e vutë në pikëpyetje vlerën e shërbimit tuaj? Nëse është kështu, fjalët e mbretit Benjamin e zëvendësoshin dyshimin tuaj dhe madje lëndimin tuaj: "Ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj"⁶.

Në vend që të krijojmë pakënaqësi, ne mund të ndërtojmë, nëpërmjet shërbimit, një marrëdhënie më të përsosur me Atin tonë Qiellor. Dashuria dhe përkushtimi ynë për Të e zëvendëson nevojën për famë apo vlerësim dhe e

lejon dashurinë e Tij të vërsjojë te ne dhe nëpërmjet nesh.

Ndonjëherë, ne mund të shërbejmë fillimisht nga një ndjesi detyre ose detyrimi, por edhe ai lloj shërbimi mund të na bëjë që të mbështetemi te diçka më e lartë brenda nesh, duke na drejtuar që të shërbejmë sipas një “udh[e] shumë më të lartë”⁷ – si në ftesën e Presidentit Nelson drejt “një qasjeje më të re, më të shenjtë ndaj përkujdesjes e dhënies së shërbesës për të tjerët”⁸.

Kur përqendrohemi te gjithçka që ka bërë Perëndia për ne, shërbimi ynë buron nga një zemër mirënjohëse. Ndërsa shqetësohemi më pak rreth lartësismit që do të marrim nga shërbimi ynë, ne e kuptojmë se në vend të kësaj qendra e shërbimit tonë do të jetë që ta vëmë Perëndinë të parin.⁹

Presidenti M. Rasëll Ballard dha mësim: “Vetëm kur [e] duam Perëndinë dhe Krishtin me gjithë zemrat, shpirtat dhe mendjet tona, ne jemi të aftë ta ndajmë këtë dashuri me fqinjët tanë nëpërmjet veprave të mirësisë dhe shërbimit”¹⁰.

Dhjetë Urdhërimet e para e përsëritin këtë urtësi hyjnore: “Unë jam Zoti, Perëndia yt. . . Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje.”¹¹ Dhënia e këtij urdhërimi na ndihmon të kuptojmë që, *nëse* e vendosim Atë si përparësinë tonë kryesore, çdo gjë tjetër përfundimisht do të zërë vendin e vet – madje edhe shërbimi ynë ndaj të tjerëve. Kur Ai zë vendin më të rëndësishëm në jetën tonë nëpërmjet zgjedhjes së ndërjegjshme, atëherë Ai është në gjendje t’i bekojë veprimet tona për të mirën tonë dhe për të mirën e të tjerëve.

Zoti këshilloi: “Shihni tek unë në çdo mendim”¹². Dhe çdo javë ne besëlidhim të bëjmë pikërisht këtë – që “gjithmonë [ta] kujtoj[m]ë atë”¹³. A mund të gjejë zbatim një përqendrim i tillë hyjnor në gjithçka që bëjmë? A mundet që kryerja madje e një detyre të përditshme të kthehet në një mundësi për të treguar dashurinë dhe përkushtimin tonë ndaj Tij? Unë besoj se është e mundur dhe me siguri që po.

Ne mund të bëjmë që çdo pikë në listën tonë të detyrave që duhen kryer, të bëhet një mënyrë për ta përlëvduar



Atë. Ne mund ta shohim secilën detyrë si një privilegj dhe mundësi për t’i shërbyer Atij, edhe kur jemi në mes të afateve, detyrave apo pelenave të pista.

Ashtu siç tha Amoni: “Po, unë e di se nuk jam asgjë; pasi nga fuqia ime jam i dobët; prandaj nuk do të mburrem për veten time, por do të krenohem për Perëndinë tim, pasi në fuqinë e tij unë mund të bëj të gjitha gjërat”¹⁴.

Kur shërbimi ndaj Perëndisë tonë bëhet përparësia jonë kryesore në jetë, ne e humbasim veten dhe, me kohë, e gjejmë veten.¹⁵

Shpëtimtari e dha mësim këtë parim në mënyrë kaq të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë: “Prandaj, le të shkëlqejë drita juaj para këtyre njerëzve, që ata të shohin veprat tuaja të mira dhe të *lëvdojnë Atin tuaj* që është në qiell”¹⁶.

Më lejoni t’ju tregoj disa fjalë të urta që u gjetën në murin e një jetimoreje në Kalkutë të Indisë: “Nëse je i sjellshëm, njerëzit mund të të akuzojnë për shtysa egoiste dhe të fshehta. Jini dashamirës gjithsesi. Atë që ju harxhoni me vite për ta ndërtuar, dikush mund ta shkatërojë brenda natës. Ndërtojeni gjithsesi. Të mirën që bëni sot, njerëzit shpesh do ta harrojnë nesër. Bëni

mirë gjithsesi. Jepini botës më të mirën që keni, dhe mund të mos jetë kurrë e mjaftueshme. Jepjani botës më të mirën që keni gjithsesi. Pra siç e shihni, në analizën përfundimtare, [gjithçka] është mes jush dhe Perëndisë tuaj . . . gjithsesi.”¹⁷

Motra, është gjithmonë midis nesh dhe Zotit. Siç tha Presidenti Xhejms E. Faust: “‘Cila është nevoja më e madhe në botë?’ . . . ‘A nuk është nevoja më e madhe në të gjithë botën për çdo njeri që të ketë një marrëdhënie vetjake, të vazhdueshme, të përditshme, në vijueshmëri me Shpëtimtarin?’ Të pasurit e një marrëdhënieje të tillë mund të nxjerrin në pah karakterin hyjnor brenda nesh dhe asgjë tjetër nuk mund të sjellë një ndryshim më të madh në jetën tonë sesa kur arrijmë ta njohim dhe ta kuptojmë marrëdhënien tonë hyjnore me Perëndinë.”¹⁸

Në mënyrë të ngjashme, Alma i shpjegoi birit të tij: “Po, le të jenë të gjitha veprimet e tua në Zotin dhe kudo që të shkosh, le të jetë në Zotin; po, le të jenë të gjitha mendimet e tua të drejtuara te Zoti; po, le të jetë dashuria e zemrës sate e vendosur përgjithnjë te Zoti”¹⁹.

Dhe Presidenti Rasëll M. Nelson na ka mësuar po ashtu: “Kur e kuptojmë Shlyerjen e Tij të vullnetshme, çdo ndjenjë e sakrificës nga ana jonë zbehet plotësisht nga një ndjenjë e thellë mirënjohjeje për privilegjin që kemi për t’i shërbyer Atij”²⁰.

Motra, unë dëshmoj se kur Jezu Krishti, nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Tij, vepron *te ne* dhe *në ne*, Ai fillon të veprojë *nëpërmjet* nesh për t’i bekuar të tjerët. Ne u shërbejmë atyre, por e bëjmë këtë duke e dashur dhe duke i shërbyer Atij. Ne bëhemi çka përshkruan shkrimi i shenjtë: “Cilido [e cilado] duke kërkuar interesin e të afërmit të tij [e të saj] dhe duke bërë gjithçka me syrin drejtuar te lavdia e Perëndisë”²¹.

Ndoshta peshkopi ynë e dinte se ai ishte mësimi që unë dhe bashkëshorti im do të mësonim nga ato përpjekje të hershme dhe me qëllim të mirë, sado të papërsosura, për t’u shërbyer bijve dhe bijave të dashura të Perëndisë. Unë jap dëshminë time vetjake dhe të sigurt për mirësinë dhe dashurinë që Ai na tregon ne, madje edhe teksa përpiqemi të shërbejmë për Të. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Karl B. Kuk, “Shërbeni”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 110–111.
2. Shih Mosia 5:2.
3. Doktrina e Besëlidhje 59:5; theksimi i shtuar.
4. Mosia 2:16; theksimi i shtuar.
5. Shih 1 Nefi 11:22.
6. Mosia 2:17.
7. 1 Korintasve 12:31.
8. Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës”, *Liahona*, maj 2018, f. 100.
9. Shih Mateu 6:1–4, 33.
10. M. Rasëll Ballard, “Duke Gjetur Gëzim përmes Shërbimit të Përzemërt”, *Liahona*, maj 2011, f. 47.
11. Eksodi 20:2–3.
12. Doktrina e Besëlidhje 6:36.
13. Doktrina e Besëlidhje 20:77, 79.
14. Alma 26:12.
15. Shih Mateu 16:24–25.
16. 3 Nefi 12:16; theksimi i shtuar.
17. Shpesh mendohet se është thënë nga Nënë Tereza; shih Kent M. Keith, *The Paradoxical Commandments* (1968).
18. James E. Faust, “A Personal Relationship with the Savior”, *Ensign*, nëntor 1976, f. 58.
19. Alma 37:36.
20. Russell M. Nelson, “The Atonement”, *Liahona*, nëntor 1996, f. 35.
21. Doktrina e Besëlidhje 82:19.



Nga Mishel D. Krejg,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Pakënaqësia e Shenjtë

Pakënaqësia e shenjtë mund të na shtyjë të veprojmë me besim, t’i ndjekim ftesat e Shpëtimtarit për të bërë mirë dhe për t’ia dhënë jetën tonë përulësisht Atij.

Kur isha në shkollën fillore, ne ecnim për në shtëpi nëpër një shteg të shtruar që dredhonte sa para-prapa përpjetë faqes së një kodre. Kishte një shteg tjetër, të pashtuar, që quhej “shtegu i djemve”. Shtegu i djemve ishte një udhë nëpër baltë që shkonte pa dredha përpjetë kodrës. Ishte më i shkurtër, por shumë më i rrëpirët. Kur isha vajzë e vogël, e dija se mund të ngjitja çfarëdo shtegu që mund të ngjtinin djemtë. Më me rëndësi, e dija se po jetoja në ditët e mëvonshme dhe se do të më duhej të bëja gjëra të vështira, ashtu siç bënë pionierët – dhe dëshiroja

të isha e përgatitur. Kështu që, herë pas here, unë do të mbetesha prapa grupit të shoqeve të mia në shtegun e shtruar, do t’i hiqja këpucët dhe do ta ngjitja këmbëzbathur shtegun e djemve. Unë po përpiqesha të forcoja këmbët e mia.

Si një vajzë e vogël e Fillores, mendoja se kjo ishte ajo që mund të bëja që të përgatitesha. Tani e di se është ndryshe! Në vend që t’u ngjitem këmbëzbathur shtigjeve malore, e di se mund t’i përgatit këmbët e mia që të eci në shtegun e besëlidhjeve duke iu përgjigjur ftesave të Frymës së Shenjtë. Pasi Zoti, nëpërmjet profetit të Tij, po e



thërret secilin prej nesh që të jetojë dhe të kujdeset [për të tjerët] në një “mënyrë më të lartë dhe më të shenjtë” dhe që të “bëjë një hap për më lart”¹.

Këto thirrje profetike për të vepëruar, të bashkuara me ndjenjën tonë të lindur që ne mund të bëjmë e të jemi [diçka] më shumë, ndonjëherë krijojnë brenda nesh atë që Plaku Nil A. Maksuell e quajti “pakënaqësia e shenjtë”². Pakënaqësia e shenjtë vjen kur ne e krahasojmë “atë që *jemi* [me] atë që kemi fuqinë që të *bëhemi*”³. Secili prej nesh, nëse tregohemi të ndershëm, ndien një mospërputhje mes asaj se ku e cilët jemi dhe asaj se ku e cilët dëshirojmë të jemi. Ne jemi të etur për aftësi më të mëdha vetjake. Ne i kemi këto ndjenja pasi jemi bija e bij të Perëndisë, të lindur me Dritën e Krishtit, por prapëseprapë duke jetuar në një botë të rënë. Këto ndjenja jepen nga Perëndia dhe krijojnë një ngut për të vepëruar.

Ne duhet t’i mirëpresim ndjenjat e pakënaqësisë së shenjtë që na thërresin drejt një udhe më të lartë, ndërsa e dallojmë dhe e shmangim sajësën e Satanit – shkurrëzim paralizues. Ky është një rast i çmuar, ku Satani është tejet i paduruar të veprojë. Ne mund të zgjedhim të ecim nëpër shtegun më të lartë që na bën ta kërkojmë Perëndinë dhe paqen e hirin e Tij, ose ne mund t’ia vëmë veshin Satanit, i cili na bombardon me mesazhe që ne kurrë nuk do të jemi mjaftueshëm [të mirë]: mjaftueshëm të pasur, mjaftueshëm të zgjuar, mjaftueshëm të bukur, mjaftueshëm në asgjë. Pakënaqësia jonë mund të bëhet shenjtëruese – ose shkatërrimtare.

Veproni me Besim

Një mënyrë për ta dalluar pakënaqësinë e shenjtë nga sajësia e Satanit është që pakënaqësia e shenjtë do të na çojë drejt veprimit me besnikëri. Pakënaqësia e shenjtë nuk është një ftesë për të qëndruar në zonën tonë të rehatisë, as nuk do të na çojë në dëshpërim. Kam mësuar se, kur përhubem në mendime të lidhura me gjithçka që *nuk* jam, unë nuk përparoj dhe më duket shumë më e vështirë që ta ndiej dhe ta ndjek Shpirtin.⁴



Kur ishte i ri, Jozef Smithi u bë mjaft i vetëdijshëm për dobësitë e tij dhe u shqetësua për “mirëqenien e shpirtit [të tij] të pavdekshëm”. Sipas fjalëve të tij: “Mendja ime u shqetësua jashtë mase pasi u binda për mëkatet e mia dhe, . . . e ndjeva se duhet të vajoja për mëkatet e mia dhe për mëkatet e botës”⁵. Kjo e bëri atë “të mendonte seriozisht dhe nuk gjente rehati”⁶. A ju tingëllon e njohur kjo? A jeni në ankth apo i/e shqetësuar për dobësitë tuaja?

Epo, Jozefi bëri diçka. Ai u shpreh: “Unë shpesh thashë me vete: Çfarë duhet të *bëhet*?”⁷ Jozefi veproi me besim. Ai iu drejtua shkrimeve të shenjta, lexoi ftesën e Jakobit [Bibël] 1:5 dhe iu drejtua Perëndisë për ndihmë. Vegimi që rrodhi, nisi Rivendosjen. Sa mirënjohëse jam që pakënaqësia e shenjtë e Jozefit, periudha e tij e ankthit dhe e pështjellimit, e shtyu atë drejt veprimit me besnikëri.

Ndiqini Nxitjet për të Bërë Mirë

Bota shpesh e përdor ndjenjën e pakënaqësisë si një shfajësim për egoizmin, për kthimin e mendimeve tona nga vetja e prapa tek e kaluara dhe për mbajtjen e mendjes individualisht tek ajo se cili/a jam *unë*, cili/a nuk jam *unë* dhe çfarë dua *unë*. Pakënaqësia e shenjtë na nxit të ndjekim shembullin

e Shpëtimtarit, “i cili e përshkoi vendin duke bërë mirë”⁸. Teksa ecim në shtegun e dishepullimit, ne do të marrim shtysa shpirtërore për t’u vajtur në ndihmë të tjerëve.

Një histori që e dëgjova vite më parë, më ka ndihmuar që t’i dalloj nxitjet nga Fryma e Shenjtë dhe pastaj të veprojmë sipas tyre. Motra Boni D. Parkin, ish-Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, tregoi sa vijon:

“Suzana . . . ishte një rrobaqepëse e mrekullueshme. Presidenti [Spenser W.] Kimball jetonte në lagjen [e saj]. Një të diel, Suzana vuri re që ai kishte veshur një kostum të ri. Kohët e fundit, i ati i kishte . . . sjellë ca cohë mëndafshi të një cilësie të shkëlqyer. Suzana mendoi që nga ajo cohë mund të qepte një kollare të bukur që do të shkonte me kostumin e ri të Presidentit Kimball. Kështu që, të hënën, ajo e qepi kollaren. E mbështolli me letër të hollë dhe eci përpjetë bllokut të ndërtesave për të shtëpia e Presidentit Kimball.

Udhës për të dera kryesore, ajo papritmas ndali dhe mendoi: ‘Kush jam unë që të qep një kollare për profetin? Ai ndoshta ka kollare me bollëk.’ Duke vendosur se kishte bërë një gabim, ajo u kthye për t’u larguar.

Pikërisht atë çast, motra Kimball hapi derën kryesore dhe tha: ‘Oh, Suzana!’



Suzana, duke iu marrë goja fare, tha: 'E pashë Presidentin Kimball të veshur me kostumin e tij të ri të dielën. Babi sapo më solli ca mëndafsh nga Nju-Jorku . . . dhe kështu i qepa një kollare.'

Përpara se Suzana të mund të vazhdonte, motra Kimball e ndaloi, i vuri duart mbi shpatullat e saj dhe tha: 'Suzana, kurrë mos e ndrydh një mendim bujar.'⁹

Më pëlqen shumë kjo! "Kurrë mos e ndrydh një mendim bujar." Ndonjëherë, kur kam një mbresë për të bërë diçka për dikë, pyes veten a ishte një nxitje apo mos ishin thjesht mendimet e mia vetjake. Por më vjen ndërmend se "ajo që është e Perëndisë fton dhe nxit për të bërë mirë përherë, prandaj çdo gjë që fton dhe nxit për të bërë mirë dhe për të dashur Perëndinë dhe për t'i shërbyer atij, është frymëzuar nga Perëndia"¹⁰.

Qoftë nëse janë nxitje të drejtpërdrejta apo thjesht shtysa për të ndihmuar, një vepër e mirë kurrë nuk shkon dëm, pasi "dashuria nuk ligshtohet kurrë"¹¹ – dhe ajo kurrë nuk është përgjigjja e gabuar.

Shpesh koha e përzgjedhur është e papërshtatshme dhe ne rrallëherë e shohim ndikimin e veprave tona të

vogla të shërbimit. Por hera-herës, ne do ta dallojmë se kemi qenë mjete në duart e Perëndisë dhe do të jemi mirënjohës/e të dimë se të punuarit e Frymës së Shenjtë nëpërmjet nesh është një shfaqje e miratimit nga Perëndia.

Motra, unë dhe ju mund të përgjeronemi që Fryma e Shenjtë të na tregojë "të gjitha gjërat që duhet të bëjmë"¹², edhe kur lista jonë e gjërave për t'u bërë duket tanimë plot. Kur marrim nxitje, ne mund t'i lemë pjatat në lavaman ose një kuti postare elektronike plot me sfida që kërkojnë vëmendje, me qëllim që t'i lexojmë një fëmije, të vizitojmë një mikeshë, të kujdesemi për fëmijët e një fqinji ose të shërbejmë në tempull. Mos më keqkuptoni – unë bëj lista gjithë kohën, më pëlqen shumë t'u heq vizë gjërave [në to]. Por paqja vjen nga dijenia se të *qenit* [diçka] më shumë, nuk është medoemos e barasvlershme me *bërjen* e [diçkaje] më shumë. Reagimi ndaj pakënaqësisë duke vendosur si synim që t'i ndjek nxitjet e ndryshon mënyrën sesi mendoj rreth "kohës sime personale" dhe unë i shoh njerëzit, jo si pengesa për kohën time, por si qëllimin e jetës sime [për t'u shërbyer].

Pakënaqësia e Shenjtë na Çon te Krishti

Pakënaqësia e shenjtë na çon në përulësi, jo në keqardhje për veten apo shkurajim që vjen nga bërja e krahasimeve nga të cilat ne përherë dalim jo mirë. Gratë që mbajnë besëlidhje, janë të gjitha të ndryshme; familjet e tyre, përvojat e jetës së tyre dhe rrethanat e tyre ndryshojnë.

Natyrisht, të gjithë ne nuk do ta arrijmë [plotësisht] potencialin tonë hyjnor dhe ka njëfarë të vërtete te përfundimi se *të vetëm* ne nuk jemi mjaftueshëm [të mirë]. Por lajmet e mira të ungjillit janë që, me anë të hirit të Perëndisë, ne *jemi* mjaftueshëm [të mirë]. Me ndihmën e Krishtit, ne mund të bëjmë gjithçka.¹³ Shkrimet e shenjta premtojnë se ne do të "gëjmë hir, për të pasur ndihmë në kohë nevojë"¹⁴.

E vërteta e habitshme është se dobësitë tona mund të jenë një bekim kur na përulin dhe na kthejnë te Krishti.¹⁵ Pakënaqësia bëhet e shenjtë kur i drejtohem përulësisht Jezu Krishtit me

dëshirat tona [për përmirësim], jo kur prapsemi nga keqardhja për veten.

Në fakt, mrekullitë e Jezusit shpesh fillojnë me dallimin e një dëshire, nevojë, mossuksesi apo papërshtatshmërie. Ju kujtohen bukët dhe peshqit? Secili nga shkruesit e Ungjillit na tregon se si Jezusi i ushqeu mrekullisht mijëra njerëzit që e ndiqnin Atë.¹⁶ Por historia fillon me pikasjen nga dishepujt të asaj çfarë iu mungonte; ata e kuptuan se kishin vetëm "pesë bukë elbi dhe dy peshq të vegjël; por ç'janë këto për aq njerëz"¹⁷? Dishepujt kishin të drejtë: ata *nuk* kishin mjaftueshëm ushqim, por ata ia dhanë atë që kishin Jezusit dhe atëherë *Ai* bëri mrekullinë.

A e keni ndier ndonjëherë se talentet dhe dhuntitë tuaja ishin tepër të vogla për detyrën që ju pret? Unë po. Por unë dhe ju mund t'ia japim atë që kemi Krishtit dhe Ai do ta shumëfishojë [efektshmërinë e] përpjekjeve tona. Ajo që keni për të dhënë, është më tepër sesa mjaftueshëm – madje edhe me dobësitë dhe të metat tuaja njerëzore – *nëse* mbështeteni te hiri i Perëndisë.

E vërteta është se secili prej nesh është një brezni larg nga Hyjnia – secili është një fëmijë i Perëndisë.¹⁸ Dhe pikërisht sikurse ka vepruar edhe me profetët, edhe me burrat e gratë e zakonshëm nëpër epoka, kështu ka për qëllim të na shndërrorë ne Ati Qiellor.

C. S. Ljuisi e shpjegoi fuqinë shndërruese të Perëndisë në këtë mënyrë: "Përfytyrojini veten tuaj si një shtëpi të banuar. Perëndia hyn brenda për ta rindërtuar atë shtëpi. Në fillim, ndoshta, ju mund ta kuptoni atë që Ai po bën. Ai po rregullon kanalet kulluese dhe po ndalon rrjedhjet në çati e kështu me radhë; ju e dinit se ato punë duheshin bërë dhe prandaj nuk çuditëni. Por tani Ai fillon ta godasë fort shtëpinë në një mënyrë që të dhemb në shpirt. . . . [E shihni], Ai po ndërton një shtëpi krejt të ndryshme nga ajo që menduat ju Ju menduat se do të bëh[eshit] një shtëpizë e hijshme me kopsht, por Ai po ndërton një pallat mbretëror. Ai ka për qëllim të vijë dhe të jetojë Vetë në të."¹⁹

Për shkak të flijimit shlyes të Shpëtimtarit tonë, ne mund të arrijmë të jemi në lartësinë e detyrave që na

presin në të ardhmen. Profetët kanë dhënë mësim se ndërsa ngjitemi nëpër shtegun e dishepullimit, ne mund të shenjtërohemi nëpërmjet hirit të Krishtit. Pakënaqësia e shenjtë mund të na shtyjë të veprojmë me besim, t'i ndjekim ftesat e Shpëtimtarit për të bërë mirë dhe për t'ia dhënë jetën tonë përulësisht Atij. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Russell M. Nelson, në Tad Walch, "The Lord's Message Is for Everyone": President Nelson Talks about Global Tour", *Deseret News*, 12 prill 2018, deseretnews.com.
2. Neal A. Maxwell, "Becoming a Disciple", *Ensign*, qershor 1996, f. 18.
3. Neal A. Maxwell, "Becoming a Disciple", f. 16; theksimi i shtuar.
4. "Shkurajimi do ta dobësojë besimin tuaj. Në qoftë se i ulni pritshmëritë tuaja, efektiviteti juaj do të zvogëlohet, dëshira juaj do të dobësohet dhe do të keni vështirësi më të mëdha për ta ndjekur Shpirtin" ("What Is My Purpose as a Missionary?" *Preach My Gospel: A Guide to Missionary Service*, bot. i rishik. [2018], lds.org/manual/missionary; [shih Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar] (2005), f. 1–16).
5. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 29.
6. Joseph Smith – Historia 1:8.
7. Joseph Smith – Historia 1:10; theksimi i shtuar.
8. Veprat e Apostujve 10:38.
9. Bonnie D. Parkin, "Personal Ministry: Sacred and Precious" (takim shpirtëror në Universitetin "Brigam Jang", 13 shkurt 2007), f. 1, speeches.byu.edu.
10. Moroni 7:13.
11. 1 Korintasve 13:8.
12. 2 Nefi 32:5.
13. "Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon" (Filipianëve 4:13).
14. Hebrejve 4:16.
15. "Dhe në qoftë se njerëzit vijnë tek unë, unë do t'u tregoj atyre dobësinë e tyre. Unë u jap njerëzve dobësi, që ata të jenë të përulur dhe hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përulen para meje; pasi në qoftë se ata përulen para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta" (Ethëri 12:27; theksimi i shtuar).
16. Shih Mateu 14:13–21; Marku 6:31–44; Luka 9:10–17; Gjoni 6:1–14.
17. Gjoni 6:9.
18. Presidenti Bojd K. Paker dha mësim: "Pavarësisht nga brezat e shumtë të paraardhësve tuaj në vdekshmëri, pavarësisht se cilën racë ose popull përfaqësoni, prejardhja e shpirtit tuaj mund të shkruhet në një rresht të vetëm. Ju jeni një fëmijë i Perëndisë!" ("To Young Women and Men", *Ensign*, maj 1989, f. 54).
19. C. S. Lewis, *Mere Christianity* (1960), f. 160.



Nga Kristina B. Franko,

Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Fillores

Gëzimi i Shërbimit Vetëmohues

Ne i kemi premtuar Atit tonë në Qiell që do t'i shërbejmë Atij dhe të tjerëve me dashuri dhe që do ta bëjmë vullnetin e Tij në të gjitha gjërat.

Pas konferencës së fundit të përgjithshme, shumë njerëz m'u afruan me të njëjtën pyetje: "A janë të rehatshme ato karrige?" Përgjigjja ime ishte e njëjta çdo herë: "Ato karrige janë shumë të rehatshme nëse nuk të duhet të flasësh". Është e vërtetë, apo jo? Karrigia ime nuk ka qenë dhe aq e rehatshme këtë konferencë, por jam

vërtet mirënjohëse për bekimin dhe nderin që t'ju flas juve këtë mbrëmje.

Nganjëherë, kur shërbejmë, duhet të ulemi në karrige të ndryshme. Disa janë tejet të rehatshme dhe disa të tjera jo, por ne i kemi premtuar Atit tonë në Qiell që do t'i shërbejmë Atij dhe të tjerëve me dashuri dhe që do ta bëjmë vullnetin e Tij në të gjitha gjërat.

Disa vite më parë, të rinjtë në Kishë mësuuan që, "kur 'hyni në shërbim të Perëndisë' [Doktrina e Besëlidhje 4:2], po i bashkoheni rrugëtimit më të hatashëm të mundshëm. Po e ndihmoni Perëndinë për ta përshpejtuar veprën e Tij dhe kjo është një përvojë e hatashme, e gëzueshme dhe e mrekullueshme."¹ Është një rrugëtim në dispozicion të të gjithëve – të çfarëdo moshe – dhe është gjithashtu një rrugëtim që na çon nëpër atë për të cilin profeti ynë i dashur ka folur si "shtegu [i] besëlidhje[s]"².

Sidoqoftë, fatkeqësisht ne jetojmë në një botë vetëdashëse ku njerëzit gjatë gjithë kohës pyetin: "Ç'përfitim kam unë nga kjo?" në vend që të pyetin: "Kë mund të ndihmoj sot?" ose "Si mund t'i shërbej më mirë Zotit në thirrjen time?" ose "A po i jap gjithçka timen Zotit?"





Një shembull i shkëlqyer në jetën time i shërbimit vetëmohues është motra Viktoria Antonieti. Viktoria ishte një nga mësueset e Filllores në degën time kur unë po rritesha në Argjentinë. Çdo të martë pasdite, kur mblidheshim për Filllore, ajo na sillte një tortë me çokollatë. Të gjithëve iu pëlqente shumë torta – epo, të gjithëve përveç meje. Unë nuk e hopenjsja tortën me çokollatë! Dhe ndonëse ajo përpiquej të më jepte edhe mua tortë, unë gjithnjë nuk e pranoja ofertën e saj.

Një ditë, pasi u kishte dhënë tortë me çokollatë të gjithë fëmijëve të tjerë, e pyeta: “Pse nuk sjell një tortë me shije tjetër – si me portokall ose vanilje?”

Pasi qeshi paksa, më pyeti: “Pse nuk e provon një copëz? Kjo tortë është bërë me një përbërës të veçantë dhe të premtoj se, po ta provosh, do të të pëlqej!”

Pashë përreth dhe, për befasinë time, dukej sikur të gjithëve po u shijonte torta. Rashë dakord ta provoja një herë. A mund ta gjeni se çfarë ndodhi? Më pëlqeu! Ajo ishte hera e parë që më shijoi një tortë me çokollatë.

Vetëm shumë vjet më vonë e zbulova se cili qe përbërësi i fshehtë në tortën me çokollatë të motrës Antonieti. Fëmijët e mi dhe unë e vizitonim çdo javë nënën time. Gjatë një rreth prej këtyre vizitave, mamasë dhe mua po na shijonte nga një copë torte me çokollatë dhe i tregova asaj si arriti të më

pëlqente torta me çokollatë për herë të parë fare. Pastaj ajo hodhi dritë mbi pjesën tjetër të historisë.

“Duhet ta dish, Kris”, tha mamaja ime, “se Viktoria dhe familja e saj nuk kishin shumë burime ekonomike dhe çdo javë asaj i duhej të zgjidhte midis pagimit për autobusin që do ta çonte atë dhe katër fëmijët e saj në Filllore, ose blerjes së përbërësve për të bërë një tortë me çokollatë për klasën e saj të Filllores. Ajo gjithnjë zgjidhte tortën me çokollatë në vend të autobusit dhe ajo dhe fëmijët e saj ecnin për më shumë se 3 km për secilin drejtim, pavarësisht nga moti.”

Atë ditë pata një vlerësim më të madh për tortën e saj me çokollatë. Më e rëndësishmja, mësova se përbërësi i fshehtë në tortën e Viktorias qe dashuria që ajo kishte për ata të cilëve u shërbente, dhe sakrificat e saj vetëmohuese për ne.

Mendimet prapa në kohë për tortën e Viktorias më ndihmojnë të kujtoj një sakrificë vetëmohuese në mësimin e dhënë nga Zoti për dishepujt e Vet ndërsa ecte drejt thesarit të tempullit, i cili vlen për çdo kohë. Ju e dini historinë. Plaku Xhejms E. Talmixh dha mësim se atje ishin 13 arka “dhe brenda tyre njerëzit hidhnin kontributet e tyre për qëllimet [e ndryshme] të treguara nga mbishkrime[et] në kuti”. Jezusi i pa reshtat e dhuruesve që përbëheshin nga lloje të ndryshëm njerëzish. Disa i

jepnin dhuratat e tyre me “qëllim të sinqertë” ndërkohë që të tjerë vinin “sasi të mëdha argjendi dhe ari”, duke shpresuar që të binin në sy, të dalloheshin dhe të lëvdoheshin për dhurimet e tyre.

“Mes njerëzve të shumtë qe një e ve e varfër e cila . . . hodhi në njërin nga arkat e thesarit dy monedha të vogla bronzi, që njiheshin si një kuadrant; kontributi i saj llogaritej në më pak se gjysmë centi me paratë amerikane. Zoti i thirri dishepujt e Tij rreth Vetes, ua tërhoqi vëmendjen për tek e veja e varfër dhe te vepra e saj dhe u tha: ‘Ju them në të vërtetë se kjo e ve e varfër ka hedhur në thesar më shumë se të gjithë të tjerët. Sepse të gjithë hodhën aty nga teprica e tyre, kurse ajo, me skamjen e vet, hodhi gjithë sa kishte për të jetuar’ [Marku 12:43–44].”³

E veja nuk dukej se kishte një pozitë të ngritur në shoqërinë e kohës së saj. Ajo në të vërtetë kishte diçka më të rëndësishme: qëllimet e saj qenë të pastra dhe ajo dha gjithçka që kishte për të dhënë. Ndoshta ajo dha më pak se të tjerët, më heshtur se të tjerët, më ndryshe se të tjerët. Në sytë e disave, sasia që dha ajo ishte e papërfillshme, por në sytë e Shpëtimtarit, [që mund] “të dallojë mendimet dhe dëshirat e zemrës”⁴ ajo dha gjithçka të sajën.

Motra, a po ia japim gjithçka tonën Zotit pa mbajtur asgjë? A po e sakrifikojmë kohën dhe talentet tona që brezi i ri të mund të mësojë ta dojë Zotin dhe t’i zbatojë urdhërimet e Tij? A po u japim shërbesë edhe atyre që na rrethojnë, edhe atyre që na janë caktuar me përkujdesje dhe zell – duke sakrifikuar kohë dhe energji që mund të përdorëshin në mënyra të tjera? A po i jetojmë dy urdhërimet e mëdha – ta duam Perëndinë dhe t’i duam fëmijët e Tij?⁵ Shpesh, ajo dashuri shpërfaqet si shërbim.

Presidenti Dallin H. Ouks dha mësim: “Shpëtimtari ynë dha veten në shërbim vetëmohues. Ai na mësoi që secili nga ne duhet Ta ndjekë duke i mohuar vetes interesat egoiste, për t’u shërbyer të tjerëve.”

Ai vazhdoi:

“Një shembull i njohur i hedhjes pa rezerva në shërbim të të tjerëve . . .

është sakrificë që bëjnë prindërit për fëmijët. Nën atë lejojnë dhembjen dhe humbjen e përparësive vetjake dhe të rehatisë, për të lindur dhe rritur secilin fëmijë. Etërit e përshtat[ur]in jetesën dhe përparësitë, për të mbajtur familjen. . . .

. . . Gëzojmë gjithashtu për ata të cilët interesohen për pjesëtarët e paaftë të familjes dhe për prindërit e moshuar. Asnjëri në këtë shërbim nuk pyet: 'Ç'përfitim nxjerr unë?' E gjitha kjo kërkon të lihet mënjanë përfitimi vetjak për të shërbyer me vetëmohim. . . .

[Dhe] e gjithë kjo ilustron parimin e përjetshëm se ne jemi më të lumtur dhe më të plotë kur veprojmë dhe shërbejmë për atë që japim, jo për atë që marrim.

Shpëtimtari ynë na mëson t'i shkojmë më pas duke bërë sakrificat që janë të nevojshme për ta humbur veten tonë në shërbim vetëmohues ndaj të tjerëve.⁶

Presidenti Tomas S. Monson në të njëjtën mënyrë dha mësim se "ndoshta kur të kemi kontakt ballë për ballë me Krijuesin tonë, nuk do të na bëhet pyetja: 'Sa pozicione mbajte?' por 'Sa njerëz ndihmove?' Në të vërtetë, nuk



mund ta duash kurrë Zotin derisa t'i shërbesh Atij duke u shërbyer njerëzve të Tij."⁷

Me fjalë të tjera, motra, nuk do të ketë rëndësi a u ulëm në karrige të rehatshme apo a qëndruam me vështirësi në mbledhje në një karrige të ndryshkur që paloset në rreshtin e fundit. Nuk do të ketë rëndësi a dolëm në korridor nga nevoja për të ngushëlluar një foshnjë që po qan. Ajo që do të ketë rëndësi, është që erdhëm me dëshirën për të shërbyer, që i vumë re

ata të cilëve u japim shërbesë, dhe i përshëndetëm me gëzim, si dhe që iu paraqitëm atyre që qenë në të njëjtin rresh karrigesh me palosje si ne – duke iu afruar miqësisht ndonëse *nuk jemi* caktuar t'u japim shërbesë atyre. Dhe me siguri do të ketë rëndësi fakti që e bëjmë gjithçka që bëjmë me përbërësin e veçantë të shërbimit të ndërthurur me dashurinë dhe sakrificën.

Kam arritur ta di se nuk kemi pse të bëjmë tortë me çokolatë për të qenë një mësuese e suksesshme ose e përkushtuar e Fillores, sepse çështja nuk qe tek torta. Çështja qe te dashuria që fshihej pas veprimit.

Unë dëshmoj se ajo dashuri shenjtërohet nëpërmjet sakrificës – sakrificës së një mësueseje dhe akoma më shumë nëpërmjet sakrificës më të lartë e të përjetshme të Birit të Perëndisë. Jap dëshmi se Ai jeton! E dua Atë dhe dëshiroj t'i largoj dëshirat egoiste në mënyrë që të dua dhe të jap shërbesë sikurse Ai. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Young Men General Presidency, "This Marvelous Work", *Liahona*, janar 2015, f. 49.
2. Rasëll M. Nelson, "Teksa Ecim Përpara së Bashku", *Liahona*, prill 2018, f. 7.
3. James E. Talmage, *Jesus the Christ* (1916), f. 561.
4. Doktrina e Besëlidhje 33:1.
5. Shih Mateu 22:37, 39.
6. Dallin H. Oaks, "Shërbimi Vetëmohues", *Liahona*, maj 2009, f. 93, 94, 96.
7. Thomas S. Monson, "Great Expectations" (takim shpirtëror i Universitetit "Brigam Jang", 11 janar 2009), f. 6, speeches.byu.edu.





Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Gratë dhe të Mësuarit e Ungjillit në Shtëpi

Shpëtimtari është shembulli juaj i përsosur i mënyrës se si do të luani një rol madhor në lëvizjen e Tij për të vënë një theks më të madh tek të mësuarit e ungjillit në shtëpi.

Motrat e mia të dashura, është e mrekullueshme të takohem me ju! Kjo është një kohë emocionuese në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Zoti po derdh njohuri mbi Kishën e Tij ashtu siç Ai premtoi se do të bënte.

Ju kujtohet që Ai tha: “Për sa kohë do të ngelen të papastra ujërat që rrjedhin? Çfarë fuqie do t’i ndalojë qiejt? Po aq sa njeriu mundet ta shtrijë krahun e tij të dobët për të ndaluar lumin Misuri në udhën e tij të përcaktuar ose t’ia kthejë mbrapsht rrjedhën, aq mund të pengohet i Plotfuqishmi nga derdhja e diturisë së tij prej qiellit mbi kokat e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.”¹

Një pjesë e përhapjes së tanishme të njohurisë së Zotit, lidhet me përshpejtimin e derdhjes së të vërtetës së përrjetshme nga ana e Tij mbi kokat dhe në zemrat e popullit të Tij. Ai e ka bërë të qartë se bijat e Atit Qiellor do të luajnë një rol kryesor në atë përshpejtim të mrekullueshëm. Një provë e mrekullisë është se Ai po e udhëheq profetin e Tij të gjallë që të vërë një theks shumë më të madh tek udhëzimi i ungjillit në shtëpi dhe brenda familjes.

Ju mund të pyetni: “Si i bën kjo motrat besnike një forcë kryesore për ta ndihmuar Zotin që të derdhë njohuri mbi shenjtoret e Tij?” Zoti e jep përgjigjen te dokumenti “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”. Ju i kujtoni fjalët, por ju mund të gjeni një domethënie të re dhe ta pranoni se Zoti i parashikoi këto ndryshime emocionuese që po ndodhin tani. Te proklamata, Ai u dha motrave porosi që të ishin

edukatoret kryesore të ungjillit në familje, me këto fjalë: “Nënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre”². Kjo përfshin edukimin me të vërtetat dhe njohurinë e ungjillit.

Proklamata vazhdon: “Etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë.”³ Ata janë partnerë të barabartë, të barabartë në potencialin e tyre për rritje shpirtërore dhe për marrjen e njohurisë, dhe kështu janë të bashkuar duke e ndihmuar njëri-tjetrin. Ata janë të barabartë në fatin e tyre hyjnor për të qenë të ekzaltuar së bashku. Në fakt, burrat dhe gratë nuk mund të ekzaltohen vetëm.

Pse, atëherë, një bijë e Perëndisë në një marrëdhënie të bashkuar e të barabartë, merr përgjegjësinë kryesore për t’i ushqyer me lëndën më të rëndësishme ushqyese të gjithë ata që duhet ta marrin, me një njohuri të së vërtetës që vjen prej qiellit? Nga ajo që kuptoj, kjo ka qenë mënyra e Zotit që kur familjet u krijuan në këtë botë.

Për shembull, ishte Eva që e mori njohurinë se Adami kishte nevojë të hante frutën e pemës së njohjes për ta, t’i zbatonte të gjitha urdhërimet e Perëndisë dhe të formonte një familje. Nuk e di pse njohuria i erdhi Evës më parë, por Adami dhe Eva ishin të bashkuar në mënyrë të përkryer kur njohuria u derdh mbi Adamin.

Një shembull tjetër i përdorimit nga ana e Zotit të dhuratave edukative të grave, është mënyra se si Ai i forcoi





bijtë e Helamanit. Më bëhet një lëmsh në fyt kur e lexoj rrëfimin dhe pastaj më kujtohen fjalët e qeta siguruese të nënës sime kur u largova nga shtëpia për shërbimin ushtarak.

Helamani shënoi:

“Nënat u kishin mësuar se, në qoftë se nuk do të dyshonin, Perëndia do t’i shpëtonte.

Dhe më përsëritën fjalët e nënave të tyre, duke thënë: Ne nuk dyshojmë që nënat tona e dinin atë.”⁴

Ndërkohë që nuk i di të gjitha arsyet përse Zoti u dha motrave besnike përgjegjësinë kryesore për edukimin në familje, unë besoj se ka të bëjë me aftësinë tuaj për të dashur. Duhet shumë dashuri për t’i ndier nevojat e dikujt tjetër më shumë sesa tuajat. Kjo është dashuria e pastër e Krishtit për individin që ju edukoni. Kjo ndjenjë e dashurisë hyjnore vjen nga individi i zgjedhur për të qenë edukatori, duke u kualifikuar për efektet e Shlyerjes së Jezu Krishtit. Motoja e Shoqatës së Ndihmës, të cilën nëna ime e mishëronte, mua më duket e frymëzuar: “Dashuria Nuk Ligështohet Kurrë”.

Si bija të Perëndisë, ju keni një aftësi të lindur dhe të madhe për t’i kuptuar nevojat e të tjerëve dhe për t’i dashur ata. Kjo, nga ana tjetër, ju bën më të ndjeshme ndaj pëshpëritjeve të Shpirtit. Atëherë Shpirti mund ta udhëheqë atë që mendoni, atë që thoni dhe atë që bëni për t’i edukuar njerëzit në mënyrë

që Zoti të mund të derdhë mbi ta njohuri, vërtetësi dhe guxim.

Ju motra që e dëgjoni zërin tim, jeni secila në një vend unik në udhëtimin tuaj të jetës. Disa janë vajza të reja në një sesion të përgjithshëm të grave për herë të parë. Disa janë të reja që po përgatiten të jenë edukatoret që Perëndia do që të jenë. Disa janë të sapomartuara, që ende nuk kanë pasur fëmijë; të tjerat janë nëna të reja me një ose më shumë fëmijë. Disa janë nëna adoleshentësh dhe të tjera janë me fëmijë në terrenin e misionit. Disa kanë fëmijë të cilët janë dobësuar në besim dhe janë larg nga shtëpia. Disa jetojnë vetëm, pa shoqëruar besnikë. Disa janë gjyshe.

Megjithatë, pavarësisht nga rrethanat tuaja vetjake – ju jeni pjesë – një pjesë kyç – e familjes së Perëndisë dhe e vetë familjes suaj, qoftë në të ardhmen, në këtë botë apo në botën e shpirtit. Përgjegjësia që iu është dhënë nga Perëndia është që të edukoni sa më shumë prej pjesëtarëve të familjes së Tij dhe tuajës që të mundeni, me dashurinë dhe besimin tuaj te Zoti Jezu Krisht.

Sfida juaj e zakonshme është që të dini se kë të edukoni, mënyrën dhe kohën kur ta bëni. Ju keni nevojë për ndihmën e Zotit. Ai i njuh zemrat e të tjerëve dhe Ai e di kur ata janë të gatshëm ta pranojnë edukimin nga ana juaj. Lutja juaj me besim do të jetë çelësi juaj i suksesit. Ju mund të mbështeteni te marrja e udhërrëfimit të Tij.

Ai dha këtë nxitje: “I kërkoni Atit në emrin tim, me besim, duke besuar se do të merrni dhe ju do të keni Frymën e Shenjtë, që i manifeston gjithë gjërat të cilat janë të domosdoshme.”⁵

Përveç lutjes, studimi serioz i shkrimeve të shenjta do të jetë pjesë e fuqisë suaj në rritje për të edukuar. Ja ku është premtimi: “As mos u shqetësoni që më parë se çfarë do të thoni; por mblidhni vazhdimisht si thesar në mendjet tuaja fjalët e jetës dhe do t’ju jepet në çastin e duhur ajo pjesë që do t’i shpërmdahet çdo njeriu.”⁶

Pra, do të gjeni më shumë kohë për t’u lutur, për të përsiatuar dhe për të medituar mbi çështjet shpirtërore. Mbi ju do të derdhet njohuri për të vërtetën dhe ju do t’ju shtohet fuqia për t’i edukuar të tjerët në familjen tuaj.

Do të ketë raste kur do të mendoni se përparimi juaj për të mësuar se si të edukoni më mirë është i ngadalshëm. Do të kërkojë besim për të duruar. Shpëtimtari ju dërgoi këtë nxitje:

“Prandaj, mos u lodhni së bëri mirë, sepse ju po ngrini themelin e një veprë të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe.

Vini re, Zoti kërkon zemrën dhe një mendje të gatshme; dhe të gatshmit dhe të bindurit do të hanë të mirat e tokës së Sionit në këto ditë të fundit.”⁷

Prania juaj sonte është një provë se jeni të gatshme ta pranoni ftesën e Zotit për t’i edukuar të tjerët. Kjo është e



vërtetë edhe për më të voglën këtu son-te. Ju mund ta dini se kë të edukoni në familjen tuaj. Nëse luteni me qëllim të vërtetë, një emër ose fytyrë do të vijë në mendjen tuaj. Nëse luteni për të ditur se çfarë të bëni ose çfarë të thoni, ju do të ndieni një përgjigje. Sa herë që bindeni, fuqia juaj për të edukuar do të rritet. Do të jeni duke u përgatitur për ditën kur do të edukoni vetë fëmijët tuaj.

Nënat e adoleshentëve mund të lutën që të dinë se si ta edukojnë një bir apo bijë që duket apatik ndaj edukimit. Ju mund të luteni për të ditur se kush mund ta ketë ndikimin shpirtëror që fëmija juaj ka nevojë të ketë dhe do ta pranonte atë. Perëndia i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve të tilla të sinqerta të nënave të shqetësuara, dhe Ai dërgon ndihmë.

Gjithashtu, një gjyshe këtu sonte mund të ndiejë dhembjen që i është shkaktuar nga stërmundimi dhe vështirësitë e fëmijëve dhe nipërve e mbesave të saj. Ju mund të merrni zemër dhe orientim nga përvojat e familjeve në shkrimet e shenja.

Që nga koha e Evës dhe Adamit, nëpërmjet atit Izrael, dhe deri te çdo

familje në Librin e Mormonit, ekziston një mësim i sigurt se çfarë duhet të bëni rreth pikëllimeve për fëmijët që nuk reagojnë: mos ndaloni kurrë së dashuri.

Ne kemi shembullin nxitës të Shpëtimtarit ndërsa Ai i edukoi fëmijët shpirtërorë rebelë të Atit të Tij Qie-llor. Edhe kur ata ose ne shkaktojmë dhembje, dora e Shpëtimtarit është ende e shtrirë.⁸ Te 3 Nefi, Ai foli për motrat dhe vëllezërit e Tij shpirtërorë, të cilët Ai ishte përpjekur pa sukses t'i edukonte: "O ju njerëz . . . që jeni nga shtëpia e Izraelit, sa herë ju kam mbledhur si një kllloçkë mbledh zogjtë e saj nën krahët e saj dhe ju kam ushqyer."⁹

Për motrat në çdo fazë të udhëtimit të jetës, në çdo situatë familjare dhe në çdo kulturë, Shpëtimtari është shembulli juaj i përsosur i mënyrës se si do të luani një rol madhor në lëvizjen e Tij për të vënë një theks më të madh tek të mësuarit e ungjillit në shtëpi dhe familje.

Ju do të sillni ndjenjën tuaj të trashëguar të dashurisë hyjnore në ndryshimin e veprimtarive dhe praktikave në familjen tuaj. Kjo do të sjellë rritje më të madhe shpirtërore. Kur luteni me pjesëtarët e familjes suaj dhe për ta, ju

do ta ndieni dashurinë tuaj për ta dhe dashurinë e Shpëtimtarit për ta. Kjo do të bëhet gjithnjë e më shumë dhurata juaj shpirtërore teksa e kërkonti atë. Pjesëtarët e familjes suaj do ta ndiejnë këtë ndërsa luteni me besim më të madh.

Kur familja të mblidhet për t'i lexuar me zë të lartë shkrimet e shenja, ju do t'i keni lexuar ato tashmë dhe do të jeni lutur për to që ta përgatitni veten tuaj. Ju do të keni gjetur çaste për t'u lutur në mënyrë që Shpirti t'ua ndriçojë mendjen. Pastaj, kur të jetë radha juaj për të lexuar, pjesëtarët e familjes do ta ndiejnë dashurinë tuaj për Perëndinë dhe për fjalën e Tij. Ata do të edukohen prej Tij dhe prej Shpirtit të Tij.

E njëjta derdhje njohurie mund të vijë në çdo mbledhje familjare nëse luteni dhe planifikoni për të. Mund të kërkojë përpjekje dhe kohë, por do të sjellë mrekulli. Më kujtohet një mësim që më mësoi nëna ime kur isha i vogël. Ende mund ta shoh në mendje hartën me ngjyra që ajo kishte bërë për udhëtimet e Apostullit Pal. Pyes veten se si gjeti kohë dhe energji ta bënte atë. Dhe deri më sot, unë jam bekuar nga dashuria e saj për atë Apostull besnik.

Secila prej jush do të gjejë mënyra për të dhënë ndihmesë në derdhjen e së vërtetës mbi familjet tuaja në Kishën e rivendosur të Zotit. Secila prej jush do të lutet, do të studiojë dhe do të përsiatë për të ditur se cili do të jetë kontributi juaj i pashoq. Por unë e di këtë: secila prej jush, duke qenë nën zgjedhje barazisht me bijtë e Perëndisë, do të jetë një pjesë e rëndësishme e mrekullisë së të mësuarit dhe të jetuarit të ungjillit, që do ta shpejtojë mbledhjen e Izraelit dhe do ta përgatitë familjen e Perëndisë për kthimin e lavdishëm të Zotit Jezu Krisht. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 121:33.
2. "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës", *Liahona*, maj 2017, f. 145.
3. "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës", f. 145.
4. Alma 56:47–48.
5. Doktrina e Besëlidhje 18:18.
6. Doktrina e Besëlidhje 84:85.
7. Doktrina e Besëlidhje 64:33–34.
8. Shih 2 Nefi 19:12, 21.
9. 3 Nefi 10:4.



Nga Presidenti Dallin H. Ouks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Prindërit dhe Fëmijët

Plani i madh i Atit tonë Qiellor për lumturinë ju tregon se kush jeni dhe qëllimin e jetës suaj.

Motra të mia të dashura, sa e mrekullueshme është që e kemi këtë sesion të ri të konferencës së përgjithshme për gratë e Kishës që janë tetë vjeç e lart. Kemi dëgjuar mesazhe frymëzuese nga motrat udhëheqëse dhe nga Presidenti Henri B. Ajring. Mua dhe Presidentit Ajring na pëlqen shumë të punojmë nën drejtimin e Presidentit Rasëll M. Nelson dhe e presim me padurim fjalimin e tij profetik.

I.
Fëmijët janë dhurata jonë më e çmuar nga Perëndia – rritja jonë e

përrjetshme. Megjithatë jetojmë në një kohë kur shumë gra dëshirojnë të marrin pjesë në lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Shumë të rinj në moshë madhore e vonojnë martesën derisa të plotësohen nevojat materiale. Mosha mesatare e martesave të anëtarëve të Kishës sonë është rritur me më shumë se dy vjet dhe po bie numri i lindjeve të anëtarëve të Kishës. Shtetet e Bashkuara dhe disa kombe të tjera kanë përballë një të ardhme me shumë pak fëmijë që rriten deri në moshë madhore për të mbështetur numrin e të rriturve që dalin në pension.¹ Mbi 40 përqind e lindjeve

në Shtetet e Bashkuara janë nga nëna të pamartuara. Ata fëmijë janë të cenueshëm. Secila prej këtyre prirjeve vepron kundër planit hyjnor të Atit tonë për shpëtimin.

II.

Gratë shenjtoje të ditëve të mëvonshme e kuptojnë se të qenit nënë është përparësia e tyre më e lartë, gëzimi i tyre më i madh. Presidenti Gordon B. Hinkli tha: “Gratë, në pjesën më të madhe, e shohin përmbushjen e tyre më të madhe, lumturinë e tyre më të madhe në shtëpi e në familje. Perëndia u dha grave diçka hyjnore që shfaqet si forcë e qetë, sqimë, paqe, mirësi, virtyt, vërtetësi, dashuri. Dhe të gjitha këto cilësi të shquara e gjejnë shprehjen e tyre më të vërtetë e më të kënaqshme te qenia nënë.”

Ai vazhdoi: “Puna më e madhe që çdo grua do të bëjë ndonjëherë, do të jetë që t’i rritë dhe t’i mësojë dhe t’i lartësojë e t’i nxitë dhe t’i rritë fëmijët e saj në drejtësi e të vërtetë. Nuk ka asgjë tjetër që do të krahasohet me këtë, pavarësisht nga ajo që bën.”²

Nëna, motra të dashura, ne ju duam për atë që jeni dhe atë që bëni për të gjithë ne.

Në fjalimin e tij të rëndësishëm të vitit 2015, të titulluar “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, Presidenti Rasëll M. Nelson tha:

“Mbretëria e Perëndisë nuk është dhe nuk mund të jetë e plotë pa gra të cilat bëjnë besëlidhje të shenjta dhe më pas i mbajnë ato, pa gra të cilat mund të flasin me fuqi dhe autoritet nga Perëndia!

Sot . . . na duhen gra, të cilat e dinë se si t’i bëjnë të ndodhin gjëra të rëndësishme me anë të besimit të tyre dhe të cilat janë mbrojtëse të guximshme të moralit dhe familjeve në një botë që dergjet në mëkat. Na duhen gra që janë të përkushtuara ndaj udhërrëfimit të fëmijëve të Perëndisë përgjatë shtegut të besëlidhjes drejt ekzaltimit; gra që dinë se si të marrin zbuluesë vetjake, që e kuptojnë fuqinë dhe paqen e dhurimit [indaumentit] të tempullit; gra që dinë se si t’u bëjnë thirrje fuqive të qiellit për të mbrojtur e forcuar fëmijët





*Fëmij' të dashur, Perëndia është
pran' jush,
Dit' e nat' të kujdeset,
Dhe gëzohet t'ju bekojë,
Nëse bëni ç'është e drejt'.⁵*

Ka dy mësimë në atë strofë: Së pari, Ati ynë Qiellor është pranë nesh dhe kujdeset për ne ditë e natë. Mendoni për këtë! Perëndia na do, Ai është pranë nesh dhe Ai na mbron. Së dyti, Ai kënaqet të na bekojë ndërsa “bëlmjë ç’është e drejt”. Çfarë ngushëllimi në mes të anktheve dhe vështirësive tonal!

Po, të reja, ju jeni të bekuara dhe ju jeni të mrekullueshme, por ju jeni si të gjithë fëmijët e Atit Qiellor ndaj kërkesës që të “bëni ç’është e drejt[ë]”.

Këtu mund t’ju jepja këshilla për shumë gjëra të ndryshme, por kam zgjedhur të flas vetëm për dy gjëra.

Këshilla ime e parë ka të bëjë me telefonat celularë. Një studim i kohëve të fundit në mbarë vendin zbuloi se më shumë se gjysma e adoleshentëve në Shtetet e Bashkuara thanë se kalojnë shumë kohë në telefonat e tyre celularë. Më shumë se 40 përqind thanë se ndiheshin në ankth kur ishin larg telefonave të tyre celularë.⁶ Kjo ishte më e zakonshme mes vajzave sesa mes djemve. Motrat e mia të reja – dhe gra në moshë të rritur gjithashtu – do ta bekonin jetën tuaj nëse e kufizoni përdorimin nga ana juaj të telefonit celular dhe varësinë tuaj prej tij.

Këshilla ime e dytë është edhe më e rëndësishme. Jini dashamirëse me të tjerët. Dashamirësia është diçka që shumë prej të rinjve tanë po e zbatojnë tashmë. Disa grupe të rinjsh në disa komunitete na e kanë treguar udhën të gjithëve. Ne jemi frymëzuar nga veprimet dashamirëse të të rinjve tanë ndaj atyre që kanë nevojë për dashuri e ndihmë. Në shumë mënyra, ju e jepni atë ndihmë dhe e tregoni atë dashuri ndaj njëri-tjetrit. Do të dëshironim që të gjithë ta ndiqnin shembullin tuaj.

Në të njëjtën kohë, ne e dimë se kundërshtari na tndon të gjithëve që të mos jemi dashamirës, dhe ka ende shumë shembuj të kësaj, madje edhe midis fëmijëve dhe të rinjve. Mungesa e vazhdueshme e dashamirësisë njihet me

dhe familjet; gra që japin mësim pa druajtje.”³

Këto mësimë të frymëzuara bazohen të gjitha te dokumenti “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, në të cilën kjo Kishë e rivendosur ripohon doktrinën dhe praktikën kryesore të planit të Krijuesit përpara se Ai të krijonte tokën.

III.

Tani i drejtohem grupit më të ri të këtij publiku. Të dashura motrat e mia të reja, për shkak të njohurisë suaj për ungujllin e rivendosur të Jezu Krishtit, ju jeni të veçanta. Njohuria juaj do t’ju aftësojë që t’i duroni dhe kapërceni vështirësitë e rritjes. Që në moshë të vogël, ju keni marrë pjesë në projekte dhe programe që i kanë zhvilluar talentet tuaja, të tilla si të shkruarit, të folurit dhe planifikimi. Ju keni mësuar sjelljen e përgjegjshme dhe si t’u bëni ballë tundimeve për të gënjyer, mashtruar, vjedhur ose për të përdorur alkool apo droga.

Veçantia juaj u vu në dukje në një studim të Universitetit të Karolinës së Veriut mbi adoleshentët amerikanë dhe fenë në Amerikë. Një artikull i gazetës *Charlotte Observer* kishte titullin “Adoleshentët mormonë i përballojnë

më mirë gjërat: Studimi gjen se ata kryesojnë mbi moshatarët në trajtimin e adoleshencës”. Ky artikull arriti në përfundimin se “mormonët kishin rezultate më të mira në shmangien e sjelljeve të rrezikshme, duke dalë mirë në shkollë dhe duke pasur një qëndrim pozitiv për të ardhmen”. Një nga hulumtuesit në studim, i cili intervistoi pjesën më të madhe të rinisë sonë, tha: “Në pothuajse çdo kategori që ne pamë, kishte një model të qartë: mormonët ishin të parët”⁴.

Pse i përballoni më së miri vështirësitë e rritjes? Të reja, kjo është ngaqë e kuptoni planin e madh të Atit tonë Qiellor për lumturinë. Kjo ju tregon se kush jeni dhe qëllimin e jetës suaj. Të rinjtë me këtë lloj kuptueshmërie janë të parët që i zgjidhin problemet dhe të parët që zgjedhin të drejtën. Ju e dini se mund ta keni ndihmën e Zotit në kapërcimin e të gjitha vështirësive të rritjes.

Një arsye tjetër përse jeni më të efektshëm është se ju e kuptoni që jeni fëmijë të një Ati Qiellor që ju do. Unë jam i sigurt se ju e njihni himnin tonë të mrekullueshëm “Dearest Children, God Is Near You” [“Fëmij’ të Dashur, Perëndia është Pran’ Jush”]. Ja strofa e parë që të gjithë e kemi kënduar dhe besuar:



Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

PRESIDENCA E PARË



Dallin H. Oaks
Këshilltar i Parë



Russell M. Nelson
President



Henri B. Airing
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMBËDHJETË APOSTUJVE



M. Russell Ballard



Xhefiri R. Holland



Diter F. Uhtdorf



Dejid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen



Ronald A. Rasband



Geri E. Stivenson



Dejili G. Renland



Gerit W. Gong



Ulises Soares

PRESIDENCA E TË SHITATËDHJETËVE



L. Uthri Këlljon



Patrik Këlljon



Keri B. Kuk



Robert C. Gë



Terens M. Vinson



Zhozë A. Tëshletra



Karlos A. Gëdobi

AUTORITETET E PËRGJITHSHME TË SHITATËDHJETËT

(sipas rendit alfabetik në anglisht)



Markos A. Alibekitis



Hore L. Alonso



Ulfjord W. Andersen



Jan S. Aderm



Siven R. Bangarter



W. Mark Baer



Dejvid S. Bakster



Randal K. Benet



Shein M. Bowen



Mark A. Breg



Methij L. Karpenier



Jun Huan Çoi



Kregj C. Kristensen



Kim B. Clark



Uetherford T. Klejton



Lorens E. Korbinoh



Valen V. Korodon



J. Devin Komish



Klaudio R. M. Kostia



Hoakin E. Kostia



LeGrand R. Kuritsi Ritu



Massimo De Feb



Benjamin De Hogjs



Eduard Dubi



Kevin R. Daniken



Timothy J. Deikas



Dejvid F. Evans



Emilke R. Fababala



Breidli D. Foster



Rendi D. Franik



Eduardo Gavaret



Xhek N. Xhearard



Tejlar G. Goboi



Kristofel Golden



Uolter F. Gonzales



O. Vincent Halek



Brock P. Hejls



Donald L. Hallstrom



Kevin S. Hamilton



Alen D. Hejini



Matias Held



Dejvid P. Homer



Pol V. Xhanson



Leni S. Keçer



Jong Mbangat



Somi L. Koh



Erik W. Kopashtke



Hugo E. Martinez



Xhejms B. Martino



Riqard J. Meinis



Kaji S. Mak-Kei



Pjeter F. Mlras



Hugo Montola



Markus B. Nlesh



K. Brent Ntates



S. Giford Nilson



Brent H. Nilsson



Adrian Orca



S. Mark Palmer



Adilson de Paula Pereira



Kevin W. Pierson



Entoni D. Petrus



Pol B. Pajper



Xhan C. Pinqiri Riu



Ratael E. Rino



Majejli T. Ringud



Lin G. Robins




Geni B. Sebin



Man A. Smmuc



Xhozef W. Sirati



Steven E. Sinou



Vern P. Stenill



Brajen K. Tejlor



Majejli Xhon U. Teh



Huan A. Uceta



Amulio Valensuela



Huan Pablo Vijar



Takashi Ueda



Janiela B. Usakob



Skot D. Uajting



Horhe F. Zabalos



Kazuniko Jamashita



Çi Hong (Sam) Uong



Leri Y. Ullson

PESHKOPATA KRYESESUE



Dini M. Dejnis
Këshilltar i Parë



Zherald Kosë
Peshkopri Kryesues



W. Kristofer Uadeli
Këshilltar i Dytë

SHKOLLA E SË DIELËS



Devin G. Durant
Këshilltar i Parë




Fed R. Kelleter
President



Biqjen K. Ashton
Këshilltar i Dytë



Misha D. Kregj
Këshilltare e Parë



Boni H. Korëni
Presidentë



Beki Kreyten
Këshilltare e Dytë


SHOQATA E NDIHMËS




Reina L. Auroro
Këshilltare e Dytë



Xhin B. Bingham
Presidentë



Liza L. Harinos
Këshilltare e Parë



Xhori D. Xhons
Presidentë



Kristina B. Franko
Këshilltare e Dytë

FILLORIA



Dajgas D. Holms
Këshilltar i Parë



Siven W. Ouen
President

TË RINITE



Mi. Xhozef Brof
Këshilltar i Dytë



shumë emra, si mujshim, sulm si grup ndaj dikujt ose grupim për të mos i pranuar të tjerët. Këta shembuj, me dashje, shkaktajnë dhembje ndaj shokëve/ shoqeve të klasës apo miqve. Motrat e mia të reja, Zotit nuk i pëlqen nëse jemi mizorë apo të ligj me të tjerët.

Ja një shembull. Di për një të ri, një refugjat këtu në Jutë, të cilin e vinin në lojë ngaqë ishte i ndryshëm, përfshirë faktin që fliste gjuhën e tij amtare. Ai u përdoq nga një grup të rinjsh të privilegjuar derisa ai u hakmor në një mënyrë që e futi në burg për më shumë se 70 ditë, ndërkohë që po shqyrtohej për dëbim [nga Shtetet e Bashkuara]. Nuk e di se çfarë e provokoi këtë grup të rinjsh, shumë prej tyre shenjtorë të ditëve të mëvonshme si ju, por mund ta shoh pasojën e dashakeqjes së tyre, një përvojë tragjike dhe në kurriz të njërit prej fëmijëve të Perëndisë. Veprime të vogla jodashamirëse mund të kenë pasoja shkatërruese.

Kur e dëgjova këtë histori, e krahasova me atë që profeti ynë, Presidenti Nelson, tha në takimin shpirtëror më të fundit mbarëbotëror për të rinjtë. Duke ju kërkuar juve dhe gjithë të rinjtë të tjerë që të ndihmoni në mbledhjen e Izraelit, ai tha: “Dalloh[uni]; . . . j[ini] të ndryshëm nga bota. Ju dhe unë e dimë se ju duhet të jeni një dritë për botën. Prandaj, Zoti ka nevojë që ju të dukeni, të tingëlloni, të veproni e të visheni si një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit.”⁷

Në batalionin e rinisë, me të cilin Presidenti Nelson ju ftoi të bashkohej, të rinjtë nuk do të jenë të ligj ndaj njëri-tjetrit. Ata do t'i ndjekin mësimet e Shpëtimtarit për t'u shtrirë dorën e ndihmës të tjerëve dhe për të qenë të dashur e të respektueshëm ndaj të tjerëve, madje për ta kthyer faqen tjetër kur ndiejmë se dikush na ka bërë padrejtësi.

Në një fjalim të një konference të përgjithshme në kohën kur shumë prej jush u lindën, Presidenti Gordon B. Hinkli i lavdëroi “të rejat e bukura që po përpiqen fort për ta jetuar ungjillin”. Ai i përshkroi ato, ashtu siç unë e ndiej t'ju përshkruaj juve:

“Ato janë bujare ndaj njëra-tjetrës. Ato kërkojnë ta forcojnë njëra-tjetrën.



Ato i nderojnë prindërit e tyre dhe familjet nga të cilat vijnë. Ato po i afrohen moshës së të qenit grua dhe do t'i mbajnë me vete gjatë gjithë jetës së tyre idealet që aktualisht u japin shtysë atyre.”⁸

Si shërbëtor i Zotit, ju them juve të rejave, bota jonë ka nevojë për mirësinë dhe dashurinë tuaj. Jini dashamirëse ndaj njëra-tjetrës. Jezusi na mësoi ta duam njëri-tjetrin dhe t'i trajtojmë të tjerët ashtu siç duam të trajtohem. Ndërsa përpiqemi të jemi dashamirës, ne afrohem më pranë Tij dhe ndikimit të Tij të dashur.

Motrat e mia të dashura, nëse jeni pjesëmarrëse në çfarëdo lloj ligësie apo zemërngushtësie – individualisht ose në grup – merreni tani vendimin për të ndryshuar dhe për t'i nxitur të tjerët të ndryshojnë. Kjo është këshilla ime dhe jua jap atë si një shërbëtor i Zotit Jezu Krisht, sepse Shpirti i Tij më ka nxitur t'ju flas për këtë temë të rëndësishme. Unë dëshmoj për Jezu Krishtin, Shpëtimtarin tonë, i cili na mësoi ta duam

njëri-tjetrin ashtu si Ai na deshi. Unë lutem që ne do të bëjmë kështu. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Sara Berg, “Nation’s Latest Challenge: Too Few Children”, *AMA Wire*, 18 qershor 2018, wire.ama-assn.org.
2. *Teachings of Gordon B. Hinckley* (1997), f. 387, 390; shih edhe M. Rasëll Ballard, “Nëna dhe Bija”, *Liahona*, maj 2010, f. 18 (në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* [2011], f. 156).
3. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 96; shih edhe Russell M. Nelson, “Children of the Covenant”, *Ensign*, maj 1995, f. 33.
4. Studimi u botua nga Oxford University Press si Christian Smith dhe Melinda Lundquist Denton, *Soul Searching: The Religious and Spiritual Lives of American Teenagers* (2005).
5. “Dearest Children, God Is Near You”, *Hymns*, nr. 49.
6. Shih “In Our Opinion: You Don’t Need to Be Captured by Screen Time”, *Deseret News*, 31 gusht 2018, deseretnews.com.
7. Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit”, (takim shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë, 3 qershor 2018), f. 8, HopeofIsrael.Lds.org.
8. Gordon B. Hinckley, “The Need for Greater Kindness”, *Liahona*, maj 2006, f. 60–61.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Pjesëmarrja e Motrave në Mbledhjen e Izraelit

Unë po ju drejtoj juve, grave të Kishës, një lutje profetike për t'i dhënë formë të ardhmes duke ndihmuar që të mbledhet Izraeli i shpërndarë.

Eshtë e mrekullueshme të jem me ju, motrat e mia të dashura e të çmuara. Ndoshta një përvojë e kohëve të fundit do t'ju japë një vështrim të shpejtë mbi mënyrën se si ndihem për ju dhe aftësitë hyjnore që ju janë dhuruar.

Një ditë, ndërsa po i flisja një bashkësie në Amerikën e Jugut, u emocionova gjithnjë e më shumë për temën time dhe, në një çast kulmor, thashë: “Si nëna e 10 fëmijëve, mund t’ju them se . . .”. Dhe pastaj vazhdova për ta përfunduar mesazhin tim.

Nuk e kuptova se kisha thënë fjalën *nënë*. Përkthyesi im, duke hamendësuar se isha ngatërruar, e ndryshoi fjalën *nënë* në *baba*, kështu që bashkësia nuk e mori vesh kurrë se unë i isha drejtuar vetes si *nënë*. Por bashkëshortja ime, Uendi, e dëgjoj atë dhe u kënaq nga shkarja ime frojdiane e gojës.

Në atë çast, dëshira e thellë e zemrës sime për të sjellë një ndryshim në botë – ashtu siç e bën vetëm një nënë – më vloi nga zemra. Përgjatë viteve, kurdoherë që më kanë pyetur se përse *zgjedha* të bëhesha mjek, përgjigjja ime ka qenë gjithmonë e njëjta: “Sepse nuk mund të *zgjedhja* që të bëhesha nënë”.

Ju lutem, vini re se kurdoherë që përdor fjalën *nënë*, nuk po flas vetëm për gratë që kanë lindur apo kanë birësuar fëmijë në këtë jetë. Unë po flas për *të gjitha* bijat e rritura të Prindërve tanë Qieilorë. *Çdo* grua është një nënë për arsye të vendmbërritjes së saj të përjetshme.

Kështu që sonte, si *babai* i 10 fëmijëve – *nëntë bijave* dhe një biri – dhe si President i Kishës, lutem që ju ta

kuptoni se çfarë ndjenje të thellë kam për ju – për atë që jeni dhe për gjithë të mirat që mund të bëni. Askush nuk mund ta bëjë atë që mund të bëjë një grua e drejtë. Askush nuk mund ta riprodhojë ndikimin e një nëne.

Burrat munden dhe shpesh vërtet ua komunikojnë të tjerëve dashurinë e Atit Qieilor dhe të Shpëtimtarit. Por gratë kanë një dhunti të veçantë për të – një dhurim hyjnor. Ju keni aftësinë që ta ndieni se çfarë i nevojitet dikujt – dhe *kur* i nevojitet atij apo asaj. Ju mund t’ia shtrini dorën, ta ngushëlloni, mësoni dhe forconi dikë pikërisht në çastin e tij apo të saj të nevojës.

Gratë i shohin gjërat ndryshe nga burrat dhe ah, sa shumë na nevojitet këndvështrimi juaj! Natyra juaj ju shtyn që të mendoni për të tjerët *së pari*, ta merrni parasysh rrjedhojën që do të ketë mbi të tjerët cilido drejtim i veprimit.

Siç e vuri në dukje Presidenti Ajring, ishte Nëna jonë e lavdishme, Eva – me pikëvështrimin e saj largpamës për planin e Atit tonë Qieilor – që e filloi atë që ne e quajmë “Rënia”. Zgjedhja e saj e mençur dhe e guximshme, si dhe vendimi përkrahës i Adamit e çuan përpara planin e Perëndisë për lumturinë. Ata e bënë të mundur që secili prej nesh të vijë në tokë, të marrë një trup dhe të vërtetojmë se ne do të zgjedhim ta përkrahim Jezu Krishtin *tani*, pikërisht siç bëmë para vdekshmërisë.



Motrat e mia të dashura, ju keni dhunti dhe prirje të veçanta shpirtërore. Sonte unë ju nxit, me tërë shpresën e zemrës sime, që të luteni për t'i kuptuar *dhuntitë tuaja shpirtërore* – t'i lëvroni, përdorni dhe zgjeroni ato, madje më shumë nga sa keni bërë ndonjëherë. Ju do ta ndryshoni botën teksa e bëni këtë.

Si gra, ju i frymëzoni të tjerët dhe vendosni një standard të denjë për t'u marrë shembull. Më lejoni t'ju jap pak të dhëna mbi dy prej njoftimeve madhore që u bënë në konferencën tonë të fundit të përgjithshme. Ju, motrat e mia të dashura, ishit thelbësore për të dyja.

Së pari, dhënia e shërbesës. Standardi më i lartë për dhënien e shërbesës është ai i Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Në përgjithësi gratë janë dhe kanë qenë gjithmonë më pranë atij standardi sesa burrat. Kur jepni vërtet shërbesë, ju i ndiqni ndjenjat tuaja për ta ndihmuar dikë tjetër që të përjetojë më shumë nga dashuria e Shpëtimtarit. Prirja për të dhënë shërbesë është e natyrshme te gratë e drejta. Njoh gra që lutën çdo ditë: "Kë dëshiron Ti që ta ndihmoj sot?"

Përpara njoftimit të prillit 2018 mbi mënyrën më të lartë e më të shenjtë të përkujdesjes për të tjerët, prirja e disa burrave ishte që ta shenjonin detyrën e tyre të mësimit të shtëpisë si "të kryer" dhe të kalonin te detyra tjetër.

Por kur *ju* e ndiet se një motre, së cilës i bëtë vizita mësimore, i nevojitej ndihmë, ju reaguat menjëherë dhe pastaj vazhduat gjatë gjithë muajit. Pra, ishte mënyra *se si* ju e bënit vizitën mësimore që e frymëzoi zhvendosjen tonë më lart për të dhënia e shërbesës.

Së dyti, në konferencën e fundit të përgjithshme, ne gjithashtu i riorganizuam kuorumet e Priftërisë Melkizedeke. Kur u lutëm mbi mënyrën se si t'i ndihmonim burrat e Kishës që të ishin më të efektshëm në përgjegjësitë e tyre, e morëm parasysh me kujdes shembullin e Shoqatës së Ndhimës.

Në Shoqatën e Ndhimës mblidhen së bashku gra të moshave të ndryshme dhe në faza të ndryshme të jetës. Secila dekadë e jetës sjell sfida të pashoqe



dhe sërish, ja ku ishit *ju* atje, javë pas javë, duke u shoqëruar së bashku, duke u rritur, duke dhënë mësim ungjillin së bashku dhe duke sjellë një ndryshim të vërtetë në botë.

Tani, duke ndjekur shembullin tuaj, mbajtësit e Priftërisë Melkizedeke janë anëtarë të kuorumit të pleqve. Këta burra kanë mosha nga 18 deri në 98 vjeç (ndoshta më shumë), me përvoja me gamë po aq të gjerë në priftëri dhe në Kishë. Këta vëllezër tani mund të krijojnë lidhje më të forta vëllazërore, të mësojnë së bashku dhe t'i bekojnë të tjerët me më shumë efektshmëri.

Ju kujtohet se qershorin e kaluar, Motra Nelson dhe unë u folëm të rinjve e të rejave të Kishës. Ne i ftuam ata të regjistroheshin në batalionin e rinisë së Zotit për të ndihmuar në mbledhjen e Izraelit në të dyja anët e velit. Kjo mbledhje është "sfida *më e madhe*, ka-
uza *më e madhe* dhe puna *më e madhe* në tokë sot"!

Është një kauzë që ka skajshëm nevojë për gratë, sepse gratë i japin formë së ardhmes. Kështu që sonte, unë po ju drejtoj juve, grave të Kishës, një lutje profetike për t'i dhënë formë të ardhmes duke ndihmuar që të mblidhet Izraeli i shpërndarë.

Nga mund t'ia nisni?

Më lejoni t'ju ofroj *katër ftesa*:

Së pari, ju ftoj të merrni pjesë në një agjërime 10-ditor nga mediat shoqërore dhe nga çfarëdolloj mjeti tjetër komunikimi që ju sjell në mendje mendime negative dhe të papastra. Lutuni për të ditur se çfarë ndikimesh të hiqni gjatë agjërimit tuaj. Rezultati i agjërimit tuaj 10-ditor mund t'ju befasojë. Çfarë vini re pasi të bëni një ndërprerje nga këndvështrimet e botës që po e lëndonin shpirtin tuaj? A ka ndonjë ndryshim te fakti se ku dëshironi *tani* ta shpenzoni kohën dhe energjinë tuaj? A është zhvendosur ndonjëra prej përparësive tuaja – qoftë edhe pak? Ju nxit që ta mbani shënim dhe të vijoni sipas secilës mbresë.

Së dyti, ju ftoj ta lexoni Librin e Mormonit duke filluar nga sot deri në fund të vitit. Sado e pamundur që mund të duket me gjithë gjërat që ju po përpique-
ni të organizoni në jetën tuaj, nëse do ta pranoni këtë ftesë me qëllim të plotë të zemrës, Zoti do t'ju ndihmojë ta gjeni një mënyrë për ta arritur. Dhe, teksa studioni plot lutje, ju premtoj se qiejt do të hapen për ju. Zoti do t'ju bekojë me frymëzim dhe zbulesë të shtuar.

Teksa lexoni, do t'ju nxitja ta shenjon çdo varg që flet për Shpëtimtarin ose i referohet Atij. Pastaj, jini të qëllimshme për të folur për Krishtin, për t'u gëzuar në Krishtin dhe për të predikuar për Krishtin te familjet dhe miqtë



tuaj.² Ju dhe ata do të shkoni më pranë Shpëtimtarit nëpërmjet këtij procesi. Dhe ndryshime, madje mrekulli, do të fillojnë të ndodhin.

Këtë mëngjes u dha njoftimi lidhur me programin e ri mësimor të së dielës të përqendruar te shtëpia dhe të për-krahur nga Kisha. Ju, motrat e mia të dashura, jeni thelbësore për suksesin e kësaj përpjekjeje të re, të baraspeshuar dhe të bashkërenduar të mësimdhënies së ungjillit. Ju lutem, jepuni mësim njerëzve që i doni, atë që ju po mësoni nga shkrimet e shenja. Mësojuni atyre se si t'i drejtohen Shpëtimtarit për fuqinë e Tij shëruese dhe pastruese kur mëkatojnë. Dhe mësojuni se si ta përdorin si burim fuqinë e Tij forcuese në çdo ditë të jetës së tyre.

Së treti, krijoni një model për pjesëmarrje të rregullt në tempull. Kjo mund të kërkojë pak më shumë sakrificë në jetën tuaj. Shtimi i kohës së rregullt në tempull do ta lejojë Zotin që t'ju mësojë se si ta përdorni si burim fuqinë e Tij të priftërisë, të cilën e keni marrë si dhurim në tempullin e Tij. Për ato prej jush që nuk jetojnë pranë një tempulli, ju ftoj të studioni plot lutje mbi tempujt në shkrimet e shenja dhe në fjalët e profetëve të gjallë. Kërkoni të *dini* më shumë, të *kuptoni* më shumë, të *ndieni* më shumë për tempujt nga sa keni bërë ndonjëherë më parë.

Në takimin tonë shpirtëror mbarëbotëror me të rinjtë e të rejtat në qershorin e kaluar, unë fola për një të ri, jeta e të cilit ndryshoi kur prindërit ia ndryshuan telefonin inteligjent me një telefon me palosje. Nëna e këtij të riu është një grua e patrembur me besim. Ajo e pa që i biri po shkonte drejt zgjedhjeve të

cilat mund ta pengonin atë të shërben-te në një mision. Ajo shkoi në tempull duke u lutur që ta dinte se si ta ndihmonte më mirë të birin. Pastaj veproi sipas çdo mbrese.

Ajo tha: “E ndjeva Shpirtin të më udhërrëfente që ta kontrolloja telefonin e djalit tim në kohë të veçanta për të kapur gjëra të veçanta. Unë nuk di se si t'i përdor këta telefona inteligjentë, por Shpirti më udhërrëfeu nëpër të gjitha mediat shoqërore të cilat unë vetë as që i përdor. E di se Shpirti i ndihmon prindërit që po kërkojnë udhërrëfim për t'i mbrojtur fëmijët e tyre. [Në fillim] biri im u tërbua me mua. . . . Por vetëm pas tri ditësh, ai më falënderoi! Ai mundi ta ndiente ndryshimin.”

Qëllimi i Shoqatës së Ndhmës

Shoqata e Ndhmës i ndihmon gratë të përgatiten për bekimet e jetës së përjetshme teksa ato:

- E rritin besimin tek Ati Qiejllor dhe te Jezu Krishti, dhe te Shlyerja e Tij.
- I forcojnë individët, familjet dhe shtëpitë nëpërmjet ordnancave dhe besëlidhjeve.
- Punojnë në unitet për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë.

Kopjet mund të sigurohen te [lds.org/callings/relief-society/purposes](https://www.lds.org/callings/relief-society/purposes) ose te [store.lds.org](https://www.lds.org/store).

Sjellja dhe qëndrimet e djalit të saj ndryshuan rrënjësisht. Ai u bë më i gjindshëm në shtëpi, buzëqeshi më shumë dhe ishte më i vëmendshëm në kishë. Atij i pëlqeu shumë të shërbente për njëfarë kohe në një pagëzimore tempulli dhe të përgatitej për misionin e tij.

Ftesa ime e katërt, për ju që jeni më në moshë, është që të merrni pjesë plotësisht në Shoqatën e Ndhmës. Ju nxit ta studioni shpalljen e tanishme për qëllimin e Shoqatës së Ndhmës. Është frymëzuese. Mund t'ju udhërrëfejë që të hartoni vetë shpalljen tuaj të qëllimit për vetë jetën tuaj. Gjithashtu ju kërkoj plot zell t'i shijoni të vërtetat në deklaratën e Shoqatës së Ndhmës të botuar thuajse 20 vjet më parë.³ Një kopje në kornizë e kësaj deklarate varet në mur në zyrën e Presidencës së Parë. Emocionohem *çdo* herë që e lexoj. Ajo përshkruan se cilat jeni dhe cilat ka nevojë Zoti që të jeni *pikërisht* në këtë kohë teksa e bëni pjesën *tuaj* që të ndihmoni për të mbledhur Izraelin e shpërndarë.

Motrat e mia të dashura, ne kemi nevojë për *ju!* Ne “kemi nevojë për forcën *tuaj*, kthimin *tuaj* në besim, bindjen *tuaj*, aftësinë *tuaj* për të udhëhequr, urtësinë *tuaj* dhe zërat *tuaj*”⁴. Ne thjesht nuk mund ta mbledhim Izraelin pa ju.

Unë ju dua e ju falënderoj dhe tani ju bekoj me aftësinë që ta lini botën pas teksa jepni ndihmesë në këtë punë jetike dhe të ngutshme. Së bashku ne mund të bëjmë gjithçka që Ati ynë Qiellor ka nevojë që të bëjmë për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Birit të Tij të Dashur.

Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit” (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), [HopeofIsrael.lds.org](https://www.hopeofisrael.lds.org).
2. Shih 2 Nefi 25:26.
3. Këto dokumente janë në dispozicion në internet. Për deklaratën e qëllimit të Shoqatës së Ndhmës, shih [lds.org/callings/relief-society](https://www.lds.org/callings/relief-society). Për deklaratën e Shoqatës së Ndhmës, shih Mary Ellen Smoot, “Rejoice, Daughters of Zion”, *Liahona*, janar 2000, f. 111–114.
4. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 96; theksimi i shtuar.



Nga Presidenti M. Rasëll Ballard,
President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Vegimi i Shëlbimit të të Vdekurve

Unë dëshmoj se vegimi që mori Presidenti Jozef F. Smith, është i vërtetë. Unë jap dëshmi se çdo person mund të arrijë ta kuptojë se është i vërtetë.

Vëllezërit dhe motrat e mia, biseda ime ishte përgatitur kohë përpara largimit nga jeta të bashkëshortes sime të dashur Barbara. Familja ime dhe unë ju falënderojmë për dashurinë dhe dhënien e mirësisë suaj. I lutem Zotit që të më bekojë ndërsa ju flas këtë mëngjes.

Në tetor 1918, 100 vjet më parë, Presidenti Jozef F. Smith mori një vegim të lavdishëm. Thujse pas 65 vjetësh shërbimi të përkushtuar ndaj Zotit në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe vetëm disa javë përpara se të ndërronte jetë më 19 nëntor 1918, ai u ul në dhomën e vet duke përsiatur për flijimin shlyes të Krishtit dhe duke lexuar përshkrimin e Apostullit Pjetër për shërbesën e Shpëtimtarit në botën e shpirtrave pas Kryqëzimit të Tij.

Ai shkroi: “Ndërsa lexoja, më lanë shumë mbresë. . . . Ndërsa përsiatja për këto gjëra . . . , sytë e të kuptuarit tim u hapën dhe Shpirti i Zotit pushoi në mua e unë pashë ushtritë e të vdekurve.”¹ Teksti i plotë i vegimit është shënuar te Doktrina e Besëlidhjet, seksioni 138.

Më lejoni të tregoj pak nga sfondi historik në mënyrë që të mund ta

vlerësojmë më plotësisht përgatitjen e Jozef F.-së një jetë të tërë, për t’a marrë këtë zbulësë mbresëlënëse.

Kur ishte President i Kishës, ai vizitoi Navunë në vitin 1906 dhe reflektoi për një kujtim që kishte pasur kur ishte vetëm pesë vjeç. Ai tha: “Pikërisht ky është vendi ku qëndrova kur [Jozefi, xhaxhai im dhe babai im, Hajrëmi], erdhën duke kalëruar teksa kishin marrë rrugën për në Karthixh. Pa zbritur nga kali i tij, babai që nga shala u përkul drejt meje dhe më ngriti nga toka. Ai më përshëndeti me puthje e më uli sërish dhe e pashë të largohej duke kalëruar.”²

Herën tjetër që Jozef F.-ja i pa ata, ishte kur nëna e tij, Meri Filding Smithi, e ngriti lart për të parë martirët të shtrirë krah për krah pasi i kishin vrarë mizorisht në burgun e Karthixhit më 27 qershor 1844.

Dy vjet më vonë, Jozef F.-ja, bashkë me familjen e tij dhe nënën besnike, Meri Filding Smithin, e lanë pas shtëpinë në Navu për të shkuar në Lagjet Dimërore. Edhe pse nuk kishte mbushur ende tetë vjeç, Jozef F.-së, iu kërkua ta drejtonte njërin nga pendët e qeve nga Montrouzi në Ajoua për në Lagjet

Dimërore dhe më pas për në Luginën e Solt-Lejkut, ku mbërriti kur ishte pothuajse 10 vjeç. Unë shpresoj që ju djem dhe të rinj po më dëgjoni dhe t’i kuptoni përgjegjësinë dhe pritshmërinë që iu vu mbi shpatulla Jozef F., gjatë djalërisë së tij.

Vetëm katër vjet më vonë, në vitin 1852, kur ishte 13 vjeç, nëna e tij e dashur ndërroi jetë – duke i lënë Jozefin dhe vëllezërit e motrat e tij jetimë.³

Jozef F. u thirr për të shërbyer në një mision në ishujt Havai në vitin 1854 kur ishte 15 vjeç. Ky mision, i cili zgjati më shumë se tre vjet, ishte fillimi i një jete shërbimi në Kishë.

Me t’u kthyer në Juta, Jozef F., u martua në vitin 1859.⁴ Gjatë disa viteve në vijim, jeta e tij ishte e mbushur me punë, detyrime familjare dhe dy misione të tjera. Më 1 korrik 1866, në moshën 27-vjeçare, jeta e Jozef F.-së, ndryshoi përgjithmonë kur ai u shuguroi si Apostull nga Brigam Jangu. Në tetor të vitit vijues, ai plotësoi një vend të mbetur bosh në Këshillin e Të Dymbëdhjetëve.⁵ Ai shërbeu si këshilltar i Brigam Jangut, Xhon Tejlorit, Uillford Udrafit dhe Lorenci Snout, përpara se të bëhej vetë President në vitin 1901.⁶

Jozef F. dhe bashkëshortja e tij, Xhulina, mirëpritën në familje fëmijën e tyre të parë, Mersi Xhozefinën.⁷ Ajo ishte vetëm dy vjeç e gjysmë kur ndërroi jetë. Fill pas kësaj, Jozef F. shkroi: “Dje u mbush një muaj qëkurse . . .





Në një vegim të lavdishëm të marrë në tetor 1918, Presidenti Jozef F. Smith pa babanë e tij, Hajrëmin, dhe Profetin Jozef Smith.

Xhozefina ime e dashur ndërroi jetë. Ah, sikur të mund ta shpëtoja që të rritej e të bëhej grua. Më merr mall për të çdo ditë dhe ndihem i vetmuar. . . . Perëndi, fale dobësinë time nëse është e gabuar t'i dua të vegjlit e mi ashtu siç i dua.”⁸

Gjatë jetës së tij, Presidenti Smith humbi të atin, nënën e tij, një vëlla, dy motra, dy bashkëshorte dhe trembëdhjetë fëmijë. Ai e njihnte mirë dhembjen dhe humbjen e njerëzve të dashur.

Kur i biri, Albert Xhesi, ndërroi jetë, Jozef F. i shkroi motrës së tij, Marta Anës, se i ishte përgjyruar Zotit që ta shpëtonte atë dhe e pyeti: “Përse ndodhi kështu? O, Perëndi përse duhej të ndodhte kjo?”⁹

Pavarësisht lutjeve të tij në atë kohë, Jozef F.-ja nuk mori përgjigje për këtë çështje.¹⁰ Ai i tha Marta Anës se “qiejt [dukeshin si] prej tunxhi mbi kokën tonë” për sa i përket temës së vdekjes dhe botës së shpirtit. Megjithatë, besimi i tij te premtimet e përjetshme të Zotit ishte i vendosur dhe i paepur.

Në kohën e caktuar nga Zoti, përgjigjet shtesë, ngushëllimi dhe kuptimi që kërkoi Presidenti Smith rreth botës së shpirtit, e erdhën atij nëpërmjet vegimit të mrekullueshëm që mori në tetor të vitit 1918.

Ai ai vit që veçanërisht i dhembshëm për të. Ai u brengos për numrin e madh të të vdekurve në Luftën e Madhe Botërore që vazhdoi të rritej deri në 20 milionë njerëz të vrarë. Përveç asaj, një epidemi gripi po përhapej në mbarë botën duke marrë jetën e më shumë se 100 milionë njerëzve.

Gjatë vitit, Presidenti Smith humbi gjithashtu tre pjesëtarë të tjerë të vyer të familjes. Plaku Hajrëm Mek Smithi, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, biri i tij i parëlindur dhe gjyshi im, vdiqën papritur nga plasja e apendicitit.

Presidenti Smith shkroi: “Kam mbetur pa fjalë – [i mpirë] nga pikëllimi! . . . Zemra më është thyer dhe më duket sikur nuk kam jetë! . . . Ah! Sa e desha atë! . . . Do ta dua përherë. Dhe kështu është dhe do të jetë me të

gjithë bijtë dhe bijat e mia, por ai është biri im i parëlindur, i pari që më solli gëzimin dhe shpresën e një emri të përjetshëm, të nderuar mes njerëzve. . . . E falënderoj Perëndinë nga thellësia e shpirtit tim për të! Por . . . ah! Kisha shumë nevojë për të! Të gjithë kishim nevojë për të! Ai ishte shumë i dobishëm për Kishën. . . . Kurse tani, . . . Ah! Çfarë mund të bëj! . . . Ah! Perëndia më ndihmoftë!”¹¹

Muajin tjetër, dhëndri i Presidentit Smith, Alonco Kesler, ndërroi jetë në një aksident tragjik.¹² Presidenti Smith shënoi në ditarin e tij: “Ky aksident vdekjeprurës, i tmerrshëm dhe tragjik, ka hedhur edhe njëherë një mbulesë trishtimi mbi gjithë familjen time”¹³.

Shtatë muaj më vonë, në shtator të vitit 1918, nusja e djalit të Presidentit Smith [u largua nga jeta] dhe gjyshja ime, Ida Bouman Smithi, ndërroi jetë pasi lindi fëmijën e saj të pestë, xhaxhanë tim, Hajrëmin.¹⁴

Dhe kështu ndodhi më 3 tetor 1918, pasi kishte përjetuar një dhembje kaq të madhe për miliona njerëz që kishin ndërruar jetë në botë prej luftës dhe sëmundjeve, si edhe për vdekjet e pjesëtarëve të tij të familjes, Presidenti Smith mori zbuluesen qiellore të njohur si “vegimi i shëlbimit të të vdekurve”.

Ai e përmendi zbuluesen ditën vijuese në sesionin e hapjes së konferencës së përgjithshme të tetorit. Shëndeti i Presidentit Smith nuk ishte i mirë, e prapëseprapë ai foli shkurtimisht: “Unë nuk do të përpiqem, nuk guxoj të përpiqem t'i trajtoj shumë gjëra që janë në mendjen time këtë mëngjes, dhe do ta shtyj për një kohë të ardhshme, dashtë Zoti, përpjekjen time për t'ju thënë disa nga gjërat që i kam në mendje dhe në zemër. Unë nuk kam jetuar i vetëm këto pesë muajt [e fundit]. Kam jetuar me shpirtin e lutjes, përgjërimit, besimit dhe vendosmërisë dhe kam pasur komunikimin tim me Shpirtin e Zotit vazhdimisht.”¹⁵

Zbulesa që mori më 3 tetor, ia ngushëlloi zemrën dhe iu dha përgjigje shumë prej pyetjeve të tij. Edhe ne mund të ngushëllohem dhe të mësojmë më shumë rreth vetë së ardhmes sonë kur ne dhe njerëzit tanë të dashur

të ndërrojmë jetë dhe të shkojmë në botën e shpirtrave, duke e studiuar këtë zbulesë dhe duke e përsiatuar domethënien e saj në mënyrën se si e jetojmë jetën çdo ditë.

Ndër shumë gjëra që Presidenti Smith pa, ishte vizita e Shpëtimtarit te njerëzit besnikë në botën e shpirtrave pas vetë vdekjes së Tij në kryq. Nga ky vegim unë citoj:

“Por vini re, mes të drejtëve, ai organizoi forcat e tij dhe caktoi lajmëtarë, të veshur me fuqi e autoritet, dhe i urdhëroi ata të shkonin dhe ta çonin dritën e ungjillit tek ata që ishin në errësirë, madje të gjithë shpirtrave të njerëzve¹⁶; dhe kështu iu predikua ungjilli të vdekurve. . . .

Këtyre iu mësua besim në Perëndinë, pendim nga mëkati, pagëzimi mëkëmbës për heqjen e mëkateve, dhurata e Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve,

Dhe të gjitha parimet e tjera të ungjillit të cilat ishin të nevojshme për ta për t'i ditur, me qëllim që të cilësosheshin se mund të gjykoreshin sipas njerëzve në mish, por të jetonin sipas Perëndisë në shpirt. . . .

Sepse të vdekurit e kishin parë mungesën e gjatë të shpirtrave të tyre nga trupat e tyre si një robëri.

Këta Zoti i mësoi dhe u dha fuqi për të ardhur, pas ringjalljes së tij së vdekuri, për të hyrë në mbretërinë e Atit të tij, atje për t'u kurorëzuar me pavdekësi dhe jetë të përjetshme.

Dhe për të vazhduar që nga ajo kohë punën e tyre, sikurse ishte premtuar nga Zoti, dhe për të qenë pjesëmarrës të të gjitha bekimeve që ishin mbajtur në ruajtje për ata që e duan atë.”¹⁷

Në vegim, Presidenti Smith pa të atin, Hajrëmin, dhe Profetin Jozef Smith. Kishin kaluar 74 vjet qëkurse ai i kishte parë ata për herë të fundit kur ishte ende djalë i vogël në Navu. Ne vetëm sa mund ta përfytyrojmë gëzimin e tij kur ka parë babanë dhe xhaxhanë e tij të dashur. Ai duhet të ketë qenë i frymëzuar dhe i ngushëlluar për njohurinë se të gjithë shpirtrat e mbajnë pamjen e trupit të tyre tokësor dhe se ata presin me padurim ditën e ringjalljes së tyre që iu është



premtuar. Vegimi zbuloi më plotësisht hollësitë e planit të Atit Qiellor për fëmijët e Tij dhe dashurinë shëlbuese të Krishtit dhe fuqinë e pashoqe të Shlyerjes së Tij.¹⁸

Në këtë përvjetor të veçantë të 100-të, unë ju ftoj ta lexoni tërësisht dhe mendueshëm këtë zbulesë. Teksa bëni kështu, Zoti ju bekoftë që ta kuptoni dhe ta vlerësoni më plotësisht dashurinë e Perëndisë dhe planin e Tij të shpëtimit dhe lumturisë për fëmijët e Tij.

Unë dëshmoj se vegimi që mori Presidenti Jozef F. Smith, është i vërtetë. Unë jap dëshmi se çdo person mund ta lexojë atë dhe të arrijë ta kuptojë se është i vërtetë. Ata që nuk e marrin këtë njohuri në këtë jetë, me siguri do të arrijnë ta kuptojnë vërtetësinë e saj kur çdokush të shkojë në botën e shpirtrave. Atje, të gjithë do t'i duan dhe do t'i përlëvdojnë Perëndinë dhe

Zotin Jezu Krisht për planin e madh të shpëtimit dhe bekimin e Ringjalljes së premtuar kur trupi dhe shpirti do të ribashkohen edhe njëherë për të mos u ndarë më kurrë.¹⁹

Sa mirënjohës jam që e di se ku është Barbara ime e vyer dhe se do të jemi bashkë sërish me familjen tonë për gjithë përjetësinë! Na mbështetë paqja e Zotit tani dhe përgjithmonë është lutja ime e përlulur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 138:6, 11.
2. Joseph F. Smith, në Preston Nibley, *The Presidents of the Church* (1959), f. 228.
3. Shih Joseph Fielding Smith, *Life of Joseph F. Smith* (1938), f. 13.
4. Ai u martua me Levira Klarkun në vitin 1859, Xhulina Lambsonin në vitin 1866, Sara Riçardsin në vitin 1868, Edna Lambsonin në vitin 1871, Elis Kimballin në vitin 1883 dhe Meri Shvarcin në vitin 1884.
5. Jozef F. Smithi u thirr si këshilltar shtesë në Presidencën e Parë (Brigam Jang, Hibër C. Kimball dhe Daniel H. Uells). Ai

shërbeu gjithashtu si Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë me tre Presidentë të Kishës: Presidentët Xhon Tejlor, Uillford Udraf dhe Lorenzo Snou.

6. Jozef F. Smithi shërbeu si këshilltar në Presidencën e Parë gjatë administrimit të Brigam Jangut dhe shërbeu si Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë gjatë administrimeve të Xhon Tejlorit, Uillford Udrafit dhe Lorenzo Snout. Ai ishte Presidenti i parë i Kishës që kishte shërbyer në Presidencën e Parë përpara se të thirrej si President.
7. Mersi Xhozefina, fëmija e parëlindur e Jozef Fildingut, lindi më 14 gusht 1867 dhe ndërroi jetë më 6 qershor 1870.
8. Ditari i Joseph F. Smith-it, 7 korrik 1870, Biblioteka e Historisë së Kishës, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve, Solt-Lejk-Siti, Juta.
9. Joseph F. Smith-i drejtuar Marta Ann Smith Harris-it 26 gusht 1883, Biblioteka e Historisë së Kishës; shih Richard Neitzel Holzapfel dhe David M. Whitchurch, *My Dear Sister: The Letters between Joseph F. Smith and His Sister Martha Ann* (2018), f. 290–291.
10. Në shumë raste, Zoti e drejtoi Jozef F. Smithin në jetën e tij vetjake dhe në shërbesën e tij si një Apostull dhe President i Kishës nëpërmjet ëndrrave, zbulesave dhe vegimeve të frymëzuara. Shpesh këto dhurata të çmuara nga Zoti u shënuan në ditarët, predikimet, kujtimet e tij dhe në dokumentet zyrtare të Kishës.
11. Ditari i Joseph F. Smith-it, 23 janar 1918, Biblioteka e Historisë së Kishës, shqiptimi dhe përdorimi i germave të mëdha i modernizuar; shih Joseph Fielding Smith, *Life of Joseph F. Smith*, f. 473–474.
12. Shih “A. [P.] Kesler Is Killed in Fall from a Building”, *Ogden Standard*, 5 shkurt 1918, f. 5.
13. Ditari i Joseph F. Smith-it, 4 shkurt 1918, Biblioteka e Historisë së Kishës.
14. Shih “Ida Bowman Smith”, *Salt Lake Herald-Republican*, 26 shtator 1918, f. 4.
15. Joseph F. Smith, në Conference Report, tetor 1918, f. 2.
16. Shih referencën për “Nëna jonë e lavdishme Eva” dhe “bija[e] saj besnike të cilat . . . [e] adhuroa[n] Perëndinë e vërtetë dhe të gjallë” (Doktrina e Besëlidhje 138:39).
17. Doktrina e Besëlidhje 138:30, 33–34, 50–52.
18. Teksti i vegimit u paraqit fillimisht më 30 nëntor 1918, botim i *Deseret News*, 11 ditë pas largimit nga jeta të Presidentit Smith më 19 nëntor. Ai u shtyp në dhjetor në revistën *Improvement Era* dhe në botimet e janarit 1919 të *Relief Society Magazine*, *Utah Genealogical and Historical Magazine*, *Young Women’s Journal* dhe *Millennial Star*.
19. Edhe pse bijtë e humbjes do të ringjallen, ata nuk do të mund t’i japin dashuri dhe përlëvdime Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit ashtu si ata që e marrin një mbretëri lavdie. Shih Alma 11:41; Doktrina e Besëlidhje 88:32–35.



Motra Boni H. Kordën,
Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Të Bëhesh Bari

Shpresoj që ata të cilëve u jepni shërbesë, do t’ju shohin si shok dhe të kuptojnë se, te ju, ata shohin një kampion dhe një njeri të besuar.

Një vit më parë, një fëmijë i Fillores që e takova në Kili më bëri të buzëqesh. “Përhëndetje”, tha ai, “Jam Davidi. A do të flasësh për mua në konferencën e përgjithshme?”

Në çaste qetësie, kam përsiatuar për përhëndetjen e papritur të Davidit. Të gjithë duam që të na njohin. Duam që të jemi të rëndësishëm, të na mbajnë mend dhe ta ndiejmë se të tjerët na duan.

Motra e vëllezër, secili prej jush është i rëndësishëm. Edhe nëse nuk flitet për ju në konferencën e përgjithshme, Shpëtimtari ju njeh dhe ju do. Në qoftë se doni të dini a është e vërtetë kjo, ju nevojitet vetëm të mendoni se Ai ju ka “gdhendur në pëllëmbët e duarve të [Tij]”¹.

Duke e ditur se Shpëtimtari na do, atëherë ne mund ta pyetim veten: “Si mund ta tregojmë më mirë dashurinë tonë për Të?”

Shpëtimtari e pyeti Pjetrin: “A më do ti mua . . . ?”

Pjetri u përgjigj: “Po, Zot, ti e di se unë të dua”. Ai i tha atij: “Kulloti qengjat e mi!”

Kur kjo pyetje: “A më do ti mua?”, iu bë për herë të dytë dhe të tretë, Pjetri u trishtua, por prapëseprapë e pohoi dashurinë e tij: “Zot, ti di çdo gjë, ti [e] di se unë të dua. Jezusi i tha: *Kulloti delet e mia*”².

A nuk e kishte vërtetuar veten Pjetri tashmë si një pasues i dashur i Krishtit? Që nga takimi i tyre i parë në breg të detit, ai i la “menjëherë” rrjetat e peshkimit për ta ndjekur Shpëtimtarin.³ Pjetri u bë një peshkatar i vërtetë njerëzish. Ai e shoqëroi Shpëtimtarin gjatë shërbesës së Tij vetjake dhe ndihmoi për t’ua mësuar të tjerëve ungjillin e Jezu Krishtit.

Por tani Zoti i ringjallur e dinte se nuk do të ishte më në krah të Pjetrit, për t’i treguar atij se si duhej të shërbente dhe kur duhej të shërbente. Në mungesë të Shpëtimtarit, Pjetrit do t’i nevojitej



të kërkonte udhërrëfim nga Shpirti, të merrte zbulesë vetë dhe më pas të kishte guximin dhe besimin për të vepëruar. Duke u përqendruar te delet e Tij, Shpëtimtari dëshironte që Pjetri të bënte atë që Ai do të bënte po të ishte i pranishëm. Ai i kërkoi Pjetrit të bëhej bari.

Prillin e kaluar, Presidenti Rasëll M. Nelson na bëri një ftesë të ngjashme që t'i kullotim delet e Atit tonë në një mënyrë më të shenjtë dhe ta bëjmë këtë nëpërmjet dhënies së shërbesës.⁴

Për ta pranuar me efektshmëri këtë ftesë, ne duhet të zhvillojmë një zemër si të bariut dhe t'i kuptojmë nevojat e deleve të Zotit. Si bëhemi barinj të Zotit ka nevojë që ne të bëhemi?

Si me të gjitha pyetjet, ne mund të shohim te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti – Bari i Mirë. Delet njiheshin dhe numëroheshin nga Shpëtimtari; për ato u tregua kujdes; ato u mbledhën në grigjen e Perëndisë.

T'i Njohim dhe t'i Numërojmë

Ndërsa përpqemi fort për ta ndjekur shembullin e Shpëtimtarit, ne duhet, së pari, t'i njohim dhe t'i numërojmë delet e Tij. Neve na janë caktuar individë dhe familje të veçanta për t'u përkujdesur, kështu që jemi të sigurt se mbahet përgjegjësi për të gjithë tufën e Zotit dhe as edhe një nuk është harruar. Sidoqoftë, numërimi nuk ka të bëjë vërtet me numrat; ka të bëjë me faktin që të sigurohemi se *çdo* njeri e ndien dashurinë e Shpëtimtarit nëpërmjet dikujt që shërben *për* Të. Në këtë mënyrë, të gjithë mund ta dallojnë se një Atë i dashur në Qiell i njeh ata.

Kohët e fundit takova një të re së cilës i është caktuar që t'i japë shërbesë një motre pothuaj pesë herë më të madhe në moshë se ajo. Së bashku, ato kanë zbuluar një dashuri të përbashkët për muzikën. Kur kjo e re e viziton, ato këndojnë së bashku dhe i tregojnë njëra-tjetrës muzikën e tyre të parapëlqyer. Ato po krijojnë një miqësi që ua bekon jetën të dyjave.

Shpresoj që ata të cilëve u jepni shërbesë, do t'ju shohin si shok dhe të kuptojnë se, te ju, ata shohin një kampion dhe një njeri të besuar – si dikush që është në dijeni për rrethanat



e tyre dhe i mbështet ata në shpresat e aspiratat e tyre.

Kohët e fundit, u caktova për t'i dhënë shërbesë një motre që as unë, as shoqja ime nuk e njihnim mirë. Teksa u këshillova me Xhesin, shoqen time 16-vjeçare për dhënien e shërbesës, ajo me urtësi sugjeroi: “Duhet ta njohim atë”.

Ne, menjëherë vendosëm se një fotografi e vetvetes dhe një mesazh për t'u njohur ishin të përshtatshme. Unë mbajta telefonin dhe Xhesi shtypi butonin për të bërë fotografinë. Mundësia jonë e parë për të dhënë shërbesë ishte një përpjekje si dyshe.

Në vizitën tonë të parë, e pyetëm motrën tonë a kishte ndonjë gjë që mund ta përfshinin në lutjet tona në emër të saj. Ajo na tregoi për një sfidë delikate vetjake dhe tha se i mirëpriste lutjet tona. Ndershmëria dhe siguria e saj krijuan menjëherë një lidhje [plot] dashuri. Çfarë privilegji i veçantë është që ta kujtoj atë në lutjet e mia të përditshme!

Teksa luteni, ju do ta ndieni dashurinë e Jezu Krishtit për ata të cilëve u jepni shërbesë. Tregojani atë dashuri atyre. A ka ndonjë mënyrë më të mirë për t'i ushqyer delet e Tij se sa t'i ndihmoni ata që ta ndiejnë dashurinë e Tij – *nëpërmjet jush?*

Të Tregojmë Kujdes

Një mënyrë e dytë për të zhvilluar zemrën e një bariut është të

kujdesemi për delet e Tij. Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne mund të lëvizim, të rregullojmë, të riparojmë dhe të rindërtojmë pothuajse çdo gjë. Jemi të shpejtë për të plotësuar një nevojë duke u zgjatur dorën apo duke u dhënë një pjatë me biskota. Por a ka më shumë për të bërë?

A e dinë delet tona se po kujdesemi për to me dashuri dhe se do të ndërmarrim veprime për t'i ndihmuar?

Te Mateu 25, lexojmë:

“Ejani, të bekuar të Atit tim; merrni në trashëgim mbretërinë që u bë gati për ju . . .

Sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë për të pirë; isha i huaj dhe më pritët’, . . .

Atëherë të drejtët do t'i përgjigjen duke thënë: ‘Zot, kur të *pamë* të uritur dhe të dhamë për të ngrënë; ose të etur dhe të dhamë për të pirë?’

Dhe kur të *pamë* të huaj dhe të pritëm?”⁵

Vëllezër e motra, fjala kyç është *pamë*. Të drejtët i panë njerëzit në nevojë ngaqë po vëzhgonin dhe po vërenin. Edhe ne mund të jemi syçelë për të shkuar në ndihmë e për të ngushëlluar, për të festuar e madje ëndërruar. Dhe ndërsa veprojmë, ne mund të jemi të sigurt për premtimin te Mateu: “Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre . . . më të vegjël[ve], këtë ma bëtë mua”⁶.



Një mik – ne do ta quajmë atë Xhoni – tregoi se çfarë mund të ndodhë kur shohim nevojën më pak të dukshme të një njeriu tjetër: “Një motër në lagjen time u orvat të vetëvritej. Pas dy muajsh, zbulova se askush në kuorumin tim nuk i ishte afruar bashkëshortit të saj për të folur për këtë përvojë tronditëse. Mjerisht, as unë nuk kisha vepruar. Më në fund, i kërkova bashkëshortit të saj të dilnim për drekë. Ai ishte një burrë i turpshëm, shpesh i rezervuar. Dhe pra-pëseprapë, kur i thashë: ‘Bashkëshortja jote u orvat të vetëvritej. Kjo duhet të jetë dërmuese për ty. A dëshiron të flasësh për këtë?’, ai qau haptazi. Ne patëm një bashkëbisedim të dhembshur dhe të thellë dhe zhvilluam një afërsi e mirëbesim të mrekullueshëm brenda disa minutash.”

Xhoni shtoi: “Mendoj se prirja jonë është që thjesht të sjellim kek me çokolatë në vend që të kuptojmë se si të përballemi me atë çast me ndershmëri e dashuri.”⁷

Delet tona mund të jenë të lënduara, të kenë humbur ose madje të kenë shkuar me dashje në udhë të gabuar; si bari i tyre, ne mund të jemi nga të parët që e shohin nevojën e tyre. Ne mund të dëgjojmë e të duam pa gjykuar dhe të ofrojmë shpresë e ndihmë me udhërrëfimin shquës të Frymës së Shenjtë.

Motra e vëllezër, bota është më e mbushur me shpresë e më gëzimplotë për shkak të veprimeve të frymëzuara dashamirëse që kryeni. Ndërkohë që kërkoni udhëzimin e Zotit mbi mënyrën se si ta përçoni dashurinë e Tij dhe t'i

shihni nevojat e atyre që u jepni shërbesë, sytë do t'ju hapen. Detyra juaj e shenjtë për të dhënë shërbesë, ju jep të drejtën hyjnore për frymëzim. Ju mund ta kërkoni atë frymëzim me vetëbesim.

Të Mblidhemi në Grigjën e Perëndisë

Së treti, ne duam që delet tona të mblidhen në grigjën e Perëndisë. Për ta bërë këtë, ne duhet të shqyrtojmë se ku janë ata në shtegun e besëlidhjes dhe të jemi të gatshëm të ecim me ta në udhëtimin e tyre të besimit. I yni është një privilegj i shenjtë që të arrijmë t'i njohim zemrat e tyre dhe t'i drejtojmë për të Shpëtimtari.

Motra Xhozefini në Fixhi e kishte të vështirë që ta shihte udhën e saj drejt shtegut të besëlidhjes – në kuptimin e vërtetë të fjalës. Shoqja e saj pa që Josivini kishte vështirësi për t'i parë shkrimet e shenjta mjaftueshëm mirë sa për të lexuar. Ajo i bleu Xhozefinit syze të reja leximi dhe një laps të verdhë të shndritshëm për të nënvizuar sa herë që Jezu Krishti përmendej te Libri i Mormonit. Ajo që filloi si një dëshirë e thjeshtë për të dhënë shërbesë dhe për të ndihmuar për studimin e shkrimit të shenjtë, bëri që Xhozefini ta vizitonte tempullin për herë të parë 28 vjet pasi u pagëzua.

Nëse delet tona janë të forta apo të dobëta, duke u gëzuar ose në ankth, ne mund të sigurohemi që as edhe një nuk ecën vetëm. Ne mund t'i duam ato sido që të jenë shpirtërisht dhe të ofrojmë mbështetje dhe nxitje për hapin tjetër të radhës. Teksa lutemi dhe

kërkojmë t'i kuptojmë zemrat e tyre, dëshmoj se Ati Qiellor do të na drejtojë dhe do ta kemi me vete Shpirtin e Tij. Ne kemi mundësinë të jemi “engjëj . . . përreth” tyre teksa Ai shkon përpara fytyrës së tyre.⁸

Zoti na fton t'i ushqejmë delet e Tij, të kujdesemi për tufat e Tij siç do të kujdesej Ai. Ai na fton të jemi barinj për çdo komb, për çdo vend. (Dhe po, Plaku Uhtdorf, ne i duam dhe kemi nevojë për barinj të gjermanë.) Dhe Ai dëshiron që të rinjtë e Tij të bashkohen në këtë kauzë.

Të rinjtë tanë mund të jenë disa nga barinj të më të fortë. Ata janë, ashtu siç tha Presidenti Rasëll M. Nelson, “nga më të mirët që Zoti ka dërguar *ndonjëherë* në këtë botë”. Ata janë “shpirtërisht fisnikë”, “lojtarët [tanë] më të mirë”, të cilët e ndjekin Shpëtimtarin.⁹ A e përfytyroni dot fuqinë që mund të sjellin barinj të tillë teksa kujdesen për delet e Tij? Duke shërbyer krah për krah me këta të rinj, ne shohim mrekulli.

Të reja e të rinj, ne kemi nevojë për ju! Nëse nuk keni një detyrë për dhënie shërbese, bisedoni me presidenten tuaj të Shoqatës së Ndihmës ose me presidentin tuaj të kuorunit të pleqve. Ata do të gëzohen nga gatishmëria juaj për t'u siguruar që delet e Tij të njihen dhe numërohen; që për ato të tregohet kujdes dhe që të mblidhen në grigjën e Perëndisë.

Kur të vijë dita që do të gjunjëzohemi të këmbët e Shpëtimtarit tonë të dashur, pasi ta kemi ushqyer tufën e Tij, unë lutem që të mund të përgjigjem ashtu siç bëri Pjetri: “Po, Zot, ti e di se unë të dua”¹⁰. Këto, delet e Tua, [ndiejnë se] i *duan*, janë të *sigurta* dhe janë në *shtëpi*. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- 1 Nefi 21:16.
- 2 Shih Gjoni 21:15–17; theksimi i shtuar.
- 3 Shih Mateu 4:20.
- 4 Shih Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës”, *Liahona*, maj 2018, f. 100.
- 5 Mateu 25:34–35, 37–38; theksimi i shtuar.
- 6 Mateu 25:40.
- 7 Letërkëmbim vetjak.
- 8 Doktrina e Besëlidhjes 84:88.
- 9 Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit” (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), *HopeofIsrael.lids.org*.
- 10 Gjoni 21:15.



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shërbesa e Pajtimimit

Unë dëshmoj për qetësinë e shpirtit që do të sjellë pajtimi me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin, nëse jemi të butë dhe të guximshëm aq sa ta kërkojmë atë.

Prillin e shkuar, kur Presidenti Rasëll M. Nelson paraqiti konceptin e dhënies së shërbesës, ai theksoi se ekzistonte një mënyrë për t'i zbatuar urdhërimet e mëdha që ta duam Perëndinë dhe ta duam njëri-tjetrin.¹ Ne, si drejtues të Kishës, haptazi ju lavdërojmë dhe përgëzojmë për reagimin e jashtëzakonshëm që keni filluar në këtë drejtim. Ju falënderojmë që e ndiqni profetin tonë të dashur në këtë përpjekje të mrekullueshme dhe sugjerojmë që të mos prisni për më shumë udhëzime të tjera. Thjesht hidhuni në pishinë dhe notoni. Drejtohuni te njerëzit nevojtarë. Mos u bllokoni duke e pyetur veten a duhet të notoni në shpinë ose të bëni not qeni. Nëse i ndjekim parimet bazë që na janë mësuar, qëndrojmë në një linjë me çelësat e priftërisë dhe kërkojmë Shpirtin e Shenjtë që të na udhërrëfejë, ne nuk mund të dështojmë.

Këtë mëngjes dëshiroj të flas për një aspekt akoma më shumë vetjak të dhënies së shërbesës që nuk është nëpërmjet caktimit, nuk përfshin një intervistë kalendarike dhe nuk ka linjë raportimi përveçse në qiell. Më lejoni të tregoj vetëm një shembull të thjeshtë të asaj lloji dhënie shërbese.

Grent Morell Boueni ishte një bashkëshort punëtor, i përkushtuar dhe

një baba i cili, si shumë që e sigurojnë jetesën nga bujqësia, pësoi një rrënim ekonomik kur prodhimi i patates në atë rajon ishte i dobët. Ai dhe bashkëshortja e tij, Norma, gjetën punë të tjera, përfundimisht u shpërngulën në një qytet tjetër dhe filluan të kishin mjaftueshëm para për stabilitet ekonomik. Megjithatë, në një incident tmerrsisht të pafat, vëllai Bouen u lëndua thellë kur, në një intervistë për rekomandim tempulli, peshkopi ishte pak dyshues lidhur me deklaratën e Morellit se ishte pagues i së dhjetës së plotë.

Nuk e di se cili nga këta burra kishte faktet më të sakta atë ditë, por vërtet e di që motra Bouen doli nga ajo

intervistë me rekomandim të ri tempulli, ndërsa vëllai Bouen doli me një zemërim që do ta largonte nga Kisha për 15 vjet.

Pavarësisht se kush kishte të drejtë për të dhjetën, me sa duket edhe Morelli, edhe peshkopi, e harruan porosinë e Shpëtimtarit që të “bë[nin] një marrëveshje miqësore me kundërshtarin [e tyre]”² dhe këshillën e Palit për të “mos mëkat[uar]; [që] dielli të mos perëndojë mbi inatin tuaj”³. E vërteta është se ata *nuk* bënë një marrëveshje dhe dielli *vërtet* perëndoi mbi inatin e vëllait Bouen për ditë, pastaj javë, më pas vite, duke vërtetuar argumentin e bërë nga njëri prej njerëzve më të urtë të romakëve të lashtë, i cili tha: “Zemërimi, nëse nuk kufizohet, shpesh është më [shkatërrues] sesa keqbërja që e provokon atë”⁴. Por mrekullia e pajtimimit është përherë në dispozicion për ne dhe për shkak të dashurisë për familjen e tij dhe Kishës që e dinte se ishte e vërtetë, Morell Boueni u aktivizua sërish plotësisht në Kishë. Më lejoni t’iu tregoj shkurtimisht se si ndodhi ajo.

Djali i vëllait Bouen, Bredi, është një mik i mirë i yni dhe një i Shtatëdhjetë Zonal i përkushtuar që po shërben në Ajdahon jugore. Bredi ishte 11 vjeç në kohën e këtij incidenti dhe për 15 vite ai vëzhgoi që po pakësohej përkushtimi fetar i babait të tij, një dëshmitar i frytit të tmerrshëm që po korrej atje ku ishin mbjellë zemërimi dhe keqkuptimi. Duhej bërë diçka. Ndaj teksa pushimet e festës së Falënderimeve afroreshin në vitin 1977, Bredi, një student 26-vjeçar në





Universitetin “Brigam Jang”; bashkëshortja e tij, Valeria; dhe i sapolinduri, Miçi, ngarkuan makinën e tyre të thjeshtë si ajo e një studenti dhe pavarësisht nga moti i keq, e nganë atë për në Billings të Montanës. Madje as përplasja me një pirg dëbore afër Jelloustounit Perëndimor nuk do ta pengonte këtë treshe nga vënia në kontakt me vëllanë Bouen Plakun për t’i dhënë shërbesë.

Pas mbërritjes, Bredi dhe motra e tij, Pami, kërkuar një çast vetëm për vetëm me babanë e tyre. “Ke qenë një baba i mrekullueshëm”, ia nisi Bredi me pak emocion, “dhe e kemi ditur gjithnjë se sa shumë na ke dashur. Por diçka nuk shkon dhe kjo ka qenë për një kohë të gjatë. Për shkak se ti u lëndove një herë, e tërë kjo familje është lënduar për vite. Ne jemi të copëtuar dhe ti je i vetmi që mund të na bashkosh. Të lutem, të lutem, pas gjithë kësaj kohe, a mund të jesh në gjendje ta lësh mënjane atë incident të pafat me atë peshkop dhe ta drejtosh sërish këtë familje tek ungjilli siç bëre dikur?”

Pati heshtje të plotë. Pastaj vëllai Bouen ngriti sytë drejt këtyre të dyve, fëmijëve të tij, kockës së kockave të tij dhe mishit të mishit të tij⁵ dhe tha shumë qetësisht: “Po. Po, do ta bëj.”

Të emocionuar por të shtangur nga përgjigjja e papritur, Bred Bouen dhe familja e tij e panë bashkëshortin dhe

babanë e tyre të shkante te peshkopi i tij i tanishëm me një frymë pajtimi për t’i rregulluar gjërat në jetën e tij. Si një përgjigje e përsosur ndaj kësaj vizite të guximshme por tërësisht të papritur, peshkopi, i cili i kishte bërë ftesa të përsëritura vëllait Bouen për t’u rikthyer, i hodhi krahët në qafë Morellit dhe thjesht e mbajti atë – e mbajti të përçafuar për një kohë shumë të gjatë.

Në vetëm pak javë – nuk zgjati shumë – vëllai Bouen u përfshi plotësisht në aktivizimin në Kishë dhe u bë i denjë për t’u rikthyer në tempull. Shumë shpejt ai pranoi thirrjen për të kryesuar në një degë të vogël prej 25 anëtarësh që po haste vështirësi, dhe e rriti atë në një bashkësi të suksesshme prej mbi 100 anëtarësh. E gjitha kjo ndodhi thujse gjysmë shekulli më parë, por pasoja e përgjërimit të një biri dhe një bije për t’i dhënë shërbesë vetë babait të tyre dhe gatishmëria e atij babai për të falur dhe shkuar përpara pavarësisht nga papërsosuritë e të tjerëve, kanë sjellë bekime që ende po vijnë – dhe do të vijnë përgjithmonë – në familjen Bouen.

Vëllezër dhe motra, Jezusi ka kërkuar që ne të “jetojmë” së bashku në dashuri⁶ pa “grindje mes [nesh]”⁷. “Ai që ka shpirtin e grindjes nuk është i imi”, i paralajmëroi Ai nefitët.⁸ Njëmend, në një masë të madhe, marrëdhënia jonë me Krishtin do të përcaktohet – ose të

paktën do të ndikohet – nga marrëdhënia jonë me njëri-tjetrin.

“Në qoftë se . . . dëshiron të vish tek unë”, tha Ai, “dhe mban mend se yt vëlla ka diçka kundër teje —

Shko së pari tek yt vëlla dhe pajtohu me [të], dhe pastaj eja tek unë me qëllim të plotë të zemrës, dhe unë do të të pranoj.”⁹

Sigurisht që secili prej nesh mund të përmendë një numër të pafundmë lëndimesh e brengash të vjetra dhe kujtimesh të dhembshme që pikërisht në këtë çast ende e prishin paqen në zemrën e dikujt ose në familje apo lagje. Qoftë nëse e kemi shkaktuar ne atë dhembje ose jemi të prekurit prej dhembjes, ato plagë nevojitet të shërohen kështu që jeta të mund të jetë aq shpërblyese sa Perëndia synoi që ajo të ishte. Ashtu si ushqimi në frigoriferin tuaj që nipërit dhe mbesat e kontrollojnë me kujdes për ju, atyre fyerjeve të vjetra ka kohë që u ka kaluar data e përdorimit. Ju lutem, mos u lini më vend të çmuar atyre në shpirtin tuaj. Ashtu si Prospero i tha Alonsos së penduar te vepra *Furtuna*: “Le të mos e ngarkojmë kujtesën tonë me një rëndesë që nuk është më”¹⁰.

“Falni dhe do të jeni të falur”¹¹, dha mësim Krishti në kohën e Dhiatës së Re. Dhe në kohën tonë: “Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit”¹². Megjithatë është e rëndësishme për disa prej jush





që jetojnë në ankth të vërtetë, që të vëreni atë që Ai *nuk* tha. Ai *nuk* tha: “Nuk ju lejohet të ndieni dhembje të vërtetë ose brengë të vërtetë nga përvojat shkatërruese që i keni pasur për shkak të një personi tjetër”. Dhe *as* nuk tha: “Me qëllim që të falni plotësisht, ju duhet të hyni sërish në një marrëdhënie helmuese ose të ktheheni në një rrethanë keqtrajtuese dhe shkatërruese”. Por pavarësisht nga fyerjet më të tmerrshme që mund të na vijnë, ne mund të ngrihemi mbi dhembjen tonë vetëm kur i vendosim këmbët tona në shtegun e shërimit të vërtetë. Ai shteg është shtegu i faljes nëpër të cilin eci Jezusi i Nazaretit, që i bën thirrje secilit prej nesh: “Eja e më ndiq”¹³.

Në një ftesë të tillë për të qenë di-shepulli i Tij dhe për t’u përpjekur që të bëjmë siç bëri Ai, Jezusi po kërkon prej nesh që të jemi mjete të hirit të Tij – të jemi “lajmëtarë për Krishtin” në “shërbimin [e] pajtimit”, siç ua përshkroi Pali korintasve.¹⁴ Shëruesi i çdo plage, Ai i cili e ndreq çdo gabim, kërkon prej nesh që të punojmë me Të në detyrën e vështirë të paqebërësit në një botë që nuk do ta gjejë atë në ndonjë mënyrë tjetër.

Pra, ashtu siç shkroi Filip Bruksi: “Ju që po i lini keqkuptimet e mjerueshme të vazhdojnë nga viti në vit, duke nënkuptuar se do t’i sqaroni një ditë; ju që po i mbani gjallë grindjet përçmuese

ngaqë nuk mund të vendosni se tani është dita për të sakrifikuar krenarinë tuaj dhe për t’i [zgjidhur] ato; ju që po kaloni të ngrysur pranë njerëzve në rrugë, duke mos u folur për shkak të ndonjë mërie pa vlerë . . . ; ju që po e lini . . . zemrën [e dikujt] të dhembë për një fjalë vlerësimi ose dashamirësie, që synoni ta jepni . . . një ditë, . . . shkoni menjëherë dhe bëni gjënë që mund të mos keni kurrë rast tjetër për ta bërë”¹⁵.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë dëshmoj se falja dhe harrimi i fyerjeve, të vjetra ose të reja, është në qendër të madhësisë së Shlyerjes së Jezu Krishtit. Unë dëshmoj se një ndreqje e tillë shpirtërore përfundimisht mund të vijë vetëm nga Shëlbuesi ynë hyjnor, Ai që vjen me ngutje për të na ndihmuar “me shërimin në krahët e tij”¹⁶. Ne e falënderojmë Atë dhe Atin tonë Qiellor që e dërgoi Atë, që ripërtëritja dhe rilindja, një e ardhme e çliruar nga brengat e vjetra dhe gabimet e së shkuarës, jo vetëm që janë të mundura, por ato tashmë janë blerë, janë paguar me një çmim torturues që simbolizohet nga gjaku i Qengjit që e derdhi atë gjak.

Me autoritetin apostullor që më është dhënë nga Shpëtimtari i botës, unë dëshmoj për qetësinë e shpirtit që do të sjellë pajtimi me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin, nëse jemi të butë dhe të guximshëm aq sa ta kërkojmë atë.

“Ndaleni zënien me njëri-tjetrin”, u lut Shpëtimtari.¹⁷ Nëse jeni në dijeni për ndonjë lëndim të vjetër, ndreqeni atë. Kujdesuni për njëri-tjetrin me dashuri.

Miqtë e mi të dashur, në shërbesën tonë të përbashkët të pajtimit, ju kërkoj të jeni paqebërës – ta doni paqen, ta kërkonte paqen, ta krijoni paqen dhe ta çmoni paqen. E bëj atë thirrje në emër të Princit të Paqes, i cili di gjithçka për të qenit të “plagosur në shtëpinë e miqve të [Tij]”¹⁸, por që ende e gjeti forcën për të falur e harruar – dhe për të shëruar – dhe për të qenë i lumtur. Për atë lutem, për ju dhe për veten, në emrin e Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Mateu 22:36–40; Lluca 10:25–28.
2. Mateu 5:25.
3. Efesianëve 4:26.
4. Seneca, në Tryon Edwards, *A Dictionary of Thoughts* (1891), f. 21.
5. Shih Zanafilla 2:23.
6. Doktrina e Besëlidhje 42:45.
7. 3 Nefi 11:22; shih edhe 3 Nefi 11:28.
8. 3 Nefi 11:29.
9. 3 Nefi 12:23–24; theksimi i shtuar.
10. William Shakespeare, *The Tempest*, akti 5, skena 1, rreshtat 199–200.
11. Lluca 6:37.
12. Doktrina e Besëlidhje 64:10.
13. Lluca 18:22.
14. Shih 2 Korintasve 5:18–20.
15. Phillips Brooks, *The Purpose and Use of Comfort* (1906), f. 329.
16. Malakia 4:2; shih edhe 2 Nefi 25:13; 3 Nefi 25:2.
17. Doktrina e Besëlidhje 136:23.
18. Zakaria 13:6; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 45:52.



Nga Plaku Shein M. Bouen,
i Të Shtatëdhjetëve

Roli i Librit të Mormonit në Kthimin në Besim

Ne po e mbledhim Izraelin për herë të fundit dhe po e bëjmë këtë me Librin e Mormonit, një nga mjetet më të fuqishme për kthimin në besim.

Shumë njerëz sot e pyetin veten rreth realitetit të Perëndisë dhe marrëdhënies tonë me Të. Shumë njerëz dinë pak ose aspak rreth planit të Tij të madh të lumturisë. Më shumë se 30 vjet më parë, Presidenti Ezra Taft Benson vërejti se “shumica e botës . . . sot e hedh poshtë hyjnueshmërinë e Shpëtimtarit. Ata e vënë në pikëpyetje lindjen e Tij të mrekullueshme, jetën e Tij të përsosur dhe vërtetësinë e Ringjalljes së Tij të lavdishme.”¹

Në kohën tonë, pyetjet përqendrohen jo vetëm te Shpëtimtari ynë, por edhe te Kisha e Tij – Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme – të cilën Ai e rivendosi nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Këto pyetje shpesh përqendrohen te historia, mësimet ose praktikat e Kishës së Shpëtimtarit.

Libri i Mormonit na Ndhmon të Rritemi në Dëshmi

Nga manuali *Predikoni Ungjillin Tim* ne lexojmë: “Mbani mend se të kuptuarit tonë [për Atin Qiellor dhe planin e Tij të lumturisë] vjen nga profetët modernë – Jozef Smithi dhe pasuesit e tij – që marrin zbulesë të drejtpërdrejtë nga Perëndia. Kështu që,

pyetja e parë që duhet t’i përgjigjet një kërkues është a ishte Jozef Smithi një profet dhe ai ose ajo mund t’i përgjigjet kësaj pyetjeje duke lexuar dhe duke u lutur rreth Librit të Mormonit.”²

Dëshmia ime për thirrjen hyjnore të Profetit Jozef Smith është forcuar duke e studiuar plot lutje Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit. Unë kam vepruar sipas ftesës së Moronit për ta “pye[tur] Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit”, që të di për vërtetësinë e Librit të Mormonit.³ Unë jap dëshmi se e di që ai është i vërtetë. Ajo

njohuri më ka ardhur, ashtu siç mund t’ju vijë edhe ju, “nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë”⁴.

Në parathënien e Librit të Mormonit shpallet: “Ata që marrin këtë dëshmi hyjnore [për Librin e Mormonit] nga Shpirti i Shenjtë, do të mësojnë gjithashtu, nga e njëjta fuqi, se Jezu Krishti është Shpëtimtari i botës, se Joseph Smithi është zbuluesi dhe profeti i tij në këto ditë të fundit dhe se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është mbretëria e Zotit e ngritur sërish mbi tokë, për të përgatitur për ardhjen e dytë të Mesias”⁵.

Kur shkova në Kili si misionar i ri në moshë, mora një mësim që të ndryshon jetën rreth fuqisë që ka Libri i Mormonit për të kthyer në besim. Zoti Gonzales shërbeu në një pozitë të nderuar në kishën e tij për shumë vjet. Ai kishte përgatitje të gjerë fetare, përfshirë edhe një diplomë në teologji. Ishte mjaft krenar për njohuritë e tij të veçanta biblike. Për ne ishte e dukshme që ai ishte një studiues feje.

Ai ishte mjaft i informuar rreth misionarëve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, gjatë kohës që ata vazhdonin punën e tyre misionare në qytetin e tij të lindjes në Limë të Perusë. Ai gjithmonë kishte dashur t’i takonte ata që të mund t’u jepte leksione rreth Biblës.

Thuajse si një dhuratë nga qielli, kështu mendoi ai, një ditë dy misionarë e ndaluan atë në rrugë dhe e pyetën a mund të shkonin në shtëpinë e tij dhe të flisnin rreth shkrimeve të shenjta



me të. Ëndrra e tij u realizua! Lutjet e tij kishin marrë përgjigje. Më në fund, ai mund t'i sillte në rrugë të drejtë këta djelmoha që ishin në rrugë të gabuar. U tha atyre se do të kënaqej po t'i vinin në shtëpinë e tij dhe të diskutonin për shkrimet e shenjta.

Mezi e priti takimin. Ai ishte i gatshëm të përdorte Biblën për t'i përgënjeshtuar bindjet e tyre. Ai ishte i bindur se Bibla do t'i nxirrte sheshit dhe qartazi gabimet gjatë mësimdhënies së tyre. Takimi i asaj mbrëmjeje erdhi dhe misionarët i trokitën në derë. Mezi po përmbahej. Më në fund i kish- te ardhur dita.

Ai e hapi derën dhe i ftoi misio- narët në shtëpi. Një nga misionarët i dorëzoi një libër blu dhe shprehu një dëshmi të sinqertë se ai e dinte që libri përmbante fjalën e Perëndisë. Misionari i dytë shtoi dëshminë e tij të fuqishme për librin, duke dëshmuar se ai ishte përkthyer nga një profet bashkëkohor i Perëndisë, i cili quhej Jozef Smith dhe se libri të mësonte rreth Krishtit. Misio- narët morën leje për t'u ngritur dhe u larguan nga shtëpia.

Zoti Gonzales u zhgënjeje jashtë mase. Por ai e hapi librin dhe filloi t'i shfletonte faqet. Lexoi faqen e parë. Lexoi faqe për faqe dhe nuk ndaloi deri pasditen e vonë të së nesërme. E lexoi të gjithë librin dhe e dinte se ishte i vërtetë. Ai e dinte se ç'duhej të bënte. U telefonoi misionarëve, mori mësimet dhe hoqi dorë nga jeta që njihete, për t'u bërë një anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Ai njeri i mirë ishte mësuesi im në QTM të Provos në Juta. Historia e kthimit në besim të vëllait Gonzales dhe fuqia e Librit të Mormonit më lanë shumë mbresa.

Kur mbërrita në Kili, presidenti im i misionit, Presidenti Rojden J. Glejld, na ftoi që ta lexonim çdo javë dëshminë e Profetit Jozef Smith të shënuar te Joseph Smith – Historia. Ai na mësoi se një dëshmi për Vegimin e Parë do të kishte një lidhje të drejtpërdrejtë me vetë dëshminë tonë për ungjillin dhe dëshminë tonë për Librin e Mormonit.

E mora seriozisht ftesën e tij. I kam lexuar rrëfimet për Vegimin e Parë; e



kam lexuar Librin e Mormonit.

Jam lutur siç na udhëzon Moroni dhe e kam pyetur “Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit”⁶ a është i vërtetë Libri i Mormonit. Jap dëshmi sot se e di që Libri i Mormo- nit, siç tha Profeti Jozef Smith, është “më i sakti nga ndonjë libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë, dhe se një njeri do t'i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër”⁷. Profeti Jozef shpalli gjithashtu: “Hiqni Librin e Mormonit e zbulesat dhe ku është besimi ynë? Ne nuk kemi asgjë.”⁸

Kthimi Vetjak në Besim

Kur e kuptojmë më mirë se kush jemi dhe qëllimet e Librit të Mormonit, kthimi ynë në besim thellohet dhe bëhet më i sigurt. Ne forcohemi në zotimin tonë për t'i mbajtur besëlidhjet që kemi bërë me Perëndinë.

Një qëllim themelor i Librit të Mormonit është që të mbledhë Izraelin e shpërndarë. Kjo mbledhje u jep të gjithë fëmijëve të Perëndisë mundësinë për të hyrë në shtegun e besëlidhjes dhe, duke i respektuar ato besëlidhje, të kthehemi sërish në praninë e Atit. Teksa japim mësim për pendimin dhe i pagëzojmë të kthyerit në besim, ne e mbledhim Izraelin e shpërndarë.

Në Librin e Mormonit shtëpia e Izraelit përmendet 108 herë. Në fillim të Librit të Mormonit, Nefi dha mësim: “Sepse i gjithë qëllimi im është që të mund të bind njerëzit, që të vijnë te Perëndia i Abrahamit, dhe te Perëndia i Isakut, dhe te Perëndia i Jakobit, dhe të shpëtohen”⁹. Perëndia i Abrahamit, Isakut dhe Jakobit është Jezu Krishti, Perëndia i Dhiatës së Vjetër. Ne shpëto- hemi kur vijmë te Krishti nëpërmjet të jetuarit e ungjillit të Tij.

Më pas, Nefi shkroi:

“Po, madje ati im foli shumë në lidhje me Johebrenjtë dhe gjithashtu në lidhje me shtëpinë e Izraelit dhe se ata duhet të krahasoheshin me një pemë ulliri, degët e së cilës do të thyheshin dhe do të përhapeshin në të gjithë faqen e dheut. . . .

Dhe pasi shtëpia e Izraelit të shpër- ndahet, ata duhet të mblidhen tok përsëri; ose në fund, pasi Johebrenjtë të kenë pranuar plotësinë e Ungjillit, degët natyrale të pemës së ullirit ose të mbeturit e shtëpisë së Izraelit, duhet të shartohen në të, ose të vijnë në njohuri- në e Mesias së vërtetë, Zotit të tyre dhe Shëlbuesit të tyre.”¹⁰

Në mënyrë të ngjashme, në fund të Librit të Mormonit, profeti Moroni na kujton për besëlidhjet tona duke thënë: “Që të mos hutohesh më, që



besëlidhjet e Atit të Amshuar që bëri me ty, O shtëpi e Izraelit, të mund të plotësohen”¹¹.

Besëlidhjet e Atit të Amshuar

Çfarë “besëlidhje[sh të] Atit të Amshuar” përmendi Moroni? Ne lexojmë të libri i Abrahamit:

“Unë quhem Jehova dhe e njoh mbarimin që nga fillimi; si rrjedhim dora ime do të jetë mbi ty.

Dhe unë do të bëj prej teje një komb të madhërishtëm dhe do të të bekoj jashtë mase, dhe do ta bëj emrin tënd të madh mes gjithë kombeve, dhe ti do të jesh një bekim për farën tënde pas teje, që në duart e tyre ata do ta mbajnë këtë shërbesë dhe Priftëri për të gjitha kombet.”¹²

Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim në një transmetim mbarëbotëror kohët e fundit se, “këto me siguri janë ditët e mëvonshme dhe Zoti po e përshpejton punën e Tij që Izraeli të mblihdet. Ajo mbledhje është gjëja më e rëndësishme që po ndodh në tokë sot. Asgjë tjetër nuk krahasohet për nga

madhësia, asgjë tjetër nuk krahasohet për nga rëndësia, asgjë tjetër nuk krahasohet për nga madhështia. Dhe nëse e zgjidhni, nëse e dëshironi, ju mund të jeni një pjesë e madhe e saj. Mund të jeni një pjesë e madhe e diçkaje të madhe, diçkaje të madhërishtë, diçkaje madhështore!

Kur flasim për *mbledhjen*, po themi thjesht këtë të vërtetë themelore: çdo-njëri nga fëmijët e Atit tonë Qiellor, në të dyja anët e velit e meriton ta dëgjojë mesazhin e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Ata e vendosin vetë a dëshirojnë të dinë më shumë.”¹³

Kjo është ajo që po bëjmë si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme: po përpiqemi t’i sjellim botës një kuptueshmëri për ungjillin e Jezu Krishtit dhe kthim në besim tek ai. Ne jemi “mbledhësit e ditëve të mëvonshme”¹⁴. Misioni ynë është i qartë. Vëllezër dhe motra, le të na njohin si ata që e kanë marrë seriozisht premtimin e Moronit, si ata që janë lutur dhe kanë marrë përgjigje për të ditur se Libri i Mormonit është

i vërtetë dhe më pas e kanë shprehur me fjalë atë njohuri me të tjerët dhe më e rëndësishmja, me vepra.

Roli i Libri të Mormonit në Kthimin në Besim

Libri i Mormonit përmban plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit¹⁵. Ai na udhëheq drejt besëlidhjeve të Atit, të cilat nëse i mbajmë, do të na sigurojë dhuratën e Tij më të madhe – jetën e përjetshme¹⁶. Libri i Mormonit është gurthemeli i kthimit në besim të të gjithë bijve dhe bijave të Atit Qiellor.

Duke e cituar sërish Presidentin Nelson: “Teksa . . . [e] lexoni përditë Librin e Mormonit, do të mësoni doktrinën e mbledhjes, të vërteta rreth Jezu Krishtit, Shlyerjes së Tij dhe plotësinë e ungjillit të Tij që nuk gjendet në Bibël. Libri i Mormonit është qendror për mbledhjen e Izraelit. Në fakt, nëse nuk do të kishte Libër të Mormonit, mbledhja e premtuar e Izraelit nuk do të ndodhte.”¹⁷

Më lejoni ta mbyll me fjalët e Shpëtimtarit teksa u mësonte nefitëve

për bekimet e premtuara: “Jeni fëmijët e profetëve; dhe jeni nga shtëpia e Izraelit dhe jeni nga besëlidhja që Ati bëri me etërit tuaj, duke i thënë Abrahamit: Dhe në farën tënde do të bekohen të gjitha fiset e tokës”¹⁸.

Unë dëshmoj se jemi bij dhe bija të Perëndisë, fara e Abrahamit, shtëpia e Izraelit. Ne po e mbledhim Izraelin për herë të fundit dhe po e bëjmë këtë me Librin e Mormonit – një libër që, i ndërthurur me Shpirtin e Zotit, është mjeti më i fuqishëm për kthimin në besim. Ne udhëhiqemi nga profeti i Perëndisë, Presidenti Rasëll M Nelson, i cili po e drejton mbledhjen e Izraelit në kohën tonë. Libri i Mormonit është i vërtetë. Ai më ka ndryshuar jetën. Unë ju premtoj, siç ka bërë Moroni dhe shumë profetë përmes epokave, që ai mund ta ndryshojë jetën tuaj.¹⁹ Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Ezra Taft Benson* (2014), f. 137.
2. “Cili Është Roli i Librit të Mormonit?” *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar*, f. 113, (2006), lds.org/manual/missionary.
3. Moroni 10:4.
4. Moroni 10:4.
5. Parathënia e Librit të Mormonit.
6. Moroni 10:4.
7. Parathënia e Librit të Mormonit.
8. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 205.
9. 1 Nefi 6:4.
10. 1 Nefi 10:12, 14.
11. Moroni 10:31.
12. Abraham 2:8–9.
13. Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit”, (takim shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë, 3 qershor 2018), f. 4, HopeofIsrael.lds.org.
14. Shih Jakobi [LiM] 5:72.
15. Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim: “Zoti Vetë ka thënë se Libri i Mormonit përmban ‘plotësinë e] ungjillit të Jezu Krishtit’ (DeB 20:9). Kjo nuk do të thotë se ai përmban çdo mësim, çdo doktrinë të zbuluar ndonjëherë. Në të kundërt, do të thotë se në Librin e Mormonit ne vërtet do të gjejmë plotësinë e atyre doktrinave që kërkohen për shpëtimin tonë. Dhe ato na mësohen thjesht dhe qartë, me qëllim që edhe fëmijët të mund t’i mësojnë udhët e shpëtimit dhe të ekzaltimit” (*Mësime: Ezra Taft Benson*, f. 138).
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 14:7.
17. Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit”, f. 7.
18. 3 Nefi 20:25.
19. Shih, për shembull, Henry B. Eyring, “The Book of Mormon Will Change Your Life”, *Liahona*, shkurt 2004, f. 12–16.



Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Plagosur

Në grumbullin e sprovave tokësore me durim shkoni përpara dhe fuqia shëruese e Shpëtimtarit do t’ju sjellë dritë, kuptueshmëri, paqe dhe shpresë.

Më 22 mars 2016, pikërisht përpara orës 8:00 të mëngjesit, shpërthyen 2 bomba të vëna nga terroristët në aeroportin e Brukselit. Plaku Riçard Norbi, Plaku Mejzon Uells dhe Plaku Xhozef Empi kishin çuar Motrën Feni Klein në aeroport për të fluturuar drejt misionit të saj në Klivlend të Ohajos. Tridhjetë e dy njerëz humbën jetën dhe të gjithë misionarët u plagosën.

Ai që u plagos më rëndë qe Plaku Riçard Norbi, 66 vjeç, i cili po shërben-te me bashkëshorten e tij, Motrën Pem Norbi.

Plaku Riçard Norbi reflektoi për atë çast:



Riçard Norbi duke marrë veten në spital.

“Sakaq e dija se çfarë kishte ndodhur.

U përpoqa të vrapoja për të gjetur siguri, por u rrëzova menjëherë . . . Munda ta shihja që këmba e majtë qe dëmtuar keq. [Vura re] se nga të dy duart po më varej një blozë e zezë si rrjetë merimange. E tërhoqa me butësi, por e kuptova se nuk qe blozë, por lëkura ime që ishte djegur. Këmisha ime e bardhë po bëhej e kuqe nga një plagosje në shpinë.

Teksa u bëra i vetëdijshëm për atë që kishte ndodhur, [pata] këtë mendim shumë të fortë . . . Shpëtimtari e dinte ku isha, atë që sapo kishte ngjarë dhe [atë] që po përjetoja në atë çast.”¹

Riçard Norbin dhe bashkëshorten e tij, Pemin, i prisnin ditë të vështira. Ai u vendos në koma artificiale, që u pasua nga operacione, infeksione dhe pasiguri e madhe.

Riçard Norbi jetoi, por jeta e tij nuk do të ishte më kurrë njësoj. Dy vjet e gjysmë më vonë, plagët nuk i janë shëruar ende; një protezë i zëvendëson pjesën që i mungon në këmbë; çdo hap është i ndryshëm nga koha përpara atij çasti në aeroportin e Brukselit.

Pse t’i ndodhte kjo Riçard dhe Pem Norbit?² Ata kishin qenë të vërtetë ndaj besëlidhjeve të tyre, kishin shërbyer në



Riçard dhe Pem Norbi.

një mision përpara këtij në Bregun e Fildishtë dhe kishin rritur një familje të mrekullueshme. Dikush në mënyrë të kuptueshme mund të thoshte: “Ata nuk e meritoni! Thjesht nuk është e drejtë! Ata po jepnin jetën për ungjillin e Jezu Krishtit; si mund të ndodhë kjo?”

Kjo Është Vdekshmëria

Ndonëse hollësitë do të ndryshojnë, tragjeditë, provat dhe sprovat e papritura, si fizike ashtu edhe shpirtërore, i vijnë secilit prej nesh sepse kjo është vdekshmëria.

Ndërsa mendoja këtë mëngjes për folësit e pikërisht këtij sesioni të konferencës, më erdhi ndër mend se dy prej tyre kanë humbur fëmijë dhe tre prej tyre kanë humbur nipër ose mbesa të cilët u kthyen papritmas në shtëpinë e tyre qiellore. Askush nuk është përjashtuar nga sëmundja dhe trishtimi dhe pikërisht ashtu siç është folur këtë javë, një engjell i tokës të cilën e duam të gjithë, Motra Barbara Ballard, kaloi butësisht përtej velit. Presidenti Ballard, ne nuk do ta harrojmë kurrë dëshminë tënde këtë mëngjes.

Ne kërkojmë lumturinë. Jemi të dëshiruar për paqe. Shpresojmë për dashuri. Dhe Zoti na derdh një bollëk të mahnitshëm bekimesh. Por, pleksur me gëzimin dhe lumturinë, një gjë është e sigurt: do të ketë çaste, orë, ditë, nganjëherë vite kur shpirti ynë do të jetë i plagosur.

Shkrimet e shenjta na mësojnë se do të shijojmë hidhërimin dhe ëmbëlsinë³ dhe se do të ketë një “kundërshtim në të gjitha gjërat”⁴. Jezusi tha: “[Ati juaj] bën të lindë diellin e tij mbi të mirët

dhe mbi të këqijtë, dhe bën të bjerë shi mbi të drejtët dhe të padrejtët”⁵.

Plagët e shpirtit nuk janë të pashembullta për të pasurit apo të varfrit, për një kulturë, një komb ose një brez. Ato u vijnë të gjithëve dhe janë pjesë e mësimi që marrim nga kjo përvojë në vdekshmëri.

Të Drejtët Nuk Janë të Paprekshëm

Mesazhi im sot është veçanërisht për ata që po i zbatojnë urdhërimet e Perëndisë, që po i mbajnë premtimet ndaj Perëndisë dhe, si çifti Norbi dhe burra, gra e fëmijë të tjerë në këtë masë mbarëbotërore shikuesish, ballafaqohen me sprovat e sfida që janë të papritura e të dhembshme.

Plagët tona mund të vijnë nga një katastrofë natyrore ose një aksident fatkeq. Mund të vijnë nga një bashkëshort ose bashkëshorte i/e pabesë, që ia kthen jetën përmbys një bashkëshorti ose bashkëshorteje të drejtë dhe fëmijëve. Plagët mund të vijnë nga errësira dhe zymtia e depresionit, nga një sëmundje e papritur, nga vuajtja ose vdekja e parakohshme e dikujt që duam, nga trishtimi kur një pjesëtar i familjes e braktis besimin e vet, nga vetmia kur rrethanat nuk sjellin një shok jete të përjetshëm ose njëqind “[hidhërimet e tjera] që s’[i] sheh syri”⁶ që ta copëtojnë zemrën e shkaktojnë dhembje.

Secili prej nesh e kupton se vështrësitetë janë pjesë e jetës, por kur na vijnë vetë neve, ato mund të na lënë pa frymë. Pa u alarmuar, nevojitet që të

jemi gati. Apostulli Pjetër tha: “Mos ju duket çudi për provën e zjarrit që u bë ndër ju për t’ju provuar, se si ju ndodhi diçka e jashtëzakonshme”⁷. Së bashku me ngjyrat e çelura të lumturisë dhe gëzimit, në pëlhurën e planit të Atit tonë thuren thellë fije të errëta sprovash e tragjeditsh. Këto mundime, ndonëse të vështira, shpesh bëhen mësueset tona më të mëdha.⁸

Kur e tregojmë historinë çudi-bërëse të 2060 ushtarëve të rinj të Helamanit, neve na pëlqen shumë ky shkrim i shenjtë: “Sipas mirësisë së Perëndisë dhe për çudinë tonë të madhe dhe gëzimin e gjithë ushtrisë sonë, nuk pati asnjë shpirt prej tyre që të mbaronte”.

Por fjalja vazhdon: “Nuk pati asnjë shpirt mes tyre që të mos kishte marrë shumë plagë”⁹. Secili prej të 2060-ve mori plagë të shumta dhe çdonjëri prej nesh do të plagoset në betejën e jetës, qoftë fizikisht, shpirtërisht ose që të dyja.

Jezu Krishti është Samaritani Ynë i Mirë

Kurrë mos u dorëzoni – sado të thella qofshin plagët e shpirtit tuaj, cilido qoftë shkaku i tyre, kudo ose kurdo që të ndodhin dhe sado pak ose gjatë që të ngulmojnë, nuk është e thënë që ju të mbaroni shpirtërisht. Është e thënë që ju të mbijetoni shpirtërisht dhe të lulëzoni në besimin dhe mirëbesimin tuaj ndaj Perëndisë.

Perëndia nuk e krijoi shpirtin tonë që ne të ishim të pavarur prej Tij. Zoti dhe Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti,



nëpërmjet dhuratës së pamatshme të Shlyerjes së Tij, jo vetëm që na shpëton nga vdekja dhe na ofron falje për mëkatet tona nëpërmjet pendimit, por Ai gjithashtu rri gati për të na shpëtuar nga pikëllimet dhe dhembjet e shpirtave tanë të plagosur.¹⁰

Shpëtimtari është Samaritani ynë i Mirë¹¹, i dërguar për të “shëruar ata që e kanë zemrën të thyer”¹². Ai vjen te ne kur të tjerët na anashkalojnë. Me dhembshuri, na vë balsamin e Tij shërues mbi plagët dhe na i lidh ato. Ai na mban në krahë. Ai kujdeset për ne. Ai na grish: “[Ejani] tek unë . . . dhe unë do t’ju shëroj”¹³.

“Dhe [Jezusi] do të . . . vuaj[ë] dhimbje dhe hidhërimi dhe tundime të çdo lloji; që . . . të [mund të] marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij . . . [duke marrë përsipër] dobësitë [tona], [duke pasur] mëshirë”¹⁴.

Ejani, ju të pangushëlluar, kudo që lëngoni;

Ejani te fronti i mëshirës, me zjarr gjunjëzohuni.

Sillini këtu zemrat e plagosura; ankthin tuaj tregoni.

*Toka nuk ka asnjë dhembje që falë qiellit s’mund ta shëroni.*¹⁵

Në një kohë vuajtjeje të pamasë, Zoti i tha Profetit Jozef Smith: “Gjithë këto gjëra do të të japin përvojë dhe do të jenë për të mirën tënde”¹⁶. Si mund të jenë plagët e dhembshme për të mirën tonë? Në grumbullin e sprovave tokësore me durim shkoni përpara dhe fuqia shëruese e Shpëtimtarit do t’ju sjellë dritë, kuptueshmëri, paqe dhe shpresë.¹⁷

Kurrë Mos u Dorëzoni

Lutuni me gjithë zemër. Forcojeni besimin tuaj te Jezu Krishti, te qenia reale e Tij, te hiri i Tij. Kapuni pas fjalëve të Tij: “Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi”¹⁸.

Mbajeni mend, pendimi është ilaç i fuqishëm shpirtëror.¹⁹ Zbatojni urdhërimet dhe jini të denjë për Ngushëlluesin, duke kujtuar se Shpëtimtari premtoi: “Nuk do t’ju lë bonjakë, do të kthehem te ju”²⁰.


Paqja e tempullit është balsam qetësues për shpirtin e plagosur. Kthehuni në shtëpinë e Zotit me zemrën tuaj të plagosur dhe emrat e familjarëve tuaj sa më shpesh të jetë e mundur. Tempulli e projekton çastin tonë të shkurtër në vdekshmëri në ekranin e gjerë të përjetësisë.²¹

Vështroni prapa, duke kujtuar se e vërtetuar denjësinë tuaj në gjendjen para lindjes. Ju jeni fëmijë trima të Perëndisë dhe me ndihmën e Tij, mund të ngadhënjoni në betejat e kësaj bote të rënë. E keni bërë më parë dhe mund ta bëni përsëri.

Vështroni para. Telashet dhe pikëllimet tuaja janë shumë reale, por nuk do të zgjatin përgjithmonë.²² Nata juaj e errët do të kalojë, sepse “Biri . . . do të ngrihet me shërim në krahët e tij”²³.

Çifti Norbi më tha: “Zhgënjimi na vjen për vizitë me raste, por e ka gjithnjë të ndaluar të rrijë këtu”²⁴. Apostulli Pal tha: “Ne jemi të shtrënguar . . . por nuk jemi të ngushtuar deri në fund; jemi ndërdyshas por jo të dëshpëruar. Jemi të përndjekur por jo të braktisur; të rrëzuar, por jo të shkatërr[uar].”²⁵ Mund të jeni të rraskapitur, por kurrë mos u dorëzoni.²⁶

Madje edhe me plagët tuaja të dhembshme, ju instinktivisht do t’u shkoni në ndihmë të tjerëve, duke i mirëbesuar premtimit të Shpëtimtarit: “Ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë atë”²⁷. Të plagosurit që kujdesen për plagët e të tjerëve janë engjëjt e Perëndisë në tokë.



Në konferencën e përgjithshme të prillit 1995, duke folur për humbjen kohët e fundit të së bijës, Emilisë, Presidenti Rasëll M. Nelson dëshmoi se Jezu Krishti mban çelësat e Ringjalljes.

Pas pak çastesh, do të dëgjojmë profetin tonë të dashur, Presidentin Rasëll M. Nelson, një burrë me besim të patrembur te Jezu Krishti, një burrë me shpresë e paqe, i dashur për Perëndinë por i papërrjashtuar nga plagët e shpirtit.

Në vitin 1995, bija e tij, Emilia, ndërkohë që priste një fëmijë, u diagnostikua me kancer. Pati ditë shprese dhe lumturie kur u lind foshnja e saj e shëndetshme. Por kanceri u rikthye dhe Emilia e tyre e dashur do të largohej nga kjo jetë vetëm dy javë pas ditëlindjes së saj të 37-të, duke lënë pas bashkëshortin e saj të dashur dhe pesë fëmijë të vegjël.

Në konferencën e përgjithshme, pak kohë pas vdekjes së saj, Plaku Nelson rrëfeu: “Lotët e mi të pikëllimit kanë rrjedhur bashkë me dëshirën që të kisha mundur të bëja më tepër për bijën



“Duke i mbajtur urdhërimet e Perëndisë”, u tha Presidenti Nelson shenjtoreve në Porto-Riko, “ne mund të gjejmë gëzim edhe mes rrethanave tona më të këqija”.



tonë. . . . Po të kisha fuqinë e ringjalljes, do të isha tunduar që ta riktheja [atë] në jetë. . . . [Por] Jezu Krishti i mban ato çelësa dhe do t'i përdorë ato për Emilinë . . . dhe për të gjithë njerëzit në kohën e vetë Zotit.”²⁸

Muajin e kaluar, ndërkohë që po vizitonte shenjtoret në Puerto-Riko dhe po kujtonte uraganin shkatërrimtar të një viti më parë, Presidenti Nelson foli me dashuri e dhembshuri:

“ [Kjo] është pjesë e jetës. Është arsyeja pse jemi këtu. Jemi këtu për të pasur një trup dhe për t'u provuar e për t'u vënë në provë. Disa nga ato prova janë fizike; disa janë shpirtërore dhe sprovat tuaja këtu kanë qenë si fizike, ashtu edhe shpirtërore.”²⁹

“Ju nuk jeni dorëzuar. Sa mirënjohës jemi për ju! Ju, shenjtore besnikë, keni humbur shumë, por gjatë gjithë kësaj, e keni mbajtur gjallë besimin tuaj te Zoti Jezu Krisht.”³⁰

“Duke i zbatuar urdhërimet e Perëndisë, ne mund të gjejmë gëzim madje në mes të rrethanave tona më të rënda.”³¹

Do të Na Fshihen të Gjithë Lotët

Vëllezërit e motrat e mia, është premtimi im për ju se rritja e besimit tuaj te Zoti Jezu Krisht do t'ju sjellë forcë të shtuar dhe shpresë më të madhe. Juve, të drejtëve, Shëruesi i shpirtave tanë, në kohën e Tij dhe sipas mënyrës së Tij, do t'ju shërojë të gjitha plagët.³² Asnjë padrejtësi, asnjë përndjekje, asnjë

sprovë, asnjë trishtim, asnjë brengë, asnjë vuajtje, asnjë plagë – sado e thellë, sado e gjerë, sado e dhembshme – nuk do të përjashtohet nga ngushëllimi, paqja dhe shpresa e përhershme e Atij, krahët e hapur dhe duart e plagosura të së Cilit do të na mirëpresin përsëri në praninë e Tij. Atë ditë, dëshmon Apostulli Gjon, të drejtët “që [vijjnë] nga shtrengimi i madh”³³, do të qëndrojnë të “veshur me rroba të bardha . . . përpara fronit të Perëndisë”. Qengji “do të banojë . . . mes [nesh] . . . dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë [tuaj]”³⁴. Kjo ditë do të vijë. Unë dëshmoj kështu, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Bashkëbisedim vetjak, 26 janar 2018.
2. Në një bashkëbisedim më herët gjatë këtij viti, Riçard Norbi më tha: “Ne i përgjigjemi asaj që na është dhënë”. Nga ditari i tij, ai tregoi: “Provot dhe sprovat që i vijnë secilit prej nesh, na japin mundësinë dhe privilegjin për ta njohur më mirë Shpëtimtarin dhe për ta kuptuar me më shumë hollësi sakrificën e tij shlyese. Tek Ai mbështetemi. Atë kërkojmë. Nga Ai varemi. Tek Ai e kemi sigurinë. Atë e duam me gjithë zemër, pa asnjë rezervë. Shpëtimtari i ka përfshirë të gjitha dhembjet fizike dhe emocionale që janë pjesë e vdekshmërisë. Ai na e heq dhembjen. Ai i merr vetë hidhërimet tona.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 29:39.
4. 2 Nefi 2:11.
5. Mateu 5:45.
6. “Zot, Un' Ty do të t'Ndjek”, *Himne*, nr. 137.
7. 1 Pjetër 4:12.
8. “Dhe ne do t'i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t'i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t'i urdhërojë” (Abraham 3:25; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 101:4–5).

9. Alma 57:25.
10. Një mik më shkroi: “Një betejë thuajse pesëvjeçare me ‘errësirë dhe zymti’ emocionale në shkallë të ndryshme të çon deri në skajin e aftësive, vendosmërisë, besimit dhe durimit tënd. Pas ditësh të tëra ‘vuajtjesh’, lodhesh. Pas javësh të tëra ‘vuajtjesh’, rraskapitesh. Pas muajsh të tërë ‘vuajtjesh’, fillon të bëhesh i pafuqishëm. Pas vitesh të tëra ‘vuajtjesh’, i dorëzohesh mundësisë që nuk do të përmirësohesh më kurrë. Shpresa bëhet më e çmueshmja dhe më bishtnuesja e dhuratave. Shkurtime, nuk jam i sigurt a e di si dola nga kjo sprovë, përveç se ishte prej [Shpëtimtarit]. Ky është i vetmi shpjegim. Nuk mund ta shpjegoj nga e di këtë, por ja që e di. Për shkak të Tij, unë dola nga kjo.
11. Shih Lluca 10:30–35.
12. Lluca 4:18; shih edhe Isaia 61:1.
13. 3 Nefi 18:32.
14. Alma 7:11–12. “Ai zbriti nën gjithçka, në atë që ai i kupton të gjitha gjërat” (Doktrina e Besëlidhje 88:6).
15. “Come, Ye Disconsolate”, *Hymns*, nr. 115.
16. Doktrina e Besëlidhje 122:7.
17. “Ti e di madhësinë e Perëndisë; dhe ai do t'i shenjtërojë hidhërimet e tua për të mirë” (2 Nefi 2:2). “Unë e di se kushdo që vë besimin e tij në Perëndi, do të përkrahet në sprovat e tij dhe në vështirësitë e tij dhe në mjerimet e tij dhe do të ngrihet në ditën e fundit” (Alma 36:3).
18. 2 Korintasve 12:9.
19. See Neil L. Andersen, “The Joy of Becoming Clean”, *Ensign*, Apr. 1995, f. 50–53.
20. Gjoni 14:18.
21. “Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve” (1 Korintasve 15:19).
22. Në vargun e parë të Librit të Mormonit, Nefi shpjegon se kishte “parë shumë vuajtje gjatë ditëve të [tij]” (1 Nefi 1:1). Më vonë, Nefi tha: “Megjithatë unë pashë të Perëndia im dhe e lavdërova atë gjatë gjithë ditës; dhe unë nuk mërmërita kundër Zotit për shkak të vuajtjeve të mia” (1 Nefi 18:16).
23. 3 Nefi 25:2.
24. Bashkëbisedim vetjak, 26 janar 2018.
25. 2 Korintasve 4:8–9.
26. Presidentin Hju B. Brown, ndërkohë që po vizitonte Izraelin, e pyetën pse u urdhërua Abrahami që ta sakrifikoje të birin. Ai u përgjigj: “Abrahami kishte nevojë të mësonte diçka rreth Abrahamit” (në Truman G. Madsen, *Joseph Smith the Prophet* [1989], f. 93).
27. Mateu 16:25.
28. Russell M. Nelson, “Children of the Covenant”, *Ensign*, may 1995, f. 32.
29. Russell M. Nelson, në Jason Swensen, “Better Days Are Ahead for the People of Puerto Rico”, *Church News*, 9 shtator 2018, f. 4.
30. Rasëll M. Nelson, në Swensen, “Better Days Are Ahead”, f. 3.
31. Rasëll M. Nelson, në Swensen, “Better Days Are Ahead”, f. 4.
32. Shih Rasëll M. Nelson, “Jezu Krishti – Mësuesi Shërues,” *Konferenca e Përgjithshme*, tetor 2005, f. 115.
33. Zbulesa 7:14.
34. Shih Zbulesa 7:13, 15, 17.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Emri i Saktë i Kishës

Jezu Krishti na drejtoi ta quajmë Kishën me emrin e Tij, sepse është Kisha e Tij, e mbushur me fuqinë e Tij.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, në këtë ditë të bukur Shabati, ne gëzohemi së bashku për bekimet tona të shumta nga Zoti. Jemi shumë mirënjohës për dëshmitë tuaja për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit, për sakrificat që ju keni bërë për të qëndruar në shtegun e besëlidhjeve të Tij apo për t'u kthyer në të, si dhe për shërbimin tuaj të përkushtuar në Kishën e Tij.

Sot ndihem i detyruar të diskutoj me ju një çështje me rëndësi të madhe. Disa javë më parë, unë nxora një deklaratë lidhur me një korrigjim në përdorimin e emrit të Kishës.¹ E bëra këtë pasi Zoti ka ngulitur në mendjen time rëndësinë e emrit që Ai e dekretoi për Kishën e Tij, madje Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.²

Siç do ta prisnit, reagimet ndaj kësaj deklaratë dhe ndaj udhëzuesit të rishikuar për stilin³ kanë qenë të përziera. Shumë anëtarë menjëherë e korrigjuan emrin e Kishës në ditarët e tyre në internet dhe në faqet e mediave shoqërore. Të tjerët vranë mendjen për arsyen përse, me gjithçka që po ndodh në botë, është e domosdoshme ta theksojmë diçka kaq “të parëndësishme”. Dhe disa thanë se nuk mund të bëhej, kështu që përse madje të përpiqemi?

Më lejoni të shpjegoj se përse ne tregojmë kaq shumë kujdes për këtë çështje. Por së pari më lejoni të shpreh se çfarë nuk është kjo përpjekje:

- Nuk është një ndryshim i emrit.
- Nuk është një riemërtim.
- Nuk është për zbukurim.
- Nuk është një tekë.
- Dhe nuk është e parëndësishme.

Përkundrazi, është një korrigjim. Është urdhri i Zotit. Jozef Smithi nuk ia vuri vetë emrin Kishës së rivendosur;

as Mormoni nuk e bëri këtë. Ishte Vetë Shpëtimtari që tha: “Sepse kështu do të quhet kisha ime në ditët e fundit, madje Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme”⁴.

Edhe më herët, në vitin 34 ps.K., Zoti ynë i ringjallur u dha udhëzim të ngjashëm anëtarëve të Kishës së Tij kur i vizitoi ata në kontinentin amerikan. Në atë kohë, Ai tha:

“Ju do ta quani kishën në emrin tim. . . .

Dhe si do të ishte kisha ime nëse nuk do të quhej me emrin tim? Pasi, në qoftë se një kishë quhet me emrin e Moisiut, atëherë do të jetë kisha e Moisiut; ose në qoftë se quhet me emrin e një njeriu, atëherë do të jetë kisha e një njeriu; por në qoftë se quhet me emrin tim, atëherë është kisha ime.”⁵

Si rrjedhojë, emri i Kishës nuk është i diskutueshëm. Kur Shpëtimtari e shpall qartë se cili duhet të jetë emri i Kishës së Tij dhe madje kur i paraprin deklaratës së Tij me fjalët: “Kështu do të quhet kisha ime”, Ai e ka seriozisht. Dhe nëse ne lejojmë që nofkat të përdoren, ose i pranojmë, ose madje i nxitim vetë ato nofka, Ai fyhet.

Çfarë vlere ka te një emër apo, në këtë rast, një nofkë? Për sa u përket nofkave të Kishës, të tilla si “Kisha SHDM”, “Kisha Mormone”, apo “Kisha e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme”, gjëja më e rëndësishme në ata emra është *mungesa* e emrit të Shpëtimtarit.





Ta heqësh emrin e Zotit nga Kisha e Zotit, është një fitore madhore për Satanin. Kur ne e *heqim* emrin e Shpëtimtarit, ne po *shpërfillim* fshehtas gjithçka që Jezu Krishti bëri për ne – madje dhe Shlyerjen e Tij.

Merreni parasysh këtë nga këndvështrimi i Tij: Para vdekshmërisë, Ai ishte Jehova, Perëndia i Dhiatës së Vjetër. Nën drejtimin e Atit të Tij, Ai ishte Krijuesi i kësaj bote dhe i botëve të tjera.⁶ Ai zgjodhi t'i nënshtrohej vullnetit të Atit të Tij dhe të bënte diçka për të gjithë fëmijët e Perëndisë që askush tjetër nuk mund ta bënte! Pasi denjoi të vinte në tokë si Biri i Vetëmlindur i Atit në mish, Atë e fyen vrazhdë, e tallën, e pështynë dhe e fshikulluan. Në Kopshtin e Gjetsemanit, Shpëtimtari ynë mori mbi Vete *çdo* dhembje, *çdo* mëkat dhe *të gjithë* ankthin dhe vuajtjen që u përjetua *ndonjëherë* nga ju dhe unë, si dhe nga cilido që ka jetuar ndonjëherë apo do të jetojë ndonjëherë. Nën peshën e asaj barre torturuese, Atij i doli gjak nga çdo por.⁷ E gjitha kjo vuajtje u përforcua kur Atë e kryqëzuan mizorisht në kryqin e Kalvarit.

Me anë të këtyre përvojave torturuese dhe Ringjalljes së Tij pasuese – Shlyerjes së Tij të pafundme – Ai u dhuroi pavdekësi të gjithëve dhe e shëlboi secilin prej nesh nga pasojat e mëkatit, me kushtin e pendimit tonë.

Në vijim të Ringjalljes së Shpëtimtarit dhe vdekjes së Apostujve të Tij, bota u zhyt për shekuj në errësirë. Pastaj në vitin 1820, Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, iu shfaqën Profetit Jozef Smith për të filluar Rivendosjen e Kishës së Zotit.

Pas gjithçkaje që Ai kishte duruar – dhe pas gjithçkaje që Ai kishte bërë për njerëzimin – unë e kuptoj me keqardhje të thellë se ne padashur e kemi pranuar në heshtje në Kishën e rivendosur të Zotit, që të thirremi me emra të tjerë, ku secili prej tyre e heq emrin e shenjtë të Jezu Krishtit!

Çdo të diel, teksa e marrim denjësisht sakramentin, ne e bëjmë sërish premtimin tonë të shenjtë ndaj Atit tonë Qiellor se ne jemi të gatshëm ta marrim mbi vete emrin e Birit të Tij, Jezu Krishtit.⁸ Ne premtojmë ta ndjekim Atë, të pendohemi, t'i zbatojmë urdhërimet e Tij dhe *gjithmonë* ta kujtojmë Atë.

Kur e lëmë jashtë emrin e Tij nga Kisha e Tij, ne jemi duke e hequr paqëllimshëm *Atë* nga pozicioni si pika qendrore e jetës sonë.

Marrja mbi vete e emrit të Shpëtimtarit përfshin deklarinim dhe dëshmimin ndaj të tjerëve – me anë të veprimeve tona dhe fjalëve tona – se Jezusi është Krishti. A kemi pasur aq shumë frikë se mos e *fyejmë* dikë që na quajti “mormonë” sa që kemi dështuar

ta *mbrojmë* Vetë Shpëtimtarin, ta përkrahim Atë madje edhe në emrin me të cilin thirret Kisha e Tij?

Nëse ne si popull dhe si individë dëshirojmë të kemi të drejtë për ta përdorur fuqinë e Shlyerjes së Jezu Krishtit – që të na pastrojë e shërojë, të na forcojë e lartësojë dhe përfundimisht të na ekzaltojë – ne duhet ta pranojmë qartë Atë si burimin e asaj fuqie. Ne mund ta fillojmë duke e quajtur Kishën e Tij me emrin që Ai dekretoi.

Për shumicën e botës, Kisha e Zotit fshihet në kohën e tanishme pas emrit “Kisha Mormone”. Por ne, si anëtarë të Kishës të Zotit, e dimë se kush qëndron në krye të saj: Jezu Krishti Vetë. Fatkeqësisht, shumë njerëz që e dëgjojnë termin *mormon*, mund të mendojnë se ne adhurojmë Mormonin. Nuk është ashtu! Ne e nderojmë dhe e respektojmë atë profet të madhërisëm amerikan të lashtësisë.⁹ Por ne *nuk* jemi dishepuj të Mormonit. Ne jemi dishepuj të Zotit.

Në ditët e hershme të Kishës së rivendosur, terma të tillë si *Kisha Mormone* dhe *mormonët*¹⁰ shpesh u përdorën si epitete – si terma mizorë, terma fyes – të krijuar për ta zhdukur dorën e Perëndisë në rivendosjen e Kishës së Jezu Krishtit në këto ditë të mëvonshme.¹¹

Vëllezër dhe motra, ka shumë argumente nga bota kundër rivendosjes

së emrit të saktë të Kishës. Për shkak të botës dixhitale në të cilën jetojmë dhe me përmirësimin e motorëve të kërkimit që na ndihmon të gjithëve ta gjejmë informacionin që na nevojitet thujse në çast – përfshirë informacionin për Kishën e Zotit – kritikët thonë se në këtë pikë, një korrigjim nuk është gjë e mençur. Të tjerët mendojnë që, meqenëse njihemi kaq gjerësisht si “mormonë” dhe si “Kisha Mormone”, ne thjesht duhet të përshtatemi.

Nëse ky do të ishte një diskutim rreth emërimit të një organizate të bërë nga njeriu, ato argumente mund të ishin mbizotëruese. Por në këtë çështje kritike, ne i drejtohemi Atij, Kisha e të cilit është kjo, dhe e pranojmë se udhët e Zotit nuk janë dhe nuk do të jenë kurrë udhët e njeriut. Nëse do të jemi të duruar dhe nëse do ta bëjmë mirë pjesën tonë, Zoti do të na udhëheqë gjatë kësaj detyre të rëndësishme. Në fund të fundit, ne e dimë se Zoti i ndihmon ata që kërkojnë të bëjnë vullnetin e Tij, pikërisht ashtu siç Ai e ndihmoi Nefin që ta përmbushte detyrën për ndërtimin e një anijeje që ta kapërcente detin.¹²

Ne do të dëshirojmë të jemi të sjellshëm dhe të duruar në përpjekjet tona për t'i korrigjuar këto gabime. Mediat e përgjegjshme do të jenë mirëkuptuese për t'iu përgjigjur kërkesës sonë.

Në një konferencë të përgjithshme të mëparshme, Plaku Benjamin De Hojos foli për një ngjarje të tillë. Ai tha:

“Disa vite përpara, kur shërbeja në zyrën e çështjeve publike të Kishës në Meksikë, [një shok dhe unë] qemë ftuar të merrnim pjesë në një diskutim në radio. . . . [Një nga drejtuesit e programit na] pyeti: ‘Përse Kisha ka një emër kaq të gjatë? . . .’

Shoku im dhe unë buzëqeshëm me një pyetje të tillë të mrekullueshme dhe pastaj vazhduam të shpjegonim se emri i Kishës nuk ishte zgjedhur nga njeriu. Ai ishte dhënë nga Shpëtimtari. . . . Drejtuesi i programit menjëherë dhe me respekt u përgjigj: ‘Ne kështu do ta përsëritim atë me kënaqësi të madhe.’¹³

Ai raportim jep një model. Një nga një, do të kërkohen përpjekjet tona më të mira si individë për të korrigjuar gabimet që janë futur brenda nëpër vite.¹⁴ Pjesa tjetër e botës mund ta ndjekë ose jo udhëheqjen tonë që të na quajnë me emrin e saktë. Por nuk është e çiltër nga ana jonë që të mërzitemi nëse shumica e botës i quan Kishën dhe anëtarët e saj me emra të gabuar, nëse ne bëjmë të njëjtën gjë.

Udhëzuesi ynë i rishikuar për stilin është i dobishëm. Ai pohon: “Në referimin e parë, parapëlqehet emri i plotë i Kishës: ‘Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme’. Kur nevojitet një referim i shkurtuar [i dytë], inkurajohet të përdoren termat ‘Kisha’ ose ‘Kisha e Jezu Krishtit’. Edhe ‘Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit’ është e saktë dhe inkurajohet të përdoret.”¹⁵

Nëse dikush do të pyeste: “A je mormon?”, mund t’i përgjigjeshit: “Nëse po pyet a jam anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, po, jam!”

Nëse dikush pyet: “A je shenjtor i ditëve të mëvonshme?”¹⁶ ju mund të përgjigjeni: “Po, jam. Unë besoj te Jezu Krishti dhe jam anëtar i Kishës së Tij të rivendosur.”

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ju premtoj që, nëse ne do të bëjmë më të mirën tonë për ta rivendosur emrin e saktë të Kishës së Zotit, Ai, Kisha e të cilit është kjo, do të derdhë fuqinë dhe bekimet e Tij mbi kokat e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme¹⁷, në mënyra të cilat ne nuk i kemi parë kurrë. Ne do të kemi njohurinë dhe fuqinë e Perëndisë që të na ndihmojnë për t’i çuar bekimet e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit te çdo komb, fis, gjuhë e popull dhe për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Zotit.

Pra, çfarë vlere ka te një emër? Kur vjen puna tek emri i Kishës së Zotit, përgjigjja është: “Gjithë vlerën e mundshme!” Jezu Krishti na drejtoi ta quajmë Kishën me emrin e Tij, sepse është Kisha e Tij, e mbushur me fuqinë e Tij.

Unë e di se Perëndia jeton. Jezusi është Krishti. Ai e udhëheq Kishën e Tij sot. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “Zoti ka ngulitur në mendjen time rëndësinë e emrit që Ai ka zbuluar për Kishën e Tij, madje Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kemi punë përpara vetes, për ta sjellë vetveten në harmoni me vullnetin e Tij. Gjatë javëve të fundit, udhëheqës dhe sektorë të ndryshëm të Kishës kanë nisur hapat e nevojshëm për ta bërë këtë. Në muajt pasues do të vihet në dispozicion informacion i mëtejshëm lidhur me këtë çështje të rëndësishme” (Rasëll M. Nelson, në “Emri i Kishës” [deklaratë zyrtare, 16 gusht 2018], mormonnewsroom.org, [https://www.mormon.al/emri-i-kishes?lang=alb-al]).
2. Presidentë të mëparshëm të Kishës kanë bërë kërkesa të ngjashme. Për shembull, Presidenti Xhorxh Albert Smith tha: “Mos e zhgënjoni Zotin duke e quajtur këtë Kisha Mormone. Ai nuk e quajti Kisha Mormone” (në Conference Report, prill 1948, f. 160).
3. Shih “Udhëzuesi për Stilin – Emri i Kishës”, mormonnewsroom.org, [https://www.mormon.al/emri-i-kishes?lang=alb-al].



4. Doktrina e Besëlidhje 115:4.
5. 3 Nefi 27:7–8.
6. Shih Moisiu 1:33.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:18.
8. Shih Moroni 4:3; Doktrina e Besëlidhje 20:37, 77.
9. Mormoni ishte një nga katër shkruesit kryesorë të Librit të Mormonit, të tjerët janë Nefi, Jakobi dhe Moroni. Të gjithë qenë dëshmitarë okularë të Zotit, ashtu siç ishte përkthyesi i tij i frymëzuar, Profeti Jozef Smith.
10. Madje fjala *mormonitë* ishte mes termave tallës që u përdorën (shih *History of the Church*, 2:62–63, f. 126).
11. Epitete të tjera duket se janë përdorur në kohët e Dhiatës së Re. Gjatë gjyqit të Apostullit Pal përpara Feliksit, u tha se Pali ishte “kryetari i sektit të Nazarenasve” (Veprat e Apostujve 24:5). Në lidhje me përdorimin e frazës “të Nazarenasve”, një komentues shkroi: “Ky ishte emri që u jepej zakonisht të krishterëve si mënyrë përbuzjeje. Ata thirrshin kështu ngaqë Jezusi ishte nga Nazareti” (Albert Barnes, *Notes, Explanatory and Practical, on the Acts of the Apostles* [1937], f. 313).
Në mënyrë të ngjashme, një koment tjetër pohon: “Ashtu si Zoti ynë quhej me përbuzje ‘Nazareasi’ (Mateu xxvi. 71), po ashtu judenjtë iu referuan dishepujve të Tij si ‘nazareas’. Ata nuk do ta pranonin që dishepujt ishin të krishterë, *d.m.th.* dishepuj të Mesias” (*The Pulpit Commentary: Acts of the Apostles*, red. H. D. M. Spence and Joseph S. Exell [1884], 2:231).
Në një mënyrë të ngjashme, Plaku Nil A. Makuell vërejt: “Në mbarë historinë e shkrimeve të shenjta, ne shohim përpjekje të përsëritura për t’i poshtëruar profetët me qëllim që të mos i pranojnë ata – t’i etiketojnë me qëllim që t’ua ulin vlerën atyre. Megjithatë, kryesisht, ata thjesht janë shpërfillur nga bashkëkohësit e tyre dhe nga historia laike. Në fund të fundit, të krishterët e hershëm u thirrën thjesht ‘sekti i Nazarenasve’. (Veprat e Apostujve 24:5.)” (“Out of Obscurity”, *Ensign*, nëntor 1984, f. 10).
12. Shih 1 Nefi 18:1–2.
13. Benjamin De Hojos, “Të Thirrur për të Qenë Shenjtorë”, *Liahona*, maj 2011, f. 106.
14. Ndërkohë që nuk kemi kontroll mbi atë se si mund të na quajnë njerëzit e tjerë, ne kemi kontroll të plotë mbi atë se si i referohemi vetes. Si mund ta presim që të tjerët ta nderojnë emrin e saktë të Kishës nëse ne, si anëtarët e saj, nuk arrijmë ta bëjmë atë?
15. “Udhëzuesi për Stilin – Emri i Kishës”, mormonnewsroom.org, [https://www.mormon.al/emri-i-kishes?lang=alb-all].
16. Termi *shenjtorë* përdoret shpesh në Biblën e Shenjtë. Në Letrën e Palit drejtuar efesianëve, për shembull, ai e përdori fjalën *shenjtor* të paktën një herë në çdo kapitull. Një shenjtor është një njeri që beson te Jezu Krishti dhe përpigjet fort ta ndjekë Atë.
17. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:33.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Përpiquni, Përpiquni, Përpiquni

Shpëtimtari po e vendos emrin e Tij në zemrat tuaja. Dhe ju po e ndieni dashurinë e pastër të Krishtit për të tjerët dhe për ju vetë.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, jam mirënjohës për mundësinë që të flas me ju. Kjo konferencë ka qenë frymëzuese dhe lartësuese moralisht për mua. Muzika e kënduar dhe fjalët e thëna janë mbajtur në zemrat tona nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Lutem që ajo që do të them, do të përçohet te ju nga po ai Shpirt.
Shumë vite më parë, isha këshilltar i parë i presidentit të distriktit në lindje të Shteteve të Bashkuara. Më shumë se një herë, ndërsa ishim duke ngarë

makinen për në degët tona të vogla, ai më tha: “Hal, kur të takosh dikë, trajtoje atë sikur të jetë në telash të madh dhe do të kesh të drejtë më shumë se gjysmën e rasteve”. Ai jo vetëm që kishte të drejtë por kam mësuar përgjatë viteve se përllogaritja e tij për rastet ishte shumë e ulët. Sot, dëshiroj t’ju nxit në telashet që hasni.

Jeta jonë në vdekshmëri është projektuar nga një Perëndi i dashur që të jetë një provë dhe burim rritjeje për secilin prej nesh. Ju i mbani mend fjalët e Perëndisë lidhur me fëmijët e Tij gjatë Krijimit të botës: “Dhe ne do t’i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t’i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t’i urdhërojë”¹.

Që nga fillimi i botës, provat nuk kanë qenë të lehta. Ne hasim prova që vijnë nga pasja e trupave të vdekshëm. Të gjithë ne jetojmë në një botë ku lufta e Satanit kundër të vërtetës dhe kundër lumturisë sonë vetjake po bëhet gjithnjë e më e madhe. Bota dhe jeta juaj mund t’ju duken sikur janë në një trazirë që sa vjen e rritet.

Siguria ime është kjo: Perëndia i dashur që i lejoi këto prova për ju, gjithashtu projektoi një mënyrë të sigurt





për t'i kaluar ato. Ati Qiellor e deshi kaq shumë botën sa që dërgoi Birin e Tij të Dashur për të na ndihmuar.² Biri i Tij, Jezu Krishti, dha jetën e Vet për ne. Jezu Krishti mbajti në Gjetseman dhe në kryq peshën e të gjitha mëkateve tona. Ai i përjetoi të gjitha hidhërimet, dhembjet dhe pasojat e mëkateve tona në mënyrë që të mund të na ngushëllonte dhe forconte gjatë çdo prove në jetë.³

Ju e mbani mend që Zoti u tha shërbëtorëve të Tij:

“Ati e unë jemi një. Unë jam në Atin dhe Ati në mua; dhe aq sa më keni pranuar mua, ju jeni në mua dhe unë në ju.

Si rrjedhim, unë jam në mes tuaj dhe unë jam bariu i mirë dhe shkëmbi i Izraelit. Ai që ndërton mbi këtë shkëmb, nuk do të bjerë kurrë.”⁴

Profeti ynë, Presidenti Rasëll M. Nelson, ka dhënë gjithashtu po atë siguri. Veç kësaj, ai përshkroi një mënyrë se si ne mund të ndërtojmë mbi atë shkëmb dhe ta vendosim emrin e Zotit në zemrat tona që të na udhërrëfejnë gjatë sprovave tona.

Ai tha: “Ju që për një çast mund të jeni të shkukuruar, kujtoni, jeta nuk ka për qëllim që të jetë e lehtë. Duhet të dalin sprova dhe duhet të durohet pikëllimi përgjatë udhës. Ndërsa kujtoni se ‘me Perëndinë asgjë s’është e pamundshme’ (Lluka 1:37), dini se Ai është Ati juaj. Ju jeni një bir ose bijë e krijuar sipas shëmbëlltërisë së Tij, që keni të drejtën

për shkak të denjësisë suaj për të marrë zbulësë që t’ju ndihmojë në përpjekjet tuaja të drejta. Ju mund të merrni mbi vete emrin e shenjtë të Zotit. Ju mund të kualifikoheni për të folur në emrin e shenjtë të Perëndisë (shih DeB 1:20).”⁵

Fjalët e Presidentit Nelson na kujtojnë premtimin që gjendet në lutjen e sakramentit, një premtim që Ati ynë Qiellor e përmbush ndërsa bëjmë atë që premtojmë në këmbim.

Dëgjojeni fjalët: “O Perëndi, Ati i Amshuar, ne të kërkojmë ty në emër të Birit tënd, Jezu Krishtit, t’u bekosh e t’u shenjtërosh këtë bukë shpirttrave të të gjithë atyre që marrin prej saj, që ata të mund të hanë në kujtim të trupit të Birit tënd dhe të mund të të dëshmojnë ty, O Perëndi, Ati i Amshuar, se ata janë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Birit tënd dhe gjithmonë ta kujtojnë atë e të zbatojnë urdhërimet që ai u ka dhënë atyre, që të mund të kenë gjithmonë Shpirtin e tij me ta. Amen.”⁶

Çdo herë që themi fjalën *amen* kur jepet ajo lutje në emrin tonë, ne zotohemi se duke e marrë bukën jemi të gatshëm të marrim mbi vete emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, gjithmonë ta kujtojmë Atë dhe t’i zbatojmë urdhërimet e Tij. Në këmbim na premtohet se mund ta kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me vete. Për shkak të këtyre premtimeve, Shpëtimtari është shkëmbi mbi të cilin ne mund të qëndrojmë të sigurt

dhe pa druajtje në çdo stuhi që hasim.

Teksa i kam përsiatur fjalët e besëlidhjes dhe bekimet përkatëse që premtohen, kam pyetur veten se çfarë do të thotë të jesh i gatshëm të marrësh mbi vete emrin e Jezu Krishtit.

Presidenti Dallin H. Oaks shpjegon: “Është domethënëse se kur ne e marrim sakramentit, ne nuk dëshmojmë se *marrim mbi vete* emrin e Jezu Krishtit. Ne dëshmojmë se jemi *të gatshëm* ta bëjmë atë. (Shih te DeB 20:77.) Fakti që ne dëshmojmë vetëm për gatishmërinë tonë sugjeron se diçka tjetër duhet të ndodhë përpara se ne të marrim faktikisht mbi vete atë emër të shenjtë në kuptimin më të rëndësishëm.”⁷

Deklarata se ne jemi “të gatshëm të marrim mbi vete” emrin e Tij na tregon se ndërsa marrim fillimisht emrin e Shpëtimtarit kur pagëzohemi, marrja e emrit të Tij nuk mbaron me pagëzimin. Ne duhet të punojmë vazhdimisht për ta marrë emrin e Tij gjatë gjithë jetës sonë, përfshirë kohën kur i përtërijmë besëlidhjet në tavolinën e sakramentit dhe bëjmë besëlidhje në tempujt e shenjtë të Zotit.

Ndaj dy pyetjet vendimtare për secilin prej nesh janë: “Çfarë duhet të jem duke bërë për të marrë emrin e Tij mbi vete?” dhe “Si do ta di se kur po bëj përparim?”

Deklarata e Presidentit Nelson sugjeron një përgjigje të dobishme. Ai tha se



ne mund ta marrim emrin e Shpëtimtari mbi vete dhe se ne mund të flasim për Të. Kur flasim për Të, ne i shërbejmë Atij. “Pasi, si do ta njohë një njeri zotëruetin, të cilit nuk i ka shërbyer dhe që është i huaj për të, dhe është larg nga mendimet dhe qëllimet e zemrës së tij?”⁸

Të flasësh për Të kërkon një lutje me besim. Ajo kërkon një lutje të zjarrtë drejtuar Atit Qiellor për të mësuar se cilat fjalë mund të themi që ta ndihmojmë Shpëtimtari në punën e Tij. Ne duhet të kualifikohemi për premtimin: “Qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj”⁹.

Sidoqoftë, për të marrë emrin e Tij mbi vete kërkohet më shumë sesa të flasësh për Të. Ne duhet të kemi ndjenja në zemrat tona për të cilat të kualifikohemi si shërbëtorë të Tij.

Profeti Mormon përshkroi ndjenjat që na kualifikojnë dhe krijojnë mundësinë për të marrë emrin e Tij mbi vete. Këto ndjenja përfshijnë besimin, shpresën dhe dashurinë hyjnore, që është dashuria e pastër e Krishtit.

Mormoni shpjegoi:

“Pasi unë gjykoj se ju keni besim në Krisht, për shkak të zemërbutësisë suaj; pasi po të mos keni besim në të, atëherë ju nuk jeni të denjë të numëroheni mes njerëzve të kishës së tij.

Dhe përsëri, vëllezër të mi të dashur, unë dua t’ju flas në lidhje me shpresën. Si do të mund të arrini të keni besim, po të mos keni shpresë?

Dhe për çfarë duhet të keni shpresë? Vini re, unë ju them juve se duhet të keni shpresë nëpërmjet shlyerjes së Krishtit dhe fuqisë së ringjalljes së tij,

që të ngriheni në jetën e përgjeshme dhe kjo për shkak të besimit tuaj në të, sipas premtimit.

Prandaj, në qoftë se një njeri ka besim, ai duhet të ketë shpresë, pasi pa besim, nuk mund të ketë ndonjë shpresë.

Dhe përsëri vini re, unë ju them juve se ai nuk mund të ketë besim dhe shpresë, në qoftë se nuk është i bindur dhe i përvuajtur në zemër.

Përndryshe, besimi dhe shpresa e tij është e kotë, meqë askush nuk pranohet para Perëndisë, në qoftë se nuk është i bindur dhe i përvulur në zemër; dhe në qoftë se një njeri është i bindur dhe i përvulur në zemër dhe pohon me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë se Jezusi është Krishti, ai duhet të ketë dashuri hyjnore; pasi në qoftë se nuk ka dashuri hyjnore, ai s’është asgjë; prandaj është e nevojshme që të ketë dashuri hyjnore.”

Pasi përshkroi dashurinë hyjnore, Mormoni vazhdon të thotë:

“Por, dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit dhe nuk ka mbarim; dhe kushdo që gjendet i zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të.

Prandaj, vëllezër të mi të dashur, lutiu Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij Jezus Krisht; që ju të mund të bëheni bijtë e Perëndisë; që kur ai të shfaqet, ne të jemi si ai, pasi ne do ta shohim atë ashtu sikurse është; që të mund të kemi këtë shpresë; që ne të mund të pastrohemi, madje ashtu si ai është i pastër. Amen.”¹⁰

Dëshmia ime është se Shpëtimtari po e vendos emrin e Tij në zemrat tuaja. Për shumë prej jush, besimi juaj në Të po rritet. Ju po ndieni më shumë shpresë dhe optimizëm. Dhe ju po e ndieni dashurinë e pastër të Krishtit për të tjerët dhe për ju vetë.

Atë e shoh te misionarët që po shërbejnë në të gjithë botën. E shoh atë tek anëtarët të cilët po u flasin miqve dhe pjesëtarëve të tyre të familjes rreth Kishës së Jezus Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Burrat, gratë, të rinjtë dhe madje fëmijët po japin shërbesë për shkak të dashurisë për Shpëtimtari dhe për fqinjët e tyre.

Me të dëgjuar lajmin e parë për fatkeqësi nëpër botë, anëtarët bëjnë plane për të shkuar për të shpëtuar, ndonjëherë përtej oqeanit, pa iu kërkuar. Nganjëherë e kanë të vështirë të presin derisa zonat e shkatërruara të mund t’i pranojnë ata për të ofruar ndihmë.

E kuptoj se disa prej jush që po dëgjojnë sot mund të mendojnë se besimi dhe shpresa juaj po mposhten nga telashet tuaja. Dhe mund të dëshironi shumë të ndieni dashuri.

Vëllezër dhe motra, Zoti ju ka dhënë mundësi [që gjenden] pranë jush që ta ndieni dhe tregoni dashurinë e Tij. Ju mund të luteni me mirëbesim që Zoti t’ju udhëheqë për ta dashur dikë për Të. Ai u përgjigjet lutjeve të vullnetarëve zemërbutë si ju. Ju do ta ndieni dashurinë që Perëndia ka për ju dhe për personin të cilit ju i shërbeni për Të. Ndërsa i ndihmoni fëmijët e Perëndisë gjatë telasheve të tyre, vetë telashet tuaja do të duken më të lehta. Besimi juaj dhe shpresa juaj do të forcohen.

Jam një dëshmitar i asaj të vërtete. Gjatë gjithë jetës, bashkëshortja ime ka folur për Zotin dhe u ka shërbyer njerëzve për Të. Siç e kam përmendur edhe më parë, një nga peshkopët tanë një herë më tha: “Jam i habitur. Çdo herë që dëgjoj se një person në lagje është në telashe, ngutem që ta ndihmoj. Megjithatë, kur arrij unë, me sa duket, gjithmonë, bashkëshortja jote ka qenë tashmë aty.” Kjo ka qenë e vërtetë në të gjitha vendet në të cilat kemi jetuar për 56 vite.

Tani ajo mund të flasë vetëm pak fjalë në ditë. Atë e vizitojnë njerëz që

i donte për Zotin. Çdo mbrëmje dhe mëngjes unë këndoj himne me të dhe lutemi. Unë duhet të jem zëri i saj në lutje dhe në këngë. Nganjëherë mund ta shoh të shqiptojë fjalë të himneve. Ajo i parapëlqen këngët e fëmijëve. Ndjenja që duket se pëlqen më shumë përmblihet te kënga “I’m Trying to Be like Jesus” [“Përpiqem t’Jem si Jezusi”]¹¹.

Ditën pasuese, pasi kënduam fjalët e refrenit: “Doni njer’zit si ju do Jezusi. [Përpiquni] mir’si [të] tregoni në gjithçka bëni”, ajo tha butësisht por qartësisht: “Përpiquni, përpiquni, përpiquni”. Mendoj se ajo do të zbulojë, kur ta shoh Atë, se Shpëtimtari ynë e ka vendosur emrin e Tij në zemrën e saj dhe se ajo është bërë si Ai. Ai po e mban atë tani gjatë telasheve të saj, ashtu siç do t’ju mbajë juve gjatë telasheve tuaja.

Ju jap dëshminë time se Shpëtimtari ju njuh dhe ju do. Ai e di emrin tuaj sikurse ju e dini emrin e Tij. Ai i di telasht tuaja. Ai i ka përjetuar ato. Nëpërmjet Shlyerjes së Tij, Ai e ka mposhtur botën. Nëpërmjet gatishmërisë suaj për të marrë emrin e Tij mbi vete, ju do t’i lehtësoni barrët e panumërta të të tjerëve. Dhe me kalimin e kohës do të zbuloni se e njihni Shpëtimtarin më mirë dhe se e doni Atë më shumë. Emri i Tij do të jetë në zemrën tuaj dhe do të ngulitet në kujtesën tuaj. Është emri nëpërmjet të cilit ju do të thirreni. Kështu unë dëshmoj me mirënjohje për dashurinë e Tij të përzemërt për mua, për të dashurit e mi dhe për ju, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Abraham 3:25.
2. Shih Gjoni 3:16–17.
3. Shih Alma 7:11–12.
4. Doktrina e Besëlidhje 50:43–44.
5. Russell M. Nelson, “With God Nothing Shall Be Impossible”, *Ensign*, maj 1988, f. 35.
6. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
7. Dallin H. Oaks, “Taking upon Us the Name of Jesus Christ”, *Ensign*, maj 1985, f. 81.
8. Mosia 5:13.
9. Doktrina e Besëlidhje 1:38.
10. Moroni 7:39–44, 47–48.
11. Shih “I’m Trying to Be like Jesus”, *Children’s Songbook*, f. 78–79.



Nga Brajën K. Ashton,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e
Përgjithshme të Shkollës të së Dielës

Ati

*Secili prej nesh e ka potencialin për t’u bërë si Ati.
Për ta bërë atë, ne duhet ta adhurojmë Atin në emrin e Birit.*

Gjithë jetën e vet, bashkëshortja ime, Melinda, është përpjekur me gjithë zemrën e saj të jetë një dishepulle besnike e Jezu Krishtit. Prapëseprapë, që nga rinia e saj, ajo ndihej e padenjë për dashurinë dhe bekimet e Atit Qiellor pasi ajo nuk e kishte kuptuar siç duhet natyrën e Tij. Fatmirësisht, Melinda vijoi t’i mbante urdhërimet pavarësisht nga trishtimi që ndiente. Disa vite më parë, ajo pati një varg përvojash që e ndihmuan ta kuptonte më mirë natyrën e Perëndisë, përfshirë dashurinë e Tij për fëmijët e Tij dhe mirënjohjen e Tij për përpjekjet tona, ndonëse të papërsosura, për të bërë punën e Tij.

Ajo shpjegon se si kjo ka ndikuar tek ajo: “Tani ndihem e sigurt se plani i Atit funksionon, se Ai është përkushtuar personalisht për suksesin tonë dhe se Ai na jep mësim e përvoja që na nevojiten për t’u kthyer në praninë e Tij. Unë i shoh më shumë veten dhe të tjerët ashtu siç na sheh Perëndia. Unë jam në gjendje të jem prind, të jap mësim e të shërbej me më shumë dashuri e më pak frikë. Unë ndiej paqe dhe besim në vetvete në vend të ankthit dhe pasigurisë. Në vend që të ndihem e paragjykuar, unë ndiej mbështetje. Besimi im është më i sigurt. Unë e ndiej dashurinë e Atit tim më shpesh dhe më thellësisht.”¹



Pasja e “një ideje të saktë për karakterin, përsosuritë dhe cilësitë e [Atit Qiellor]” është thelbësore për ushtrimin e besimit të mjaftueshëm që të marrim ekzaltimin.² Një kuptueshmëri e saktë për karakterin e Atit Qiellor mund ta ndryshojë mënyrën se si e shohim veten dhe të tjerët, dhe mund të na ndihmojë ta kuptojmë dashurinë e jash-tëzakonshme të Perëndisë për fëmijët e Tij dhe dëshirën e Tij të madhe për të na ndihmuar që të bëhemi si Ai. Një këndvështrim i pasaktë për natyrën e Tij mund të na bëjë të ndihemi sikur jemi të paaftë për t’ia dalë mbanë ndonjëherë që të kthehemi në praninë e Tij.

Qëllimi im sot është që të jap mesim pika doktrinale kyç rreth Atit që do ta lejojnë secilin prej nesh, por veçanërisht ata që e pyetin veten a i do Perëndia, që ta kuptojnë më mirë karakterin e Tij të vërtetë dhe të ushtrojnë besim më të madh tek Ai, Biri i Tij dhe plani i Tij për ne.

Jeta Para Lindjes

Në botën para lindjes, ne iu lindëm si shpirtra Prindërve Qiellorë dhe jetuam me Ta si një familje.³ Ata na njihnin, na mësonin e na donin.⁴ Ne dëshironim vërtet shumë që të ishim njësoj si Ati ynë Qiellor. Megjithatë, për ta arritur atë, ne e kuptuam se do të na duhej:

1. Të merrnim trupa fizikë, të përlëvduar e të pavdekshëm⁵;

2. Të martoheshim dhe krijojmë familje me anë të fuqisë vulosëse të priftërisë⁶; dhe
3. Të fitonim të gjithë njohurinë, fuqinë si edhe cilësitë hyjnore.⁷

Për rrjedhojë, Ati krijoi një plan i cili, në bazë të disa kushteve⁸, do të na lejonte të fitonim një trup fizik që do të bëhej i pavdekshëm dhe i përlëvduar në Ringjallje; të martoheshim e krijojmë familje në vdekshmëri ose, për besnikët që nuk e patën këtë mundësi [në këtë jetë], pas vdekshmërisë⁹; të përparonim drejt përsosjes; dhe përfundimisht të ktheheshim te Prindërit tanë Qiellorë dhe të jetonim me Ta dhe familjet tona në një gjendje ekzaltimi dhe lumturie të përjetshme.¹⁰

Shkrimet e shenjta e quajnë këtë plani i shpëtimit.¹¹ Ne ishim kaq mirënjohës për këtë plan sa që kur na u paraqit, ne lëshuam britma gëzimi.¹² Secili prej nesh i pranoi kushtet e planit, përfshirë përvojat dhe sfidat e vdekshmërisë që do të na ndihmonin të zhvillonim cilësi hyjnore.¹³

Jeta në Vdekshmëri

Gjatë jetës në vdekshmëri, Ati Qiellor na siguron kushtet që na nevojiten për të përparuar në planin e Tij. Ati e lindi Jezu Krishtin në mish¹⁴ dhe i siguroi Atij ndihmë hyjnore që ta përmbushte misionin e tij në vdekshmëri. Ati Qiellor po ashtu do ta ndihmojë secilin prej nesh nëse do të përpiqemi t’i mbajmë

urdhërimet e Tij.¹⁵ Ati na jep lirinë e zgjedhjes.¹⁶ Jeta jonë është në duart e Tij dhe “ditët [tona] njihen” e “s’do të numërohen më pak”¹⁷. Dhe Ai siguron që përfundimisht të gjitha gjërat të veprojnë për të mirën e atyre të cilët e duan Atë.¹⁸

Është Ati Qiellor i cili na e jep bukën tonë të përditshme¹⁹, e cila përfshin si ushqimin që hamë, edhe forcën që na nevojitet për t’i mbajtur urdhërimet e Tij.²⁰ Ati jep dhuratat e mira.²¹ Ai i dëgjon dhe iu përgjigjet lutjeve tona.²² Ati Qiellor na çliron nga i ligu kur e lejojmë Atë.²³ Ai vajton për ne kur vuajmë.²⁴ Përfundimisht, të gjitha bekimet tona vijnë nga Ati.²⁵

Ati Qiellor na udhërrëfen dhe na jep përvojat që na nevojiten bazuar në fuqitë, dobësitë dhe zgjedhjet tona, në mënyrë që të mund të japim fryt të mirë.²⁶ Ati na ndëshkon kur është e nevojshme, për shkak se na do.²⁷ Ai është “Njeri i Këshillës”²⁸, që do të këshillohet me ne nëse ia kërkojmë.²⁹

Është Ati Qiellor që sjell edhe ndikimin, edhe dhuratën e Frymës së Shenjtë në jetën tonë.³⁰ Njëpërmjet dhuratës së Frymës së Shenjtë, lavdia – apo inteligjenca, drita e fuqia – e Atit mund të jenë në ne.³¹ Nëse do të përpiqemi të rritemi në dritë e të vërtetë derisa sytë tanë të drejtohen vetëm te lavdia e Perëndisë, Ati Qiellor do të dërgojë Shpirtin e Shenjtë të Premtimit për të na vulosur për jetën e përjetshme dhe do të na zbulojë fytyrën e Tij – qoftë në këtë jetë ose në tjetrën.³²

Jeta Pas Vdekjes

Në botën e shpirtrave pas vdekjes, Ati Qiellor vazhdon të derdhë Frymën e Shenjtë dhe të dërgojë misionarë tek ata që kanë nevojë për ungjillin. Ai iu përgjigjet lutjeve dhe i ndihmon që t’i marrin ordinancat shpëtuese mëkëmbëse ata të cilëve iu mungojnë ato.³³

Ati ngriti Jezu Krishtin dhe i dha Atij fuqi që të bënte të ndodhte Ringjallja³⁴, e cila është mënyra me anë të së cilës ne marrim trupa të pavdekshëm. Shëlbimi dhe Ringjallja e Shpëtimtarit na kthejnë përsëri në praninë e Atit, ku do të gjykohehi nga Jezu Krishti.³⁵



Ata që mbështeten te “merita[t] dhe mëshir[a] dhe hiri [i] Mesias së Shenjtë”³⁶ do të marrin trupa të përlëvdur sikurse Ati³⁷ dhe do të jetojnë me Të “në një gjendje lumturie të pafund”³⁸. Aty, Ati do të thajë çdo lot tonin³⁹ dhe do të na ndihmojë të vazhdojmë në udhëtimin tonë për t’u bërë si Ai.

Siç mund ta shihni, Ati Qiellor na gjendet përherë pranë.⁴⁰

Karakteri i Atit

Që të bëhemi si Ati, ne duhet të zhvillojmë tiparet e karakterit të Tij. Përsosuritë dhe cilësitë e Atit Qiellor përfshijnë sa vijon:

- Ati është “i Pafundëm e i Përjetshëm”⁴¹.
- Ai është përsosurisht i drejtë, i mëshirshëm, i mirë, i durueshëm dhe do vetëm atë që është më e mira për ne.⁴²
- Ati Qiellor është dashuri.⁴³
- Ai i mban besëlidhjet e Tij.⁴⁴
- Ai nuk ndryshon.⁴⁵
- Ai nuk mund të gënjejë.⁴⁶
- Perëndia nuk tregohet i anshëm.⁴⁷
- Ai i di të gjitha gjërat – të kaluara, të tashme dhe të ardhme – që nga fillimi.⁴⁸
- Ati Qiellor është më inteligjent⁴⁹ sesa të gjithë ne.⁵⁰
- Ati ka të gjithë fuqinë⁵¹ dhe bën gjithçka që e merr për zemër që ta bëjë.⁵²

Vëllezër dhe motra, ne mund t’i mirëbesojmë Atit dhe të mbështetemi tek Ai. Për shkak se Ai ka një këndvështrim të përjetshëm, Ati Qiellor mund të shohë gjëra që ne nuk mund t’i shohim. Gëzimi, vepra dhe lavdia e Tij janë që të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe ekzaltimi ynë.⁵³ Çdo gjë që Ai bën, është për përfitimin tonë. Ai “e dëshiron lumturinë [tonë] të përjetshme shumë më tepër sesa e duam [ne]”⁵⁴. Dhe Ai “nuk do të [na] kërkonte të përjetonim asnjë çast me më shumë vështirësi nga ç’është absolutisht e nevojshme për përfitimin [tonë] apo për përfitimin e atyre që [ne] i duam”⁵⁵. Si rrjedhim, Ai përqendrohet te dhënia e ndihmës që të përparojmë, jo te gjykimi apo dënimi ynë.⁵⁶



Të Bëhemi Si Ati Ynë

Si bij dhe bija shpirtërorë të Perëndisë, secili prej nesh e ka potencialin për t’u bërë si Ati. Për ta bërë atë, ne duhet ta adhurojmë Atin në emrin e Birit.⁵⁷ Ne e bëjmë këtë duke u përpjekur që të jemi të bindur ndaj vullnetit të Atit ashtu siç ishte Shpëtimtari⁵⁸, dhe duke u pënduar vazhdimisht.⁵⁹ Teksa i bëjmë këto gjëra, ne “m[arrin] hir pas hiri” derisa marrim plotësinë e Atit⁶⁰ dhe “karakteri, përsosuritë dhe cilësitë e Tij”⁶¹ na dhurohen neve.

Duke e pasur parasysh largësinë ndërmjet asaj që jemi ne si të vdekshëm dhe asaj që është bërë Ati Qiellor, nuk është e habitshme që disa njerëz mendojnë se bërja si Ati është e paarritshme. Sidoqoftë, shkrimet e shenjta janë të qarta. Nëse do të kapemi pas besimit në Krisht, do të pendo kemi e kërkojmë hirin e Perëndisë nëpërmjet bindjes, përfundimisht ne do të bëhemi si Ati. Mua më jep ngushëllim të madh fakti se ata që përpiqen të jenë të bindur do të “m[arrin] hir pas hiri” dhe përfundimisht e “m[arrin] plotësinë e tij”⁶². Me fjalë të tjera, ne nuk do të bëhemi si Ati [duke u mbështetur] vetëm te vetja.⁶³ Përkundrazi, ajo do të ndodhë nëpërmjet dhuratave të hirit, disa të

mëdha, por më së shumti të vogla, që ndërtohen njëra mbi tjetrën derisa ne marrim një plotësi. Por, vëllezër e motra, ajo do të ndodhë!

Unë ju ftoj të mirëbesoni se Ati Qiellor e di se si t’ju ekzaltojë ju; kërkojeni ndihmën e Tij të përditshme mbështetëse; dhe shkoni përpara me besim në Krishtin edhe kur nuk mund ta ndieni dashurinë e Perëndisë.

Ka shumë gjëra që ne nuk i kuptojmë rreth të bërit si Ati.⁶⁴ Por unë mund të dëshmoj me siguri se ia vlen çdo sakrificë që të përpiqesh për t’u bërë si Ati.⁶⁵ Sakrificat që bëjmë këtu në vdekshmëri, pavarësisht se sa të mëdha, janë thjesht të pakrahasueshme me gëzimin, lumturinë dhe dashurinë e pamatshme që do të ndiejmë në praninë e Perëndisë.⁶⁶ Nëse keni vështirësi ta besoni se ia vlejnjë sakrificat që ju kërkohen të bëni, Shpëtimtari ju thërret, duke ju thënë: “Ju nuk keni kuptuar ende ç’bekime të mëdha Ati Qiellor ka . . . përgatitur për ju; . . . ju nuk mund t’i duroni të gjitha gjërat tani; megjithatë, merrni zemër, sepse unë do t’ju udhëheq përgjatë udhës”⁶⁷.

Unë dëshmoj se Ati juaj Qiellor ju do dhe dëshiron që ju të jetoni me Të përsëri. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- Shënime në pronësi të autorit; shih edhe D. Melinda Ashton, "The Holy Ghost: Direction, Correction, and Warning" (Konferenca e Grave e Universitetit "Brigam Jang", 28 prill 2016), byutv.org.
- Lectures on Faith* (1985), f. 38.
- Shih "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona*, maj 2017, f. 145; "Nëna në Qiell", Temat e Ungjillit, topics.lds.org.
- Apostulli Pal sugjeroi se ne e njihnim Atin aq mirë sa shpirti ynë ende dëshiron ta thërrasë Atë *Abba*, që do të thotë "Babi", një term që përdoret vetëm për etërit me të cilët kemi marrëdhënie shumë të afërt (shih Romakëve 8:15).
- Shih Doktrina e Besëlidhje 130:22.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 132:19–20.
- Shih Mateu 5:48; shih edhe 2 Pjetër 1:3–8.
- Këto kushte përfshinin ruajtjen e gjendjes sonë të parë (shih Abraham 3:26) dhe më pas, në vdekshmëri, ushtrimin e besimit të Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij, pendimin dhe pagëzimin me anë të zhytjes nga një person që mban autoritetin e priftërisë së Perëndisë, marrjen e dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimin deri në fund (shih 3 Nefi 27:16–20).
- Presidenti Dallin H. Oaks ka dhënë mësim: "Disa që po e dëgjojnë këtë mesazh, ndoshta po thonë: 'Po unë vallë?' Ne e dimë se shumë shenjtoreve të ditëve të mëvonshme, të denjë e të mrekullueshëm, aktualisht u mungojnë mundësitë ideale dhe kërkesat thelbësore për përparimin e tyre. Beqaria, mospasja e fëmijëve, vdekja dhe shkurorëzimi i pengojnë idealet dhe e shtojnë përmbushjen e bekimeve të premtuara. . . . Por këto pengesa janë vetëm të përkohshme. Zoti ka premtuar se, në përjetësi, asnjë bekim nuk do t'u mohohet bijve dhe bijave të Tij që i mbajnë urdhërimet, që janë të vërtetë ndaj besëlidhjeve të tyre dhe që dëshirojnë atë që është e drejtë" ("The Great Plan of Happiness", *Ensign*, nëntor 1993, f. 75).
- Shih Mosia 2:41.
- Shih Alma 42:5; ai quhet edhe plani i shëlbimit (shih, për shembull, Jakobi [LiM] 6:8) dhe plani i lumturisë (shih Alma 42:8, 16).
- Shih Jobi 38:4–7.
- Shih, për shembull, Hebrejve 5:8; 12:11; Ethëri 12:27. Të paktën fillimisht, disa prej sfidave që hasim në vdekshmëri, mund të na duken, nga kuptueshmëria jonë e kufizuar, se ato do të jenë një pengesë që të marrim disa prej bekimeve të premtuara më të dëshiruara nga ne. Pavarësisht nga këto, në dukje, kontradikta, Perëndia do të na japë çdo bekim të premtuar nëse qëndrojmë besnikë.
- Shih Lluca 1:31–35; Gjoni 1:14; 1 Nefi 11:18–21; Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Jezu Krisht", scriptures.lds.org.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 93:4–5, 16–17, 19–20.
- Shih Moisiu 7:32.
- Doktrina e Besëlidhje 122:9.
- Shih Romakëve 8:28.
- Shih Mateu 6:11.
- Shih N. Eldon Tanner, "The Importance of Prayer", *Ensign*, maj 1974, f. 50–53.



- Shih Lluca 11:10–13; Jakobit [Bibël] 1:17.
- Shih Lluca 11:5–10; 3 Nefi 13:6.
- Shih Mateu 6:13.
- Shih Moisiu 7:31–40.
- Shih Jakobit [Bibël] 1:17.
- Shih Gjoni 15:1–2; Doktrina e Besëlidhje 122:6–7.
- Shih Hebrejve 12:5–11; Doktrina e Besëlidhje 95:1.
- Moisiu 7:35.
- Shih Alma 37:12, 37.
- Shih Gjoni 14:26; 2 Nefi 31:12.
- Shih Gjoni 17:21–23, 26; Doktrina e Besëlidhje 93:36.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 76:53; 88:67–68.
- Shih 1 Pjetër 4:6. Plaku Melvin J. Ballard, duke folur rreth arsyes përse një burrë që e kishte pagëzuar, ishte bashkuar me Kishën, tha: "Mu bë e ditur se paraardhësit e tij në botën e shpirtave e kishin pranuar Ungjillin vite më parë dhe ishin lutur që një person nga familja e tyre në tokë do ta hapte derën [e ordinarncave] për ta dhe se lutjet e tyre ishin dëgjuar dhe Zoti i kishte udhërrëfyer misionarët te dera e këtij burri" (në Melvin R. Ballard, *Melvin J. Ballard, Crusader for Righteousness* [1966], f. 250).
- Shih Mormoni 7:5–6; shih edhe Gjoni 5:21, 26; 1 Korintasve 6:14; 2 Nefi 9:11–12; Alma 40:2–3; 3 Nefi 27:14.
- Shih Gjoni 5:22; Jakobi [LiM] 6:9; Alma 11:44; Helamani 14:15–18. Shlyerja e Krishtit i mposht të gjitha pasojat e Rënies së Adamit, përfshirë si vdekjen fizike, edhe atë shpirtërore, të cilat që të dyja duhet të mposhten, që të na lejojnë të kthehemi në praninë e Atit tonë Qiellor. Ata që janë penduar për mëkatet e tyre, do të jetojnë me Atin dhe Birin në përjetësi. Mirëpo, ata që nuk kanë arritur të pendohen, do të vuajnë vdekjen e dytë, e cila shkaktohet nga vetë mëkatet e tyre (shih Helamani 14:15–18).
- 2 Nefi 2:8.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 76:56; 88:28–29.
- Mosia 2:41.
- Shih Zbulesa 7:17.
- Shih Moisiu 7:30. Madje vetë Ati Qiellor vazhdon të përkujdeset dhe të sigurojë për ata që janë në mbretërinë terestriale nëpërmjet shërbesave të Jezu Krishtit dhe qenieve të tjera celestiale (shih Doktrina e Besëlidhje 76:77, 87), gjithashtu dhe për ata që janë në mbretërinë telestiale nëpërmjet shërbesave të Frymës së Shenjtë dhe engjëjve (shih Doktrina e Besëlidhje 76:86, 88).
- Moisiu 7:35; shih edhe Psalmeve 90:2.
- Shih Psalmeve 103:6–8; Lluca 6:36; Moisiu 7:30.
- Shih 1 Gjoni 4:16.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 84:40.
- Shih Jakobit [Bibël] 1:17.
- Shih Numrat 23:19.
- Shih Veprat e Apostujve 10:34–35.
- Shih 1 Nefi 9:6; Doktrina e Besëlidhje 130:7.
- Faqja në internet dictionary.com e përkufizon fjalën *inteligjencë* si "aftësi për të mësuar, arsyetuar, kuptuar dhe forma të ngjashme të veprimtarisë mendore; zotësi në rrokjen e së vërtetës, marrëdhënieve, fakteve, kuptimeve, etj." dhe si "njohuri".
- Shih Abraham 3:19. Jezu Krishti si një qenie e përlëvdur dhe e përsosur është gjithashtu më inteligjent sesa të gjithë ne.
- Shih Zbulesa 21:22.
- Shih Abraham 3:17.
- Shih Moisiu 1:39.
- Richard G. Scott, "Trust in the Lord", *Ensign*, nëntor 1995, f. 17.
- Richard G. Scott, "Trust in the Lord", f. 17.
- Shih Gjoni 5:22; Moisiu 1:39. Është Satani dhe vetja jonë që na dënon (shih Zbulesa 12:10; Alma 12:14).
- Shih Gjoni 4:23; Doktrina e Besëlidhje 18:40; 20:29.
- Shih 3 Nefi 11:11; Doktrina e Besëlidhje 93:11–19.
- Pendimi është procesi me anë të të cilit ne ndryshojmë vetë natyrën tonë, kështu që ne bëhemi si Perëndia. Prandaj, ne duhet të pendohemi vazhdimisht, jo thjesht të pendohemi kur "bëjmë diçka të gabuar".
- Shih Doktrina e Besëlidhje 93:19–20.
- Lectures on Faith*, f. 38; shih edhe Moroni 7:48; 10:32–33; Doktrina e Besëlidhje 76:56, 94–95; 84:33–38.
- Doktrina e Besëlidhje 93:20; theksimi i shtuar.
- Shih Moroni 10:32–33; Doktrina e Besëlidhje 76:69, 94–95.
- Përse Perëndia nuk mund të zbulojë ose nuk do të zbulojë më shumë në lidhje me procesin se si të bëhemi si Ai? Unë, sinqerisht, nuk i di të gjitha arsyet. Por ka të paktën dy arsye të cilat unë vërtet i kuptoj. E para është se disa gjëra janë thjesht të papercptueshme në gjendjen tonë në vdekshmëri (shih Doktrina e Besëlidhje 78:17). Mund të jetë njësoj si të përpiqesh t'i shpjegosh për internetin një personi që jetoi në Mesjetë. Thjesht mungon konteksti dhe këndvështrimi. Dhe e dyta është që dhuratat e hirit shpesh na vijnë pikërisht ngaqë ne duhet të vuajmë e të kemi vështirësi nga mos njohuria.
- Sakrificat që na kërkojnë të bëjmë, mund të jenë të qenësishme për arritjen e përsosjes.
- Shih Romakëve 8:18.
- Doktrina e Besëlidhje 78:17–18.



Nga Plaku Robert C. Gei,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Marrja mbi Vete e Emrit të Jezut Krishtit

Marrshim mbi vete besnikërisht emrin e Jezut Krishtit - duke parë sikurse Ai sheh, duke shërbyer sikurse Ai shërbeu dhe duke mirëbesuar që hiri i Tij mjafton.

Vëllezërit dhe motrat e mia, kohët e fundit, ndërsa përsiatja detyrën e Presidentit Rasëll M. Nelson për ta quajtur Kishën me emrin e saj të zbulësës, u drejtova në shkrimet e shenjta, ku Shpëtimtari i udhëzoi neftët rreth emrit të Kishës.¹ Ndërsa lexoja fjalët e Shpëtimtarit, më bëri përshtypje mënyra se si Ai gjithashtu u tha njerëzve: “ju duhet të merrni mbi vete emrin e Krishtit”.² Kjo më bëri të shoh nga vetja dhe të pyes: “A po e marr mbi vete emrin e Shpëtimtarit siç Ai do të donte të bëja?”³ Sot do të doja të tregoja disa nga mbresat që kam marrë në përgjigje të pyetjes sime.

Së pari, të marrim mbi vete emrin e Krishtit do të thotë të përpiqemi besnikërisht për të parë sikurse Perëndia sheh.⁴ Si sheh Perëndia? Jozef Smithi ka thënë: “Ndërkohë që një pjesë e racës njerëzore e gjykon dhe e dënon pa mëshirë pjesën tjetër, Prindi i Madh i universit e trajton të gjithë familjen njerëzore me kujdes dhe vëmendje atërore” sepse “dashuria e Tij është e pamatshme.”⁵

Pak vite më parë motra ime më e madhe ndërroi jetë. Ajo pati një jetë

sfiduese. Ajo pati vështirësi me ungjillin dhe nuk qe kurrë vërtet aktive. Bashkëshorti e braktisi martesën e tyre dhe e la atë me katër fëmijë të vegjël për t'i rritur. Mbrëmjen e vdekjes së saj, në një dhomë me fëmijët e saj të pranishëm, unë i dhashë asaj një bekim për t'u

kthyer në shtëpi paqësisht. Në atë çast kuptova se e pata përkufizuar jetën e saj tepër shpesh nisur nga sprovat dhe mosaktivizimi i saj. Ndërsa vura duart mbi kokën e saj atë mbrëmje, unë mora një qortim të ashpër nga Shpirti. E kuptova fort mirë mirësinë e saj dhe m'u lejua ta shihja sikurse Perëndia e shihte – jo si dikë që pati vështirësi me ungjillin dhe jetën por si dikë së cilës iu desh të merrej me probleme të vështira që unë nuk i kisha. Unë e pashë si një nënë të mrekullueshme që, me gjithë pengesat e mëdha, kishte rritur katër fëmijë të mrekullueshëm, mahnitës. Unë e pashë si mikeshën e nënës sonë, që kalonte kohë për t'u përkujdesur e për të qenë shoqëruese e saj pasi babai ynë ndërroi jetë.

Gjatë asaj mbrëmjeje të fundit me motrën time, unë besoj se Perëndia po më pyeste: “A nuk mund ta shohësh që gjithsecili rreth teje është një qenie e shenjtë?”

Presidenti Brigam Jang dha mësim:

“Unë uroj që t'ju mësoj ju shenjtoreve . . . që t'i kuptoni burrat e gratë siç ata janë dhe jo t'i kuptoni siç jeni vetë.”⁶

Sa shpesh thuhet – ‘Ky njeri ka gabuar dhe nuk mund të jetë shenjtor’. . . . Ne dëgjojmë disa të shajnë dhe të gënjejnë . . . [ose] të shkelin Shabatin. . . . Mos i gjykoni këta persona, pasi





ju nuk e dini planin e Zotit lidhur me ta. . . . [Përkundrazil] jini të durueshëm me ta”.⁷

A mundet ndonjëri nga ju ta përfytyrojë Shpëtimtarin tonë t’ju lërë ju dhe barrët tuaja të kalojnë pa u vënë re prej Tij? Shpëtimtari e vështroi samaritanin, shkelësin e martesës, tagrambledhësin, lebrozin, të sëmurin mendor e mëkatarin me të njëjtin sy. Të gjithë ishin fëmijë të Atit të Tij. Të gjithë ishin të shëlbueshëm.

A mund ta përfytyroni Atë duke i kthyer shpinën dikujt me dyshime rreth vendit të tij në mbretërinë e Perëndisë ose ndonjërit të prekur në çfarëdolloj mënyre?⁸ Unë nuk mund ta përfytyroj. Në sytë e Krishtit, çdo shpirt është me vlerë të pafundme. Askush nuk është parashuguruar që të dështojë. Jeta e përrjetshme është e mundur për të gjithë.⁹

Nga qortimi i Shpirtit pranë shtratit të motrës sime, unë mora një mësim të madhërishtëm: që kur ne shohim sikurse Ai sheh, fitorja jonë do të jetë

e dyfishtë – shëlbim i atyre që prekim dhe shëlbim i vetvetes.

Së dyti, që të marrim mbi vete emrin e Krishtit, duhet jo vetëm të shohim siç Perëndia sheh, por duhet të bëjmë punën e Tij dhe të shërbejmë siç shërbeu Ai. Ne i jetojmë dy urdhërimet e mëdha, i nënshtrohemi vullnetit të Perëndisë, mbledhim Izraelin dhe lëmë dritën tonë “të shndritë . . . para njerëzve”.¹⁰ Ne i marrim dhe i jetojmë besëlidhjet dhe ordinancat e Kishës së Tij të rivendosur.¹¹ Kur e bëjmë këtë, Perëndia na pajis me forcë për të bekuar veten, familjet tona dhe jetën e të tjerëve.¹² Pyeteni veten: “A njoh ndonjë që nuk ka nevojë për fuqitë e qiellit në jetën e vet?

Perëndia do të bëjë mrekulli midis nesh ndërsa e shenjtërojmë vetveten.¹³ Ne e shenjtërojmë vetveten duke pastruar zemrat tona.¹⁴ Ne i pastrojmë zemrat tona ndërsa e dëgjojmë Atë,¹⁵ pendohemi për mëkatet tona,¹⁶ kthehemi në besim,¹⁷ dhe i duam të tjerët sikurse Ai i do.¹⁸ Shpëtimtari na pyeti:

“Sepse, po të doni vetëm ata që ju duan, çfarë shpërblimi do të keni?”¹⁹

Kohët e fundit, mësova rreth një përvoje në jetën e Plakut Xhejms E. Talmixh që më bëri të ndalem dhe të shqyrtoj se sa i dua dhe u shërbej atyre që më rrethojnë. Si profesor i ri, përpara se të bëhej Apostull, në kulmin e epidemisë së diferisë vdekjeprurëse të vitit 1892, Plaku Talmixh zbuloi një familje të huajsh, joanëtarë të Kishës, që jetonin pranë tij, të cilët qenë goditur nga sëmundja. Askush nuk donte ta vinte veten në rrezik duke u futur në shtëpinë e infektuar. Plaku Talmixh, gjithsesi, menjëherë u drejtua për tek ajo shtëpi. Gjeti katër fëmijë: një dy vjeç e gjysmë të vdekur në shtrat, një pesëvjeçare dhe një dhjetëvjeçar në dhembje të madhe dhe një trembëdhjetëvjeçare të dobësuar. Prindërit po vuanin me hidhërim e lodhje.

Plaku Talmixh u kujdes për të vdekurit dhe të gjallët, fshiu dhomat, nxori jashtë veshjet e ndotura dhe dogji rrekat e papastra me infeksionin e

sëmundjes. Ai punoi gjithë ditën dhe pastaj u rikthye mëngjesin tjetër. Dhjetëvjeçari vdiq gjatë natës. Ai e ngriti dhe e mbajti në krahë pesëvjeçaren. Ajo kollitej duke i hedhur këlbazë të përgjakur kudo në fytyrë dhe në rroba. Ai shkroi: “Nuk mund ta largoja nga vetja” dhe ai e mbajti deri sa ajo vdiq në duart e tij. Ai ndihmoi për varrosjen e të tre fëmijëve dhe siguroi ushqim dhe veshje të pastra për familjen në zi. Kur u kthye në shtëpi, Vëllai Talmixh i hodhi rrobat e tij, u la me tretësirë zinku, u izolua prej familjes së vet dhe ka-loi një goditje të lehtë nga sëmundja.²⁰

Sa jetë përreth nesh janë në rrezik! Shenjtorët e marrin mbi vete emrin e Shpëtimtarit duke u bërë të shenjtë dhe duke u shërbyer të gjithëve pavarësisht se ku ndodhen dhe si janë – shpëtohen jetë kur ne veprojmë kështu.²¹

Së fundi, Unë besoj se, që të marrim mbi vete emrin e Tij, ne duhet t’i mirëbesojmë Atij. Në një mbledhje ku mora pjesë një të diel, një e re pyeti për diçka të tillë si në vijim: “I dashuri im dhe unë kohët e fundit u ndamë dhe ai zgjodhi ta lërë Kishën. Ai më thotë se ai nuk ka qenë kurrë më i lumtur se tani. Si mund të ndodhë kjo?”

Shpëtimtari iu përgjigj kësaj pyetjeje kur Ai u tha nefitëve: “Por, nëse [jeta juaj] nuk është ndërtuar mbi ungjillin tim dhe është ndërtuar mbi veprat e njerëzve ose mbi veprat e djallit, në të vërtetë, unë ju them juve, [ju do të ken]

gëzim në veprat [tuaja] për një stinë dhe së shpejti vjen fundi”²². Thjesht nuk ka gëzim të qëndrueshëm jashtë ungjillit të Jezu Krishtit.

Në atë mbledhje, gjithsesi, unë mendova rreth shumë njerëzve të mirë që njoh, të cilët luftojnë me barrë të mëdha dhe urdhërime që më e pakta i trembin ata. E pyeta veten: “Çfarë tjetër mund t’u thoshte Shpëtimtari atyre?”²³ Unë besoj se Ai do të pyeste: “A më mirëbesoni mua?”²⁴ Gruas me problemin e gjakut, Ai i tha: “Besimi yt të shëroi; shko në paqe!”²⁵

Një nga shkrimet e mia të parapëlqyera është: Gjoni 4:4, ku lexohet: “Por duhej të kalonte nëpër Samari”.

Përse më pëlqen ai shkrim i shenjtë? Sepse Jezusi *kishte nevojë* të shkonte në Samari. Hebrenjtë e kohës së Tij i përçmonin samaritanët dhe kalonin nëpër një rrugë përreth Samarisë. Por Jezusi zgjodhi të shkonte atje për të deklaruar përpara gjithë botës se Ai ishte Mesia i premtuar. Për këtë mesazh, Ai zgjodhi jo vetëm një grup të përjashtuar por gjithashtu edhe një grua – dhe jo një grua çfarëdo, por një grua që jetonte në mëkat – dikë që asaj kohe konsiderohej si njeriu më i ulët i shoqërisë. Unë besoj se Jezusi e bëri këtë që secili prej nesh të mund të kuptojë gjithmonë se dashuria e Tij është më e madhe se frika jonë, plagët tona, varësitë tona, dyshimet tona, tundimet tona, mëkatet tona, familjet tona

të shkatërruara, depresioni dhe ankthet tona, sëmundja jonë kronike, varfëria jonë, keqtrajtimi ynë, dëshpërimi ynë dhe vetmia jonë.²⁶ Ai do që të gjithë ta dinë se nuk ka asgjë dhe asnjë njeri që Ai nuk mund ta shërojë dhe t’i sjellë gëzim të qëndrueshëm.²⁷

Hiri i Tij është i mjaftueshëm.²⁸ Vetëm Ai zbriti nën të gjitha gjërat. Fuqia e Shlyerjes së Tij është fuqia për të mposhtur çfarëdo barre në jetën tonë.²⁹ Mesazhi i gruas te pusi është se Ai i di situatat e jetës sonë³⁰ dhe që ne mund të ecim gjithmonë me Të pavarësisht se ku ndodhemi. Asaj dhe secilit prej nesh, Ai i thotë: “Kush pi nga uji që do t’i jap unë nuk do të ketë kurrë etje përjetë; por [do të ketë] një burim uji që gufon në jetë të përjetshme”³¹.

Në çfarëdo pike të udhëtimit tuaj në jetë, përse do largoheshit nga i vetmi Shpëtimtar që ka gjithë fuqinë t’ju shërojë e çlirojë? Çfarëdo çmimi që duhet të paguani për t’i mirëbesuar Atij, ia vlen. Vëllezër dhe motra të mia, le të zgjedhim ta rritim besimin tonë tek Ati Qiellor dhe Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti.

Nga vetë thellësia e shpirtit tim, jap dëshmi që Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është Kisha e Shpëtimtarit, e drejtuar nga Krishti i gjallë nëpërmjet një profeti të vërtetë. Lutja ime është që ne do të marrim mbi vete besnikërisht emrin e Jezu Krishtit – duke parë sikurse Ai sheh, duke shërbyer sikurse Ai shërbeu dhe duke mirëbesuar që hiri i Tij mjafton për të na çuar në shtëpi dhe drejt gëzimit të përhershëm. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih 3 Nefi 27:3-8.
2. Shih 3 Nefi 27:5-6; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 20:77 dhe besëlidhjen e sakramentit.
3. Shih Dallin H. Oaks, *His Holy Name* (1998) për një diskutim tërësor rreth marrjes mbi vete dhe të qenit dëshmitarë të emrit të Jezu Krishtit.
4. Shih Mosia 5:2-3. Pjesë e ndryshimit të madh të zemrës midis njerëzve të Mbretit Benjamin, që morën mbi vete emrin e Krishtit, ishte që atyre iu hapën sytë për [të parë] “vegime të mëdha”. Ata të cilët trashëgojnë mbretërinë çelestiale janë individë që “shohin ashtu siç shihen” (Doktrina e Besëlidhje 76:94).
5. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 41.





6. Brigham Young, në *Journal of Discourses*, 8:37.
7. *Discourses of Brigham Young*, përzgj. John A. Widtsoe (1954), f. 278.
8. Shih 3 Nefi 17:7.
9. Shih Gjoni 3:14–17; Veprat e Apostujve 10:34; 1 Nefi 17:35; 2 Nefi 26:33; Doktrina e Besëlidhje 50:41–42; Moisiu 1:39. Plaku Tod D. Kristoferson gjithashtu na mësoi: “Me vetëbesim ne dëshmojmë se Shlyerja e Jezu Krishtit e ka paraprirë dhe, më së fundi, do ta dëmshpërblejë gjithë mungesën e mundësive dhe humbjen për ata që kthehen tek Ai. Askush nuk është i paracaktuar që të marrë më pak sesa gjithçka që Ati ka për fëmijët e Tij” (“Përse Martesa, Përse Familja”, *Liahona*, maj 2015 f. 52).
10. Shih Mateu 5:14–16; 22:35–40; Mosia 3:19; Doktrina e Besëlidhje 50:13–14; 133:5; shih edhe Rasëll M. Nelson, “Mbledhja e Izraelit të Shpërndarë”, *Konferenca e Përgjithshme*, tetor 2006 f. 79-81.
11. Shih Levitiku 18:4; 2 Nefi 31:5–12; Doktrina e Besëlidhje 1:12–16; 136:4; Nenet e Besimit 1:3–4.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:20–21; 110:9.
13. Shih Jozueu 3:5; Doktrina e Besëlidhje 43:16; shih edhe Gjoni 17:19. Shpëtimtari e shenjtëroi veten që të kishte fuqi të na bekonte.
14. Shih Helamani 3:35; Doktrina e Besëlidhje 12:6–9; 88:74.
15. Shih Jozef Smith—Historia 1:17, urdhërimi i parë që iu dha Profetit Jozef Smith në vegim nga Perëndia; shih edhe 2 Nefi 9:29; 3 Nefi 28:34.
16. Shih Marku 1:15; Veprat e Apostujve 3:19; Alma 5:33; 42:22–23; Doktrina e Besëlidhje 19:4–20. Gjithashtu përasiatni këto dy meditime mbi mëkatin. Së pari, Hju Nibli shkruan: “Mëkati është të çosh diçka dem. Është të bësh diçka kur duhet të jesh duke bërë diçka tjetër dhe gjëra më të mira për të cilat e ke aftësinë” (“Zeal without Knowledge” [Zell pa Njohuri], *Approaching Zion*, f. 66). Nëna e Xhon Ueslit, Suzana Uesli, i shkroi birit të saj:

“Përdor këtë rregull. Çfarëdolloj gjëje që e dobëson arsyen tënde, dëmton butësinë e ndërgjegjes tënde, errëson ndjesinë tënde për Perëndinë, që ta heq kënaqësinë nga gjërat shpirtërore; . . . çfarëdolloj gjëje që e rrit . . . autoritetin e trupit tënd mbi mendjen tënde; ajo gjë është mëkat për ty, sado e pafajshme të mund të duket në vetvete”. (*Susanna Wesley: The Complete Writings*, ed. Charles Wallace Jr. [1997], 109).

17. Shih Lluka 22:32; 3 Nefi 9:11, 20.
18. Shih Gjoni 13:2–15, 34. Në prag të Shlyerjes së Tij, Shpëtimtari lau këmbët e dikujt që e tradhtoi Atë, të një tjetri që e mohoi Atë dhe madje të të tjerëve që ranë në gjumë në orën kur Ai kishte më shumë nevojë. Ai mandej dha mësim: “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur”.
19. Mateu 5:46.
20. Shih John R. Talmage, *The Talmage Story: Life of James E. Talmage—Educator, Scientist, Apostle* (1972), f. 112–114.
21. Shih Alma 10:22–23; 62:40.
22. 3 Nefi 27:11.
23. Te Mateu 11:28, 30, Zoti thotë: “Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje. . . . Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!” Gjithashtu merrni parasysh 2 Korintasve 12:7–9: Pali përshkruan vuajtjen si një “gjemb në mish”, që ai lutej për ta hequr. Krishti i tha atij: “Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi”. Shih edhe Ethëri 12:27.)
24. Shih Mosia 7:33; 29:20; Helamani 12:1; Doktrina e Besëlidhje 124:87.
25. Shih Lluka 8:43–48; Marku 5:25–34. Gruaja me problemin e gjakut ishte në nevojë të dëshpëruar dhe pa zgjidhje. Ajo vuante që prej 12 vjetësh dhe i kishte shpenzuar të gjitha paratë me mjekët dhe po bëhej më keq. E dëbuar nga njerëzit dhe familja e saj, ajo me synim çau rrugën nëpër një turmë të madhe dhe shkoi me vrull te Shpëtimtari. Ajo kishte mirëbesim dhe

besim të plotë te Shpëtimtari dhe Ai e ndieu prekjen e saj te cepi i rrobës së Tij. Prej atij besimi, Ai e shëroi atë menjëherë dhe tërësisht. Ai mandej e thirri atë “bijë”. Ajo nuk ishte më një e dëbuar, por anëtare e familjes së Perëndisë. Shërimi i saj ishte fizik, shoqëror, emocional dhe shpirtëror. Sfidat mund të zgjatin me vite ose një jetë, por premtimi i Tij për shërim është i sigurt dhe absolut.

26. Shih Lluka 4:21; Gjoni 4:6-26. Lluka, jo Gjoni, shënon se herët në shërbesën e Jezusit, Ai shkoi te vetë sinagoga e Tij në Nazaret, lexoi një pjesë nga Isaia që profetizoi për Mesian dhe pastaj deklaroi: “Sot ky Shkrim u përbush në veshët tuaja”. Kjo është hera e parë e shënuar në anal që Shpëtimtari flet për Vetën si Mesia. Sidoqoftë, te pusi i Jakobit, Gjoni shënon herën e parë që Jezusi e deklaroi në një forum të hapur se është Mesia. Në këtë mjedis, duke qenë se samaritanët konsideroheshin si johebrenj, Jezusi dha mësim gjithashtu se unguilli i Tij ishte për të gjithë, për hebrenjtë dhe për johebrenjtë. Kjo deklaratë ndodh në “orën gjashtë” ose në mesditë, kur toka merr dritën e saj të plotë nga dielli. Pusi i Jakobit është gjithashtu në luginën mu pranë vendit ku Izraeli i lashtë bëri besëlidhje ceremoniale me Zotin pasi hyri në tokën e premtuar. Interesante, në një anë të luginës është një mal i thatë dhe në anën tjetër është një mal plot burime uji jetëdhënës.
27. Plaku Nill A. Maksulli dha mësim: “Kur në situata stresi themi me vete a kemi gjë tjetër për të dhënë, ne mund të ngushëllohemi nga dija se Perëndia, që e njeh aftësinë tonë përsosurisht, na vuri këtu që të arrijmë sukses. Asnjë nuk është parashuguarur që të dështojë a të jetë i lig. . . . Kur ndihemi të dërrmuar, le të kujtojmë sigurinë që Perëndia nuk do të na mbingarkojë” (“Meeting the Challenges of Today” [Brigham Young University devotional, 10 tetor 1978], speeches.byu.edu).
28. Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim: “Në një kohë të ardhme, ju do të paraqiteni përpara Shpëtimtarit. Do të jeni aq të tronditur që do të jeni në praninë e Tij të shenjtë, sa do të përloteni. Zor se do të gjeni dot fjalë për ta falënderuar Atë që pagoi për mëkatet tuaja, që ju fali për ndonjë sjellje të vrazhdë ndaj të tjerëve, që ju shëroi nga lëndimet dhe padrejtësitë e kësaj jete.
Do ta falënderoni Atë që ju forcoi për të bërë të pamundurën, që i ktheu dobësitë tuaja në forcë dhe që e bëri të mundur për ju të jetoni me Të dhe me familjen tuaj përgjithmonë. Identiteti i Tij, Shlyerja e Tij dhe tiparet e Tij do të bëhen vetjake dhe të vërteta për ju”. (“Profetët, Udhëheqja dhe Ligji Hyjnor” [takimi shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë në moshë madhore, 8 janar 2017], broadcasts.lds.org).
29. Shih Isaia 53:3–5; Alma 7:11–13; Doktrina e Besëlidhje 122:5-9.
30. Shih Jozef Smith – Historia 1:17; Elen S. Dalton, “Ai ju Njeh me Emër”, *Konferenca e Përgjithshme*, prill 2005.
31. Gjoni 4:14.



Nga Plaku Methju L. Carpenter,
i Të Shtatëdhjetëve

A Dëshiron të Shërohesh?

Për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, nëse zgjedhim të pendohemi dhe t'i kthejmë zemrat tona tërësisht te Shpëtimtari, Ai do të na shërojë shpirtërisht.

Pak muaj pasi kishte filluar misionin, djali ynë më i vogël dhe shoku i tij misionar po përfundonin studimin e tyre kur biri ynë ndjeu një dhembje të lehtë në kokë. Pati një ndjenjë të çuditshme; në fillim humbi kontrollin e krahut të majtë, më pas gjuha iu mpi. Ana e majtë e fytyrës filloi t'i varej. E kishte të vështirë të fliste. E dinte se diçka nuk po shkonte. Ajo që nuk dinte, ishte që gjendej në mes të një ishemie të madhe në tri zona të trurit. Frika filloi të shfaqej teksa u paralizua pjesërisht. Koha sa shpejt mund të marrë kujdes mjekësor një viktimitë e ishemiesë cerebrale, mund të ketë një ndikim të madh në shkallën e shërimit të tij. Shoku i tij misionar plot besim veproi me vendosmëri. Pasi mori në telefon urgjencën, ai i dha atij një bekim. Për mrekulli, ambulanca ishte vetëm pesë minuta larg.

Pasi djalin e çuan me urgjencë në spital, personeli mjekësor me të shpejtë e vlerësoi gjendjen dhe vendosi që duhej t'i jepnin birit tonë një ilaç që kishte mundësi t'i largonte dalëngadalë me kalimin e kohës pasojat paralizuese të ishemiesë cerebrale.¹ Gjithsesi, nëse biri

ynë nuk po kalonte një ishemi cerebrale, ilaçi mund të kishte pasojat të rënda, të tilla si një hemoragji në tru. Biri ynë duhej të zgjidhte. Ai zgjodhi ta pranonte ilaçin. Ndërkohë që shërimi i plotë kërkoi operacione të tjera dhe shumë muaj, biri ynë më së fundi u rikthye dhe e përfundoi misionin e tij pasi i ishin larguar konsiderueshëm pasojat e ishemiesë cerebrale.

Ati ynë Qiellor është i gjithëfuqishëm dhe i gjithëdijshëm. Ai i njeh mundimet tona fizike. Ai është i vetëdijshëm për dhembjet tona fizike për shkak të sëmundjes, lëngatës, moshës së vjetër, aksidenteve apo çrregullimeve që nga lindja. Ai është i vetëdijshëm për vështirësitë tona emocionale që shoqërohen me ankthin, vetminë, depresionin ose sëmundjet mendore. Ai e njeh çdo njeri që ka vuajtur padrejtësi ose me të cilin është abuzuar. Ai i njeh dobësitë, prirjet dhe tundimet me të cilat ndeshemi.

Gjatë vdekshmërisë ne vihemi në provë që të shihet nëse do të zgjedhim të mirën kundrejt së ligës. Ata që i zbatojnë urdhërimet e Tij, do të jetojnë me Të “në një gjendje lumturie të pafund”². Që të na ndihmojë në përparimin tonë për t'u bërë si Ai, Ati Qiellor ia ka dhënë të gjithë fuqinë dhe diturinë Birit të Tij, Jezu Krishtit. Nuk ka ligshiti fizike, emocionale apo shpirtërore që Krishti nuk mund ta shërojë.³

Nga shërbesa e Shpëtimtarit në vdekshmëri, shkrimet e shenjta tregojnë shumë ngjarje të mrekullueshme ku Jezu Krishti e përdori fuqinë e Tij hyjnore për t'i shëruar ata që vuanin fizikisht.

Ungjilli sipas Gjonit tregon historinë e një burri që kishte duruar një paaftësi ligështuese për 38 vjet.

“Jezusi, duke e parë shtrirë dhe duke ditur se prej shumë kohe ishte





në atë gjendje, i tha: 'A dëshiron të shërohesh?'

Burri i pafuqishëm u përgjigj se askush nuk ishte atje që ta ndihmonte kur kishte më shumë nevojë për ndihmë.

"Jezusi i tha: 'Çohu, merr vigun tënd dhe ec!'.

Njeriu u shërua *në çast*, mori vigun e tij dhe eci."⁴

Vini re, ju lutem, pranëvënien e dy të kundërtave: se sa gjatë vuajti ky burrë vetëm – 38 vjet – dhe se sa shpejt erdhi shërimi kur u përfshi Shpëtimtari. Shërimi ishte "*në çast*".

Në një rast tjetër, një grua me një fluks gjaku për 12 vjet, e cila "kishte shpenzuar ndër mjekë gjithë pasurinë e saj, . . . iu afrua nga pas dhe i preku cepin e rrobës së tij dhe *në atë çast [i pushoi] fluksi i gjakut. . .*

Por Jezusi tha: 'Dikush më preku, sepse e ndjeva që një fuqi doli prej meje'.

Atëherë gruaja, duke parë se nuk mbeti e padiktuar, . . . i deklaroi në prani të gjithë popullit, . . . si ishte shëruar *në çast*."⁵

Gjatë shërbesës së Tij, Krishti dha mësim se Ai kishte fuqi mbi trupin fizik. Ne nuk mund ta kontrollojmë kohën se kur do të ndodhë shërimi i sëmundjeve tona fizike prej Krishtit. Shërimi ndodh në përputhje me vullnetin dhe urtësinë e Tij. Në shkrimet e shenjta disa njerëz vuajtën për dekada; të tjerë gjatë gjithë jetës së tyre në vdekshmëri. Paaftësitë fizike në

vdekshmëri mund të na përmirësojnë dhe të na e thellojnë mbështetjen tonë te Perëndia. Por, kur e lejojmë Krishtit të përfshihet, Ai gjithmonë do të na forcojë shpirtërisht që të mund të kemi aftësi më të madhe për t'i duruar barrët tona.

Më së fundi, ne e dimë se çdo sëmundje, dobësi apo papërsosuri fizike do të shërohet në Ringjalljen. Ajo është një dhuratë për të gjithë njerëzimin nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit.⁶

Jezu Krishti mund të shërojë më shumë sesa thjesht trupat tanë fizikë. Ai mund t'i shërojë edhe shpirtat tanë. Gjatë gjithë shkrimit të shenjtë, ne mësojmë se si Krishti i ndihmoi ata, shpirtat e të cilëve ishin të dobët, dhe i bëri të shërohen.⁷ Kur i përsiatim këto përvoja, rritet shpresa dhe besimi ynë te fuqia e Shpëtimtarit për ta bekuar jetën tonë. Jezu Krishti mund të na ndryshojë zemrën, mund të na shërojë nga pasojat e padrejtësisë ose abuzimit që mund të përjetojmë, dhe mund ta forcojë aftësinë tonë për t'i bërë ballë humbjes dhe pikëllimit, duke na sjellë paqe për të na ndihmuar që t'i durojmë sprovat e jetës sonë, duke na shëruar emocionalisht.

Krishti gjithashtu mund të na shërojë kur mëkatojmë. Ne mëkatojmë kur me vetëdije e shkelim njërin nga ligjet e Perëndisë.⁸ Kur mëkatojmë, shpirtat tanë bëhen të papastër. Asgjë e papastër nuk mund të banojë në praninë e Perëndisë.⁹ "Pastrimi nga mëkati do të thotë të shërohesh shpirtërisht."¹⁰

Perëndia, Ati, e di se do të mëkatojmë, por Ai ka përgatitur një udhë që ne të shëlbohemi. Plaku Lin G. Robins dha mësim: "Pendimi nuk është plani . . . rezervë [i Perëndisë] në rastin kur ne mund të dështojmë. Pendimi është plani i Tij, duke e ditur që do të dështojmë."¹¹ Kur mëkatojmë, ne kemi mundësinë të zgjedhim të mirën nga e liga. Ne zgjedhim të mirën kur pendohemi pasi kemi mëkatur. Nëpërmjet Jezu Krishtit dhe flijimit të Tij shlyes, ne mund të shëlbohemi prej mëkateve tona dhe të kthehemi në praninë e Perëndisë, Atit, nëse pendohemi. Shërimi shpirtëror nuk është i njëanshëm – ai kërkon fuqinë shëlbuese të Shpëtimtarit dhe pendimin e sinqertë nga ana e mëkatarit. Ata që zgjedhin të mos pendohen, nuk po e pranojnë shërimin që ofron Krishti. Për ta është sikur të mos ishte bërë shëlbimi.¹²

Kur jam këshilluar me njerëz të tjerë që po kërkonin të pendoheshin, unë jam befasuar që njerëzit, të cilët po jetonin në mëkat, e kishin të vështirë që të merrnin vendime të drejta. Fryma e Shenjtë do të largohej prej tyre dhe shpesh mezi ia dilnin të bënin zgjedhje që do t'i sillnin më pranë Perëndisë. Ata do të ndesheshin për muaj ose madje vite, të turpëruar ose të frikësuar nga pasojat e mëkateve të tyre. Shpesh, ata ndienin se kurrë nuk mund të ndryshonin ose të merrnin falje. Shpesh i kam dëgjuar të tregojnë për frikën e tyre se, në qoftë se njerëzit e tyre të dashur do ta dinin se çfarë kishin bërë, nuk do t'i donin më ose do të largoheshin prej tyre. Kur e ndiqnin këtë rrjedhë mendimi, arrinin në përfundimin që thjesht të mos tregonin dhe ta vononin pendimin e tyre. Duke u gabuar, ndienin se ishte më mirë të mos pendoheshin tani, që të mos i lëndonin më tej njerëzit që i donin. Në mendjen e tyre ishte më mirë të vuanin pas kësaj jete, sesa të kalonin përmes procesit të pendimit tani. Vëllezër e motra, nuk është *kurrë* një ide e mirë që ta shtyni për më vonë pendimin tuaj. Kundërshtari shpesh e përdor frikën për të mos na lejuar që të veprojmë në çast sipas besimit tonë te Jezu Krishti.

Kur njerëzit e dashur përballen me të vërtetën rreth sjelljes mëkatore, ndërkohë që mund të ndihen thellësisht të lënduar, ata shpesh dëshirojnë ta ndihmojnë mëkatarin, i cili pendohet sinqerisht, që të ndryshojë dhe të pajtohet me Perëndinë. Me të vërtetë, shërimi shpirtëror përshpejtohet kur mëkatarin e rrëfen mëkatin dhe rrethohet nga ata që e duan dhe e ndihmojnë t'i braktisë mëkatin e tij. Ju lutem, mbajeni mend se Jezu Krishti është i fuqishëm në mënyrën se si Ai i shëron edhe viktimat e pafajshme të mëkatit, që i kërkojnë ndihmë Atij.¹³

Presidenti Bojd K. Paker shpalli: “Shpirtrat tanë dëmtohen kur bëjmë gabime dhe kryejmë mëkate. Por ndryshe nga rasti i trupave tanë të vdekshëm, kur procesi i pendimit është tërësor, asnjë shenjë nuk mbetet për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Premtimi është: ‘Vini re, ai që është penduar për mëkatin e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato’ [Doktrina e Besëlidhje 58:42].”¹⁴

Kur pendohemi “me qëllim të plotë të zemrës”¹⁵, “plani i madh i shëlbimit do të realizohet menjëherë” në jetën tonë.¹⁶ Shpëtimtari do të na shërojë.

Shoku misionar dhe profesionistët e mjekësisë të cilët e ndihmuan birin tonë të goditur nga ishemia cerebrale në fushën e misionit, vepruan me të shpejtë. Biri ynë zgjodhi që të merrte ilaçin që e largonte ndikimin e ishemiisë. Ndikimet paralizuese të ishemiisë cerebrale, që mund ta kishin ndjekur atë gjatë gjithë jetës së tij në vdekshmëri, u prapësuan. Po ashtu, sa më shpejt që ne pendohemi dhe e sjellim Shlyerjen e Jezu Krishtit në jetën tonë, aq më shpejt mund të shërohemi nga pasojat e mëkatit.

Presidenti Rasëll M. Nelson ofroi këtë ftesë: “Nëse jeni larguar nga shtegu, . . . ju ftoj . . . që, . . . të ktheheni [ju lutem]. Cilatdo qofshin shqetësimet tuaja, cilatdo qofshin sfidat tuaja, ka vend për ju në këtë, Kishën e Zotit. Ju dhe brezat ende të palindur do të bekoheni nga veprimet tuaja tani për t’u kthyer në shtegun e besëlidhjeve.”¹⁷

Shërimi ynë shpirtëror kërkon nga ne që t’u nënshtrohemi kushteve që ka përvijuar Shpëtimtari ynë. Nuk duhet të vonohemi! Duhet të veprojmë sot!



Veproni tani, në mënyrë që paraliza shpirtërore të mos e pengojë përparimin tuaj të përjetshëm. Ndërkohë që kam folur, nëse e keni ndier nevojën për të kërkuar faljen e dikujt ndaj të cilit keni vepruar gabim, ju ftoj të veproni. Tregojuni se çfarë keni bërë. Kërkoni faljen e tyre. Nëse keni kryer një mëkat që ndikon te denjësia juaj për në tempull, ju ftoj të këshilloheni me peshkopin tuaj – sot. Mos e vononi.

Vëllezërit dhe motrat e mia, Perëndia është Ati ynë i dashur në Qiell. Ai ia ka dhënë të gjithë fuqinë dhe diturinë Birit të Tij të dashur, Jezu Krishtit. Për shkak të Tij, i gjithë njerëzimi do të shërohet një ditë nga çdo sëmundje fizike përgjithmonë. Për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, nëse zgjedhim të pendohemi dhe t’i kthejmë zemrat tona tërësisht te Shpëtimtari, Ai do të na shërojë shpirtërisht. Ai shërim mund të fillojë në çast. Zgjedhja është e jona. *A dëshirojmë të shërohemi?*

Unë dëshmoj se Jezu Krishti e pagoi çmimin që ne të mund të shërohemi. Por duhet të zgjedhim që ta përdorim atë ilaç shërues që Ai ofron. Përdoreni sot. Mos e vononi. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Ilaçi quhet tPA (aktivizuesi plazminogjen i indeve).
2. Mosia 2:41.
3. Shih Mateu 4:24. Krishti shkoi kudo duke shëruar të gjithë të sëmurët, edhe ata me “lëngata”, “dhimbje të ndryshme”, që ishin

“të demonizuar” dhe “epileptikë”.

4. Shih Gjoni 5:5–9; theksimi i shtuar.
5. Shih Lluca 8:43–47; theksimi i shtuar.
6. Shih Alma 40:23; Helamani 14:17.
7. Shih Lluca 5:20, 23–25; shih edhe Joseph Smith Translation [Përkthimin prej Joseph Smith-it], Luke 5:23 (në Biblën në anglisht Luke 5:23, poshtëshënimi a): “A kërkohet më shumë fuqi për të falur mëkatin apo për ta bërë të sëmurin të ngrihet dhe të ecë?”
8. Shih 1 Gjon 3:4.
9. Shih 3 Nefi 27:19.
10. “The Gospel of Jesus Christ”, *Preach My Gospel: A Guide to Missionary Service*, bot. i rishik (2018), lds.org/manual/misionary.
11. Lin G. Robins, “Deri Shtatëdhjetë Herë Shtatë”, *Liahona*, maj 2018, f. 22.
12. Shih Mosia 16:5.
13. Në shumë raste, e kam dëshmuar shërimin e përshpejtuar të individëve kur anëtarët e familjes janë grumbulluar përreth dikujt që i ka shkelur zotimet e besnikërisë dhe mirëbesimit, duke i ndihmuar të kthehen te Shpëtimtari më tërësisht për fuqinë e Tij shëruese në jetën e tyre. Nëse njeriu i penduar vërtet kërkon sinqerisht të ndryshojë, anëtarët e familjes që e ndihmojnë në studimin e ungjillit, lutjen e sinqertë dhe shërbimin si të Krishtit, jo vetëm që e ndihmojnë mëkatarin të ndryshojë, por gjithashtu e hapin derën për shërimin e shtuar nga Shpëtimtari në jetën e tyre. Kur është e përshtatshme, viktimat e pafajshme mund ta ndihmojnë mëkatarin në gabim duke kërkuar udhërrëfim qiellor se çfarë të studiojnë së bashku, se si të shërbejnë dhe se si t’i përfshijnë pjesëtarët e familjes që ta përkrahin dhe forcojnë shpirtin pendues që të ndryshojë e të përfitojë nga fuqia shëlbuese e Jezu Krishtit.
14. Bojd K. Paker, “Plani i Lumturisë”, *Liahona*, maj 2015, f. 28.
15. 3 Nefi 18:32.
16. Alma 34:31; theksimi i shtuar.
17. Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 7.



Nga Plaku Dejll G. Renland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Zgjidhni Sot

Shkalla e lumturisë sonë të përjetshme varet nga sa e zgjedhim Perëndinë e gjallë dhe bashkimin me Të në veprën e Tij.

Personazhi artistik i Meri Popinsit është një dado tipike angleze e cila ka aftësi magjike.¹ Ajo vjen duke fluturuar me erën nga lindja që t'i vijë në ndihmë familjes Benks plot tela-she, e cila jeton në adresën Cherry Tree Lane, numër 17 në Londrën e fillimit të viteve 1900. Asaj i jepet përgjegjësia që të kujdeset për fëmijët, Xhejnin dhe Majkëllin. Me një mënyrë të rreptë, por dashamirëse, ajo fillon t'u japë mësimet të vlefshme në një mënyrë të veçantë magjepsë.

Xhejni dhe Majkëlli përparojnë mjaft, por Meri vendos se është koha për të që të largohet. Në shfaqjen ske-nike, miku oxhakpastrues i Merit, Bërti, përpiket t'ia ndryshojë mendjen që të mos largohet. Ai argumenton: “Por ata janë fëmijë të mirë, Meri”.

Meri përgjigjet: “A do ta merrja mundimin të shqetësoshesha për ta po të mos ishin? Por nuk mund t'i ndihmoj nëse ata nuk më lejojnë t'i ndihmoj dhe nuk ka njeri më të vështirë për ta mësuar sesa fëmija që di gjithçka.”

Bërti pyet: “Prandaj?”

Meri përgjigjet: “Prandaj ata duhet ta bëjnë vetë këtë pjesën që pason”².

Vëllezër dhe motra, ashtu si Xhejn e Majkëll Benksi, ne jemi “fëmijë të mirë” për të cilët ia vlen të marrësh mundimin që të shqetësoshesh. Ati ynë Qiellor

dëshiron të na ndihmojë dhe të na bekojë, por ne nuk e lejojmë gjithmonë Atë. Madje nganjëherë ne veprojmë sikur tashmë e dimë gjithçka. Dhe ne gjithashtu kemi nevojë ta bëjmë vetë “pjesën që pason”. Kjo është arsyeja përse erdhëm në tokë nga një shtëpi qiellore e paralindjes. “Pjesa” jonë përfshin bërjen e zgjedhjeve.

Qëllimi i Atit tonë Qiellor si prindi ynë nuk është që t'i bëjë fëmijët e Tij të bëjnë atë që është e drejtë; është



që t'i bëjë fëmijët e Tij të zgjedhin të bëjnë atë që është e drejtë dhe më së fundi të bëhen si Ai. Nëse thjesht Ai do të donte që ne të ishim të bindur, Ai do të përdorte shpërblime dhe ndëshkime të menjëhershme për të ndikuar te sjelljet tona.

Por Perëndia nuk ka interes që fëmijët e Tij thjesht të bëhen “kafshë shtëpiake” të ushtruara dhe të bindura, që nuk do t'i shqyjnë pantoflat e Tij në dhomën qiellore të ndenjes.³ Jo, Perëndia do që fëmijët e Tij të rriten shpirtërisht dhe të bashkohen me Të në punën e familjes.

Perëndia krijoi një plan me anë të të cilit ne mund të bëhemi trashëgimtarë në mbretërinë e Tij, një shteg besëlidh-jesh që na çon deri atje sa të bëhemi si Ai, na bën të kemi llojin e jetës që jeton Ai dhe të jetojmë përgjithmonë si fa-milje në praninë e Tij.⁴ Zgjedhja vetjake ishte – dhe është – jetike për këtë plan, për të cilin mësuam në ekzistencën tonë para lindjes. Ne e pranuan planin dhe zgjodhëm të vinim në tokë.

Për t'u siguruar që do të ushtronim besim dhe do të mësonim ta përdornim siç duhet lirinë tonë të zgjedhjes, një vel harrese u hodh mbi mendjet tona kështu që ne nuk do ta mbanim mend planin e Perëndisë. Pa atë vel, qëllimet e Perëndisë nuk do të arriheshin ngaqë ne nuk do të mund të përparonim dhe të bëheshim trashëgimtarët e besuar që Ai dëshiron që ne të jemi.

Profeti Lehi tha: “Kështu që, Zoti Perëndi e lejoi njeriun që ai të veprojë nga vetja e tij. Prandaj, njeriu nuk do të mund të vepronte nga vetja e tij, po të mos ishte që ai të joshej nga njëri ose tjetri.”⁵ Në një nivel themelor, njëra mundësi përfaqësohet nga Jezu Krishti, i Parëlinduri i Atit. Mundësia tjetër përfaqësohet nga Satani, Luciferi, i cili dëshiron ta shkatërrojë lirinë e zgjedhjes dhe të uzurpojë fuqi.⁶

Te Jezu Krishti ne “kemi një avokat te Ati”⁷. Pasi e kreu fljimin e Tij shlyes, Jezusi “u ngjit në qiell . . . për t'i kërkuar Atit të drejtat e tij të mëshirës që ai ka mbi fëmijët e njerëzve”. Dhe ngaqë i ka kërkuar të drejtat e mëshirës, “ai [e] përkrah çështjen e fëmijëve të njerëzve”⁸.



Ndërmjetësimi i Krishtit me Atin në emrin tonë nuk është në kundërshtim me planin. Jezu Krishti, i cili e lejoi vullnetin e Tij të shkrihej me vullnetin e Atit⁹, nuk do të përkrahte asgjë të ndryshme nga ajo që Ati ka dëshiruar gjatë gjithë kohës. Ati Qiellor pa dyshim brohoret dhe duartroket për sukseset tona.

Ndërmjetësimi i Krishtit është, të paktën pjesërisht, për të na kujtuar se Ai ka paguar për mëkatet tona dhe se askush nuk përjashtohet nga shtrirja e mëshirës së Perëndisë.¹⁰ Ata që besojnë te Jezu Krishti, pendohen, pagëzohen dhe durojnë deri në fund – një proces që çon drejt pajtimit¹¹ – Shpëtimtari i fal, i shëron dhe ndërmjetëson për ta. Ai është ndihmuesi, këshilluesi dhe ndërmjetësi – duke vërtetuar dhe garantuar pajtimin tonë me Perëndinë.¹²

Krejtësisht ndryshe, Luciferi është një paditës ose përndjekës. Gjon Zbuluesi e përshkroi humbjen përfundimtare të Luciferit: “Atëherë dëgjova një zë të madh në qiell që thoshte: ‘Tani arriti shpëtimi, fuqia dhe mbretëria e Perëndisë tonë, dhe pushteti i Krishtit të tij’”. Përse? Sepse u “hodh poshtë paditësi i vëllezërve tanë, ai që i padiste përpara Perëndisë tonë ditë e natë. Dhe ata e fituan atë me anë të gjakut të Qengjit, dhe me anë të falës së dëshmisë së tyre.”¹³

Luciferi është ky paditës. Ai foli kundër nesh në ekzistencën para lindjes

dhe vazhdon të na paditë në këtë jetë. Ai kërkon të na tërheqë poshtë. Ai dëshiron që ne të përjetojmë fatkeqësi pa fund. Është ai që na thotë se nuk jemi të përshtatshëm, është ai që na thotë se nuk jemi mjaft të mirë, është ai që na thotë se nuk ka shërim nga një gabim. Ai është kërcënuesi më i madh, është ai që na shkelmon kur jemi të rrëzuar përtokë.

Nëse Luciferi do të ishte duke e mësuar një fëmijë që të ecte dhe fëmija do të pengohej, ai do t’i bërtiste fëmijës, do ta ndëshkonte dhe do t’i thoshte të mos përipiqej më. Mënyrat e Luciferit sjellin shkurajim dhe dëshpërim – përfundimisht dhe përgjithmonë. Ky atë i gënjeshtrove është përçuesi më i madh i gjërave të rreme¹⁴ dhe djallëzisht vepron për të na mashtruar dhe për të na e shpërqendruar vëmendjen, “pasi ai kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë”¹⁵.

Nëse Krishti do të ishte duke e mësuar një fëmijë që të ecte dhe fëmija do të pengohej, Ai do ta ndihmonte fëmijën të ngrihej në këmbë dhe do t’i jepte zemër për të hedhur hapat vijues.¹⁶ Krishti është ndihmuesi dhe ngushëlluesi. Mënyrat e Tij sjellin gëzim dhe shpresë – më së fundi dhe përgjithmonë.

Plani i Perëndisë përfshin udhëzime për ne, të cilave shkrimet e shenjta u drejtohen si urdhërime. Këto urdhërime

nuk janë as një grumbull i çuditshëm, as një përmbledhje e paarsyeshme rregullash të detyrueshme që kanë si qëllim vetëm të na mësojnë se si të jemi të bindur. Ato lidhen me zhvillimin tonë të tipareve të perëndishmërisë, me kthimin tek Ati ynë Qiellor dhe marrjen e gëzimit të përherëshëm. Bindja ndaj urdhërimeve të Tij nuk është e verbër; ne në mënyrë të vetëdijshme e zgjedhim Perëndinë dhe shtegun e Tij drejt shtëpisë. Modeli për ne është i njëjtë sikurse ishte për Adamin dhe Evën, ku “Perëndia u dha atyre urdhërime, pasi u bëri të ditur planin e shëlbimit”¹⁷. Edhe pse Perëndia do që ne të jemi në shtegun e besëlidhjeve, Ai na jep dinjitetin që të zgjedhim.

Me të vërtetë, Perëndia dëshiron, pret dhe udhëzon që secili prej fëmijëve të Tij të zgjedhë për veten e vet. Ai nuk do të na detyrojë. Nëpërmjet dhuratës së lirisë së zgjedhjes, Perëndia i lejon fëmijët e Tij të “veprojnë për veten e tyre dhe të mos detyrohen të veprojnë”¹⁸. Liria e zgjedhjes na lejon të zgjedhim që të hyjmë në shteg, ose jo. Na lejon të largohemi prej tij, ose jo. Ashtu si nuk mund të na detyrojnë të bindemi, ne nuk mund të na detyrojnë të mos bindemi. Askush, pa bashkëpunimin tonë, nuk mund të na largojë nga shtegu. (Tani, kjo nuk duhet të ngatërrohet me ata njerëz të cilëve u dhunohet liria e zgjedhjes. Ato nuk janë



jashtë shtegut; ato janë viktima. Ata e marrin të kuptuarit, dashurinë dhe dhembshurinë e Perëndisë.)

Por, kur largohemi nga shtegu, Perëndia trishtohet ngaqë Ai e di se më së fundi, por pa asnjë përjashtim, kjo çon në lumturi të pakësuar dhe bekime të humbura. Në shkrimet e shenjta largimit nga shtegu i referohemi si mëkat dhe pakësimi i lumturisë që vjen si rrjedhojë, si dhe bekimet e humbura quhen ndëshkim. Në këtë kuptim, nuk është Perëndia që po na ndëshkon; ndëshkimi është pasojë e vetë zgjedhjeve tona, jo e zgjedhjeve të Tij.

Kur zbulojmë se jemi larguar nga shtegu, ne mund të qëndrojmë larg tij ose, për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, mund të zgjedhim të kthehemi mbrapsht dhe të hyjmë sërish në të. Në shkrimet e shenjta procesit të marrjes së vendimit për të ndryshuar shtegun dhe për t'u kthyer në shteg i referohemi si pendim. Kur nuk arrijmë të pendohejmë, kjo do të thotë që ne zgjedhim vetë të mos kualifikohemi për bekimet që Perëndia dëshiron të na i japë. Nëse “nuk [jemi] të gatshëm të gëzojmë] atë që mund të [kemi] marrë”, ne do të “kthehe[m]i . . . në vendin . . . [tonë], për të gëzuar atë që [jemi] të gatshëm të marri[m]”¹⁹ – zgjedhjen tonë, jo zgjedhjen e Perëndisë.

Pavarësisht se sa kohë kemi qenë larg shtegut ose sa larg jemi endur, në

çastin kur vendosim të ndryshojmë, Perëndia na ndihmon të kthehemi.²⁰ Sipas këndvështrimit të Perëndisë, nëpërmjet pendimit të sinqertë dhe shkuarjes përpara me vendosmëri në Krisht, pasi të kthehemi në shteg, do të jetë sikur të mos ishim larguar kurrë.²¹ Shpëtimtari shpague për mëkatet tona dhe na çliron nga pakësimi i pashmangshëm i lumturisë dhe bekimeve. Kësaj shkrimet e shenjta i referohen si falje. Pas pagëzimit, të gjithë anëtarët rrëshqasin jashtë shtegut – disa nga ne madje kërcejnë jashtë tij. Si rrjedhim, ushtrimi i besimit të Jezu Krishtit, pendimi, marrja e ndihmës prej Tij dhe marrja e faljes nuk janë ngjarje që ndodhin vetëm një herë, por procese gjatë gjithë jetës, procese që janë të përsëritura dhe të ngadalshme. Kjo është mënyra se si “durojmë] deri në fund”²².

Ne kemi nevojë të zgjedhim se kujt do t'i shërbejmë.²³ Shkalla e lumturisë sonë të përjetshme varet nga nga sa e zgjedhim Perëndinë e gjallë dhe bashkimin me Të në veprën e Tij. Teksa përpigëmi të bëjmë vetë “pjesën që pason”, ne e ushtrojmë përdorimin e lirisë sonë të zgjedhjes siç duhet. Sikurse thanë dy ish-Presidente të Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës, ne nuk duhet të jemi “fëmijë që kanë nevojë për vëmendje dhe korigjim gjithë kohën”²⁴. Jo, Perëndia dëshiron që ne të bëhemi të rritur të pjekur dhe ta qeverisim veten.

Zgjedhja për ta ndjekur planin e Atit është mënyra e vetme se si mund të bëhemi trashëgimtarë në mbretërinë e Tij; vetëm atëherë Ai mund të na mirëbesojë që madje as të mos e kërkojmë atë që është në kundërshtim me vullnetin e Tij.²⁵ Por na nevojitet të kujtojmë se “nuk ka njeri më të vështirë për ta mësuar sesa fëmija që di gjithçka”. Prandaj na nevojitet të jemi të gatshëm që të mësohemi sipas mënyrave të Zotit nga Zoti dhe shërbëtorët e Tij. Ne mund të mirëbesojmë se jemi fëmijë të dashur të Prindërve Qiellorë²⁶ për të cilët “ia vlen të marrësh mundimin që të shqetësohesh” dhe mund të jemi të sigurt se të jemi “vetëm”, nuk do të thotë kurrë “të vetmuar”.

Siç tha Profeti Jakob i Librit të Mormonit, unë them me të:

“Kështu që, gëzoni zemrat tuaja dhe kujtoni se ju jeni të lirë të veproni nga vetja juaj – të zgjidhni udhën e vdekjes së pafundme, ose udhën e jetës së përjetshme.

Kështu që, vëllezërit [dhe motrat] e mi[a] të dashur[a], pajtohuni me vullnetin e Perëndisë dhe jo me vullnetin e djallit . . . ; dhe kujtoni, se pasi të pajtoheni me Perëndinë, është vetëm dhe nëpërmjet hirit të Perëndisë që ju shpëtoni.”²⁷

Prandaj zgjidhni besim të Krishtit; zgjidhni pendim; zgjidhni të pagëzoheni dhe të merrni Frymën e Shenjtë; zgjidhni të përgatiteni në mënyrë të vetëdijshme për sakramentin dhe ta merrni atë me denjësi; zgjidhni të bëni besëlidhje në tempull; dhe zgjidhni t'u shërbeni Perëndisë së gjallë dhe fëmijëve të Tij. Zgjedhjet tona përcaktojnë se kush jemi dhe se kush do të bëhemi.

E përfundoj me pjesën tjetër të bekimit të Jakobit: “Kështu që, le t’ju ngrejë Perëndia nga . . . vdekja e pafundme nëpërmjet fuqisë së shlyerjes, që ju të mund të pranoheni në mbretërinë e përjetshme të Perëndisë”²⁸. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Personazhi artistik i Meri Popinsit i pati fillesat prej shkrimeve të Pamela Lindon Traversit. Librat e saj hodhën bazat për një film muzikor fantazie të vitit 1964, të prodhuar nga Walt Disney dhe për një përshtatje të mëvonshme në skenë të filmit.
2. Pjesa teatrale përfshin skenën e

- përshkruar. Shih *Libretto to Mary Poppins: The Broadway Musical*, f. 70.
3. Shih Spencer W. Kimball, në Konferencën Zonale të Brisbejnit 1976, f. 19. Presidenti Kimball u shpreh: "Pikërisht gjëja e parë që tha Zoti përpara se ta fillonim botën tonë këtu është: 'Do t'ju jap lirinë tuaj të zgjedhjes. Dua që burrat dhe gratë të jenë të fortë pasi është e drejtë të jenë të fortë. Nuk dëshiroj njerëz të plogësht të cilët janë të drejtë vetëm ngaqë detyrohen të jenë të drejtë.'"
 4. Shih, për shembull, Rasëll M. Nelson, "Teksa Ecim Përpara së Bashku", *Liahona*, prill 2018, f. 7. Shtegut të besëlidhjeve gjithashtu i referohen si plan lumturie (shih Alma 42:8, 16) dhe plan shëlbimi (shih Alma 12:25–35).
 5. 2 Nefi 2:16.
 6. Shih Moisiu 4:3.
 7. 1 Gjon 2:1; shih edhe Përkthimi prej Joseph Smith-it, 1 Gjon 2:1.
 8. Moroni 7:27, 28.
 9. Shih Mosia 15:7.
 10. Shih 1 Gjon 2:2.
 11. Shih 2 Korintasve 5:16–21; Kolosianëve 1:19–23; 2 Nefi 10:24.
 12. Fjala greke për avokat (*paraklētōs*) do të thotë ndërmjetës, ndihmues, ngushëllues ose këshillues (shih në Biblën në anglisht 1 John 2:1, poshtëshënimi *b*; *The New Strong's Expanded Exhaustive Concordance of the Bible* (1984), seksioni grek i fjalorit, f. 55; 2 Nefi 10:23–25; Doktrina e Besëlidhje 45:3–5.
 13. Zbulesa 12:10–11.
 14. Shih Ethëri 8:25.
 15. 2 Nefi 2:27; shih edhe 2 Nefi 2:6–8, 16, 26.
 16. Shih Fiona dhe Terryl Givens, *The Christ Who Heals* (2017), f. 29, 124. Për citimin origjinal, shih Anthony Zimmerman, *Evolution and the Sin in Eden* (1998), f. 160, duke cituar Denis Minns, *Irenaeus* (2010), f. 61.
 17. Alma 12:32.
 18. 2 Nefi 2:26; shih edhe 2 Nefi 2:16.
 19. Doktrina e Besëlidhje 88:32.
 20. Shih Alma 34:31.
 21. Shih 2 Nefi 31:20; Mosia 26:29–30; Doktrina e Besëlidhje 58:42–43; Bojd K. Paker, "Plani i Lumturisë", *Liahona*, maj 2015, f. 28. Presidenti Paker tha: "Kur procesi i pendimit është tërësor, asnjë shenjë nuk mbetet për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit".
 22. 2 Nefi 31:20.
 23. Shih Jozueut 24:15.
 24. Xhuli B. Bek, "Në Ato Ditë do të Përhap Frymën Time mbi Shërbëtorët", *Liahona*, maj 2010, f. 12; Motra Bek po citonte Eliza R. Snoun, fjalim në Shoqatën e Ndihmës të Lagjes Lihaj, 27 tetor 1869, Lagjia Lihaj, Kunji Allpajn (Juta), në Relief Society, Minute Book, 1868–1879, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejck-Siti, f. 26–27.
 25. Shih 2 Nefi 4:35; Helamani 10:5.
 26. Shih "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona*, maj 2017, f. 145.
 27. 2 Nefi 10:23–24.
 28. 2 Nefi 10:25.



Nga Plaku Xhek N. Xherard,
i Të Shtatëdhjetëve

Tani Është Koha

Nëse ka ndonjë gjë në jetën tuaj që keni nevojë ta shqyrtoni, tani është koha.

Disa vite më parë, ndërsa përgatitesha për një udhëtim pune, fillova të ndieja dhembje gjoksi. Nga shqetësimi për mua, bashkëshortja ime vendosi të më shoqëronte. Në fluturimin e parë të udhëtimit tonë, dhembja u shtua në pikën saqë e kisha të vështirë të merrja frymë. Kur u ulëm në tokë, dolëm nga aeroporti dhe shkuam te spitali vendor ku, pas shumë analizash, mjeku specialist njoftoi se ishte pa rrezik që ta vazhdonim udhëtimin tonë.

U kthyem në aeroport dhe morëm një fluturim për në vendmbërritjen tonë

përfundimtare. Ndërsa po zbritnim, piloti foli nga altoparanti dhe më kërkoi që të identifikohesha. Ndihmësja për fluturimin u afrua, tha se sapo kishin marrë një telefonatë urgjente dhe më tregoi se në aeroport gjendej një ambulancë që po priste për të më çuar në spital.

Hipëm në ambulancë dhe na çuan me nxitim në urgjencën vendore. Aty na takuan dy mjekë të shqetësuar, të cilët shpjeguan se më ishte vënë një diagnozë e gabuar dhe në fakt kisha një emboli serioze pulmonare apo një mpiksje gjaku në mushkëri, e cila





kërkonte përkujdesje të menjëhershme mjekësore. Ata na vunë në dijeni se shumë pacientë nuk i mbijetojnë kësaj gjendjeje shëndetësore. Mjekët, duke e ditur se ishim larg shtëpisë dhe të pasigurt a ishim të përgatitur për ngjarje të tilla që ta ndryshojnë kryekëput jetën, na thanë se nëse kishte ndonjë gjë në jetën tonë që kishim nevojë ta shqyrtonim, tani ishte koha.

Më kujtohet mirë se si pothuaj menjëherë në atë çast plot ankth, i tërë këndvështrimi im ndryshoi. Ajo çfarë dukej kaq e rëndësishme vetëm çaste më parë, më ngjallte pak interes tani. Mendja ime rendi larg rehatisë dhe shqetësimeve të kësaj jete drejt një këndvështrimi të përjetshëm – [te] mendimet për familjen, fëmijët, bashkëshorten time dhe përfundimisht te një vlerësim i vetë jetës sime.

Si ishte ecuria jonë si familje dhe individë? A po e jetonim jetën tonë në përputhje me besëlidhjet që kishim bërë dhe pritshmëritë e Zotit, apo mos ndoshta pa dashje kishim lejuar që shqetësimet e botës të na shpërquendronin nga ato gjëra që kanë më shumë rëndësi?

Unë do të doja t’ju ftoja të merrnit parasysh një mësim të rëndësishëm të marrë nga kjo përvojë: Të bëni një hap larg [shqetësimeve të] botës dhe ta vlerësoni jetën tuaj. Ose sipas fjalëve të mjekut, nëse ka ndonjë gjë në jetën tuaj që keni nevojë ta shqyrtoni, tani është koha.

Vlerësimi i Jetës Sonë

Ne jetojmë në një botë me mbingarkesë informacioni, të sunduar nga shpërquendime gjithnjë e më të mëdha që e bëjnë gjithmonë e më të vështirë të shqyrtosh përmes trazirës së kësaj jete dhe të përqendrohesh te gjërat me vlerë të përjetshme. Jeta jonë e përditshme bombardohet nga tituj kryeartikujsh që tërheqin vëmendje, të paraqitura nga teknologji që ndryshojnë me shpejtësi.

Përveçse nëse harxhojmë kohë për të reflektuar, ne mund të mos e kuptojmë ndikimin në jetën tonë të përditshme dhe në zgjedhjet që bëjmë, të këtij mjedisi që ecën shpejt. Ne mund ta shohim jetën tonë të konsumohet nga vrulle informacioni të paketuara në figura “meme”, materiale filmike dhe

tituj llamburitës kryeartikujsh. Ndonëse interesante dhe argëtuese, shumica prej këtyre kanë pak të bëjnë me përparimin tonë të përjetshëm, dhe prapëseprapë ato i japin formë mënyrës se si ne e shohim përvojën tonë në vdekshmëri.

Këto shpërquendime të botës mund të krahasohen me ato në ëndrën e Lehit. Teksa përparojmë nëpër shtegun e besëlidhjes me dorën tonë të kapur fort pas shufrës së hekurit, ne i dëgjojmë dhe i shohim ata që “tall[en] dhe . . . treg[ojnë] me gisht” që nga ndërtesa e gjerë dhe e madhe (1 Nefi 8:27). Ne mund të mos kemi ndër mend ta bëjmë atë me dashje, por ndonjëherë ne ndalojmë dhe e hedhim vështrimin tonë për të parë çfarë është gjithë ajo trazirë. Disa prej nesh mund edhe ta lëshojnë shufrën e hekurit dhe të shkojnë më afër për një pamje më të qartë. Të tjerë mund të largohen plotësisht nga udha “për shkak të atyre që po i përqueshnin” (1 Nefi 8:28).

Shpëtimtari na paralajmëroi që të “k[emi] kujdes që zemrat t[ona] të mos rëndohen nga . . . preokupimet e kësaj jete” (Lluka 21:34). Zbulesa moderne na kujton se shumë janë thirrur, por pak janë zgjedhur. Ata nuk janë zgjedhur “sepse zemrat e tyre vihen . . . mbi gjërat e kësaj bote dhe aspirojnë nderet e njerëzve” (Doktrina e Besëlidhje 121:35; shih edhe vargu 34). Vlerësimi i jetës sonë na jep mundësi që të bëjmë një hap larg botës, të reflektojmë në lidhje me atë se ku jemi për gjatë shtegut të besëlidhjeve dhe, nëse është e nevojshme, të bëjmë ndryshime për t’u siguruar që të kapemi fort e ta mbajmë shikimin përpara.

Kohët e fundit, në një takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, Presidenti Rasëll M. Nelson i ftoi të rinjtë e të rejat që të bënin një hap larg botës, të shkëputeshin nga mediat shoqërore duke mbajtur një agjërëm shtatëditor. Dhe vetëm mbrëmjen e djeshme, ai u bëri një ftesë të ngjashme motrave si pjesë e sesionit të grave të konferencës. Ai më pas u kërkoi të rinjve e të rejave që të vinin re ndonjë ndryshim te mënyra se si ndihen, tek ajo që mendojnë ose madje te mënyra se si mendojnë. Ai më pas i ftoi ata që të “bëni[n] një vlerësim tërësor

të jetës me Zotin . . . për t'u siguruar që këmbët [e tyre] të jenë ngulur fort në shategun e besëlidhjes". Ai i nixti që nëse kishte gjëra në jetën e tyre që nevojitej t'i ndryshonin, "sot është koha e përkryer për të ndryshuar"¹.

Në vlerësimin e gjërave në jetën tonë që nevojitet të ndryshojnë, ne mund t'i bëjmë vetes një pyetje praktike: Si ngrihemi mbi shpërqendrimet e kësaj bote dhe qëndrojmë të përqendruar te pikëvështrimi i përjetësisë para nesh?

Në një bisedë në konferencën e vitit 2007 të titulluar "Mirë, Më Mirë, Më e Mira", Presidenti Dallin H. Oaks dha mësim se si t'u japim përparësi zgjedhjeve tona mes shumë kërkesave tona kontradiktore tokësore. Ai këshilloi: "Duhet të heqim dorë nga disa gjëra të mira, që të mund të zgjedhim të tjera që janë më të mira ose më të mirat, sepse zhvillojnë besim tek Zoti Jezu Krisht dhe forcojnë familjet tona"².

Më lejoni të sugjeroj se gjërat më të mira në këtë jetë janë të përqendruara te Jezu Krishti dhe tek të kuptuarit e të vërtetave të përjetshme se kush është Ai dhe kush jemi ne në marrëdhënien tonë me Të.

Kërkojeni të Vërtetën

Teksa kërkojmë ta njohim Shpëtimtarin, ne nuk duhet të anashkalojmë të vërtetën themelore se kush jemi dhe përse jemi këtu. Amuleku na kujton se "kjo jetë është koha . . . që të përgatite[m]i të takohe[m]i me Perëndinë", koha "që na është dhënë për t'u përgatitur për përjetësi[në]" (Alma 34:32-33). Ashtu siç na kujton aksioma e mirënjohur: "Ne nuk jemi qenie njerëzore që po kalojmë një përvojë shpirtërore. Ne jemi qenie shpirtërore që po kalojmë një përvojë njerëzore."³

Të kuptuarit e prejardhjes sonë hyjnore është thelbësor për përparimin tonë të përjetshëm dhe mund të na çlirojë nga shpërqendrimet e kësaj jete. Shpëtimtari dha mësim:

"Nëse do të qëndroni në fjalën time, jeni me të vërtetë dishepujt e mi; do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë të lirë" (Gjoni 8:31-32).

Presidenti Jozef F. Smith shpalli: "Arritja më e madhe që njerëzimi mund



të bëjë në këtë botë, është që njerëzit ta familjarizojnë veten me të vërtetën hyjnore, aq tërësisht, aq përsosurisht, sa shembulli apo sjellja e asnjë krijese të gjallë në botë nuk mund t'i largojë kurrë nga njohuria që kanë fituar"⁴.

Në botën sot, debati për të vërtetën ka arritur një pikë të nxehtë, ku të gjitha palët shprehin pretendime për të vërtetën sikur ajo të ishte një koncept relativ i hapur për interpretim individual. Djaloshi i ri Jozef Smith zbuloi se "kaq e madhe ishte ngatërresa dhe grindja" në jetën e tij, "sa ishte e pamundur . . . të arri[n]te në njëfarë përfundimi se kush kishte të drejtë dhe kush ishte gabim" (Joseph Smith – Historia 1:8). Ishte "në mes të kësaj lufte fjalësh dhe ngatërrese opinionesh" që ai kërkoi udhëheqje hyjnore duke kërkuar të vërtetën (Joseph Smith – Historia 1:10).

Në konferencën e prillit, Presidenti Nelson dha mësim: "Nëse duam të kemi ndonjë shpresë për ta shoshitur morinë e zërave dhe filozofive të njerëzve që e sulmojnë të vërtetën, ne duhet të mësojmë të marrim zbulësë"⁵. Ne duhet të mësojmë të mbështetemi te Shpirti i së Vërtetës, të cilin "bota nuk mund ta marrë, sepse nuk e sheh dhe nuk e njeh" (Gjoni 14:17).

Ndërsa kjo botë lëviz me vrik drejt realiteteve të tjera, ne duhet të kujtojmë

fjalët e Jakobit se "Shpirti flet të vërtetën dhe nuk gënjen. Prandaj, ai flet për gjëra ashtu siç janë në të vërtetë dhe për gjëra ashtu siç do të jenë në të vërtetë; prandaj, këto gjëra janë shfaqur te ne qartësisht, për shpëtimin e shpirttrave tanë" (Jakobi [LiM] 4:13).

Teksa bëjmë një hap larg botës dhe e vlerësojmë jetën tonë, tani është koha për të shqyrtuar se çfarë ndryshimesh kemi nevojë të bëjmë. Ne mund të marrim shpresë të madhe nga njohuria se Modeli ynë shembullor, Jezu Krishti, na e ka prirë edhe një herë udhën. Përpara vdekjes dhe Ringjalljes së Tij, teksta po punonte për t'i ndihmuar njerëzit rreth vetes ta kuptonin rolin e Tij hyjnor, Ai u kujtoi atyre: "Ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën" (Gjoni 16:33). Për Atë unë jap dëshmi, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, "Shpresa e Izraelit" (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), HopeofIsrael.lds.org.
2. Dallin H. Oaks, "Mirë, Më Mirë, Më e Mira", *Liahona*, nëntor 2007, f. 107.
3. Shpesh i atribuohet Pierre Teilhard de Chardun.
4. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 42.
5. Rasëll M. Nelson, "Zbulësë për Kishën, Zbulësë për Jetën Tonë", *Liahona*, maj 2018, f. 96.



Nga Plaku Geri E. Stivenson,
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kujdestaria si një Bari për Shpirtrat

Ne u shkojmë të tjerëve në ndihmë, sepse kjo është ajo që na urdhëroi Shpëtimtari të bëjmë.

Në një bashkëbisedim të kohëve të fundit me një shok timin, ai më tha se kur ishte i vogël, anëtar i sapopagëzuar i Kishës, ai papritur u ndje sikur nuk i përkiste më lagjes së tij. Misionarët që i kishin dhënë mësimet, ishin transferuar larg dhe ai u ndje sikur ishte i papërfillur. Pa miq në lagje, ai gjeti miqtë e tij të vjetër dhe u përfshi me ta në veprimtari që e larguan nga pjesëmarrja në kishë – aq shumë sa filloi të dilte nga grigja. Me lot në sy, ai përshkroi se sa thellësisht mirënjohës kur një bashkanëtar i lagjes i zgjati një dorë shërbestare dhe, në një mënyrë të ngrohtë dhe përfshirëse, e ftoi të rikthehej. Brenda disa muajve ai u kthye në sigurinë e grigjës, duke forcuar njerëz të tjerë dhe veten. A nuk jemi mirënjohës për bariun në Brazil i cili shkoi për ta kërkuar të riun, Plakun Karlos A. Godoi, i cili tani është ulur prapa meje si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve?

A nuk është mbresëlënëse mënyra se si përpjekje të tilla të vogla mund të kenë pasoja të përjetshme? Kjo e vërtetë është në thelbin e përpjekjeve shërbestare të Kishës. Ati Qiellor mund t'i marrë përpjekjet tona të thjeshta, të përditshme dhe t'i kthejë ato në diçka

mrekullibërëse. Kanë kaluar vetëm gjashtë muaj qëkur Presidenti Rasëll M. Nelson njoftoi se “Zoti ka bërë përshtatje të rëndësishme në mënyrën se si përkujdesemi për njëri-tjetrin”¹, duke shpjeguar: “Do të vëmë në zbatim një qasje më të re, më të shenjtë ndaj përkujdesjes e dhënies së shërbesës për të tjerët. Këtyre përpjekjeve do t’iu referohemi thjesht si ‘dhënia e shërbesës’.”²

Presidenti Nelson shpjegoi gjithashtu: “Një tipar dallues i Kishës së vërtetë dhe të gjallë të Zotit do të jetë gjithmonë një përpjekje e organizuar,



e drejtuar për t’u dhënë shërbesë fëmijëve individualë të Perëndisë dhe familjeve të tyre. Ngaqë kjo është Kisha e Tij, ne si shërbëtorë të Tij do t’i japim shërbesë individit, pikërisht siç bëri Ai. Ne do të japim shërbesë në emër të Tij, me fuqinë dhe autoritetin e Tij dhe me mirësinë e Tij plot dashuri.”³

Që nga [ai] lajmërim, reagimi juaj ka qenë i pabesueshëm! Kemi marrë raportime për sukses të madh në vënie në zbatim të këtyre ndryshimeve pothuajse në çdo kunj në botë, sikurse u udhëzua nga profeti ynë i gjallë. Për shembull, familjeve u janë caktuar vëllezër dhe motra shërbestare, janë organizuar dyshe shoqëruese – përfshirë të rinjtë e të rejtat – dhe po ndodhin intervista për dhënien e shërbesës.

Nuk mendoj se është një rastësi që gjashtë muaj para shpalljes së djeshme zbuluese – “një baraspeshë [të] re me udhëzimit për ungjillin në shtëpi dhe atij në kishë”⁴ – u dha shpallja zbuluese mbi dhënien e shërbesës. Duke filluar nga janari, ndërsa shpenzojmë një orë më pak në adhurimin në kishë, e gjitha ajo që kemi mësuar gjatë dhënies së shërbesës do të na ndihmojë ta baraspeshojmë sërish atë boshllëk me një përvojë më të lartë dhe më të shenjtë Shabati të përqendruar në shtëpi, me familjen dhe me njerëzit tanë të dashur.

Me këto strukturime organizative që po vihen në funksionim, ne mund të pyetim: “Nga e dimë se po japim shërbesë sipas mënyrës së Zotit? A po i vijmë në ndihmë Bariut të Mirë sipas mënyrës që Ai ka për qëllim?”

Në një diskutim kohët e fundit, Presidenti Henri B. Ajring i lëvdoi shenjtorët që iu përshtatën këtyre ndryshimeve të dukshme, por shprehu edhe shpresën e tij të sinqertë që anëtarët do ta dallojnë se dhënia e shërbesës është më shumë sesa “thjesht të qenit i sjellshëm”. Kjo nuk do të thotë se të qenit i sjellshëm është e parëndësishme, por ata që e kuptojnë frymën e vërtetë të dhënies së shërbesës, e kuptojnë se kjo shkon shumë më larg sesa thjesht të qenit i sjellshëm. Kur bëhet sipas mënyrës së Zotit, dhënia e shërbesës mund të ketë një ndikim të gjerë veprimi për mirë që shtrihet gjatë gjithë përjetësisë,

sikurse ka ndodhur me Plakun Godoi.

“Shpëtimtari tregoi me anë të shembullit çfarë do të thotë të japësh shërbesë, teksa Ai shërbeu nga dashuria . . . Ai . . . dha mësim, u lut për njerëzit përreth Tij, i ngushëlloi dhe i bekoj ata, duke i ftuar të gjithë ta ndiqnin Atë. . . . Kur anëtarët e Kishës japin shërbesë [në një mënyrë më të lartë e të shenjtë], ata plot lutje kërkojnë të shërbejnë sikurse shërbeu Ai – . . . ‘të vëzhgoj[në] mbi kishën gjithmonë dhe të je[në] me ta e t’i forcoj[në] ata’, ‘të vizitoj[në] shtëpinë e çdo anëtari’ dhe ta ndihmojnë çdo anëtar që të bëhet dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit.”⁵

Ne e kuptojmë se një bari i vërtetë i do delet e tij, e njeh secilën me emër dhe “interesohet personalisht” për to.⁶

Miku im i vjetër e kaloi jetën si pronar ferme, duke bërë punën e rëndë të rritjes së bagëtisë dhe deleve në Malet e thepisura Shkëmbore. Ai një herë më tregoi për sfidat dhe rreziqet që lidhen me rritjen e deleve. Ai më përshkroi se në fillim të pranverës, kur bora kishte shkrirë më së shumti mbi hapësirën e gjerë malore, ai e vendoste kopenë e familjes prej përafërsisht 2000 delesh në male për periudhën e verës. Atje, ai i vëzhgonte delet deri në fund të vjeshtës, kur lëviznin nga kullota e verës në një kullotë dimërore në shkretëtirë. Ai e përshkroi sa e vështirë qe përkujdesja për një grigjë të madhe delesh, që i kërkonte zgjim herët dhe fjetje natën vonë – duke u zgjuar mjaft kohë para lindjes së diellit dhe duke e mbaruar punën shumë kohë pasi errësohej. Ai nuk mundej kurrsesi t’ia dilte i vetëm.

Njerëz të tjerë e ndihmonin të kujdesej për grigjën, përfshirë një larmi punëtorësh ferme me përvojë që ndihmoheshin nga punëtorë më të rinj në moshë të cilët përfitonin nga urtësia e shokëve të tyre të punës. Ai gjithashtu mbështetej te dy kuaj të vjetër, dy mëza në stërvitje e sipër, dy qen të vjetër stani dhe dy ose tre këlyshë të qenve të stanit. Gjatë verës, miku im dhe delet e tij përballëshin me erë dhe furtunë, sëmundje, dëmtime, thatësi dhe pothuajse çdo vështirësi tjetër që mund të përfytyrohet nga dikush. Disa vjet atyre iu desh të bartnin ujë gjithë verën vetëm për t’i



mbajtur gjallë delet. Më pas, çdo vit në fund të vjeshtës, kur moti dimëror bëhej kërcënues dhe i zbritnin nga mali e i numëronin delet, zakonisht kishin humbur më shumë se 200.

Tufa prej 2000 delesh kur vendosej nëpër male në fillim të pranverës zvogëlohej në më pak se 1800. Shumica e deleve që mungonin *nuk* u humbën prej sëmundjes ose vdekjes natyrale, por prej grabitqarëve të tillë si macet e egra ose ujqërit e stepave të Amerikës. Këta grabitqarë zakonisht i gjenin qengjat që ishin endur larg nga siguria e grigjës, duke u larguar nga mbrojtja e bariut të tyre. A mund ta merrni parasysh për një çast këtë që sapo përshkrova në një kontekst shpirtëror? Kush është bariu? Kush është grigja? Cilët janë ata që i vijnë në ndihmë bariut?

Vetë Zoti Jezu Krisht tha: “Unë jam bariu i mirë, dhe i njoh delet e mia dhe . . . lë jetën time për delet”⁷.

Profeti Nefi po ashtu dha mësim se Jezusi “do [t’i] ushqejë delet e tij dhe në të ato do të gjejnë kullotë”⁸. Unë gjej paqe të qëndrueshme te dijenia se “Zoti është bariu *im*”⁹ dhe se Ai e njeh dhe e ka nën kujdesin e Tij secilin prej nesh. Kur përballemi me erë dhe furtunë, sëmundje, dëmtime e thatësi në jetë, Zoti – Bariu ynë – do të na japë shërbesë. Ai do t’i rimëkëmbë shpirtat tanë.

Në të njëjtën mënyrë si u kujdes miku im për delet e tij me ndihmën e punëtorëve të rinj e të moshuar të fermës, të kuajve e të qenve të stanit,

edhe Zoti kërkon ndihmë për punën sfiduese të përkujdesjes për delet në grigjën e Tij.

Si fëmijë të një Ati të dashur Qiellor dhe si dele në grigjën e Tij, ne gëzojmë bekimin e marrjes së shërbesës individuale nga Jezu Krishti. Në të njëjtën kohë, kemi përgjegjësi për t’u siguruar ndihmë me anë të shërbesës njerëzve të tjerë përreth nesh duke qenë vetë barinj. Ne ua vëmë veshin fjalëve të Zotit: “Do të më shërbesh dhe do të shkosh në emrin tim dhe do të mbledhësh tok delet e mia”¹⁰.

Kush është bari? Çdo burrë, grua dhe fëmijë në mbretërinë e Perëndisë është bari. Nuk kërkohet asnjë thirrje për këtë. Nga çasti kur dalim nga ujërat e pagëzimit, ne jemi të ngarkuar me këtë punë. Ne u shkojmë të tjerëve në ndihmë, sepse kjo është ajo që na urdhëroi Shpëtimtari të bëjmë. Alma theksoi: “Pasi, ç’bari . . . që ka shumë dele . . . nuk kujdeset për to, që ujëqit të mos hyjnë dhe të përpijnë grigjën e tij? . . . A nuk [i] dëbon ai at[a]?”¹¹ Sa herë që fqinjët tanë kanë shqetësime materiale ose shpirtërore, ne vrapojmë për t’i ndihmuar. Ne mbajmë barrët e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta. Vajtojmë me ata që vajtojnë. I ngushëlojmë ata që kanë nevojë për ngushëllim.¹² Zoti plot dashuri, e pret këtë prej nesh. Dhe do të vijë dita kur do të mbajmë përgjegjësi për kujdesin që tregojmë në dhënien e shërbesës për grigjën e Tij.¹³



Një qen stani i vendosur i udhëheq delet e humbura sërish drejt sigurisë së bariut dhe të tufës.

Miku im bari tregoi një element tjetër të rëndësishëm në vrojtimin ruajtës të deleve në kullotë. Ai përshkroi se delet e humbura qenë veçanërisht të cenueshme nga rreziqet e grabitqarëve. Në fakt, deri në 15 përqind e gjithë kohës së tij dhe të skuadrës së tij i përkushtohet gjetjes së deleve të humbura. Sa më shpejt t'i gjenin delet e humbura, përpara se delet të endeshin tepër larg grigjës, aq më pak gjasë kishte që delet të dëmtoheshin. Shpëtimi i deleve të humbura kërkon shumë durim dhe disiplinë.

Disa vjet më parë, gjeta një artikull në një gazetë vendore që ma zgjoi aq shumë kureshtjen, sa e ruajta. Titulli kryesor i faqes së parë thoshte: “Një Qen i Vendosur Nuk Pranon t'i Braktisë Delet e Humbura”¹⁴. Ky artikull përshkruan një numër të vogël delesh që i përkitnin një ferme jo larg pronës së mikut tim, që ishin lënë disi prapa në kullotën verore. Dy ose tre muaj më vonë, ato ngecën nëpër shkëmbinj dhe u bllokuan nga dëborë e maleve. Kur delet mbetën prapa, qeni i stanit qëndroi

me to, sepse ishte detyra e tij që të kujdesej për delet e t'i mbronte ato. Ai nuk donte të ndalonte së bëri rojë! Ai qëndroi atje – duke u vërtitur për qark deleve të humbura për disa muaj në motin e ftohtë dhe me dëborë, duke shërbyer si mbrojtje kundër ujçërve, maceve të egra ose çdo grabitqari tjetër që do t'i dëmtonte delet. Ai qëndroi atje derisa që në gjendje t'i udhëhiqte ose mblidhte përsëri tok delet drejt sigurisë së bariut dhe të grigjës. Pamja e kapur në faqen e parë të këtij artikulli bën të mundur që çdokush të shohë forcë karakteri në sytë dhe sjelljen e këtij qeni stani.

Në Dhiatën e Re ne gjejmë një shëmbëlltyrë dhe udhëzim nga Shpëtimtari që japin këndvështrim të mëtejshëm lidhur me përgjegjësinë tonë si barinj, motra e vëllezër shërbetarë, të deleve të humbura:

“Cili njeri prej jush, që ka njëqind dele dhe një prej tyre t'i humbasë, nuk i lë të nëntëdhjetë e nëntat në shkretirë dhe nuk shkon pas asaj që humbi deri sa ta gjejë?

Dhe, kur e gjen, e merr mbi supë gjithë gaz;

dhe, kur arrin në shtëpi, i thërret miqtë dhe fqinjët dhe u thotë: ‘Gëzohuni bashkë me mua, sepse e gjeta delen time që më kishte humbur.’¹⁵

Teksa e përmbledhin mësimin që morëm në shëmbëlltyrë, ne gjejmë këtë këshillë të vlefshme:

1. Ne duhet t'i identifikojmë delet e humbura.
2. I kërkojmë ato derisa t'i kemi gjetur.
3. Kur i gjejmë, mund të na duhet t'i marrim mbi supë për t'i sjellë në shtëpi.
4. I rrethojmë ato me miq pas kthimit të tyre.

Vëllezër dhe motra, sfidat tona më të mëdha dhe shpërblimet tona më të mëdha mund të vijnë teksa u japim shërbesë deleve të humbura. Anëtarët e Kishës në Librin e Mormonit “u kujdesën për njerëzit e tyre dhe i ushqyen me gjëra që kishin të bënin me drejtësinë”¹⁶. Ne mund ta ndjekim shëmbëllimin e tyre dhe ta mbajmë mend që dhënia e shërbesës duhet të “udhëhiqet nëpërmjet Shpirtit, . . . [të jetë] e ndryshueshme dhe [të] përshtatet sipas nevojave të secilit anëtar”. Është gjithashtu thelbësore që ne të “përpiqemi t'i ndihmojmë individët dhe familjet që të përgatiten për ordinancën e tyre të ardhshme, që t'i mbajnë besëlidhjet [e tyre] dhe që të bëhen të mbështetur te vetja”¹⁷.

Çdo shpirt është i çmuar për Atin tonë Qiellor. Ftesa e Tij vetjake për të dhënë shërbesë është me vlerë dhe rëndësi të skajshme për Të, pasi kjo është vepra dhe lavdia e Tij. Është me plot kuptimin e fjalës vepra e përjetësisë. Secili prej fëmijëve të Tij ka një potencial të pallogaritshëm në sytë e Tij. Ai *ju* do me një dashuri që ju nuk mundeni as të filloni ta kuptoni. Njësoj si qeni i përkushtuar i stanit, Zoti do të qëndrojë në mal për *t'ju* mbrojtur gjatës erës, furtunave, dëborës dhe *më shumë* se kaq.

Presidenti Rasëll M. Nelson na mësoi në konferencën e fundit: “Mesazhi ynë drejtuar botës [dhe më lejoni të shtoj

‘drejtuar grigjës sonë shërbestare’ është i thjeshtë dhe i sinqertë: ne i ftojme të gjithë fëmijët e Perëndisë *në të dyja anët e velit* të vijnë te Shpëtimtari i tyre, të marrin bekimet e tempullit të shenjtë, të kenë gëzim të përhershëm dhe të kualifikohen për jetën e përjetshme”¹⁸.

E ngritshim vështrimin tonë në lartësinë e këtij vegimi profetik që të mund t’u prijme udhën si barinj shpirtrave drejt tempullit dhe përfundimisht te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti! Ai nuk pret që ne të bëjmë mrekulli. Ai kërkon vetëm që ne t’i sjellim vëllezërit dhe motrat tona tek Ai, sepse *Ai* e ka fuqinë për t’i shëlbuar shpirtrat. Teksa e bëjmë këtë, ne mundemi dhe do ta sigurojmë këtë premtim: “Dhe kur të shfaqet kryebariu, do të merrni kurorën e lavdisë që nuk fishket”¹⁹. Për këtë unë dëshmoj – dhe për Jezu Krishtin si Shpëtimtarin dhe Shëlbuesin tonë – në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, “Punës Le t’i Vihemi”, *Liahona*, maj 2018, f. 118.
2. Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës”, *Liahona*, maj 2018, f. 100.
3. Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë”, *Liahona*, maj 2018, f. 69–70.
4. Rasëll M. Nelson, “Fjalët e Hapjes”, *Liahona*, nëntor 2018, f. 8.
5. “Dhënia e Shërbesës me Kuorume të Përforuara të Priftërisë Melkizedeke dhe Shoqata të Përforuara të Ndihmës”, shtojcë e letrës së Presidencës së Parë e datës 2 prill 2018, f. 3, ministering.lds.org; Mosia 18:9; Doktrina e Besëlidhje 20:51, 53; shih edhe Gjoni 13:35.
6. James E. Talmage, *Jesus the Christ* (1916), f. 417.
7. Gjoni 10:14–15.
8. 1 Nefi 22:25.
9. Psalmeve 23:1; theksimi i shtuar.
10. Mosia 26:20.
11. Alma 5:59.
12. Shih Mosia 18:8–9.
13. Shih Mateu 25:31–46.
14. Shih John Wright, “Safe or Stranded? Determined Dog Won’t Abandon Lost Sheep”, *Logan Herald Journal*, 10 janar 2004, hjnews.com.
15. Lluca 15:4–6.
16. Mosia 23:18.
17. “Dhënia e Shërbesës me Kuorume të Përforuara të Priftërisë Melkizedeke dhe Shoqata të Përforuara të Ndihmës”, f. 4, 5, ministering.lds.org.
18. Rasëll M. Nelson, “Punës Le t’i Vihemi”, f. 118–119; theksimi i shtuar.
19. 1 Pjetër 5:4.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Të Bëhemi Shenjtorë Shembullorë të Ditëve të Mëvonshme

Unë lë mbi ju dashurinë dhe bekimin tim, që ju të mund të ushqeheni me bollëk me fjalën e Zotit dhe t’i vini në zbatim mësimet e Tij në jetën tuaj vetjake.

Kjo ka qenë një konferencë frymëzuese dhe historike. Ne shohim drejt së ardhmes me entuziazëm. Kemi marrë shtysë që të *bëjmë* më mirë dhe të *jemi* më të mirë. Mesazhet e mrekullueshme, të dhëna nga kjo foltore nga Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit tanë të Përgjithshëm, si dhe muzika, kanë qenë frymëzuese. Unë ju nxit t’i studioni këto mesazhe, duke filluar që këtë javë.¹ Ato shprehin mendjen dhe vullnetin e Zotit për popullin e Tij, sot.

Programi i ri dhe i harmonizuar mësimor, i përqendruar te shtëpia dhe i përkrahur nga Kisha, ka fuqinë ta çlirojë forcën e familjeve, teksa secila familje vijon me vetëdije dhe me kujdes që ta shndërrorë shtëpinë e vet në një shenjtorë besimi. Ju premtoj që, teksa ju punoni me zell për ta shndërruar shtëpinë tuaj në një qendër të të mësuarit të ungjillit, me kalimin e kohës, ditët *tuaja* të Shabatit, me të vërtetë do të jenë një kënaqësi. Fëmijët *tuaj* do të ngazëlleshin që t’i mësojnë dhe jetojnë

mësimet e Shpëtimtarit dhe ndikimi i kundërshtarit në jetën *tuaj* dhe në shtëpinë *tuaj* do të pakësohet. Ndryshimet në familjen tuaj do të jenë thelbësore dhe mbështetëse.

Gjatë kësaj konference, e kemi forcuar vendosmërinë tonë që ta zbatojmë përpjekjen thelbësore për ta nderuar Zotin Jezu Krisht *çdo* herë që i referohemi Kishës së Tij. Ju premtoj se vëmendja jonë e repretë, për ta përdorur





emrin e saktë të Kishës së Shpëtimtarit dhe anëtarëve të saj, do të çojë në besim më të madh dhe në të drejtë për të përdorur fuqi shpirtërore më të madhe për anëtarët e Kishës së Tij.

Tani le t'i kthehemi temës së tempujve. E dimë se koha jonë e kaluar në tempull është vendimtare për shpëtimin dhe ekzaltimin tonë dhe për atë të familjeve tona.

Pasi i marrim vetë ordinancat tona të tempullit dhe bëjmë besëlidhje të shenjta me Perëndinë, secili prej nesh ka nevojë për forcimin dhe udhëzimin e vazhdueshëm shpirtëror, që janë të mundur *vetëm* në shtëpinë e Zotit. Dhe paraardhësit tanë kanë nevojë që ne të shërbejmë si mëkëmbës për ta.

Merrini parasysh mëshirën dhe paanësinë e madhërishtme të Perëndisë, i cili, që përpara krijimit të botës, siguroi një mënyrë për t'ua dhënë bekimet e tempullit atyre që ndërjuan jetë pa një njohuri për ungjillin. Këto rite të shenjta të tempullit, janë të lashta. Për mua, fakti që janë të lashta, është emocionues dhe një provë tjetër e vërtetësisë së tyre.²

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, sulmet e kundërshtarit po shtohen në mënyrë eksponenciale, për nga intensiteti dhe larmia.³ Nevoja jonë për të qenë në tempull rregullisht dhe shpesh nuk ka qenë kurrë më e madhe. Ju përgjrohëm ta merrni parasysh plot

lutje mënyrën se si e shpenzoni kohën tuaj. Kushtojani kohën të ardhmes suaj dhe asaj të familjes suaj. Nëse keni mjaftueshëm afër një tempull, ju nxit të gjeni një mënyrë për të lënë një takim rregullisht me Zotin – për të qenë në shtëpinë e Tij të shenjtë – dhe pastaj shkoni në atë takim me përpikëri dhe gëzim. Ju premtoj se Zoti do t'i sjellë mrekullitë që Ai e di se ju nevojiten teksa bëni sakrifica për të shërbyer dhe adhuruar në tempujt e Tij.

Aktualisht ne kemi 159 tempuj të përkushtuar. Kujdesi dhe mirëmbajtja e duhur e atyre tempujve është shumë e rëndësishme për ne. Me kalimin e kohës tempujt kanë nevojë në mënyrë të pashmangshme për rifreskim dhe ripunime. Për këtë arsye, tani po bëhen plane për të përtëritur dhe përditësuar Tempullin e Solt-Lejkut dhe tempujt të tjerë të kohës së pionierëve. Hollësitë për këto projekte do të shpërndahen ndërsa zhvillohen.

Sot kemi kënaqësinë të shpallim planet për të ndërtuar 12 tempujt të tjerë. Këta tempuj do të ndërtohen në vendet në vijim: Mendoza, Argjentinë; Salvador, Brazil; Juba-Siti, Kaliforni; Pnom-Pen, Kamboxhia; Praija, Kepi i Gjellbër; Zhigo, Guam; Puebla, Meksikë; Okland, Zelandë e Re; Lagos, Nigeri; Davao, Filipine; San-Huan, Porto-Riko dhe Konteja Uashington, Jutë.

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e tempujve mund të mos ta ndryshojnë jetën tuaj, por kalimi i kohës suaj në tempull sigurisht që do ta ndryshojë. Ju që nuk e keni vizituar prej shumë kohësh tempullin, ju nxit të përgatiteni e të ktheheni sa më shpejt të jetë e mundur. Pastaj ju ftoj të adhuroni në tempull dhe të luteni për ta ndier thellësisht dashurinë e pafundme të Shpëtimtarit për ju, që secili prej jush të mund ta fitojë dëshminë e vet që Ai e drejton këtë punë të shenjtë dhe të amshuar.⁴

Vëllezërit dhe motrat e mia, ju falënderoj për besimin dhe përpjekjet tuaja mbështetëse. Unë lë mbi ju dashurinë dhe bekimin tim, që ju të mund të ushqeheni me bollëk me fjalën e Zotit dhe t'i vini në zbatim mësimet e Tij në jetën tuaj vetjake. Ju siguroj se zbulosa vazhdon në Kishë dhe do të vazhdojë derisa “qëllimet e Perëndisë të përmbushen dhe Jehova i Madh të thotë se puna u krye”⁵.

Ju bekoj me besim të shtuar tek Ai dhe te puna e Tij e shenjtë, me besim dhe këmbëngulje për t'i duruar sfidat tuaja vetjake në jetë. Ju bekoj që të bëheni shenjtore shembullorë të ditëve të mëvonshme. Kështu ju bekoj dhe jap dëshminë time se Perëndia jeton! Jezusi është Krishti! Kjo është Kisha e Tij. Ne jemi populli i Tij, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih mesazhet e konferencës së përgjithshme në internet në LDS.org dhe në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit]. Atë do të shtypen në revistat *Ensign* dhe *Liahona*. Revistat e Kishës, përfshirë *New Era* dhe *Friend*, të dërguara me postë apo të shkarkuara në internet, janë pjesë e rëndësishme të programit tuaj mësimor për ungjillin, të përqendruar te shtëpia.
2. Shih, për shembull Eksodi 28; 29; Levitiku 8.
3. Shih Mosia 4:29.
4. Shih Wilford Woodruff, “The Law of Adoption”, fjalim i mbajtur në konferencën e përgjithshme të Kishës, 8 prill 1894. Presidenti Udraf tha: “Ne nuk kemi mbaruar [me] zbulësën. Ne nuk kemi mbaruar [me] punën e Perëndisë. . . . Nuk do të ketë fund për këtë punë derisa të përsoset” (*Deseret Evening News*, 14 prill 1894, f. 9).
5. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 147.

Lista vijuese e përvojave të përzgjedhura, të treguara gjatë konferencës së përgjithshme, mund të përdoret për studim vetjak, mbrëmje familjare dhe mësimdhënie tjetër. Numri i referohet faqes së parë të bisedës.

Folësi	Ngjarja
Nil L. Andersen	(83) Duke e perceptuar se Shpëtimtari e njej vuajtjen e tij, një misionar besnik e kapërcen zhgënjimin ndërsa merr veten nga plagët që pësoi nga bombat e vëna nga terroristët. Pas vdekjes të së bijës, Rasëll M. Nelsoni beson se Jezu Krishti do t'i përdorë çelësat e ringjalljes në emër të të gjithë atyre që ndërrojnë jetë. Rasëll M. Nelsoni u dëshmon anëtarëve në Puerto-Riko se "ne mund të gjejmë gëzim madje në mes të rrethanave tona më të rënda".
Brajën K. Ashton	(93) Bashkëshortja e Brajën K. Ashtonit arrin ta kuptojë më mirë natyrën e Perëndisë dhe dashurinë e mirënjohjen e Tij për fëmijët e Vet.
M. Rasëll Ballard	(71) Pasi përjetoj një dhembje kaq të madhe për vdekjen e pjesëtarëve të familjes dhe miliona njerëzve që ndërruan jetë prej luftës dhe sëmundjeve, Jozef F. Smithi merr "vegim[n] e] shëlbimit të të vdekurve".
Stiven R. Bangerter	(15) Nipërit dhe mbesat e Stiven R. Bangerterit gropisin gurë që përfaqësojnë Jezu Krishtin si themelin e një jete të lumtur. Presidenti Rasëll M. Nelson u kujton prindërve përgjegjësinë për t'u dhënë mësim fëmijëve të tyre. Djali i Stiven R. Bangerterit ofron që të ndihmojë prindërit e tij të përgatiten për të shërbyer në një mision. Fryma e Shenjtë e udhërrëfen një burrë në moshë sërisht në Kishë dhe te siguria shpirtërore e fëmijërisë së tij.
Shein M. Bouen	(80) Kthimi në besim i një burri për në Kishë nëpërmjet fuqisë së Librit të Mormontit i lë shumë mbresa Shein M. Bouenit.
M. Xhozef Brof	(12) Në një aventurë në Alaskë të SHBA-së, M. Xhozef Brofi mëson se me Perëndinë asgjë s'është e pamundshme. Një president kunji mëson se paqja vjen me faljen nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit. Nga dëshira e saj për të shërbyer në një mision, vajza e M. Xhozef Brofit i mëson atij të bëjë gjëra të vështira.
Methju L. Karpenter	(101) Djali i Methju L. Karpenterit e përfundon misionin e tij kohëplotë pasi shërohet nga ishemia cerebrale.
D. Tod Kristoferson	(30) Pavarësisht nga fatkeqësia, katër anëtarë të Kishës qëndrojnë të vendosur në besimin e tyre te Krishti dhe marrin përkrahjen e Tij mbështetëse.
Kuentin L. Kuk	(8) Materiali burimor <i>Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet</i> i forcon besimin, dëshminë dhe kuptueshmërinë për ungjillin një familjeje në Brazil.
Boni H. Kordën	(74) Një e re dhe një motër më e madhe në moshë krijojnë një marrëdhënie që e bekon jetën e tyre. Boni H. Kordëni dhe shoqja e saj shërbestare krijojnë menjëherë një lidhje [plot] dashuri me një motër që vizitojnë. Një vëlla shërbestar zhvillon një afërsi e mirëbesim me një vëlla, bashkëshortja e të cilit u orvat të vetëvritej.
Mishel D. Kregj	(52) Kamila Kimballi i mëson një anëtareje të lagjes që "kurrë [të] mos [e] ndrydh[ë] një mendim bujar".
Din M. Dejvis	(34) Presidenti Gordon B. Hinkli parashikon se ku duhet të ndërtohet Tempulli i Vankuverit në Kolumbinë Britanike.
Henri B. Ajring	(58) Henri B. Ajringu pyet veten se si mamaja e tij e gjeti kohën dhe energjinë për të bërë një hartë të udhëtimeve të Apostullit Pal. (90) Henri B. Ajringu mëson t'i trajtojë njerëzit sikur "të je[në] në telash të madh". Shpëtimtari e mban bashkëshorten e Henri B. Ajringut gjatë telasheve të saj.
Kristina B. Franko	(55) Kristina B. Franko mëson se dashuria dhe sakrificat janë përbërësit e fshehtë tek torta me çokolatë e mësueses së saj të Fillores.
Robert C. Gei	(97) Fryma e Shenjtë e ndihmon Robert C. Gein që ta shohë motrën e tij më të madhe sikurse Perëndia e sheh atë. Xhejms E. Talmixhi i jep shërbesë një familjeje të prekur nga difteria.
Xhek N. Xherard	(107) Pasi Xhek N. Xherardi diagnostikohet me një gjendje të rëndë shëndetësore, ai e sheh jetën nga një këndvështrim i përjetshëm.
Gerit W. Gong	(40) Plaku Riçard G. Skot dhe Gerit W. Gongu diskutojnë për besimin ndërsa pikturojnë me bojëra uji një zjarr kampi. Një mbajtës i priftërisë ndihmon një çift më pak aktiv që të kthehet sërisht në Kishë.
Xhefri R. Holland	(77) Një përgjërëm për të dhënë shërbesë nga fëmijët e tij e ndihmon një baba të falë dhe të rikthehet në Kishë, duke i sjellë bekime familjes së tij.
Xhoi D. Xhons	(50) Xhoi D. Xhonsi dhe bashkëshorti i saj krijojnë një miqësi afatgjatë me një familje pak aktive pasi mësojnë të shërbejnë nga dashuria për Zotin.
Rasëll M. Nelson	(6) Një nëne i pëlqen ta zhvillojë kishën në shtëpinë e saj, sepse bekimi i sakramentit në shtëpi çdo të diel e shtyn bashkëshortin e saj të përdorë një fjalor më të mirë. (68) Rasëll M. Nelsoni gabimisht i drejtohet vetes si nënë. Një bir e falënderon nënën e tij pasi Fryma e Shenjtë e udhërrëfen atë që ta ndërrojë telefonin e tij inteligjent me një telefon me palosje. (87) Benjamin De Hojosi i shpjegon një drejtuesi programi në radio se emri i gjatë i Kishës u zgjodh nga Shpëtimtari.
Dallin H. Ouks	(61) Një refugjat të ri në moshë e futin në burg pasi hakmerret ndaj të rinjve që e provokojnë atë.
Pol B. Pajper	(43) Një vajzë e re që po përgatitet të pagëzohet, thotë se marrja e emrit të Jezu Krishtit do të thotë: "[Unë] mund të kem Frymën e Shenjtë".
Ronald A. Rasband	(18) Vajza dhe dhëndri i Ronald A. Rasbandit e mposhtin frikën e tyre për të sjellë fëmijë në botë.
Geri E. Stivenson	(110) Një anëtar i lagjes ia zgjat dorën shërbestare Karlos A. Godoit, i cili kishte dalë nga udha. Një pronar ferme humbet 200 dele nga grabitqarët. Një qen stani i udhëheq delet e humbura drejt sigurisë.



Presidenti Nelson e Prin Udhën

Presidenti Rasëll M. Nelson e ka këshilluar secilin prej nesh që të jetë më i sjellshëm, më i ngjashëm me Krishtin dhe më shpirtëror ndërsa u japim shërbesë të tjerëve, dhe ka dhënë një shembull të asaj se çfarë do të thotë kjo me mënyrën se si ai ka dhënë shërbesë që nga konferenca e përgjithshme e fundit.

Pak pas konferencës së përgjithshme të prillit 2018, Presidenti Nelson u nis për një turne që e çoi atë dhe bashkëshorten e tij, Uendin, dhe Plakun Xhefri R. Holland, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe bashkëshorten e tij, Patrishian, në Angli, Izrael, Kenia, Zimbabve, Indi, Tajlandë, Kinë dhe Havai, SHBA.

Në udhëtimin vijues, Presidenti Nelson u takua me anëtarë, misionarë, udhëheqës dhe miq të Kishës në Kanadanë perëndimore, qendrore dhe lindore; Siatëll të Uashingtonit në SHBA dhe Republikën Dominikane – ku foli gjerësisht në spanjisht, hera e parë që një President Kise ka dhënë një bisedë të gjatë në një gjuhë tjetër përveç anglishtes.

Në mbledhjet dhe mbremjet rreth vatrës, Presidenti Nelson dha mësim për emrin e saktë të Kishës; shpërndarjen e ungjillit me të tjerët; ushqyerjen e dashurisë

për Librin e Mormonit; mënyrën se si të jetuarit e ungjillit e bën jetën më të mirë; se si udha e Krishtit është udha e gëzimit dhe e lumturisë, tani dhe në përjetësi; lutjen; bërjen e shtëpisë një shenjtërore për fëmijët; përdorimin e lirisë së zgjedhjes për të mposhtur tundimin dhe për ta ndjekur Shpëtimtarin; përkujdesjen ndaj të tjerëve dhe përgatitjen e marrjen e bekimeve që vijnë nga tempulli.

Presidenti dhe Motra Nelson gjithashtu folën në një takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë më 3 qershor 2018, ku Presidenti Nelson tha se të rinjtë e të rejtat që rekrutohen në “batalionin ... [e] Zotit” dhe ndihmojnë për ta mbledhur Izraelin, kanë mundësinë të jenë “pjesë ... e diçkaje të madhe, diçkaje të madhërishtme, diçkaje madhështore”. Ai i nixti të rinjtë e të rejtat që të shpëputen nga përdorimi i vazhdueshëm i medias shoqërore, të sakrifikojnë pak kohë për Zotin, të bëjnë një vlerësim tërësor të jetës me Zotin, të luten për ditë që të gjithë fëmijët e Perëndisë të mund ta marrin ungjillin dhe të jenë një dritë për botën. ■

Për informacion shtesë rreth shërbesës së Presidentit Rasëll M. Nelson, shkoni te prophets.lds.org. Shiheni të gjithë transmetimin për rininë në HopeofIsrael.lds.org.

Lajme për Tempujt

Kisha planifikon të ndërtojë 12 tempuj të rinj, njoftoi Presidenti Rasëll M. Nelson në fjalën e tij përmblyëse në konferencën e përgjithshme (shih faqen 113). Ai gjithashtu njoftoi planet për të përtëritur Tempullin e Solt-Lejkut dhe tempujt të tjerë të “kohës së pionierëve”, duke shtuar që hollësitë do të jepen më vonë.

Tempujt do të ndërtohen në Mendoza, Argjentinë; Salvador, Brazil; Juba-Siti, Kaliforni, SHBA; Pnom-Pen, Kamboxhia; Praija, Kepi i Gjellbër; Zhigo, Guam; Puebla, Meksikë; Okland, Zelandë e Re; Lagos, Nigeri; Davao, Filipine; San-Huan, Porto-Riko dhe Konteja Uashington, Jutë, SHBA.

Katër tempuj do të përkushtohen së shpejti: Tempulli i Konsepsionit, Kili më 28 tetor; Tempulli i Barrankijës, Kolumbi më 9 dhjetor; Tempulli i Romës, Itali në javën nga 10 deri më 17 mars 2019 dhe Tempulli i Kinshasës, Republika Demokratike e Kongos më 14 prill 2019.

Dhe dy tempuj u ripërkushtuan kohët e fundit: Tempulli i Hjustonit, Teksas u ripërkushtua më 22 prill 2018 dhe Tempulli i Xhordan Riverit, Jutë u ripërkushtua më 20 maj 2018. ■

Mësoni më shumë te temples.lds.org.

Ndryshimet Ndhimojnë për ta Baraspeshuar Udhëzimin për Ungjillin në Shtëpi dhe atij në Kishë

Si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për t'i ndihmuar shenjtoret e ditëve të mëvonshme ta "mës[ojnë] doktrinën, [ta] forc[ojnë] besimin dhe [të] nxit[im] një adhurim vetjak më të madh", Presidenti Rasëll M. Nelson njoftoi përshtatje për të ndihmuar që të baraspeshohen e të lidhen mënyrat e pashoqe dhe thelbësore se si anëtarët e adhurojnë dhe e mësojnë dhe e jetojnë ungjillin e Shpëtimtarit si në kishë edhe në shtëpi.

Udhëheqësit e Kishës kanë njoftuar ndryshime në programin për mbledhjen e së dielës, duke filluar nga janari i vitit 2019, në lidhje me nxjerrjen e një programi të ri mësimor të përqendruar te shtëpia dhe të përkrahur nga Kisha. Këto ndryshime dhe të tjera të

ndërtuara mbi disa nisma të mëparshme që Kisha ka vënë në lëvizje vitet e fundit, kanë për qëllim t'i ndihmojnë anëtarët ta përqendrojnë jetën e tyre më plotësisht tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti dhe ta thellojnë besimin tek Ata. Këto nisma përfshijnë përqendrimin në një studim më kuptimplotë të ungjillit në shtëpi, nderimin e Zotit duke e mbajtur të shenjtë ditën e Shabatit dhe përkujdesin për njëri-tjetrin siç do të bënte Shpëtimtari dhe siç udhëzohemi nga Shpirti.

Me qëllim që ta përgatitin popullin e Zotit për rikthimin e Tij, këto ndryshime synojnë thellimin e kthimit individual në besim, shpjegoi Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë

Apostujve, ndërsa përvijoi ndryshimet në sesionin e paradites të së shtunës të konferencës së përgjithshme.

"Ne e dimë ndikimin shpirtëror dhe kthimin e thellë dhe afatgjatë në besim që mund të arrihet në mjedisin e shtëpisë . . .", tha ai. "Qëllimi ynë është t'i baraspeshojmë përvojat në Kishë dhe në shtëpi në një mënyrë që do ta rritë shumë besimin e shpirtshmërinë dhe do ta thellojë kthimin në besim tek Ati Qiellor dhe Zoti Jezu Krisht."

Përshtatjet në Shtëpi

Udhëheqësit e Kishës po bëjnë ftesë për një përqendrim më të madh te rritja e pjesëmarrjes në ushtrimin e fesë personalisht dhe familjarisht në shtëpi, përfshirë studimin e ungjillit në shtëpi ditën e diel dhe gjatë gjithë javës si dhe përshtatjet në mbrëmjen familjare.

Si për udhëzimin ashtu edhe për vënien në zbatim, shtëpia është qendra thelbësore për të mësuarit dhe të jetuarit e ungjillit. Studimi individual dhe familjar i ungjillit në shtëpi të dielën dhe gjatë gjithë javës ofron mundësi për të gjetur forcë shpirtërore çdo ditë dhe lejon përshtatshmëri më të madhe për studim dhe zbulës të individualizuar. Mbështetja vetëm te koha e kufizuar në kishë për udhëzimin për ungjillin krijon një çekuilibrë që nuk ka gjasë ta arrijë kthimin e thellë dhe të qëndrueshëm në besim që është i nevojshëm.

"Secili prej nesh është përgjegjës për rritjen tonë shpirtërore vetjake", tha Presidenti Nelson. "Dhe shkrimet e shenjta e bëjnë të qartë se prindërit e kanë përgjegjësinë parësore për t'ua dhënë mësimin doktrinën fëmijëve të tyre."

Ndryshimet përfshijnë futjen e një materiali të ri burimor për studimin e ungjillit për individët dhe familjet në shtëpi. Individët dhe familjet mund ta përdorin materialin e ri burimor *Eja, Më*



Ndiq – Për Individët dhe Familjet nëse dëshirojnë, për ta udhërrëfyer përvojën e tyre të studimit të ungjillit jashtë kishë. Materiali i ri burimor ecën paralel me burimet shoqëruese për mësuesit e Shkollës të së Dieles dhe Fillores për t'i harmonizuar mësimet e së dieles me studimin e shkrimeve të shenjta në shtëpi dhe sugjerimet për mbrëmjet familjare.

Përveç nxitjes së studimit të ungjillit, udhëheqësit e Kishës e përsëritën ftesën e tyre ndaj të gjithëve që të marrin pjesë në ditën e Shabatit – dhe gjatë gjithë javës – në këshillat familjare, mbrëmjen familjare, historinë familjare dhe punën në tempull, dhënien e shërbesës, adhurimin vetjak dhe çastet e gëzueshme me familjen.

Materialet që u janë dërguar anëtarëve dhe udhëheqësve, shpjegojnë se udhëheqësit e Kishës i nxitin anëtarët që të mbajnë mbrëmje familjare dhe të bëjnë studim të ungjillit në Shabat – ose në kohë të tjera si ta zgjedhin individët dhe familjet. Një natë veprimtarie familjare mund të mbahet të hënën ose në kohë të tjera. Për këtë arsye, udhëheqësit duhet të vazhdojnë t'i mbajnë mbrëmjet e të hënave pa mbledhje dhe pa veprimtari të Kishës. Gjithsesi, koha e shpenzuar për studimin e ungjillit në shtëpi dhe veprimtaritë për familjet dhe individët planifikohet sipas rrethanave individuale.

Adhurimi i Perëndisë në kishë, pjesëmarrja në ordiancat e shenjta atje dhe mbledhja së bashku për t'i dhënë mësim njëri-tjetrit, për ta forcuar e për t'i shërbyer njëri-tjetrit, janë elemente thelbësore të thellimit të besimit dhe kthimit vetjak në besim. Pakësimi i kohës së harxhuar në kishë mund të mos jetë frytdhënës nëse individët dhe familjet nuk e kanë për qëllim forcimin e shtëpive të tyre.

Presidenti Nelson dha mësim: “Si shenjtore të ditëve të mëvonshme, jemi mësuar ta mendojmë ‘kishën’ si diçka që ndodh në shtëpitë tona të mbledhjeve, e përkrahur nga ajo që ndodh në shtëpi. Kemi nevojë për një përshtatje të këtij modeli. Është koha për një *Kishë të përqendruar te shtëpia*, të përkrahur nga ajo që ndodh brenda ndërtesave tona të degës, lagjes dhe kunjit.”

Përshtatjet në Kishë

Përshtatjet të përvoja në Kishë kanë për qëllim ta përkrahin rritjen e të mësuarit dhe të jetuarit e ungjillit në shtëpi. Këto ndryshime përfshijnë përshtatjen e programit javor për të dieles që të përfshijë:

- Një mbledhje 60-minutëshe të sakramentit,
- Kalimin 10-minutësh nëpër klasa,
- Dhe një orë mësimore 50-minutëshe, siç përvijohet në modelin e programit më poshtë:

PROGRAMI PËR TË DIELËN DUKE FILLUAR NGA JANARI I 2019-ës	
60 minuta	Mbledhja e sakramentit
10 minuta	Kalimi nëpër klasa
50 minuta	Orët mësimore për të rriturit; orët mësimore për rininë; Fillorja

Ora mësimore 50-minutëshe do të përfshijë Filloren çdo javë për fëmijët dhe do të ndryshojë çdo javë për rininë dhe të rriturit si vijon:

- E diela e parë dhe e tretë: Shkolla e së Dieles.
- E diela e dytë dhe e katërt: kuoromet e priftërisë, Shoqata e Ndhmës dhe Të Rejat.

- E diela e pestë: mbledhjet për rininë dhe të rriturit nën drejtimin e peshkopit.

Nëse Fillorja është mjaft e madhe sa për t'u ndarë si Fillorja për më të vegjëlit dhe Fillorja për më të rriturit, udhëheqësit duhet ta përmbysin rendin e programit në vijim për gjysmën e femijëve dhe ta rregullojnë kohën si të jetë e nevojshme.

PROGRAMI PËR FILLORËN DUKE FILLUAR NGA JANARI I 2019-ës	
25 minuta	Lutja, shkrimi i shenjtë ose neni i besimit, bisedë (5 minuta). Koha e të kënduarit: Muzikë që i përkrah shkrimet e shenjta që studiohen në orën mësimore (20 minuta)
5 minuta	Kalimi nëpër klasa
20 minuta	Orët mësimore: mësimi nga <i>Eja, Më Ndiq – Për Filloren</i>

Ndryshimet në Programin Mësimor

Kjo përshtatje e programit për mbledhjet funksionon krah për krah me shtojcën më të re te programi mësimor i Kishës i materialit burimor *Eja, Më Ndiq*. Duke filluar nga janari, ky program mësimor i përqendruar te shtëpia dhe i përkrahur nga Kisha, do ta harmonizojë atë që po mësojnë të rriturit, rinia dhe fëmijët në orët mësimore të Shkollës të së Dieles dhe të Fillores, duke ua bërë më të lehtë familjeve që të studiojnë së bashku në shtëpi gjatë javës.

Udhëzimet, përvijimet e mësimave dhe burimet mund të gjenden në:

- *Eja, Më Ndiq – Për Kuorumin e Pleqe dhe Shoqatën e Ndhmës*

(gjetet te revistat *Ensign* dhe *Liahona* nëntor 2018)

- *Eja, Më Ndiq – Për Kuorumet e Priftërisë Aarone*
- *Eja, Më Ndiq – Për të Rejat*
- *Eja, Më Ndiq – Për Shkollën e së Dielës*
- *Eja, Më Ndiq – Për Filloren*

Vizitoni ejamendiq.lds.org për më shumë informacion.

Ndryshime të tjera të rëndësishme përfshijnë sa vijon:

- Mbledhjet e këshillit të mësuesve do të mbahen çdo tre muaj dhe jo çdo muaj.
- Programet mësimore të kuorumit të pleqve dhe Shoqatës së Ndhmës nuk do të përfshijnë më mbledhjen e këshillit të dielën e parë ose një temë të veçantë të dielën e katërt. Mësimet do të përqendrohen te mesazhet e konferencës së përgjithshme të fundit.
- Koha e të kënduarit do të zëvendësojë kohën e përbashkët. *Orientuesi për Kohën e Përbashkët* do të ndërpritet.
- Kursi Parimet e Ungjillit do të ndërpritet. Të gjithë anëtarët dhe miqtë e interesuar do të ftohen të marrin pjesë në orën e tyre mësimore përkatëse të Shkollës të së Dielës për të rriturit ose rininë.
- Kurse jo të detyrueshme – të tilla si ato për forcimin e martesës dhe familjes, përgatitjen për tempull, përgatitjen për mision dhe historinë familjare – nuk do të mbahen gjatë kohës së orës mësimore të së dielës. Këto kurse mund të jepen mësim në kohë të tjera për individët, familjet ose grupet, bazuar te nevojat vendore dhe sipas vlerësimit të peshkopit.

Qëllimet e Këtyre Ndryshimeve

Udhëheqësit e Kishës po kërkojnë të krijojnë një baraspeshë të re dhe një

lidhje më të madhe midis epërsive të pashoqe të përvojave në shtëpi dhe në Kishë me qëllime të veçanta në mendje.

“Ka shumë më tepër në këtë përshtatje sesa thjesht shkurtimi i orarit të së dielës në shtëpinë e mbledhjeve . . .”, tha Plaku Kuk. “Qëllimet dhe bekimet që lidhen me këtë përshtatje dhe ndryshime të tjera të kohëve të fundit, përfshijnë sa vijon:

- Thellimin e kthimit në besim tek Ati Qjellor dhe Zoti Jezu Krisht, si dhe forcimin e besimit tek Ata.
- Forcimin e individëve dhe të familjeve nëpërmjet një programi mësimor të përqendruar te shtëpia dhe të përkrahur nga Kisha, i cili kontribuon në të jetuarit plot gëzim të ungjillit.
- Nderimin e ditës së Shabatit, me

një përqendrim tek ordianca e sakramentit.

- Të ndihmuarit e të gjithë fëmijëve të Atit Qjellor në të dyja anët e velit nëpërmjet punës misionare dhe marrjes së ordiancave, besëlidhjeve dhe bekimeve të tempullit.”

Për njoftimin e këtyre përshtatjeve, shih Rasëll M. Nelson, “Fjalët e Hapjes”, në faqen 6 të kësaj reviste; Kuentin L. Kuk, “Kthim i Thellë dhe Afatgjatë në Besimin tek Ati Qjellor dhe Zoti Jezu Krisht”, në faqen 8. Për më shumë informacion rreth këtyre përshtatjeve, vizitoni Shabati.lds.org për të gjetur një letër nga Presidenca e Parë, përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra rëndom dhe burime shtesë që mund t’i ndihmojnë individët dhe familjet ta nderojnë Shabatit. ■





Përfshihuni në Librin e Ri të Himneve, Librin e Ri të Këngëve

Kisha po përgatit botime të reja si të *Himneve* edhe të *Librit të Këngëve për Fëmijë* dhe po kërkon sugjerime dhe dorëzime nga anëtarët e Kishës kudo.

Te muzikaere.lds.org, ju mund:

Të jepni sugjerime - himnet ose këngët tuaja për fëmijë të parapëlqyera të tanishme, himne ose këngë për fëmijë të shenjtorëve të ditëve të mëvonshme apo jo të shenjtorëve të ditëve të mëvonshme që t'i përfshijmë, himne ose këngë të tanishme që të mos i përfshijmë, vështirësitë me librat e tanishëm të muzikës dhe përshtypje të tjera.

Ta dorëzoni materialin origjinal - himne, tekste të himneve, këngë për fëmijë ose tekste të këngëve për fëmijë. Muzika duhet të jetë e përshtatshme për shërbimet e adhurimit. Të gjitha gjuhët dhe stilet kulturore do të merren parasysh. Ata që janë nën moshën 18 vjeç mund të bëjnë dorëzime nëse sigurojnë lejen nga prindi ose kujdestari. Dorëzimet duhet të merren brenda datës 1 korrik 2019. ■



Plaku Bruk P. Hejls

Autoritet i Përgjithshëm i Shtatëdhjetë

Kur Plaku Bruk P. Hejls ishte tetë ose nëntë vjeç, ai ishte në një mbledhje agjërimi dhe dëshmie ku babai i tij po kryesonte si peshkop. Babai i tij e ftoi bashkësinë për të dhënë dëshmi dhe thaujse të gjithë të pranishmit dhanë dëshmi. “Ishte ndoshta hera e parë që e ndjeva Shpirtin të më dëshmonte për vërtetësinë e ungjillit”, kujton Plaku Hejls.

Ai e ka ndier atë dëshmi shumë herë që nga ajo kohë, veçanërisht ndërsa shërbente si sekretar i Presidencës së Parë që nga viti 2008. Kur Presidenti Tomas S. Monson u mbështet si profet dhe President i Kishës, dhe sërisht kur u mbështet Presidenti Rasëll M. Nelson, ai dëshmoi se “manteli i profetit bie mbi secilin prej këtyre burrave dhe unë e dija pa dyshim se ata ishin zgjedhur dhe thirrur për të qenë President i Kishës për kohën e tyre të veçantë”.

Plaku Hejls u thirr si Autoritet i Përgjithshëm i Shtatëdhjetë më 17 maj 2018 dhe u mbështet më 6 tetor 2018. Ai do të vazhdojë si sekretar i Presidencës së Parë.

I lindur në Ogden, Jutë, SHBA, më 7 prill 1956, nga Klea dhe Glen Filip Hejls, Plaku Hejls mori diplomë universitare për shërbime bankare dhe financë nga Kolegji Shtetëror i Uibërit (tani Universiteti Shtetëror i Uibërit) në 1980-ën. Pas diplomimit, ai punoi për veprime të bankave tregtare dhe në Sektorin e Financave dhe Dokumenteve të Kishës. Ai u martua me Denis Imlei Hejlsin në vitin 1981 dhe ata janë prindërit e katër fëmijëve. Plaku Hejls ka shërbyer si misionar kohëplotë në Misionin e Francës, Paris, këshilltar në peshkopatë, udhëheqës i grupit të priftërinjve të lartë, peshkop, president kunji, organist i priftërisë, mësues i Shkollës të së Dielës dhe vulosës në tempull.

Atë ditë, kur ishte djalë i vogël, Plaku Hejls nuk e dha dëshminë e tij. Por që nga ajo kohë ajo është forcuar më shumë. “Ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Libri i Mormonit është i vërtetë, Perëndia na do në mënyrë të përsosur dhe mezi pret të na bekojë, Jezusi është Shpëtimtari ynë dhe jemi të bekuar që kemi shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë ndërsa jemi të denjë për të”, thotë ai. ■



EJA, MË NDIQ

Për Kuorumin e
Pleqve dhe Shoqatën
e Ndhmës

Tetor 2018

*Gjejini këto burime te programi kompjuterik
Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] dhe te
ejamendiq.lds.org.*

Përse Kemi Mbledhje të Kuorumit dhe të Shoqatës së Ndhimës?

Në këto ditë të fundit, Perëndia i ka rivendosur priftërinë, kuorumet e organizuara të priftërisë dhe Shoqatën e Ndhimës për të ndihmuar të përmbushet vepra e Tij për shpëtimin. Për shkak të kësaj, çdo të diel kur mblihdemi në mbledhjet e kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhimës, ne diskutojmë dhe planifikojmë se çfarë do të bëjmë që të ndihmojmë të përmbushet vepra e Perëndisë. Që të jemi të efektshëm, këto mbledhje kanë nevojë të jenë më shumë sesa orë mësimore. Ato janë mundësi për t'u këshilluar rreth punës së shpëtimit, për të mësuar së bashku rreth asaj pune nga mësimet e udhëheqësve të Kishës dhe për të planifikuar e për t'u organizuar që ta përmbushim atë.



Programi Mësimor për Periudhën Tetor–Dhjetor 2018

Në vitin 2018, mbledhjet e së dielës për kuorumin e pleqve dhe Shoqatën e Ndhimës ndjekin këtë program mësimor mujor:

E Diela e Parë: Këshillohuni së bashku mbi përgjegjësitë, mundësitë e sfidat vendore dhe bëni plane për të vepruar.

E Diela e Dytë dhe e Tretë: Studioni mesazhe nga konferenca më e fundit e përgjithshme, siç zgjidhen nga anëtarë të presidencës ose, sipas rastit, nga peshkopi ose presidenti i kungjit.

E Diela e Katërt: Diskutoni një temë të veçantë, të zgjedhur nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve. Nga tetori deri në fund të dhjetorit 2019, tema është studimi vetjak dhe familjar i shkrimeve të shenjtja.

E Diela e Pestë: Nën drejtimin e peshkopatës.



"Ne kemi besim se ju do të këshilloheni së bashku dhe do të kërkonti zbulësë për vënien në zbatim të këtyre përshtatjeve. . . . [Orari i ri i së dielës] do të çojë në bekime të thella për ata që [e] përqafojnë me entuziazëm [atë] dhe e kërkojnë udhërrëfimin e Frymës së Shenjtë. Ne do t'u afrohem më shumë Atit tonë Qiellor dhe Zotit e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit."

Plaku Kuentin L. Kuk,
Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve

Programi i Ri Mësimor për 2019-ën

Duke filluar nga janari 2019, mbledhjet e kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndihmës do të zhvillohen vetëm në të dielat e dyta dhe të katërta të çdo muaji. Këto mbledhje do të përqendrohen te mesazhet nga konferenca e përgjithshme më e fundit. Sugjerimet për mësimdhënien për këto mbledhje gjenden në botimet konferencës së përgjithshme të majit dhe nëntorit të revistave *Liahona* dhe te programi kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit].

Ndryshime të tjera që fillojnë në vitin 2019, përfshijnë sa vijon:

- Mbledhjet e këshillit të së dielës së parë do të ndërpriten. Gjithsesi, sipas nevojës, kuorumet e pleqve dhe Shoqatat e Ndihmës mund të përdorin pjesë të mbledhjes të dielën e dytë ose të katërt që të këshillohen rreth një teme të rëndësishme.
- Nuk do të zhvillohen ushtrimet e hapjes në të cilat kuorumet e Priftërisë Aarone dhe Melkizedeke takohen së bashku ose motrat e Shoqatës së Ndihmës dhe të rejtat takohen së bashku.
- Mbledhjet e kuorumeve të pleqve dhe të Shoqatës së Ndihmës nuk do të fillojnë me një himn ose lutje hapjeje, por do të mbarojnë me një lutje mbylljeje.



Të Mësuarit nga Mesazhet e Konferencës së Përgjithshme (2018 dhe 2019)

Mësimet e dhëna nga profetët, shikuesit dhe zbuluesit e gjallë mund të japin udhërrëfim të frymëzuar për punën e kuorumeve të pleqve dhe Shoqatave të Ndihmës. Për javët kur do të studiohen mesazhet e konferencës, presidenca e kuoromit të pleqve ose e Shoqatës së Ndihmës do të përzgjedhë që të përdoret një mesazh nga konferenca, nisur nga nevojat e anëtarëve. Me raste, edhe peshkopi ose presidenti i kunjit mund të sugjerojë një mesazh. Udhëheqësit duhet ta vënë theksin te mesazhet nga anëtarët të Presidencës së Parë dhe të Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve. Gjithsesi, anëtarët/et e presidencave mund të përzgjedhin cilindo mesazh nga konferenca e kohëve më të fundit, nisur nga nevojat e shenjtorëve vendorë dhe frymëzimi nga Shpirti.

Udhëheqësit/et dhe mësuesit/et duhet të gjejnë mënyra për t'i nxitur anëtarët/et që ta lexojnë mesazhin e përzgjedhur paraprakisht. Duhet t'i nxitin anëtarët/et që të vijnë në mbledhje të përgatitur për të shprehur të vërteta të ungjillit që i kanë mësuar dhe idetë e tyre rreth mënyrës se si të veprojnë sipas atyre të vërtetave. Vëprimtaritë mësimore të sugjeruara më poshtë, të cilat bazohen në parimet e manualit *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, mund t'i ndihmojnë anëtarët/et që të mësojnë nga mesazhet e konferencës së përgjithshme.



Dejvid A. Bednar, *“T’i Sjellim në një Krye të Vetëm, në Krishtin, Të Gjitha Gjërat”*

Merreni parasysh të sillni një litar dhe një listë kontrolli për t’i shfaqur në klasë. Ftojini anëtarët/et të diskutojnë ndryshimin midis vështrimit të të vërtetave të ungjillit dhe programeve të Kishës si një litar dhe vështrimit të tyre si një listë kontrolli për tema dhe detyra individuale. Nxitini të kërkojnë ide të shembujt në mesazhin e Plakut Bednar. Çfarë do të thotë t’i “sillte në një krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat”? (Shih Efesianëve 1:10.) Çfarë mund të bëjmë që të marrim premtimin në përfundim të mesazhit të Plakut Bednar?

Dallin H. Ouks, *“E Vërteta dhe Planit”*

Si na ndihmon të kuptuarit e “të vërteta[ve të] ungjillit të rivendosur” kur përballemi me kundërshtim ndaj bindjeve dhe praktikave tona? Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, anëtarët/et mund të shqyrtojnë shembuj nga të vërtetat themelore në pjesën II të mesazhit të Presidentit Ouks. Gjithashtu mund të shqyrtojnë shembuj për mënyrën se si zbatohen këto të vërteta (shih pjesa III). Mund të jetë e dobishme që anëtarët/et ta interpretojnë me role mënyrën se si do t’i përdornin disa prej këtyre të vërtetave themelore për t’u përgjigjur kritikave ndaj një mësimi ose praktike të Kishës.

Kuentin L. Kuk, *“Kthim i Thellë dhe Afatgjatë në Besimin tek Ati Qjellor dhe Zoti Jezu Krisht”*

Anëtarët/et mund të jenë të interesuar të dëgjojnë nga njëri-tjetri se cilat ishin reagimet e tyre të para kur dëgjuan rreth ndryshimeve të përshkruara në mesazhin e Plakut Kuk. Nëse një mik/e i/e një besimi tjetër fetar do t’i pyeste përse Kisha po i bën këto përshtatje, çfarë do të thonin ata? Nxitini të kërkojnë përgjigje të mundshme në mesazhin e Plakut Kuk. Çfarë mund të bëjmë si individë e familje dhe si një kuorum apo Shoqatë Ndihme, për të siguruar që ndryshimet përmbushin atë që ka për qëllim Zoti? Si pjesë e këtij diskutimi, ju mund të jepni edhe ide nga fjalët e hapjes

të Presidentit Nelson, të cilat i frymëzojnë anëtarët/et që “me entuziazëm [t’]i përqafojnë” këto ndryshime.

Ronald A. Rasband, *“Mos u Shqetësoni”*

Mesazhi i Plakut Rasband nxjerr në pah disa shkrime të shenjta që mund të na ndihmojnë për ta larguar çfarëdo frike që mund ta kemi prej kohës së vështirë në të cilën jetojmë. Vërimi anëtarët/et të kërkojnë këshillë në këto shkrime të shenjta, të cilën mund t’ia japin dikujt që ka frikë për të ardhmen. Çfarë tjetër mund të thonë nga mesazhi i Plakut Rasband? Si “e ka kufizuar [frika] largpamësinë e fëmijëve të Perëndisë”? Ftojini anëtarët/et të tregojnë se si kanë mësuar ta mposhtin frikën dhe të jetojnë me besim.

D. Tod Kristoferson, *"I Vendosur dhe i Paapur në Besimin te Krishti"*

Ju mund ta filloni një diskutim të këtij mesazhi duke vizatuar një vijë në tabelë me fjalët *Të Nxitur nga Shoqëria* në njërin cep dhe *Zotim si të Krishtit* në cepin tjetër. Ftojini anëtarët/et të lexojnë paragrafin që fillon me frazën "Shumica prej nesh në këtë çast e gjejnë veten në vazhden . . ." dhe të përsiatin se ku e ndiejnë se janë në këtë vazhdë. Çfarë mësojmë nga shembujt në mesazhin e Plakut Kristoferson që na frymëzon të bëhemi të vendosur dhe të paapur gjatë fatkeqësisë? (Shih edhe Alma 36:27–28). Nxitini anëtarët/et të tregojnë shembuj të njerëzve që i njohin, të cilët kanë treguar zotim si të Krishtit ndaj ungjillit, edhe kur janë përballur me fatkeqësi.

Ulises Soares, *"Një në . . . Krishtin"*

Sipas Plakut Soares, si i përfaqëson lumi i Amazonës anëtarët e Kishës së rivendosur të Jezu Krishtit? Çfarë na mëson ky krahasim rreth ndikimit që mund të kenë anëtarët e rinj mbi Kishën? Si mund ta ndjekim ne, si një kuorum ose Shoqatë Ndihme, këshillën e Plakut Soares që t'i nxitim, t'i përkrahim dhe t'i duam të kthyerit e rinj në besim? (Shih Moroni 6:4–5). Ndoshta disa anëtarë/e mund të tregojnë disa sfida me të cilat u përballën kur ishin anëtarë të rinj të Kishës dhe mënyrën se si anëtarë të tjerë i ndihmuan ata. Ju mund të diskutoni edhe mënyra se si anëtarët e rinj e kanë forcuar lagjen ose degën tuaj.

Gerit W. Gong, *"Zjarri Ynë i Kampit të Besimit"*

Merreni parasysh të paraqitni një pikturë të një zjarri kampi dhe të ftoni dikë të tregojë një përvojë kur ai ose ajo ishte mirënjohës/e që e patën një zjarr kampi. Kërkojuni anëtarëve/eve të diskutojnë atë që Plaku Gong donte të thoshte kur foli rreth një "zjarri të kampit". Më pas mund t'i ndani anëtarët/et në grupe dhe ta ftoni secilin grup të shqyrtojë dhe të tregojë njëri nga pesë mënyrat që sugjeron Plaku Gong, se si mund të na nxitë një "zjarr . . . i kampit të besimit". Jepuni kohë anëtarëve/eve të përsiatin se si mund ta forcojnë besimin e tyre vetjak ose besimin e dikujt që e njohin.

Diter F. Uhtdorf, *"Beso, Duaj, Bëj"*

Ju mund ta filloni një diskutim të këtij mesazhi duke shkruar në tabelë fjalët *Humbja e Shpresës* dhe *Lumturia*. Ftojini anëtarët/et ta kontrollojnë mesazhin për cilësi e bindje që çojnë drejt humbjes së shpresës ose drejt lumturisë dhe t'i renditin ato në tabelë. Ftojini anëtarët/et të shprehin mënyra se si e kanë përjetuar lumturinë që vjen nga besimi, dashuria dhe bërja, sikurse jep mësim Plaku Uhtdorf. Nxitini anëtarët/et të gjejnë një citim nxitës nga mesazhi për ta vënë në një vend të dukshëm në shtëpinë e tyre ose për t'ia treguar një miku ose një mikeshë.

Xhoi D. Xhons, *"Për Të"*

Merreni parasysh të tregoni historinë në fillim të mesazhit të Motrës Xhons dhe t'i pyetni

anëtarët/et të mendojnë rreth rasteve kur shërbimi dhe përpjekjet e tyre për të dhënë shërbesë mund të jenë dukur si të "pa . . . vën[a] re . . . ose edhe [të] ishin të padëshiruara". Pasi ta diskutoni historinë, merreni parasysh të shkruani në tabelë *Përse duhet të shërbejmë?* Ftojini anëtarët/et t'i përgjigjen kësaj pyetjeje duke rishikuar pjesën tjetër të mesazhit të Motrës Xhons, duke kërkuar ide (shih Doktrina e Besëlidhje 59:5). Si mund ta ndryshojë këshilla e Motrës Xhons mënyrën se si kujdesemi për njëri-tjetrin dhe i japim shërbesë njëri-tjetrit?

Mishel D. Krejg, *"Pakënaqësia e Shenjtë"*

Motra Krejg flet për "një mospërputhje mes asaj se ku e cilët jemi dhe asaj se ku e cilët dëshirojmë të jemi". Si na do Perëndia të ndihemi rreth kësaj mospërputhjeje? Si na do Satani të ndihemi rreth saj? Çdo anëtar/e mund të hetojë një nga tri pjesët në mesazhin e Motrës Krejg për të gjetur përgjigje për këto pyetje. Çfarë mund të bëjmë që të sigurohemi që "pakënaqësia e shenjtë" nuk bëhet "shkurajim paralizues"?

Kristina B. Franko, *"Gëzimi i Shërbimit Vetëmohues"*

Për të na mësuar se "dashuri[a] shenjtërohet nëpërmjet sakrificës", Motra Franko tregoi dy histori – një rreth Viktorias dhe një rreth një të veje. Ju mund të ftoni dy anëtarë/e që të vijnë të përgatitur për të treguar atë që mësojnë nga këto histori rreth dashurisë dhe sakrificës. Çfarë përvojash të tjera mund të tregojmë që na e mësojnë të njëjtin parim? Shfaqja e një materiali filmik që e përshkruan Shpëtimtarin duke u shërbyer të tjerëve (të tillë si "Ndriçoje Botën – Ndiqeni Shembullin e Jezu Krishtit" te kanali Mormon Albanian në Youtube), mund të çojë te një diskutim i mënyrës se si mund ta ndjekim shembullin e Tij të "shërbimit të ndërthurur me dashurinë dhe sakrificën".

Henri B. Ajring, *"Gratë dhe të Mësuarit e Ungjillit në Shtëpi"*

Fragmente të shkrimeve të shenjta dhe citime nga "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës" që Presidenti Ajring i përdor në mesazhin e



tij, japin ide rreth rëndësisë së ndikimit të grave në shtëpi. Anëtarët/et mund të punojnë së bashku për t'i gjetur këto fragmente e citime dhe për të diskutuar atë që mësojnë. Çfarë ftesash na drejton Presidenti Ajring? Çfarë premtimesh bën ai? Merreni parasysh mënyrën se si mund ta përforcojë diskutimin nëse këndonin ose lexoni një himn rreth shtëpisë, të tillë si "Parajs' mund t'Jet' Shtëpia" (*Himne*, nr. 193).

Dallin H. Ouks, "Prindërit dhe Fëmijët"

Teksa përgatiteni të jepni mësim, merreni parasysh se cila pjesë e mesazhit të Presidentit Ouks është më domethënëse për njerëzit në kuorumin ose Shoqatën tuaj të Ndhimës. Ja disa pyetje të mundshme që mund t'i bëni për ta nxitur diskutimin rreth këtij mesazhi: Si veprojnë kundër planit të Atit Qiellor prirjet bashkëkohore të përmendura në mesazhin e Presidentit Ouks te pjesa I? Çfarë shembujsh të grave besnike mund të tregojmë, që përfaqësohen nga thëniet rreth grave te pjesa II? Si mund t'i nxitim të rejtat që njohim, që ta ndjekin këshillën e veçantë të Presidentit Ouks për to te pjesa III?

Rasëll M. Nelson, "Pjesëmarrja e Motrave në Mbledhjen e Izraelit"

Nëse jepni mësim në Shoqatën e Ndhimës, merreni parasysh t'i ndani motrat në katër grupe dhe kërkoni secilit grup të lexojë rreth

njëres prej katër ftesave në mesazhin e Presidentit Nelson. Grupet mund të diskutojnë se çfarë u bën përshtypje atyre rreth ftesës, përvojave që kanë pasur kur vepruan sipas saj, dhe ideve rreth mënyrës se si të veprojnë në të ardhmen. Më pas secili grup mund t'u tregojë të gjithave se për çfarë folën. Nëse u jepni mësim mbajtësve të priftërisë, ju mund t'u kërkoni të gjejnë thënie në mesazhin e Presidentin Nelson që tregojnë se si ndihet Ati Qiellor rreth bijave të Tij. Çfarë mund të bëjmë që ta mbështetim e nxitim pjesëmarrjen e motrave në mbledhjen e Izraelit?

M. Rasëll Ballard, "Vegimi i Shëlbimit të të Vdekurve"

Ju mund t'i ftoni anëtarët/et ta pranojnë ftesën e Presidentit Ballard dhe të lexojnë Doktrinën e Besëlidhjet 138 përpara diskutimit tuaj. Kërkoni anëtarëve/eve të tregojnë gjatë mbledhjes përvojat e tyre me këtë seksion dhe me idetë në atë seksion. Pyetje si këto mund t'i ndihmojnë anëtarët/et ta kuptojnë rëndësinë e kësaj zbuluese: Si na sjell ngushëllim kjo zbuluese? dhe Çfarë të vërtetash përmban kjo zbuluese që mund të ndikojnë te 'mënyr[a] se si e jetojmë jetën çdo ditë?

Boni H. Kordën, "Të Bëhesh Bari"

Që t'i ndihmoni anëtarët/et të marrin parasysh mënyra se si mund t'i përmirësojnë përpjekjet e tyre të dhënies së shërbesës, ju mund t'i

ndani në tri grupe dhe t'i kërkoni secilit grup të lexojë njëren prej tri pjesëve të titulluara të mesazhit të Motrës Kordën. Ftojini të tregojnë parimet që mësuuan për dhënien e shërbesës. Si mund të na ndihmojë përpjekja e fortë për t'i ndjekur këto parime që të "bëhemi barinj të Zotit ka nevojë që ne të bëhemi"? Ftojini anëtarët/et të tregojnë përvoja kur dhënia e shërbesës nga dikush tjetër i ndihmoi të ndiejnë se Shpëtimtari i njeh dhe i do.

Xhefri R. Holland, "Shërbesa e Pajtimit"

Ju mund ta filloni një diskutim rreth mesazhit të Plakut Holland duke i ftuar anëtarët/et të mendojnë rreth një marrëdhënieje në jetën e tyre që ka nevojë për shërim ose pajtim. Më pas mund ta hetojnë mesazhin e Plakut Holland, duke kërkuar mënyrën se si Bred dhe Pem Boueni ishin në gjendje ta ndihmonin atin e tyre që të shërohej. Çfarë bekimesh erdhën nga kjo përpjekje? Çfarë idesh fitojnë anëtarët/et që mund t'i ndihmojnë për t'i shëruar vetë marrëdhënien e tyre?

Nil L. Andersen, "Të Plagosur"

Për ta paraqitur mesazhin e Plakut Andersen, ju mund të lexoni së bashku te Lluka 10:30–35 ose të shihni materialin filmik "Parable of the Good Samaritan" ["Shëmbëlltira e Samaritanit të Mirë"] (LDS.org). Ku ngjasojmë ne të gjithë me burrin që ra në duart e kusarëve? Sipas Plakut Andersen, në çfarë kuptimi Jezu Krishti është "Samaritani ynë i Mirë"? Si mund ta pranojmë shërimin e Tij? Ndoshta mund t'i ftoni anëtarët/et të tregojnë mënyra në të cilat Shpëtimtari i ka shëruar plagët e tyre ose plagët e njerëzve të tyre të dashur. Ata mund të kërkohen edhe fjalët e Plakut Andersen për të gjetur një mesazh nxitës që mund t'ia japin dikujt që është i plagosur.

Rasëll M. Nelson, "Emri i Saktë i Kishës"

Jezu Krishti ka urdhëruar që Kisha të quhet sipas emrit të Tij. Ju mund t'i ndihmoni anëtarët/et ta rritin dëshirën e tyre për ta ndjekur këtë udhëzim duke i ftuar të hetojnë mesazhin e Presidentit Nelson, duke kërkuar arsyet përse "emri i Kishës nuk është i diskutueshëm". Më pas ftojini të kërkohen në fund të mesazhit të Presidentit Nelson



për premtimet që ai tha se do të na vijnë kur punojmë për ta "rivendosur emrin e saktë të Kishës së Zotit". Çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar në këtë përpjekje?

Henri B. Ajring, *"Përpiquni, Përpiquni, Përpiquni"*

Presidenti Ajring ngre "dy pyetje vendimtare": "Çfarë duhet të jem duke bërë për të marrë emrin e [Shpëtimtarit] mbi vete?" dhe "Si do ta di se kur po bëj përparim?" Ndoshta mund t'i shkruani këto pyetje në tabelë dhe t'i ftoni anëtarët/et që të japin ide që i fitojnë rreth këtyre pyetjeve nga mesazhi i Presidentit Ajring dhe shembulli i Motrës Ajring. Presidenti Ajring gjithashtu i drejtohet këngës "I'm Trying to Be like Jesus" ["Përpiqem t'Jem si Jezusi"] (*Children's Songbook*, f. 78–79). Çfarë i shtojnë diskutimit fjalët e kësaj kënge?

Dejll G. Renland, *"Zgjidhni Sot"*

Anëtarët/et mund të mendojnë për dikë që do të donin ta nxitnin të ndjekë planin e Atit Qiellor, të tillë si një pjesëtar i familjes ose dikush të cilit i japin shërbesë. Më pas ata mund të shqyrtojnë mesazhin e Plakut Renland për të zbuluar se çfarë ndiejnë për ne Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Si na ndihmojnë Ata që të zgjedhim bindjen? Çfarë sugjeron shembulli i Tyre rreth mënyrës se si mund t'i përmirësojmë përpjekjet tona në familjet tona dhe në dhënien e shërbesës sonë?

Geri E. Stivenson, *"Kujdestaria si Një Bari për Shpirtrat"*

Njerëzit të cilëve u jepni mësim, mund të kenë bërë një pyetje si kjo nga mesazhi i Plakut Stivenson: "Nga e dimë se po japim shërbesë sipas mënyrës së Zotit?" Ata mund të përfitojnë nga diskutimi i përgjigjeve të mundshme për këtë pyetje që i gjejnë në këtë mesazh. Ose përndryshe mund të sillni një figurë të Shpëtimtarit si bari (shih *Libri i Figurave Artistike të Ungjillit* [2009], nr. 64) dhe ftojini anëtarët/et të tregojnë një të vërtetë nga mesazhi i Plakut Stivenson që e përfaqëson figura. Më pas anëtarët/et mund të tregojnë gjëra që kanë pasur mbresa t'i bëjnë si rrjedhojë e diskutimit.



Mbledhjet e të Dielës së Katërt (Tetor–Dhjetor 2018)

STUDIMI VETJAK DHE FAMILJAR I SHKRIMEVE TË SHENJTA

Të dielën e katërt gjatë vitit 2018, kuorumet e pleqve dhe Shoqatat e Ndhmës do të diskutojnë studimin vetjak dhe familjar të shkrimeve të shenjta. Udhëheqësit/et ose mësuesit/et mund të zgjedhin të udhëheqin diskutime për cilindo prej parimeve vijuese.

Studimi Vetjak i Shkrimeve të Shenjta

Për t'i ndihmuar anëtarët/et që të frymëzohen për t'i studiuar rregullisht shkrimet e shenjta, merreni parasysh ta ftoni çdo anëtar/e që të përzgjedhë për ta lexuar njërin prej fragmenteve vijuese: Jozueut 1:8; 2 Timoteut 3:15–17; 1 Nefi 15:23–25; 2 Nefi 32:3; Doktrina e Besëlidhje 11:22–23; 33:16–18. Pasi të kenë pasur kohë që të lexojnë e përsiatin, mund t'i tregojnë dikujt tjetër në dhomë se çfarë u mëson fragmenti i tyre rreth studimit të shkrimeve të shenjta.

Gjithashtu mund t'i ftoni anëtarët/et të japin dëshmitë e tyre për bekimet që marrin kur i studiojnë shkrimet e shenjta. Anëtarët/et gjithashtu mund të përfitojnë kur dëgjojnë njëri-tjetrin duke treguar atë

që bëjnë për ta bërë domethënës studimin vetjak të shkrimeve të shenjta (shih disa shembuj tek "Ide për ta Përmirësuar Studimin Tuaj Vetjak të Shkrimeve të Shenjta" në materialin burimor *Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet*). Ju gjithashtu mund t'u tregoni anëtarëve atë që dha mësim Plaku Kuentin L. Kuk për "qëllimet dhe bekimet e lidhura me [përshtatjet në programin mësimor të së dielës] dhe ndryshime të tjera të kohëve të fundit" (shih "Kthimi i Thellë dhe Afatgjatë në Besimin tek Ati Qiellor dhe Zoti Jezu Krishti", *Liahona*, nëntor 2018). Anëtarët/et mund të diskutojnë se si përpjekjet tona për ta përmirësuar studimin tonë të shkrimeve të shenjta mund të ndihmojnë për t'i përmbushur këto qëllime. Videot vijuese te LDS.org gjithashtu mund

t'i frymëzojnë anëtarët: "Words with Friends" ["Fjalë me Miqtë"], "The Blessings of Scripture" ["Bekimet e Shkrimit të Shenjtë"], "Daily Bread: Pattern" ["Buka e Përditshme: Modeli"] dhe "What Scriptures Mean to Me" ["Çfarë Domethënieje Kanë Shkrimet e Shenjta për Mua"].

Vazhdueshmëria në Studimin e Ungjillit

Plaku Dejvid A. Bednar e krahasoi studimin e vazhdueshëm familjar të shkrimeve të shenjta dhe zakone të tjera të drejta me gjurmët e vogla të penelit të cilat krijojnë një pikturë të bukur. Për t'i ndihmuar anëtarët ta kuptojnë atë që dha mësim Plaku Bednar, ndoshta ju mund të paraqitni një pikturë në të cilën janë të dukshme gjurmët e penelit të artistit. Anëtarët/et më pas mund të lexojnë analogjinë e Plakut Bednar, që gjendet te biseda "Më të Zellshëm dhe më të Përfshirë në Shtëpi" (*Liahona*, nëntor 2009, f. 19–20), dhe të diskutojnë se si gjurmët e penelit në këtë pikturë janë të ngjashme me studimin e shkrimeve të shenjta. Çfarë na ka ndihmuar t'i kapërcejmë pengesat për studimin e vazhdueshëm të ungjillit, nëse po studiojmë qoftë si individë apo me familjet tona? Çfarë u premtoi Presidenti Rasëll M. Nelson atyre që "punojnë" me zell për ta shndërruar shtëpinë [e tyre] në një qendër të të mësuarit të ungjillit? (Shih "Të Bëhemi Shenjtorë Shembullorë të Ditëve të Mëvonshme", *Liahona*, nëntor 2018). Jepuni kohë anëtarëve/eve që të përsiatin dhe tregojnë atë që frymëzohen të bëjnë për shkak të asaj që mësuan sot.

Diskutimet e Ungjillit në Shtëpi dhe në Kishë

Një mënyrë se si t'i ndihmoni anëtarët/et që ta kuptojnë rëndësinë e diskutimeve për temat nga ungjilli në shtëpi dhe kishë, mund të jetë t'i ftoni një fëmijë dhe një prind të këndojnë "Mësom' të Eci në Drit" (*Himne*, nr. 199). Çfarë na mëson rreth të mësuarit të ungjillit ndërveprimi midis fëmijës dhe prindit në fjalët e kësaj kënge? Ndoshta disa anëtarë/e do të jenë të gatshëm/e të shprehin mendimet e tyre për mënyrën se si t'i bëjnë diskutimet e ungjillit një pjesë të natyrshme dhe të rregullt të jetës familjare. Shkrimet e shenjta vijuese mund të japin ide: Ligji i Përtërirë 11:18–20; 1 Pjetër 3:15; Mosia 18:9; Moroni 6:4–5, 9; Doktrina e Besëlidhje 88:122. Si mund të na sjellin më pranë Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit diskutimet tona në shtëpi dhe në kishë?

IDE PËR PËRFORCIMIN E STUDIMIT TË SHKRIMEVE TË SHENJTA NË SHTËPI GJATË VITIT 2019

Gjatë vitit 2019 të gjithë anëtarët e lagjeve do të studiojnë Dhiatën e Re – në shtëpi, në Shkollën e së Dieles dhe në Fillore. Në mbledhjet e kuorumit dhe Shoqatës së Ndhmës, udhëheqësit/et dhe mësuesit/et duhet t'i kujtojnë anëtarët/et rreth shkrimeve të shenjta të planifikuara për javën e ardhshme tek Eja, Më Ndiq – Për Individët dhe Familjet që të mund t'i studiojnë në shtëpi. Ky kujtues i thjeshtë mund të bëhet me shkrim, gojarisht ose në të dyja mënyrat.

Udhëheqësit dhe mësuesit e kuorumit të pleqve dhe udhëheqëset dhe mësueset e Shoqatës së Ndhmës mund ta nxitin këtë studim të shkrimeve të shenjta me anë të gjetjes së mundësive për të sjellë ide nga Dhiata e Re në mbledhjet e kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhmës. Për shembull, udhëheqësit dhe mësuesit e kuorumit të pleqve dhe udhëheqëset dhe mësueset e Shoqatës së Ndhmës mund:

- Të vënë re se si historitë ose doktrina nga studimi i tyre i shkrimeve të shenjta gjen zbatim për një mësim të kuorumit të pleqve ose Shoqatës së Ndhmës. Udhëheqësit/et dhe mësuesit/et mund ta japin këtë ide në një mbledhje të së dieles.
- T'u tregojnë anëtarëve/eve se si historitë ose doktrina nga Dhiata e Re gjejnë zbatim për përgjegjësitë e tyre në kuorumin e pleqve ose në Shoqatën e Ndhmës.
- T'u tregojnë anëtarëve/eve përvoja pozitive që i kanë pasur me studimin e Dhiatës së Re në shtëpi dhe t'i nxitin anëtarët/et që gjithashtu t'i tregojnë këto përvoja.





“Zoti dhe Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, nëpërmjet dhuratës së pamatshme të Shlyerjes së Tij, jo vetëm që na shpëton nga vdekja dhe na ofron falje për mëkatet tona nëpërmjet pendimit, por Ai gjithashtu rri gati për të na shpëtuar nga pikëllimet dhe dhembjet e shpirtrave tanë të plagosur.

Shpëtimtari është Samaritani ynë i Mirë, i dërguar për të ‘shëruar ata që e kanë zemrën të thyer’ [Lluka 4:18]. Ai vjen te ne kur të tjerët na anashkalojnë. Me dhembshuri, na vë balsamin e Tij shërues mbi plagë dhe na i lidh ato. Ai na mban në krahë. Ai kujdeset për ne. Ai na grish: ‘[Ejani] tek unë . . . dhe unë do t’[ju] shëroj’ [3 Nefi 18:32].”

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Të Plagosur”, f. 84–85.

Samaritani i Mirë,
nga Annie Henrie Nader



“Programi i ri dhe i harmonizuar mësimor, i përqendruar te shtëpia dhe i përkrahur nga Kisha, ka fuqinë ta çlirojë forcën e familjeve, teksa secila familje vijon me vetëdije dhe me kujdes që ta shndërrojë shtëpinë e vet në një shenjtërore besimi”, tha Presidenti Rasëll M. Nelson gjatë sesionit përmbyllës të Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetore të 188-të të Kishës. “Ju premtoj që, teksa ju punoni me zell për ta shndërruar shtëpinë tuaj në një qendër të të mësuarit të ungjillit, me kalimin e kohës, ditët *tuaja* të Shabatit, me të vërtetë do të jenë një kënaqësi. Fëmijët *tuaj* do të ngazëlleshin që do t’i mësojnë dhe jetojnë mësimet e Shpëtimtarit dhe ndikimi i kundërshtarit në jetën *tuaj* dhe në shtëpinë *tuaj* do të pakësohet. Ndryshimet në familjen tuaj do të jenë thelbësore dhe mbështetëse.”

KISHA E
Jezu Krishtit
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME